

2024

RAPORTI VJETOR

PËR REVIZIONET E KRYERA DHE PUNËN E
ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION



RAPORTI VJETOR

PËR REVIZIONET E KRYERA DHE PUNËN E ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION

PËR VITIN **2024**

Titulli original:

Годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија за 2024 година

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

Botues:

Enti Shtetëror i Revizionit – Shkup
Rruga Pavel Shatev nr. 2,
Pallati Emanuel Çučkov, Shkup

657.6(497.7)"2024"(047.31)

Për botuesin:

mr. Maksim Acevski, Kryerevizori shtetëror

ГОДИШЕН извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија за 2024 година / [уредник Максим Ацевски]. - Скопје:

Државен завод за ревизија, 2025. - 284 стр. : илустр. ; 30 см

Redaktor:

mr. Maksim Acevski, Kryerevizori shtetëror

Фусноти кон текстот

Shtypi:

Shoqëria për aktivitetin e shtypjes grafike, tregtinë, prodhimin dhe shërbimet GETEO print Pero SHPKNJP eksport - import - Shkup

ISBN 978-608-5006-09-0

Përpunimi kompjuterik dhe teknik:

Jana Sajkovska Dimitrievski, Nadica Donevski, Vesna Bogdanovic, Elena Dogazanska

а) Државен завод за ревизија (Скопје) -- 2024 -- Извештаи

COBISS.MK-ID 66135301

Албански јазик**Përkthim maqedonisht-shqip:**

Sefedin Rexhepi

Viti:

2025

Tirazh:

200 kopje

Vendi i botimit:

Shkup



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Zbatuar nga:



Ky publikim është përgatitur në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), projekt i Qeverisë së Zvicrës nën patronazhin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. PSP zbatohet nga Instituti Nacional Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve (QMP). Përmbytja e këtij publikimi nuk mund të konsiderohet, në asnjë mënyrë, se pasqyron pikëpamjet e SDC.

PËRMBAJTJA

1.	PËR ENTIN SHETËTOR TË REVIZIONIT	17
1.1.	KORNIZA JURIDIK	22
1.2.	DOKUMENTET DHE AKTIVITETET STRATEGJIKE DHE VJETORE	23
1.3.	DOKUMENTET METODOLOGJIKE DHE ZBATIMI I PRAKTIKAVE TË MIRA	39
1.4.	PEER REVIEW I ENTIT SHETËTOR TË REVIZIONIT	40
2.	KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI ME PALËT E INTERESUARA	41
2.1.	KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA NË PUNË	42
2.2.	BASHKËPUNIMI ME KUVENDIN, ORGANET SHETËTORE, ASOCIACIONET DHE INSTITUCIONET PROFESIONALE, ORGANIZATAT CIVILE DHE PUBLIKUN E GJERË	46
2.3.	BASHKËPUNIMI ME ORGANET KOMPETENTE PËR REVIZIONET DHE EFEKTET E TYRE	53
2.4.	KONTRIBUTI I ESHR-SË NË STRATEGJINË NACIONALE TË ZHVILLIMIT 2024-2044	54
3.	KAPACITETET ADMINISTRATIVE	56
3.1.	STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE	57
3.2.	RRITJA E NJOHURIVE DHE AFTËSIVE TË REVIZORËVE SHETËTORË	58
3.3.	BURIMET E TI-SË	62
3.4.	MJETET FINANCIARE PËR PUNËN E ESHR-SË	64
3.5.	ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE MBROJTJA E MJEDISIT JETËSOR	67
4.	BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	68
4.1.	BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	69
4.2.	AKTIVITETET E PROJEKTIT	86
4.3.	INTEGRIMI NË BE	92
5.	REVIZIONET E KRYERA	93
5.1.	VLERA E SHTUAR E REVIZIONEVE	102
5.2.	REVIZIONET E RREGULLSHMËRISË (REVIZIONET E RAPORTEVE FINANCIARE DHE REVIZIONET E PAJTUESHMËRISË)	104
5.2.1.	BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	104
5.2.2.	GJYQËSORI DHE SUNDIMI I SË DREJTËS	126

5.2.3.	TRAFIKU, TRANSPORTI DHE KOMUNIKIMET	129
5.2.4.	CILËSIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE GRUMBULLIMI, SHPENZIMI DHE SHFRYTËZIMI I MJETEVE DHE BURIMEVE PUBLIKE	136
5.2.5.	ARSIMI	139
5.2.6.	VEPRIMTARITË KOMUNALE PUBLIKE	143
5.2.7.	VETËQEVERISJA LOKALE DHE ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL	147
5.2.8.	PARTITË POLITIKE DHE PROCESET ZGJEDHORE	151
5.2.9.	SIGURIA DHE MBROJTJA SHETËTORE	156
5.2.10.	MEKANIZMAT E KONTROLLIT DHE FUNKSIONIMI I TYRE NË SISTEMIN SHETËTOR	159
5.2.11.	EKONOMIA	164
5.2.12.	AGJENCIA PËR PROMOVIMIN DHE MBËSHETJETEN E TURIZMIT	170
5.2.13.	SISTEMI SHËNDETËSOR	177
5.2.14.	KULTURË DHE SPORT	183
5.2.15.	PUNË DHE POLITIKË SOCIALE	195
5.3.	REVIZIONET E SUKSESIT DHE REVIZIONET E PAJTUESHMËRISË	203
5.3.1.	INTELIJENCA ARTIFICIALE	203
5.3.2.	SISTEMET E TI-SË DHE SIGURIA DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE	205
5.3.3.	PUNË DHE POLITIKË SOCIALE	213
5.3.4.	VETËQEVERISJA LOKALE DHE ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL	224
5.3.5.	CILËSIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE GRUMBULLIMI, SHPENZIMI DHE SHFRYTËZIMI I MJETEVE DHE BURIMEVE PUBLIKE	227
5.3.6.	GJYQËSORI DHE SUNDIMI I SË DREJTËS	232
5.3.7.	TRAFIKU, TRANSPORTI DHE KOMUNIKACIONI	234
5.3.8.	SISTEMI SHËNDETËSOR	244
5.3.9.	QËLLIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË OKB-SË - AGJENDA 2030 DHE MJEDISI I SHËNDETSHËM JETËSOR	248
6	DOBËSITË SISTEMORE	257
7	RAPORTET FINANCIARE TË ENTIT SHETËTOR TË REVIZIONIT DHE RAPORTI I REVIZORIT TË PAVARUR	265
	SHKURTESAT E PËRDORURA	282



TË NDERUAR,

Në duart tuaja ndodhet Raporti Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024 – dokument që përfaqëson kulmin e përkushtimit tonë, profesionalizmit dhe vendosmërisë së palëkundur për llogaridhënie, transparencë dhe interes publik. Ky raport është rezultat i investimit të vazhdueshëm në njohuritë dhe aftësitë e punonjësve tanë, entuziazmin dhe punën jo egoiste të tyre. Ai përfaqëson jo vetëm një përmbledhje faktesh dhe shifrash, por edhe një dëshmi për misionin tonë – të jemi gardian të interesit publik dhe shembull i integritetit institucional.

Gjatë vitit 2024 kemi zbatuar me sukses Programin Vjetor të Punës, me të cilën janë përfshirë 88 revizione. Si rezultat i punës sonë, kemi konstatuar 1.240 gjetje dhe çështje të rëndësishme dhe kemi dhënë 882 rekomandime, të përfshira në 132 raporte të revizionit. Këto dokumente nuk janë vetëm shënime administrative – ato paraqesin pasqyrë reale të funksionimit të institucioneve, reflektojnë gjendjen e sistemeve dhe ofrojnë një udhërrëfyes të qartë për përmirësim.

Jemi veçanërisht krenarë për revizionet tona të suksessit, të cilat mbuluan fusha kritike si: objektivat për zhvillim të qëndrueshëm, barazinë gjinore, shërbimet shëndetësore, sigurinë në trafik, partneritetin publiko-privat, digjitalizimin, inteligjencën artificiale dhe shumë të tjera. Besojmë se me këto revizione kemi ofruar pasqyrë objektive, kemi nxitur debatin publik dhe kemi dhënë udhëzime të qarta për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve tanë.

Njëkohësisht, me rekomandimet tona ne treguam mënyra të veprimit për organet kompetente, me qëllim arritjen e një efikasiteti, efektiviteti dhe drejtësie më të madhe. Punuam edhe në miratimin e Planit Vjetor për parandalimin e korrupsionit dhe Planit për përmirësim të vazhdueshëm profesional – sepse besojmë se njohuria është mjete më i fuqishëm që posedojmë.

Me krenari të veçantë theksojmë faktin se edhe këtë vit, Enti Shtetëror i Revizionit mbajti vendin e parë në Sistemin Kombëtar të Integritetit, sipas të dhënave të KSHPK-së. Kjo njohje konfirmon edhe një herë profesionalizmin, ndershmërinë dhe etikën e punonjësve tanë, si dhe kontributin tonë të vazhdueshëm në forcimin e besimit publik.

Në vitin 2024, ne zgjeruam fushëveprimin e revizioneve të të ardhurave dhe shpenzimeve publike, duke siguruar vlerë të shtuar të

konsiderueshme – nëpërmjet përcaktimit të detyrimeve papaguara publike dhe inicimit të veprimeve konkrete në interes të buxhetit të shtetit dhe komunave. Puna jonë nuk është vetëm një shifër – ajo është ndikim, ndryshim, përmirësim.

Edhe pse me vite sugjerojmë te dobësitë sistemore, mbetemi zëri që insiston për ndryshime dhe zgjidhje. Besojmë fort se ndikimi ynë është kyç në avancimin e rregullativës dhe krijimin e mjedisit ligjor dhe institucional të volitshëm për zhvillim.

Duke mbajtur parimet e INTOSAI – P12 dhe P20, si dhe Strategjinë tonë të Komunikimit, në vitin 2024 vendosëm standarde të reja për llogaridhënie dhe transparencë. Me 221,718 vizita në faqen tonë të internetit dhe mbi 500,000 vizitorë në faqen tonë në Facebook, kemi krijuar një lidhje të fortë me publikun, duke dëshmuar se revizioni është i gjallë, i hapur dhe i rëndësishëm për çdo qytetar.

Veçanërisht e rëndësishme ishte edhe bashkëpunimi ynë me Prokurorinë Publike, duke siguruar zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete në komunikimin mes prokurorëve publikë dhe revizorëve shtetëror/ të autorizuar. Besojmë se kjo qasje është një model për bashkëpunim institucional që sjell rezultate.

Në plan ndërkombëtar, pjesëmarrja jonë në aktivitetet e INTOSAI dhe EUROSAT, si dhe bashkëpunimet bilaterale, e pozicionojnë institucionin tonë si një partner të respektuar dhe të barabartë në skenën evropiane dhe botërore të revizionit.

Pas gjithë këtyre rezultateve qëndron një ekip ekspertësh, profesionistësh të motivuar dhe të përkushtuar - punonjësit tanë, si dhe mbështetja e ekspertëve dhe donatorëve vendas dhe ndërkombëtarë, të cilëve u shprehim mirënjohjen tonë të madhe.

Të ardhmen e Entit Shtetëror të Revizionit e shohim përmes prizmes së pavarësisë, inovacionit dhe integritetit. Do të vazhdojmë me aktivitetet për realizimin e qëllimeve strategjike, forcimin e kapaciteteve dhe zbatimin e aktiviteteve të dakorduara me Kuvendin – me një qëllim të qartë: roli i vërtetë i revizionit në procesin demokratik.




DHE NË FUND, DO TË THEM SE INVESTIMI NË NJOHURITË DHE AFTËSITË E BURIMEVE NJERËZORE MBETET PARIMI YNË UDHËHEQËS, SEPSE KJO ËSHTË NJË INVESTIM QË GJITHMONË SHPËRBLEHET – PËR INSTITUCIONIN, PËR SHTETIN DHE MË SË SHUMTI PËR QYTETARËT.

Kryerevizori shtetëror
mr. Maksim Acevski

REZULTATET KYÇE NGA PUNA E ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT

në 000 denarë



PROGRAMI VJETOR I PUNËS SË ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT PËR VITIN 2024



TEMAT E
PËRFSHIRA ME
REVIZIONET

88

REVIZIONET E KRYERA

72

Revizione të rregullshmërisë

10

Revizione të suksesit

4

Revizione të TI-së


2

Revizione të pajtueshmërisë

QËLLIMET PËR ZHVILLIMIN E
QËNDRUESHËM TË
PËRFSHIRA ME REVIZIONET



REVIZIONET PËRMES NUMRAVE




TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË REVIDUARA


GJITHSEJ **451.728 MILION DENARË** të ardhura publike të reviduara dhe **227.777 MILION DENARË** shpenzime publike të reviduara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2024

	Të ardhurat publike të reviduara	Shpenzimet publike të reviduara
Buxheti Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut	264.348 203.174	59.574 15.619
Buxhetet e fondeve	149.216 135.804	145.363 129.629
Buxhetet e njëjësive të vetëqeverisjes lokale	4.073 5.243	3.760 4.888
Shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së	3.386 1.730	3.360 1.720
Partitë politike dhe pjesëmarrësit në fushatat zgjedhore	1.276 19	1.067 19
Ndërmarrjet publike	1.381 14.681	1.534 10.947
Ndërmarrjet dhe institucionet e tjera publike / Personat juridikë në të cilat shteti është aksionar dominues	4.693 1.523	4.811 1.539
Të përfshira me Revizionet e Suksesit	23.355 2.851	8.302 181.154
Të përfshira me Revizionet e Pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizioneve	0 0	3 50.446


2024



2023



2022



HUAMARRJE ME KREDI/GRANTE

të përfshira me revizionin e Buxhetit themelor për vitin **2023**

PASQYRË E HUAMARRJES ME HUA/GRANTE, MJETET E PËRGJITHSHME TË TËRHEQURA DHE TË PATËRHEQURA DHE SHPENZIME PËR PROVIZION TË MJETEVE TË PATËRHEQURA PËR PROJEKTET RRJEDHËSE, NGA INSTITUCIONET KOMPETENTE, ME GJENDJE 31.12.2023

000 denarë

							Dinamika e realizimit, në përputhje me periudhën e huamarrjes me hua/grant
Ministria e Financave	3.068.601	277.049	2.791.551	9%	91%	8.266	2 projekte nga viti 2021 dhe 2023 me dinamikë të rregullt të realizimit
Ministria e Transportit dhe Lidhjes	8.498.609	4.171.167	4.327.442	49%	51%	36.588	2 projekte nga vitet 2019-2023 me dinamikë të rregullt të realizimit dhe 1 projekt nga viti 2019 me dinamikë të ngadalhtë të realizimit
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	6.456.975	0	6.456.975	0%	100%	0	2 projekte nga vitet 2022 dhe 2023 me dinamikë të ngadalhtë të realizimit
Ministria e Shëndetësisë	1.656.519	830.183	826.336	50%	50%	0	1 projekt nga viti 2015, i cili ka shënuar ngecje
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	2.613.538	1.406.994	1.206.544	54%	46%	21.719	2 projekte nga vitet 2018 dhe 2020 me dinamikë të rregullt të realizimit
Ministria e Drejtësisë - Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve	2.828.770	1.291.395	1.537.375	46%	54%	0	1 projekt nga viti 2010, i cili ka shënuar ngecje
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit	7.994.350	302.776	7.691.574	4%	96%	44.849	1 projekt nga viti 2019 që ka shënuar ngecje dhe 1 projekt nga vitet 2021/2022 me dinamikë të rregullt të realizimit
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	4.875.635	2.689.050	2.186.585	55%	45%	15.801	3 projekte nga vitet 2011/2022 dhe 2021 me dinamikë të rregullt të realizimit dhe 1 projekt nga viti 2019 me dinamikë të ngadalhtë të realizimit
SHA Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut	9.224.250	3.964.091	5.260.59	43%	57%	0	1 projekt nga viti 2023, me dinamikë të rregullt të realizimit
Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore - NPRRS	77.579.604	45.542.819	32.036.785	59%	41%	613.680	6 projekte nga vitet 2014-2022 me dinamikë të ngadalhtë të realizimit dhe 1 projekt nga periudha 2014/2019 që është në ngecje
NP për Infrastrukturë Hekurullorë HRMV Shkup	46.684.472	5.014.016	41.670.456	11%	89%	459.227	2 projekte nga vitet 2012 dhe 2014/2018 me dinamikë të ngadalhtë të realizimit dhe 1 projekt nga viti 2023 me dinamikë të rregullt të realizimit
SHA Elektraat e Maqedonisë së Veriut - ESM	8.571.552	1.302.939	7.268.612	15%	85%	65.226	4 projekte nga vitet 2015 - 2023 me dinamikë të rregullt të realizimit dhe 1 projekt nga periudha 2018/2019 me dinamikë të ngadalhtë të realizimit
SHA MEPSO	4.550.630	2.602.641	1.947.989	57%	43%	131.295	2 projekte nga vitet 2013 dhe 2015/2016 me dinamikë të ngadalhtë të realizimit
SHA NOMAGAS Shkup	2.559.668	0	2.559.668	0	100%	0	1 projekt nga viti 2021 me dinamikë të ngadalhtë të realizimit
M-NAV SHA SHKUP	600.806	129.227	471.579	22%	78%	3.426	1 projekt nga viti 2022 me dinamikë të ngadalhtë të realizimit
Qyteti i Shkupit	4.304.650	0	4.304.650	0	100%	0	1 projekt nga viti 2021, i cili ka shënuar ngecje
NP Ujësjellësi dhe Kanalizimi Shkup	12.039.754	922.425	11.117.329	8%	92%	0	1 projekt nga periudha 2019/2023 me dinamikë të ngadalhtë të realizimit

204.108.382

70.446.770

133.661.612

1.400.077



Institucioni kompetent



Shuma totale e huave / granteve investuese



Shuma e mjeteve të tërhequra



Shuma e mjeteve të patërhequra



% e mjeteve të tërhequra





% e mjeteve të patërhequra




Shpenzimet e provizioneve për mjetet patërhequra

Publikimi RPR në veb faqen e ESHR-së

2021-2024



Video publikimet në YouTube kanal



Video të lidhura me RPR




Video të lidhura me ESHR




Vizita në
WWW.DZR.MK

Deri vitin 2024 numri i vizituesve të faqës së internetit është rritur për **460%** ose për **4.6** herë në krahasim me vitin 2020



PROCESI I REVIZIONIT



**PËR ENTIN
SHTETËROR TË
REVIZIONIT**

01




ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) është Institucion Suprem i Pavarur i Revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili për 25 vjet ka informuar në mënyrë transparente, në kohë dhe objektive institucionet kompetente dhe publikun për gjendjet e konstatuara nga revizionet e kryera.

ESHR-ja i kryen revizionet në përputhje me parimet, standardet dhe udhëzimet e revizorit të përmbajtura në Kornizën e Publikimeve Profesionale të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI).

Pavarësia e institucionit përcaktohet me Ligjin për revizion shtetëror, i cili rregullon kompetencat e ESHR-së, përcakton një mandat të gjerë për kryerjen e revizioneve, me qasje të lirë në të gjitha informacionet e domosdoshme, dokumentacionet dhe evidencat e nevojshme për të zbatuar revizionin shtetëror.

ESHR-ja e përcakton në mënyrë të pavarur Programin Vjetor të Punës, vendos në mënyrë objektive për subjektet që janë lëndë e revizionit, si dhe për mënyrën e raportimit mbi revizionet e kryera, pa paragjykime dhe e liruar nga ndikimet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv.



25 VJET ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT



Për Entin Shtetëror të Revizionit, viti 2024 ishte vit jubilar. Në nëntor, festuam denjësisht 25 vjet të kryerjes së drejtpërdrejtë të aktiviteteve të revizorit në fushën e revizionit shtetëror si Institucion Suprem i Revizionit (ISR) i pavarur dhe autonom në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Jemi krenarë për rezultatet e arritura në periudhën e kaluar dhe vlerësimet e mira që i marrim vazhdimisht nga institucionet kompetente ndërkombëtare dhe vendase. Puna në ekip, burimet njerëzore profesionale, integriteti që ishin ndërtaur gjatë 25 viteve të fundit, transparencja dhe llogaridhënia në punën tonë i kanë dhënë dhe vazhdojnë t'i japin rezultatet e dëshiruara, lider në mbrojtjen e mjeteve publike, lider në mbrojtjen e interesave financiare të qytetarëve dhe në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Këto rezultate konfirmojnë se ESHR-ja është e përkushtuar për t'i zbatuar parimet e INTOSAI-t – P 12, duke siguruar kështu "Vlerën dhe përfitimet e ISR-së që bëjnë dallimin në jetën e qytetarëve" dhe besojmë se kemi siguruar:

- /// forcimin e llogaridhënies, transparencës dhe integritetit të organeve shtetërore dhe subjekteve të sektorit publik;
- /// demonstrimin e rëndësisë së përhershme për qytetarët, parlamentin dhe palët e tjera të interesuara dhe
- /// jemi organizatë shembullore.

25 VJET PUNË PROFESIONALE E ESHR-SË SI ISR

Institucionet e para të revizionit shtetëror u themeluan menjëherë pas vitit 1945 dhe ato pësuan një sërë reformash deri në themelimin e Entit Shtetëror të Revizionit si Institucion Suprem i Revizionit, duke ndjekur shembullin e përvojave dhe praktikave të mira evropiane.

Raporti i parë Vjetor i Punës së Entit Shtetëror të Revizionit dhe për revizionet e kryera iu dorëzua Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në vitin 2000 dhe i referohet punës së ESHR-së për vitin 1999.

Puna aktuale e ESHR-së rregullohet me Ligjin për revizion shtetëror, i miratuar për herë të parë në vitin 1997 dhe i ndryshuar dhe i plotësuar disa herë deri në vitin 2022.

Si subjekt i pavarur juridik, ESHR-ja filloi të funksionojë në fillim të vitit 1999, me 9 punonjës të cilët u morën nga Drejtoria e Revizionit Ekonomik dhe Financiar në ish-Entin e Qarkullimit Pagesor. Sot, ESHR-ja e kryen mandatin dhe funksionon e vet me 126 punonjës, nga të cilët ka kryerevizor shtetëror, zëvendëskryerevizor shtetëror, sekretar të përgjithshëm të emëruar nga kryerevizori shtetëror, 114 punonjës janë revizorë shtetërorë, 6 punonjës punojnë në mbështetjen e revizionit dhe 3 punonjës janë personel ndihmës-technik.

MISIONI

KUSH JEMI DHE ÇFARË PUNOJMË?



Detyra jonë është të zbatojmë kontrole, të ofrojmë vlerësime dhe të japim opinione nga revizionet e kryera që do të kenë vlerë të shtuar për qytetarët dhe shoqërinë.

Enti Shtetëror i Revizionit është Institucion Suprem i Revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili ka mandat për t'i kryer punët e revizionit shtetëror. Enti Shtetëror i Revizionit e kryen revizionin shtetëror të raporteve financiare, të pajtueshmërisë me rregullat ligjore dhe rregullativën, si dhe revizionin e suksesit në përputhje me kërkesat e standardeve të INTOSAI-t.

Rezultatet e punës sonë dhe mandati ynë janë në funksion të përmbushjes së nevojave dhe pritshmërive të shfrytëzuesve tanë, me qëllim të promovimit dhe sigurimit të llogaridhënies, objektivitetit dhe transparencës në mbështetje të organeve kompetente, drejt menaxhimit të mençur dhe të ndershëm të mjeteve publike.



VIZIONI

ÇFARË SYNOJMË?



Në synimet për të përmbushur misionin tonë, konsiderojmë se do të vazhdojmë të ruajmë pavarësinë, profesionalizmin, etikën dhe ndershmërinë tonë, duke i zbatuar detyrat tona në përputhje me ligjin dhe mandatin, duke siguruar promovimin e vazhdueshëm të objektivitetit dhe transparencës, duke qenë frymëzues dhe inovativë dhe duke dhënë shembullin më të mirë për mbrojtjen e interesit publik në funksion të arritjes së nivelit të lartë të besimit të opinionit.

Në drejtim të arritjes së këtyre vlerave tona, të gjithë punonjësit tanë punojnë me përkushtim si profesionistë të kualifikuar, duke i mbrojtur dhe respektuar interesat e profesionit të revizorit.



1.1

KORNIZA JURIDIKE

PAVARËSIA DHE KOMPETENCAT LIGJORE

Enti Shtetëror i Revizionit është Institucion Suprem i Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kompetencat e të cilit përcaktohen me Ligjin për revizion shtetëror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/10, 145/10, 12/14, 43/14, 154/15, 192/15, 27/16 dhe 83/18 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 122/2021 dhe 3/25) dhe ato kryhen në përputhje me standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Revizionit - INTOSAI. Përveç ligjit themelor, me ligje të veçanta nga legjislacioni nacional rregullohen çështjet e caktuara brenda kompetencës së Entit Shtetëror të Revizionit.

Për nga rëndësia e vet, veçohen dispozitat e Ligjit për buxhete në lidhje me kompetencën e ESHR-së për revizionin e Propozim-llogarisë përfundimtare të Buxhetit, Ligjit për prokurime publike në lidhje me kompetencën për revizionin e shfrytëzimit dhe shpenzimit të mjeteve për prokurimet publike nga organet kontraktuese, Ligjit për financimin e partive politike në lidhje me revizionin e raporteve financiare të partive politike, dispozitat e Kodit Zgjedhor në lidhje me revizionin e raporteve financiare të pjesëmarrësve në fushatat zgjedhore, revizionin e raporteve financiare të komunave në përputhje me Ligjin për financimin e njësisve të vetëqeverisjes lokale dhe Ligjin për vetëqeverisjen lokale, etj.

Enti Shtetëror i Revizionit është pjesëmarrës aktiv në realizimin e Programit Nacional për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) 2021–2025 për Kapitullin 3.32. Kontrolli financiar, ndërsa kontributin e vet në grupet e punës për negociata dhe kontributin në raportin mbi progresin e vendit në procesin e integritimit evropian e jep vazhdimisht në një numër të madh kapitujsh, të tilla si prokurimet publik, gjyqësori, lufta kundër korrupsionit, barazia gjinore, funksionaliteti i institucioneve demokratike dhe reforma e administratës publike.

Enti Shtetëror i Revizionit është faktor aktiv në arritjen e qëllimeve, marrjen e masave dhe zbatimin e aktiviteteve të përfshira në një nga dokumentet më të rëndësishme të programit të shtetit, Programin e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike "FINANCAT PUBLIKE SMART" 2022 - 2025¹.

Në vitin 2024, vëmendje e veçantë iu kushtua zbatimit të Udhëzimit për Njoftimin mbi Gjendjet e Konstatuara në Kryerjen e Revizionit Shtetëror për të cilat ekziston dyshimi se subjekti që është lëndë e revizionit ka kryer veprë penale, dhe në përputhje me të cilën u zbatua bashkëpunimi i vazhdueshëm me Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut në lidhje me gjendjet e konstatuara në revizionet për të cilat ekziston dyshimi bazë për kryerjen e veprës penale nga subjektet e revizionit.

Me qëllim të zbatimit të praktikave më të mira në bashkëpunimin e dy institucioneve, me mbështetjen e Fondacionit Westminster, në vitin 2024 u realizua vizita studimore e ESHR-së dhe PPRMV-së në ISR-në e Polonisë dhe Prokurorinë Publike të Polonisë.

Miratimi i propozim-amendamenteve për ndryshimin dhe plotësimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut me qëllim të vendosjes kushtetuese, përkatësisht garancisë më të lartë juridike të pavarësisë dhe autonomisë së saj, si dhe Propozim-ligjit për revizion shtetëror të përgatitur dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit, në përputhje me legjislacionin e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe praktikën e Institucioneve Supreme të Revizionit që janë anëtare të EUROSAL-t, mbeten sfida vendimtare për organet e pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ në vitin 2025.

¹ Programi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike "FINANCAT PUBLIKE SMART" 2022 - 2025 dhe Draft-Programi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2025 - 2028

1.2

DOKUMENTET DHE AKTIVITETET STRATEGJIKE DHE VJETORE

Në raportet e vlerësimeve të kryera nga organizatat ndërkombëtare relevante, si dhe në Raportin për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2023 të Komisionit Evropian lidhur me Fushën Revizioni i Jashtëm, theksohen aspektet e mëposhtme për përmirësim nga organet kompetente:

- /// përfundimi efektiv i procedurës për rregullimin e kushtetutshmërisë dhe miratimi i Ligjit të ri për revizion shtetëror me qëllim të forcimit të pavarësisë financiare dhe operative të ESHR-së, në përputhje me parimet, standardet dhe udhëzimet e INTOSAI-t;

- /// rritja e mbikëqyrjes dhe ndjekjes nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes shqyrtimit të raporteve të ESHR-së me qëllim të përmirësimit të shkallës së zbatimit të rekomandimeve.

Këto aspekte për përmirësim, si dhe prioritetet e përcaktuara në Programin e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike², të cilat i referohen ESHR-së, përmbahen në dokumentet strategjike të ESHR-së, siç janë:

1.2.1

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E ESHR-SË PËR VITET 2023 - 2027

Strategjia e Zhvillimit e ESHR-së për periudhën 2023-2027 e pasqyron perspektivën pesëvjeçare të zhvillimit të institucionit suprem të revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kjo perspektivë përkufizohet përmes 4 qëllimeve strategjike për zhvillimin e ESHR-së, përkatësisht:



² Programi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike "FINANCAT PUBLIKE SMART" 2022 - 2025 dhe Draft-Programi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2025 - 2028

³ Burimi: INTOSAI Building capacity in Supreme Audit Institutions A Guide;

1.2.2

STRATEGJIA E TI-SË E ESHR-SË PËR VITET
2023 - 2027

Në përputhje me përcaktimin për të avancuar vazhdimisht punën dhe për të rritur efikasitetin e sistemit të informacioneve, si dhe në drejtim të mbështetjes së zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Entit Shtetëror të Revizionit për vitet 2023–2027, ESHR-ja në vitin 2024 bëri revidimin e Strategjisë së TI-së së ESHR-së për vitet 2023–2027, me qëllim të përshtatjes me kushtet dhe nevojat e reja dhe zbatimin e trendeve

dhe teknologjive të reja. Strategjia e TI-së ka për qëllim të mundësojë zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e duhur të kapaciteteve të TI-së dhe sistemit të informacioneve për të ofruar mbështetje të vazhdueshme dhe cilësore për punën e ESHR-së, me qëllim të arritjes së qëllimeve strategjike të TI-së që lidhen me:

	<p>Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të integruar dhe të sigurt të TI-së së ESHR-së;</p>		<p>Përmirësimin e komunikimit digjital dhe prezantimit të rezultateve të punës së ESHR-së;</p>
	<p>Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e arkitekturës informatike dhe të komunikimit;</p>		<p>Hulumtimin, testimin dhe planifikimin e zbatimit të zgjidhjeve inovative të TIK-së;</p>
	<p>Zhvillimin dhe mbështetjen e zgjidhjeve aplikative që janë relevante me veprimtarinë e revizorit;</p>		<p>Avancimin e vazhdueshëm të aftësive digjitale përmes edukimit, certifikimit dhe trajnimeve profesionale të punonjësve.</p>

1.2.3

STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE PËR VITET
2024 - 2027

Qëndrueshmëria e procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore në Entin Shtetëror të Revizionit (ESHR) është aspekt i rëndësishëm në arritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në punë. Me Strategjinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për periudhën








2024-2027, ESHR-ja u kushton rëndësi disa fushave vendimtare që janë të domosdoshme për krijimin e mjedisit të qëndrueshëm dhe të suksesshëm të punës:

<p>1 PUNËSIMI</p> <p>Sigurimi i kushteve përkatëse të punësimit, si dhe tërheqja dhe mbajtja e personave të talentuar dhe të kualifikuar.</p> 	<p>2 KARRIERA DHE AVANCIMI</p> <p>Sigurimi i kushteve të barabarta për punonjësit për avancim dhe zhvillim në karrierë, gjë që do të kontribuojë në motivimin dhe kënaqësinë e tyre në vendin e punës.</p> 	<p>3 PËRSOSJA E VAZHDUESHME PROFESIONALE</p> <p>Inkurajimi i punonjësve për të përsosur veten dhe për të fituar aftësi dhe njohuri të reja përmes programeve të ndryshme të arsimit dhe trajnimit, të cilat do të rrisin kompetencën e tyre dhe do të përmirësojnë performancën e tyre.</p> 
<p>4 MATJA E PERFORMANCËS</p> <p>Vlerësimi i punës dhe arritjeve të punonjësve, me qëllim të ndjekjes së rregullt të produktivitetit dhe rezultateve të tyre, si dhe shpërblimin e atyre që janë të suksesshëm.</p> 	<p>5 QËNDRUESHMËRIA E MJEDISIT TË PUNËS</p> <p>Krijimi i mjedisit të punës që është pozitiv dhe që inkurajon produktivitetin, inovacionet dhe zhvillimin personal të punonjësve.</p> 	<p>6 DIGJITALIZIMI I PROCESEVE</p> <p>Integrimi i mjeteve digjitale në proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore, të cilat do t'i lehtësojnë dhe avancojnë proceset e evidentimit, trajnimit, vlerësimit dhe menaxhimit të të dhënave.</p> 

ESHR-ja i ka realizuar plotësisht aktivitetet e parashikuara në Strategjinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, gjë që konfirmohet nga treguesit për shkallën e realizimit. Deri në fund të vitit 2024, ESHR-ja kishte realizuar 100% të aktiviteteve të planifikuara, gjë që tregon suksesin dhe qëndrueshmërinë e këtij procesi. Kjo është bazë e rëndësishme për avancimin dhe mirëmbajtjen e mëtejshme të burimeve njerëzore në institucion,

si dhe për përmirësimin e funksionalitetit të përgjithshëm të saj dhe rezultateve të punës, ndërsa rritja e njohurive dhe aftësive të punonjësve të ESHR-së mbetet një nga përpjekjet kryesore të institucionit, të cilat pasqyrohen në planet vjetore për përsosjen e vazhdueshme profesionale, ndërsa realizimi i tyre prezantohet në pikën 3.2. të këtij raporti.

Niveli i realizimit të masave të përcaktuara në strategjinë për menaxhimin me burimet njerëzore për vitin 2024

REZULTATET	100% REALIZIMI	 <p>Masë e përgjithshme Analiza</p>	 <p>Masë e veçantë Punësimi</p>	 <p>Masë e veçantë Karrierë</p>
	 <p>Masë e veçantë PVP, EDUKIMI</p>	 <p>Masë e veçantë Matja e performancës së punonjësve</p>	 <p>Masa e veçantë Mjedis i qëndrueshëm i</p>	 <p>Masë e veçantë Digitalizimi</p>


1.2.4

STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË RREZIQEVE E ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT PËR VITET 2024 - 2027

Në përputhje me parimet e përcaktuara në ISSAI 140 dhe INTOSAI-P 20, Enti Shtetëror i Revizionit vazhdon edhe në vitin 2024 të zbatojë aktivitete për menaxhimin sistematik të rreziqeve që mund të ndikojnë në arritjen e qëllimeve dhe funksionimin e institucionit. Në përputhje me Strategjinë e Menaxhimit të Rreziqeve për periudhën 2024–2027, rreziqet kategorizohen në strategjike, të jashtme, operative, administrative dhe etike, me theks të veçantë në rreziqet e korrupsionit. Në këtë pjesë, Strategjia është harmonizuar me Metodologjinë për Vlerësimin e Rreziqeve të Korrupsionit dhe

Strategjinë Nacionale për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, si dhe Udhëzimin për Revizionin e Parandalimit të Korrupsionit – GUID 5270. Strategjia ofron qasje të strukturuar për identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe ndjekjen e rreziqeve, duke përdorur Regjistrin e Rreziqeve që përditësohet rregullisht.

Me këtë qasje, ESHR-ja e konfirmon fokusin e vet të vazhdueshëm në menaxhimin institucional transparent, të përgjegjshëm dhe efikas.



1.2.5

PLANI STRATEGJIK I REVIZIONIT PËR VITET
2024 - 2027

Korniza e Publikimeve Profesionale e INTOSAI-t (IFPP - The INTOSAI Framework of Professional Pronouncements) përmes publikimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (ISSAI) dhe Udhëzimeve të INTOSAI-t (GUID) i përcakton kërkesat për planifikimin strategjik dhe operativ të institucioneve supreme të revizionit.

Kërkesat për planifikimin strategjik dhe operativ të institucioneve supreme të revizionit janë në drejtim të përcaktimit të prioritetëve të ISR-ve, me qëllim të përmbushjes së mandatit të tyre ligjor dhe detyrimeve të tjera në përputhje me rregullativën dhe zbatimin e kriterëve profesionale për përzgjedhjen e fushave dhe subjekteve për revizion.

Institucionet supreme të revizionit kanë detyrimin të planifikojnë dhe zbatojnë revizione në mënyrën që do të ofrojë siguri se merren parasysh pritshmëritë e të gjithë palëve të interesuara dhe të gjitha rreziqëve të parashikueshme dhe të pritshme.

Në përputhje me Vizionin dhe Misionin e Entit Shtetëror të Revizionit, mandatin dhe qëllimet strategjike, aktivitetet e planifikimit strategjik dhe operativ janë në funksion të sigurimit dhe përmbushjes së kërkesave të komunitetit profesional për transparencë, llogaridhënie, integritet dhe objektivitet të Entit Shtetëror të Revizionit në punën e tij.

Qëllimet strategjike për revizionet për periudhën e ardhshme katërvjeçare, duke filluar nga viti 2024 deri në vitin 2027, janë përcaktuar me Vendimin për përcaktimin e qëllimeve strategjike për revizionet e Entit Shtetëror të Revizionit për periudhën 2024 - 2027 dhe për fushat prioritare për revizione sipas sektorëve që kryejnë revizion, nr. 03-905/1 nga 07.09.2023, i përgatitur në bazë të procedurave të zbatuara në përputhje me Udhëzimin për Planifikimin Strategjik dhe Vjetor të Revizioneve nr. 02 - 735/1 nga 09.07.2020 nga sektorët që kryejnë revizione në Entin Shtetëror të Revizionit dhe informacioneve të marra mbi fushëveprimin, rëndësinë dhe rreziqet, të cilat rrjedhin nga qëllimet strategjike (QS) dhe qëllimet e menjëhershme (QM) të Strategjisë së Zhvillimit të Entit Shtetëror të Revizionit për vitet 2023 - 2027.

Me Vendim, kryerevizori shtetëror i përcaktoi qëllimet strategjike për revizionet për periudhën katërvjeçare, duke filluar nga vitet 2024 - 2027, si në vijim:

- /// Dhënia e opinionit për prezantimin e vërtetë dhe objektiv të raporteve financiare dhe rezultateve të aktiviteteve financiare të subjekteve që janë lëndë e revizioneve në përputhje me Kornizën e Publikimeve Profesionale të INTOSAI-t (The INTOSAI Framework of Professional Pronouncements (IFPP), Ligjin për revizion shtetëror dhe standardet dhe parimet e pranuar të kontabilitetit;
- /// Dhënia e opinionit për shfrytëzimin me dedikim dhe të ligjshëm të mjeteve në përputhje me rregullativën ligjore pozitive - shqyrtimin e transaksioneve financiare që janë të ardhura dhe shpenzime publike;
- /// Dhënia e vlerësimit për shfrytëzimin e burimeve publike në aspektin e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të arritur;
- /// Njoftimi transparent dhe llogaridhënës mbi gjendjet e konstatuara, rekomandimet e dhëna dhe veprimet e ndërmarra/mosndërmarra nga subjektet që janë lëndë e revizionit pas kryerjes së revizioneve, si dhe iniciimi i propozimeve për përmirësimin e kornizës juridike para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, publikut dhe të gjitha palëve të interesuara;
- /// Marrja e veprimeve për të njoftuar dhe bashkëpunuar me organet kompetente në RMV, në lidhje me rreziqet, dyshimet, veprimet dhe transaksionet e paligjshme të mundshme ose të zbuluara, të cilat tregojnë mbi konfliktet e mundshme të interesave, korrupsionin dhe mashtrimin, gjatë kryerjes së revizioneve dhe lëshimit të raportit të revizorit, me qëllim të përcjelljes së veprimit të tyre të mëtejshëm;

- /// Përzgjedhja e revizioneve që do të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve publike;
- /// Përzgjedhja e revizioneve që do të kontribuojnë në rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit publik dhe rëndësisë së fushave prioritare të mjedisit jetësor dhe qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm;
- /// Përzgjedhja e revizioneve me interes publik;
- /// Përzgjedhja e revizioneve si pjesë e aktiviteteve ndërkombëtare të Entit Shtetëror të Revizionit me qëllim të rritjes së njohurive, kapaciteteve dhe aftësive të revizorëve;

- /// Vlera e shtuar nga revizionet duke ofruar rekomandime të qarta, konkrete dhe konstruktive që tregojnë dobësi ose probleme të caktuara, në drejtim të përmirësimit të gjendjeve, veçanërisht në mënyrat e menaxhimit, shfrytëzimit dhe mbikëqyrjes së mjeteve publike dhe parandalimit të korrupsionit dhe menaxhimit të rreziqeve të korrupsionit, si dhe në menaxhimin e borxhit publik dhe investimeve kapitale.

Fushat dhe prioritetet e mundshme të sektorëve që kryejnë revizion në Entin Shtetëror të Revizionit për periudhën 2024 - 2027, në përputhje me kornizën e përgjithshme të përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit të ESHR-së për vitet 2023 - 2027, në përputhje me Vendimin, si dhe në përputhje me planet strategjike të revizionit të paraqitura në nivelin e sektorëve të revizionit, janë si në vijim:

 Lufta kundër korrupsionit dhe	 Cilësia e shërbimeve publike dhe mbledhja, shpenzimi dhe përdorimi i fondeve dhe burimeve publike	 Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies	 Raportimi cilësor financiar	 Harmonizimi me rregullativën
 Mekanizmat kontrollues dhe funksionimi i tyre në sistemin shtetëror	 Borxhi publik dhe përdorimi i kredive dhe huave (menaxhimi i borxhit publik dhe investimeve kapitale)	 Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të OKB-së - Agjenda 2030 dhe një mjedis i	 Efektet e përdorimit të fondeve të BE-së dhe të institucioneve të tjera ndërkombëtare	 Sistemet e TI-së dhe siguria dhe mbrojtja e të dhënave
 Intelegjenca Artificiale (AI);	 Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut	 Siguria dhe mbrojtja shtetërore	 Partit Politike dhe Proceset Zgjedhore në RMV	 Vetëqeverisja lokale dhe zhvillimi i barabartë rajonal
 Veprimtari komunale publike	 Punë dhe Politik Sociale	 Arsim	 Kultur dhe sport	 Sistem shëndetësor
 Mjedisit Jetësor	 Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi i Ujit	 Gjyqësori dhe sundimi i ligjit	 Ekonomi	 Trafiku, transporti dhe komunikimet

Realizimi i Planit Strategjik të Revizionit për periudhën 2024-2027 do të bëhet nëpërmjet PV-së individuale për punën e Entit Shtetëror të Revizionit.

Programi Vjetor i ESHR-së për vitin 2024, në pjesën mbi kryerjen e revizioneve i përfshin revizionet e rregullshmërisë të propozuara dhe të përzgjedhura (revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e përputhshmërisë), revizionet e suksesit dhe revizionet e pajtueshmërisë bazuar në zbatimin e kriterëve të përcaktuara në përputhje me standardet profesionale të INTOSAI-t.

Me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2024 përcaktohen aktivitetet prioritare në drejtim të arritjes së qëllimeve dhe detyrave të ESHR-së, përkatësisht arritjes së qëllimeve strategjike të institucionit.

Aktivitetet e ndërmarra për të arritur qëllimet strategjike sigurojnë mbulim adekuat të mjeteve të reviduara publike, rrisin njohuritë dhe aftësitë të punonjësve, kryejnë revizionin e suksesit të programeve dhe projekteve të ndryshme që janë në funksion të arritjes së llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë, shqyrtojnë rezultatet në aspektin e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve të sektorit publik, informojnë palët e interesuara dhe publikun rreth gjendjeve të konstatuara në raportet përfundimtare të revizionit dhe përmirësojnë cilësinë e shërbimeve që sektori publik është i detyruar t'u ofrojë personave juridikë dhe fizikë.

Planifikimi vjetor i revizioneve kryhet në përputhje me dispozitat e Ligjit për revizion shtetëror, sipas të cilit detyrimisht një herë në vit bëhet revizioni i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe i buxheteve të fondeve, përfshirë Agjencinë e Punësimit, ndërsa për subjektet e tjera kryhet brenda afateve të përcaktuara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së.

Përzgjedhja e subjekteve të revizionit u krye në përputhje me nenet 22 dhe 23, paragrafi 1 të Ligjit për revizion shtetëror, Rregulloren mbi mënyrën e kryerjes së revizionit shtetëror, Udhëzimin për planifikimin strategjik dhe vjetor të revizioneve, Vendimin për përcaktimin e qëllimeve strategjike për revizionet e Entit Shtetëror të Revizionit për periudhën 2024-2027 dhe për fushat prioritare për revizionet sipas sektorëve që kryejnë revizion, Planin Strategjik të Revizionit të Entit Shtetëror të Revizionit për vitet 2024-2027, si dhe propozimet nga palët e interesuara.

Me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024 planifikohet të zbatohen 88 revizione, nga të cilat 72 janë revizione të rregullshmërisë, 13 janë revizione të suksesit dhe 3 janë revizione të pajtueshmërisë.



1.2.6

STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT E ESHR-SË PËR VITET 2024 - 2027

Enti Shtetëror i Revizionit vazhdon të forcojë proceset e komunikimit përmes Strategjisë së Komunikimit për periudhën 2024-2027, e cila synon të përfshijë në mënyrë më efektive publikun, mediat dhe sektorin civil në angazhimin e përbashkët për llogaridhënie dhe transparencë.

Si pjesë e Strategjisë, ESHR-ja vendosi regjistër të palëve të interesuara, i cili pas përditësimit të fundit numëron 2.417 kontakte, duke zgjeruar ndjeshëm rrjetin e faktorëve të informuar dhe të përfshirë. Në mënyrë plotësuese, për të lehtësuar qasjen në gjetjet e revizorit, ESHR-ja ka prezantuar abstrakte të revizorit dhe njoftime për publikun, përmes të cilave informacionet kryesore nga raportet përfundimtare të revizorit bëhen më të arritshme dhe të kuptueshme. Për raportet e caktuara vendimtare të revizorit për të cilat ESHR-ja konsideron se kërkojnë informim shtesë për publikun e gjerë, përgatit video duke përdorur Inteligjencën Artificiale, ku videoja përfshin edhe të folurit, përveç tekstit të shkruar.

Përveç komunikimit të drejtpërdrejtë me mediat dhe sektorin civil, ESHR-ja ka forcuar transparencën online - të gjitha informacionet, raportet dhe analizat e rëndësishme publikohen rregullisht në faqen e internetit (www.dzr.mk) dhe në profilin zyrtar në Fejsbuk.

Deri në fund të vitit 2024, ESHR-ja kishte realizuar 15 nga 24 aktivitetet e planifikuara. Megjithatë, 9 aktivitete mbeten të porealizuara për shkak të faktorëve të jashtëm dhe nevojës për koordinim me institucionet e tjera.

Me këto aktivitete, ESHR-ja jo vetëm që përmirëson modelin e komunikimit dypalësh, por edhe e forcon rolin e vet si faktor vendimtar në promovimin e llogaridhënies në sistemin institucional.



FUSHËVEPRIMI I STRATEGJISË

NË STRATEGJI JANË PËRKUFIZUAR DY QËLLIME STRATEGJIKE TË KOMUNIKIMIT:

QËLLIMI I PARË STRATEGJIK I KOMUNIKIMIT TONË



Për të mundësuar përfshirje më të thellë dhe gjithëpërfshirëse, me bazë strategjike të grupeve të synuara në fushën civile, në luftën e përbashkët për efikasitet më të madh, transparencë dhe llogaridhënie të aktorëve në sistemin institucional të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

QËLLIMI I DYTË STRATEGJIK I KOMUNIKIMIT TONË



T'u mundësojmë aktorëve në sistemin institucional që të njohin më qartë punën tonë si bazë për forcimin e qeverisjes së mirë, ndërsa institucionin tonë si katalizator të demokratizimit.

1

QËLLIMI SPECIFIK

T'i sjellim gjetjet tona për punën e institucioneve më afër qytetarëve dhe t'ua afrojmë misionin tonë të përgjithshëm atyre, duke forcuar nivelin e tyre të njohurive dhe besimit në institucionin tonë.

QËLLIMI SPECIFIK

Të strukturojmë dhe të intensifikojmë dialogun me Prokurorinë Publike të RMV-së për të vendosur praktikë të diskutimit të rregullt të revizorëve me prokurorët publikë rreth gjetjeve prej revizioneve tona.

4

2

QËLLIMI SPECIFIK

Të forcojmë eko-sistemin e komunikimit në të cilin zhvillohet biseda e vazhdueshme midis ESHR-së dhe aktorëve në fushën civile: gazetarët dhe aktivistët në organizatat qytetare, në mënyrë që bashkërisht të motivojmë qeverisjen e mirë me institucionet.

QËLLIMI SPECIFIK

Duke e rritur njohurinë e deputetëve dhe shërbimeve të Kuvendit për revizionin, të sigurojmë që gjetjet prej në raportet e revizorit revizorit të diskutohen rregullisht dhe sipas rëndësisë në diskutimet e komisioneve dhe seancave plenare.

5

3

QËLLIMI SPECIFIK

Të zgjerojmë fushëveprimin e komunikimit me aktorët në fushën civile që punojnë jashtë kryeqytetit dhe që ofrojnë shërbime për qytetarët e cenueshëm dhe të marginalizuar.

QËLLIMI SPECIFIK

Le të hapim dialog me Qeverinë për rëndësinë e gjetjeve të ESHR-së për ndërtimin e politikave të përgjithshme në vend.

6

Zbatimi i aktiviteteve strategjike dhe orientimi i vazhdueshëm i shërbimit të ESHR-së ndaj publikut të gjerë bënë që ESHR-ja të vlerësohet si institucioni më i mirë në sistemin nacional të integritetit, përkatësisht:

- /// Sipas Raportit të Transparency International Macedonia ⁴, ESHR-ja nga gjithsej 15 shtylla të Sistemit Nacional të Integritetit zë vendin e parë me gjithsej 86 pikë indeksi nga maksimum 100, përkatësisht 24 pikë indeksi nuk u dhanë për shkak të mosmiratimit të

Ligjit për revizion shtetëror dhe inkorporimit të ESHR-së si kategori kushtetuese - aktivitet që është jashtë kontrollit të ESHR-së, dhe

- /// - Sipas Raportit ⁵ të KSHPK-së, ESHR-ja në pjesën e zbatimit të sistemit të integritetit në organet e administratës shtetërore, organet e pavarura shtetërore dhe organet shtetërore renditet në vendin e parë me 92,3% përmbushje të detyrimeve dhe suksesit të zbatimit të sistemit të integritetit.

1.2.7.

PROGRAMI I REFORMËS SË MENAXHIMIT TË FINANCIVE PUBLIKE "FINANCAT PUBLIKE SMART" PËR VITET 2022 - 2025

Në Programin e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike "FINANCAT PUBLIKE SMART" për periudhën 2022 - 2025 i miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut përcaktohen prioritetet për revizionin e jashtëm dhe mbikëqyrjen parlamentare në kompetencë të Entit Shtetëror të Revizionit. Qëllimi i këtyre prioritetëve është:

- /// forcimi i menaxhimit të financave publike dhe sigurimi i llogaridhënies në shfrytëzimin e mjeteve publike duke forcuar kornizën juridike për revizionin e jashtëm me arritjen e pavarësisë kushtetuese të ESHR-së dhe duke forcuar pavarësinë financiare dhe operative në përputhje me parimet, standardet dhe udhëzimet e INTOSAI-t;

- /// vendosja e mekanizmit për shqyrtimin e raporteve të revizorit dhe masave të marra sipas rekomandimeve të dhëna në raportet e revizorit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe forcimi i kapaciteteve institucionale të Kuvendit për shqyrtimin e raporteve të revizorit.

Në Planin e Veprimit për Zbatimin e Programit të Reformës së Menaxhimit të Financave Publike për vitin 2024 përmbahen aktivitetet për zbatimin e masave dhe për arritjen e treguesve që u referohen prioritetëve për revizionin e jashtëm dhe mbikëqyrjen parlamentare në kompetencë të ESHR-së. Enti Shtetëror i Revizionit mori pjesë aktive edhe në përgatitjen e Programit të ri të Menaxhimit të Financave Publike për vitet 2025-2028, i cili pritet të miratohet në vitin 2025.

⁴ Sistemi Nacional i Integritetit – Vlerësimi për Republikën e Maqedonisë së Veriut, Shkup 2024;

⁵ Raporti nga ndjekja e kryer e zbatimit të Sistemit të Integritetit për vitin 2024, shkurt 2025.

1.2.8.**GRUPI SEKTORIAL I PUNËS DHE KËSHILLI I
MENAXHIMIT TË FINANCEVE PUBLIKE**

Enti Shtetëror i Revizionit merr pjesë aktive në Grupin Sektorial të Punës për Menaxhimin e Financave Publike, të kryesuar nga ministri i Financave, qëllimi i të cilit është të vendos dhe të mirëmbajë qasje sektoriale funksionale në fushën e menaxhimit të financave publike. Gjithashtu, kryerevizori shtetëror mori pjesë si anëtar në punën e Këshillit të Menaxhimit të Financave Publike, i cili është trup koordinues i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për ndjekjen e zbatimit të reformave të menaxhimit të financave publike të parashikuara nga

Programi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike. Arritja e qëllimeve strategjike të përcaktuara në dokumentet strategjike të ESHR-së kërkon miratimin e akteve në bazë vjetore për realizimin e tyre. Janë miratuar më shumë akte dhe është vendosur sistemi i ndjekjes së vazhdueshme të realizimit të akteve strategjike dhe vjetore të ESHR-së, për të cilin përgatiten raporte përkatëse në nivel gjysmëvjetor dhe vjetor.

1.2.9.**PROGRAMI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2024**

Programi Vjetor i Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024 është miratuar bazuar në Ligjin për revizion shtetëror, Rregulloren për mënyrën e kryerjes së revizionit shtetëror dhe Udhëzimin për planifikimin strategjik dhe vjetor të revizioneve, në përputhje me Vendimin për përcaktimin e qëllimeve strategjike për revizionet e Entit Shtetëror të Revizionit për periudhën 2024 - 2027 dhe për fushat prioritare për revizionet sipas sektorëve që kryejnë revizione, Planin Strategjik të revizionit të Entit Shtetëror të Revizionit për vitet 2024 - 2027, Strategjinë e Zhvillimit të Entit Shtetëror të Revizionit për vitet 2023 - 2027, Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të KB-së dhe kriteret e përcaktuara me metodologjinë e vlerësimit nga OECD-SIGMA, duke marrë parasysh burimet e disponueshme të ESHR-së.

Enti Shtetëror i Revizionit, duke ndier nevojën për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjësinë e vet në ekzekutimin e kompetencave të deleguara ligjërisht, në kuadër të

përgatitjes së Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2024, dorëzoi njoftim për dorëzimin e kërkesave/propozimeve për kryerjen e revizioneve për 1.200 palë të interesuara. Përmes shfrytëzimit të rrjeteve sociale (FB), ishte publikuar thirrja drejtuar të gjithë personave juridikë dhe fizikë të interesuar për të dorëzuar kërkesë për kryerjen e revizionit, dhe gjithashtu në faqen e vet të internetit vazhdimisht është publikuar formulari "Kërkesë për Revizion".

Nga 78 kërkesat e mbërritura, në kuadër të përgatitjes së Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2024, janë pranuar 23 kërkesa (29%) e totalit të kërkesave të marra, në përputhje me dokumentet strategjike, kriteret e përzgjedhjes të rregulluara në përputhje me standardet profesionale të INTOSAI-t, kriteret e përzgjedhjes në përputhje me Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të KB-së, kriteret e përzgjedhjes së OECD-SIGMA-së dhe burimet e disponueshme të revizionit.


Kërkesat e mbërritura dhe kërkesat e pranuar sipas llojeve të subjekteve që kanë dorëzuar kërkesa

	NJVL	Kërkesat e mbërritura	3	Kërkesat e pranuar	2
	Institucionet, organizatat civile, shoqatat dhe personat juridikë	Kërkesat e mbërritura	46	Kërkesat e pranuar	15
	Qytetarët dhe Anonimë	Kërkesat e mbërritura	29	Kërkesat e pranuar	6
			Gjithsej kërkesat e mbërritura	78	Gjithsej kërkesat e pranuar
					23

Enti Shtetëror i Revizionit ka zbatuar plotësisht Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2024. Me Programin Vjetor për vitin 2024 janë kryer 88 revizione, nga të cilat



Në kuadër të Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2024, janë zbatuar 13 revizione të suksesit, nga të cilat:




Me revizionet e suksesit në vitin 2024 janë përfshirë temat në vijim:

	Siguria në trafikun rrugor në Republikën e Maqedonisë së Veriut
	Zbatimi i Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) me vështrim të veçantë ndaj shërbimeve të specializuara për gratë viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje
	Planifikimi urbanistik i infrastrukturës së gjelbër në qytetet
	Përmirësimi dhe avancimi i shërbimeve publike dhe objekteve infrastrukturore me partneritet publiko privat
	Investimet publike për të siguruar kapacitete dhe kushte për mbrojtjen e fëmijëve në kopshte
	Shfrytëzimi i pajisjeve mjekësore moderne
	Reforma e sistemit penitenciar
	Efektet e investimeve publike në zhvillimin e barabartë rajonal
	Tranzicioni i gjelbër përmes promovimit të burimeve të rinovueshme të energjisë
	Përgatitja e Republikës së Maqedonisë së Veriut për t'u përballur me ndryshimet klimatike
	Digjitalizimi i librave të amzës
	Sistemi i Planifikimit të Integruar të Burimeve - Sistemi PIB
	Mundësitë për përdorimin e inteligjencës artificiale në sektorin publik

Revizionet e suksesit janë të lidhura plotësisht me Strategjinë Nacionale të Zhvillimit 2024-2044. Secili prej këtyre revizioneve është i lidhur edhe me qëllimet përkatëse të zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Në përputhje me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2024, u zbatuan 3 revizione të pajtueshmërisë, përkatësisht:



Fushat e mbuluara me revizionet e theksuara ofrojnë bazë për përcaktimin e mënyrës së veprimit nga organet kompetente, por në të njëjtën kohë sigurojnë kontributin aktiv të Entit Shtetëror të Revizionit duke dhënë rekomandime mbi mënyrën e veprimit të tyre, duke dhënë vlerësim për zbatimin e proceseve të reformës, duke dhënë këshilla mbi mënyrën e realizimit

të të ardhurave publike dhe shfrytëzimit të mjeteve publike, mënyrën e shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe energjensave, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe mjedisit jetësor, si dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

1.2.10.

PLANI VJETOR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT PËR VITIN 2024

Aktivitetet e Entit Shtetëror të Revizionit në lidhje me parandalimin e korrupsionit kryhen në përputhje me autorizimet dhe detyrimet e përcaktuara me Ligjin për revizion shtetëror, Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Udhëzimin për revizionin e parandalimit të korrupsionit - GUID 5270 dhe rregullativën tjetër ligjore relevante. Në drejtim të parandalimit të korrupsionit, ESHR-ja miratoi "Planin Vjetor për Parandalimin e Korrupsionit të Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024", i cili, ndër të tjera, përcakton masa dhe aktivitete për:

/// demonstrimin e vullnetit të kuadrit udhëheqës të ESHR-së për të parandaluar korrupsionin dhe konfliktin e interesave;

/// demonstrimin e etikës dhe integritetit në parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe zbatimin e Kodit të Etikës së ESHR-së në përputhje me praktikën më të mirë të ISR-ve evropiane dhe në përputhje me SNISR-të;

/// rishqyrtimin e rregullativës ligjore që lidhen me revizionin shtetëror në lidhje me parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave;

/// digjitalizimin e vazhdueshëm në kryerjen e revizionit shtetëror;

- /// llogaridhënien dhe transparencën e vazhdueshme në kryerjen e revizionit shtetëror dhe komunikimin me mediat dhe publikun e gjerë;
- /// menaxhimin e burimeve njerëzore në drejtim të edukimit dhe veprimit për të parandaluar korrupsionin dhe konfliktin e interesave;
- /// respektimin e parimeve të përcaktuara në dispozitat e Ligjit për prokurimet publike gjatë dhënies së kontratave të prokurimeve publike dhe Ligjit për buxhete gjatë ekzekutimit të planit financiar (buxhetit) për ESHR-në dhe njoftimit mbi ekzekutimin e tij;
- /// bashkëpunimin e vazhdueshëm me organet e tjera kompetente që janë të ngarkuara për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe bashkëpunimit me ISR të tjera për përdorimin e praktikave të mira;
- /// certifikimin e ESHR-së për sistemin e zbatuar për trajtimin e korrupsionit në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO 37001:2017 dhe menaxhimin e sigurisë së informacioneve në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO 27001:2017.

Realizimi i aktiviteteve të përcaktuara në Planin Vjetor ndiqet në nivel gjysmëvjetor dhe vjetor, ndërsa për shkallën e zbatimit të tyre njoftohet kryerevizori shtetëror. Nga treguesit e vendosur, mund të konkludohet se aktivitetet e Planit Vjetor ose janë realizuar plotësisht në vitin 2024 ose, për shkak të natyrës së aktiviteteve, ato janë në vazhdim, përkatësisht realizohen vazhdimisht.

1.2.11.

PLANI VJETOR PËR PËRSOSJEN E VAZHUESHME PROFESIONALE PËR VITIN 2024

Plani Vjetor i PVP-së për vitin 2024 i Entit Shtetëror të Revizionit u zbatua duke përdorur burimet e brendshme të institucionit dhe duke përdorur ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë në fushën përkatëse. Aktivitetet e dedikuara për organizimin e trajnimeve kryhen nga ESHR-ja me ndihmën e organizatave ndërkombëtare, asociacioneve profesionale, shoqatave, iniciativave ndërkombëtare, si dhe personave juridikë privatë nga vendi dhe jashtë vendit që ofrojnë edukim në më shumë fusha që lidhen me revizionin shtetëror, në (47) tema të ndryshme.

Me qëllim të marrë informacione kthyese mbi cilësinë e edukimeve të mbajtura, ESHR-ja zbaton rregullisht vlerësime të edukimeve të organizuara, të cilat kanë treguar se më shumë se 80% e punonjësve kanë ndikim pozitiv nga trajnimet e organizuara dhe se ato do të kontribuojnë në përmirësimin e punës së tyre.

Gjatë vitit 2024, u zbatuan edhe trajnime të dizajnuara posaçërisht për revizorët shtetërorë të punësuar rishtazi, me qëllim të lehtësimit të përshtatjes së tyre profesionale në mjedisin e ri të punës, duke u mundësuar njëkohësisht të fitojnë përvojë për vendin e duhur të punës përmes kryerjes së detyrave të ndryshme të revizorit, si dhe përmes pjesëmarrjes në trajnime të ndryshme. Forcimi i njohurive dhe aftësive të punonjësve të ESHR-së kryhet edhe përmes zbatimit të revizioneve paralele, ndërkombëtare të përbashkëta dhe kooperative në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të ISR-së (INTOSAI) dhe bashkëpunimit bilateral midis ESHR-së dhe ISR-ve të tjera.

U realizuan vizita studimore të punonjësve të ESHR-së në ISR të tjera, ku nëpërmjet pjesëmarrjes në seminare, punëtori dhe konferenca të organizuara në kuadër të Organizatës Ndërkombëtare të ISR-ve (INTOSAI) dhe formave të saj rajonale, Gjykatës Ndërkombëtare të Revizionit, SIGMA-së, si dhe në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare: CEF, Banka Botërore, UN Women, UNDP, Instituti Nacional për Demokraci, Fondacioni Vestminster (FVD) dhe të tjera, u rritën njohuritë dhe aftësitë e punonjësve të ESHR-së.

1.2.12.**PLANI VJETOR I SIGURIMIT TË CILËSISË PËR VITIN 2024**

ESHR-ja ka për detyrë të zbatojë kontrolle, të ofrojë vlerësime dhe të japë opinione për revizionet e kryera që do të kenë vlerë të shtuar për të gjithë komunitetin.

Rezultatet e punës dhe mandatit të ESHR-së janë në funksion të përmbushjes së nevojave dhe pritshmërive të shfrytëzuesve, me qëllim të promovimit dhe sigurimit të llogaridhënies, objektivitetit dhe transparencës në mbështetjen e shtetit, ndërsa në drejtim të menaxhimit të mençur dhe të ndershëm të mjeteve publike.

Sfida kryesore me të cilën përballen të gjitha ISR-të është ofrimi i vazhdueshëm i revizioneve me cilësi të lartë dhe detyrave të tjera. Puna cilësore e kryer nga ISR-ja ndikon në reputacionin dhe besueshmërinë e tyre, si dhe në aftësinë e tyre për të përmbushur mandatin e tyre⁶.

Funksioni i sigurimit të cilësisë së revizioneve (monitorimit) është i pavarur nga procesi i revizionit dhe është kontrolli i cilësisë së revizioneve të kryera nga persona të pavarur nga revizionet për të ofruar siguri për menaxhmentin e Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR) se cilësia e revizioneve të kryera është në nivel të pranueshëm.

Udhëzimet kryesore për realizimin e funksionit të sigurimit të cilësisë (monitorimit) në ESHR janë dhënë në Udhëzimin e Sigurimit të Cilësisë së Revizioneve nr. 01-1365/1 nga 03.10.2022 në përputhje me standardin ndërkombëtar të INTOSAI-t, ISSAI 140.

Funksioni i sigurimit të cilësisë së revizioneve (monitorimit) nga ekipi i kontrollit i punonjësve të ESHR-së pas përfundimit të revizioneve siguron: përmirësimin e punës dhe rezultateve të revizioneve të kryera, mundësinë e vetëvlerësimit të punës së kryer të revizorit, përcaktimin e nevojave të mundshme nga trajnimet e revizorëve, të cilat do të kontribuojnë në ruajtjen e shkallës së lartë të integritetit, llogaridhënies dhe kompetencës së punës së revizorit.

Në përputhje me Planin Vjetor të Sigurimit të Cilësisë për vitin 2024 dhe procedurat e përcaktuara në Udhëzimin e Sigurimit të Cilësisë së Revizioneve, kontrollet zbatohen në periudhën nga 01.03.2024 deri më 31.12.2024, duke mbuluar gjashtë (6) revizione nga Programi Vjetor i Punës së ESHR-së për vitin 2023 nga gjashtë (6) sektorë të revizionit.

Bazuar në kontrollet e kryera të cilësisë së revizioneve të zbatuara përmes procedurave dhe dokumentacionit të revizorit të anuluar në dosjen e revizorit në AMS nga anëtarët e ekipit të revizorëve, u arrit në përfundimin se revizioni u zbatua në përputhje me metodologjinë e përcaktuar të ESHR-së (doracakët, programet, pyetësorët dhe llojet e tjera të formularëve) për të gjitha revizionet që janë lëndë e kontrollit.



⁶ ISSAI 140 Quality Control for SAs

1.2.13.**RAPORTI VJETOR PËR REVIZIONET E KRYERA DHE PUNËN E ESHR-SË PËR VITIN 2023**

Raporti Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2023 është përgatitur dhe dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut brenda afatit të përcaktuar me ligj - deri në fund të qershorit 2024. Raporti është i disponueshëm publikisht në ueb-faqen zyrtare të ESHR-së në tri gjuhë: maqedonisht, shqip dhe anglisht ⁷(linku)⁸.

Në drejtim të avancimit të transparencës dhe llogaridhënies në punën e vet, Enti Shtetëror i Revizionit e vazhdoi praktikën e ndarjes aktive dhe ofrimin të qasjes në të dhënat dhe informacionet e përmbytura në Raportin Vjetor. Raporti u dorëzohet rregullisht institucioneve supreme të revizionit, Gjykatës Evropiane të Revizorëve, Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI), Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Revizionit

(EUROSAI), Delegacionit të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përfaqësive të organizatave ndërkombëtare, si dhe misioneve diplomatike të akredituara në vend.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e 14-të të mbajtur më 17 shtator 2024, e shqyrtoi dhe miratoi Raportin Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e ESHR-së për vitin 2023. Më pas, u miratuan 14 konkluzione që synojnë mbështetjen e aktiviteteve të ESHR-së, avancimin e zbatimit të rekomandimeve të revizorit, tejkalimin e dobësive dhe mospërputhjeve sistematike në rregullativën ligjore dhe nënligjore, si dhe forcimin e bashkëpunimit midis ESHR-së dhe Kuvendit.

1.3.**DOKUMENTET METODOLOGJIKE DHE ZBATIMI I PRAKTIKAVE TË MIRA**

Në vitin 2024, të inkurajuar nga nevoja për të harmonizuar aktet e brendshme metodologjike të Entit Shtetëror të Revizionit me kërkesat profesionale të INTOSAI-t - International Organization of Supreme Audit Institutions, si dhe IAS - International Accounting Standards, Enti Shtetëror i Revizionit bëri ndryshime dhe miratoi Doracak të ri dhe të përmirësuar për revizionin e rregullshmërisë me dy shtojca (shtojcat për shfrytëzuesit buxhetorë dhe për ndërmarrjet publike) në Doracakun për revizionin e raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë. Shtojcat i referohen formatit dhe përmbytjes së formularëve "Draft / Raporti Përfundimtar nga revizioni i kryer i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë" në Doracakun për revizionin e rregullshmërisë. Ndryshimet e bëra nga Enti Shtetëror i Revizionit në këtë Doracak janë në drejtim të harmonizimit të akteve metodologjike të institucionit të këtij lloji të revizionit me standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (ISSAI - International Standards of the Supreme Audit Institutions), në të gjitha fazat

e revizionit të rregullshmërisë - planifikimin, zbatimin, njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, duke i marrë parasysh kërkesat e dhëna në ISSAI, si dhe praktikën e mirë nga ISR të tjera. Gjithashtu i kushtuam vëmendje të veçantë edhe zbatueshmërisë së mundshme të disa praktikave të mira nga ISR të tjera në mjedisin e revizorëve në të cilin punon Enti Shtetëror i Revizionit.

Aktualisht, në vitin 2024, filluan edhe aktivitetet për të miratuar Udhëzimin për revizionin e suksesit të menaxhimit të investimeve publike në gjuhën angleze me përkthim në gjuhën maqedonase, të hartuar në kuadër të Projektit për forcimin e mbikëqyrjes, transparencës dhe llogaridhënies së shpenzimeve të investimeve publike "Ndhima teknike e Entit Shtetëror të Revizionit për suksesin e investimeve publike" në bashkëpunim me Ernst & Young dhe Bankën Botërore.



⁷ Raporti Vjetor 2023

⁸ https://dzt.mk/sites/default/files/dzt/doc/izvestai/Godisen_izvestaj_MKD_2023.pdf



1.4.

PEER REVIEW I ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT

Në vitin 2024, ekipi profesional i Institucionit Suprem të Revizionit të Polonisë (NIK) zbatoi kontroll profesional të cilësisë së punës (peer review) të Entit Shtetëror të Revizionit, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar reciprokisht, si dhe në përputhje me Udhëzimet INTOSAI GUID 1900, parimet, standardet dhe udhëzimet e Kornizës së Publikimeve Profesionale INTOSAI (IFPP) dhe ligjet dhe rregullativat nacionale për kryerjen e peer review.

Qëllimi kryesor i kontrollit profesional të cilësisë së punës (peer review) ishte të vlerëonte përputhshmërinë e ESHR-së me standardet ndërkombëtare, veçanërisht në lidhje me:

- /// pavarësinë,
- /// menaxhimin e burimeve njerëzore,
- /// metodologjinë e revizorit dhe
- /// komunikimin me palët e interesuara.

Konkluzioni i përgjithshëm i përmbajtur në Raportin e kontrollit profesional të cilësisë së punës (peer review) është se puna e Entit Shtetëror të Revizionit është harmonizuar me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira të institucioneve supreme të revizionit, ndërsa e vetmja mangësi është pavarësia e plotë.

Prandaj, Raporti rekomandon përpjekje të mëtejshme për t'i avancuar draft-ndryshimet e Kushtetutës dhe Ligjin e ri të propozuar për revizion shtetëror, me qëllimin përfundimtar që ato të miratohen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, si parakusht pa të cilin Enti Shtetëror i Revizionit nuk do të jetë në gjendje të ruajë progresin e arritur.

Sipas mendimit të ekipit që kreu kontrollin profesional, sfida më e madhe me të cilën përballlet ESHR-ja është mungesa e pavarësisë së plotë - mungesa e dispozitave kushtetuese që garantojnë pavarësinë, mungesa e pavarësisë financiare, si dhe statusi i punonjësve të ESHR-së si nëpunës administrativë, gjë që ndikon edhe në procedurën e punësimit.

Në të njëjtën kohë, ekipi që kreu kontrollin profesional e theksoi progresin e madh të ESHR-së në zhvillimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjike - si të përgjithshme, ashtu edhe të atyre për fushat specifike, siç janë menaxhimi i burimeve njerëzore dhe komunikimi me palët e interesuara. Dokumentet strategjike të analizuar nga ekipi i përmbushin standardet ndërkombëtare dhe janë në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Ekipi i cili e kreu kontrollin profesional konfirmoi gjithashtu se metodologjia e revizorit e aplikuar në ESHR për llojet kryesore të revizionit - financiar, të suksesit dhe të përputhshmërisë - është plotësisht në harmonizim me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (ISSAI) në të gjitha fazat e procesit të revizionit: nga planifikimi, përmes realizimit, deri te njoftimi dhe ndjekja e rekomandimeve.

Ekipi i cili e kreu kontrollin profesional u impresionua gjithashtu nga qasja moderne e ESHR-së ndaj komunikimit: strategjia e përgatitur mirë e komunikimit, rritja e vazhdueshme e pranisë në mediat, duke i përfshirë edhe mediat sociale, aktivitetin mbresëlënës në vend dhe përfshirjen në angazhimet ndërkombëtare.

Sa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore, jepen rekomandime për ndjekjen e vazhdueshme të Strategjisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe përditësimin e saj bazuar në përvojën praktike, rritjen e numrit të revizorëve, ofrimin e rrogës tërheqëse dhe përmirësimin e kushteve të punës për të parandaluar fluktuacionin e tepërt të punonjësve. Gjithashtu, jepen rekomandime për përmirësimin e kanaleve të komunikimit dhe mjeteve për komunikim me palët e interesuara.

Me mbështetjen e institucioneve relevante që kanë kompetenca për t'i zbatuar rekomandimet e dhëna, do të sigurohet që ESHR-ja të ruajë dhe avancojë statusin e vet si institucion suprem i revizionit, i pavarur dhe modern.

KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI ME PALETË E INTERESUARA

02



2.1.

KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA NË PUNË



Sigurimi i shkallës së lartë të transparencës dhe llogaridhënies në punën e Entit Shtetëror të Revizionit gjatë vitit 2024 ishte një nga përcaktimet strategjike kryesore me rëndësi thelbësore për sigurimin e besimit, menaxhimit të përgjegjshëm të financave publike dhe llogaridhënies institucionale.

Enti Shtetëror i Revizionit nëpërmjet publikimit të raporteve përfundimtare të revizorit, komunikimit të hapur dhe në kohë me mediat, organizatat civile dhe palët e tjera të interesuara, ka siguruar shkallë të lartë të informimit të qytetarëve dhe publikut të gjerë në lidhje me rezultatet e punës së ESHR-së dhe prania aktive, si në rrjetet sociale, ashtu edhe në mediat nëpërmjet realizimit të intervistave dhe deklaratave të shumta mbi gjendjet e konstatuara në Raportet Përfundimtare të Revizorit.

Gjatë vitit 2024, nëpërmjet pjesëmarrjes proaktive në intervistat në mediat nacionale dhe deklaratave nga menaxhmenti dhe udhëheqësia e ESHR-së në lidhje me gjendjet e konstatuara në raportet përfundimtare të revizorit, Enti Shtetëror i Revizorit e forcoi imazhin e vet duke e promovuar veten në një nga institucionet më të besueshme dhe transparente në vend.


Enti Shtetëror i Revizionit si partner i mediave dhe organizatave civile, përdor mjete të ndryshme të komunikimit me publikun, duke u përpjekur t'i prezantojë gjendjet e konstatuara në raportet e revizorit në mënyrë të lehtë dhe të kuptueshme përmes abstrakteve, njoftimeve për mediat dhe materialeve video mbi gjendjet e konstatuara kryesore në raportet e revizorit, me qëllim të informimit të publikut rreth mënyrës së shfrytëzimit të mjeteve publike.

Qasja e tillë proaktive ndaj komunikimit dhe transparencës ka për qëllim veprimin në kohë nga institucionet kompetente, veçanërisht sipas rekomandimeve të dhëna të Entit Shtetëror të Revizionit dhe zbatimin e tyre më efikas.


Rezultatet dhe aktivitetet e realizuara me sukses në pjesën e komunikimit me palët e interesuara dhe shkallën e lartë të transparencës së Entit Shtetëror të Revizionit janë paraqitur në grafikët e mëposhtëm:




LISTA - MEJLING E ESHR-së DHE KOMUNIKIMI ME 1215 PALË TË JASHTME TË INTERESUARA Mars 2024



LISTA-MEJLING E ESHR-së DHE KOMUNIKIMI ME PALË TË JASHTME TË INTERESUARA 2020-2024



 https://www.facebook.com/DrzavenZavodzaRevizija/ Është hapur 17.11.2021	Ndjekës të faqe 762 31.12.2021 6.967 31.12.2022 9.116 31.12.2023 9.324 31.12.2024		Numri i përgjithshëm për 3 përmbytjet me më shumë shikime të arritura 8.000 31.12.2021 62.869 31.12.2022 76.697 31.12.2023 82.346 31.12.2024
	Numri i përgjithshëm për 10 përmbytjet e fundit të publikuara 8.637 31.12.2021 25.021 31.12.2022 56.281 31.12.2023 15.972 31.12.2024		
Numri mesatar i frekuentimeve ditore 518 31.12.2021 2.232 31.12.2022 858 31.12.2023 2.678 31.12.2024	Numri i përgjithshëm i vizituesve 2.077.768 22.808 31.12.2021 710.301 31.12.2022 844.417 31.12.2023 500.242 31.12.2024		

INFO PËR FAQEN E FACEBOOK TË ESHR-SË

ANKETA PUBLIKE - SHKALLA E KËNAQËSISË

Në drejtim të avancimit të transparencës dhe cilësisë së punës së vet, Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) zbaton rregullisht anketa publike për të matur perceptimin dhe kënaqësinë e palëve të interesuara.

Në vitin 2024, për këtë qëllim, pyetësi i disponueshëm publikisht u vu në dispozicion në ueb-faqen zyrtare të ESHR-së, ndërsa në mënyrë plotësuese u ishte dorëzuar pyetësor ankete përfaqësuesve të sektorit publik dhe privat, mediave dhe organizatave civile. Anketa u publikua edhe në faqen zyrtare të Fejsbukut të ESHR-së.

Rezultatet e anketës tregojnë në nivelin e lartë të kënaqësisë - 98% e të anketuarve e vlerësuan bashkëpunimin me ESHR-në si pozitiv, veçanërisht në pjesën e informimit në kohë mbi raportet e revizorit dhe transparencën ndaj mediave dhe sektorit civil.

Puna e ESHR-së u vlerësua si e paanshme, e pavarur, ligjore, objektive, transparente dhe profesionale, ndërsa raportet e revizorit u vlerësuan lart. Rezultatet e anketës janë tregues i rëndësishëm për forcimin e llogaridhënies dhe avancimin e komunikimit me publikun dhe palët e interesuara.

Rezultatet tregojnë edhe për nivelin e lartë të besimit dhe perceptimit pozitiv tek palët e interesuara në lidhje me praktikën dhe mjetet e komunikimit të përdorura nga ESHR-ja, ndërsa në drejtim të informimit të palëve të interesuara me informacione nga puna e vet dhe gjendet e konstatuara të cilat janë prezantuar në raportet përfundimtare të revizorit. Kënaqësia e lartë me mjetet e ndryshme të komunikimit konfirmon se qasja ndaj transparencës dhe disponueshmërisë së informacioneve ofron përgjigje efektive dhe përkatëse ndaj nevojave të publikut.


ESHR-JA ME PUNËN E VET SIGURON:



VLERËSIMI I RAPORTEVE TË REVIZORIT:



STRUKTURA E TË ANKETUARVE:



KËNAQËSIA NGA BASHKËPUNIMI ME ESHR-NË:



2.2.

BASHKËPUNIMI ME KUVENDIN, ORGANET SHTETËRORE, ASOCIACIONET DHE INSTITUCIONET PROFESIONALE, ORGANIZATAT CIVILE DHE PUBLIKUN E GJERË



Bashkëpunimi i ESHR-së vazhdoi edhe në vitin 2024 me një numër të madh asociacionesh dhe institucionesh profesionale vendase që kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në realizimin e qëllimeve strategjike. ESHR-ja njihet nga këto organizata si institucion shoqërisht i përgjegjshëm dhe me ndikim që ofron të dhëna, informacione dhe shpjegime në kohë dhe të përditësuara mbi gjendjet dhe rekomandimet që i jep përmes lëshimit të Raporteve Përfundimtare të Revizorit. Përmes bashkëpunimit me asociacionet profesionale, institucionet e arsimit të lartë, qendrat kërkimore shkencore dhe organizatat e tjera nga sektori civil, puna e ESHR-së është bërë e arritshme për qytetarët, duke u mundësuar atyre t'i analizojnë të dhënat e përmbajtura në Raportet Përfundimtare të Revizorit dhe në të njëjtën kohë duke u mundësuar atyre të marrin informacione objektive dhe në kohë mbi mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve të tatimpaguesve, si dhe të dhëna mbi cilësinë e shërbimeve të kryera dhe të ofruara për personat juridikë dhe qytetarët.

Konsiderojmë se kjo qasje bashkëpunuese nga ESHR-ja dhe palët e interesuara, ESHR-ja u ka mundësuar atyre t'i vlerësojnë performancat e administratës publike dhe të rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve në lidhje me mjedisin mikro dhe makro në fushën e menaxhimit të financave publike dhe mbikëqyrjes së shpenzimit të mjeteve publike.

Për këtë qëllim, në vitin 2024, ESHR-ja i ruajti format ekzistuese të bashkëpunimit dhe vazhdoi procesin e zgjerimit, përkatësisht lidhjen e formave të reja të bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe organizatat profesionale dhe të tjera nga sektori civil, në përputhje me memorandumet e bashkëpunimit të lidhura.

2.2.1

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Enti Shtetëror i Revizionit e njofton Kuvendin në kohë dhe në mënyrë objektive mbi punën e vet, mbi gjetjet e revizorit nga revizionet e kryera, dhe i ofron mbështetje Kuvendit në përmbushjen e një pjese të kompetencave të tij duke konstatuar dhe raportuar parregullsitë, mosrespektimin e rregullave ligjore, veprimin e paligjshëm të mjeteve publike dhe rastet e mundshme të korrupsionit dhe abuzimit me detyrën zyrtare, prandaj komunikimi me Kuvendin konsiderohet veçanërisht i rëndësishëm.

Bashkëpunimi midis ESHR-së dhe Kuvendit zhvillohet vazhdimisht në më shumë drejtime dhe në përputhje me Ligjin për revizion shtetëror dhe Memorandumin e Bashkëpunimit midis Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Entit Shtetëror të Revizionit të nënshkruar më 21 tetor 2022. Në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit të nënshkruar, në vitin 2024, u përgatitën dhe iu dorëzuan Kuvendit dy raporte përmbledhëse, të cilat paraqesin përmbledhje të gjetjeve kryesore nga revizionet individuale të kryera në përputhje me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2023.

Me mbështetjen e Institutit Demokratik Nacional (NDI), ndërsa në drejtim të bashkëpunimit më të madh midis institucioneve dhe mbikëqyrjes së shpenzimit publik, u mbajtën takime midis ESHR-së dhe Kuvendit gjatë vitit 2024, duke përfshirë edhe Komisionin për Financim dhe Buxhet, Zyrën Buxhetore të Kuvendit dhe Institutin Parlamentar.

Në qershor të vitit 2024, kryerevizori shtetëror i dorëzoi Kryetarit të Kuvendit, Raportin Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2023. Më 12.09.2024, në Seancën e Katërmbëdhjetë të Kuvendit të RMV-së, u shqyrtua dhe u miratua Raporti Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e ESHR-së për vitin 2023 dhe për të u miratuan 14 konkluzione. Në ekspozenë e tij para deputetëve në Kuvend, kryerevizori shtetëror theksoi se ESHR-ja, duke vepruar në përputhje me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t për sa i përket asaj që do të thotë të bësh dallim në jetën e qytetarëve, si Institucion Suprem i Revizionit, ka zbatuar dhe përcaktuar më shumë se 18 indikatorë që janë tregues i matshëm për punën e institucionit.

Në korrik të vitit 2024, me ftesë të kryetarit të Komisionit për Çështje Ekonomike, Punë dhe Politikë Energjetike pranë Kuvendit të RMV-së, u mbajt takimi i punës, në të cilin morën pjesë kryerevizori shtetëror, zëvendëskryerevizori shtetëror me bashkëpunëtorët e tyre dhe përfaqësuesit e NDI-së dhe VFD-së. Në mbledhje ishte miratuar konkluzioni se në periudhën e ardhshme, shqyrtimi i raporteve përfundimtare të revizorit do të jetë një nga prioritetet, si të Kuvendit të RMV-së, ashtu edhe të Komisionit për Çështje Ekonomike, Punë dhe Politikë Energjetike, ndërsa do të ndërmerren aktivitete për të ndjekur në mënyrë më efektive zbatimin e rekomandimeve të dhëna subjekteve që janë lëndë e revizionit në raportet përfundimtare të revizorit.

Në shtator të vitit 2024, në ambientet e ESHR-së u organizua punëtorja për shkëmbim dhe përvojave dhe praktikave në veprimin midis ISR-ve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Zvicrës dhe Sekretariatit të Kuvendit dhe shërbimeve parlamentare zvicerane, me mbështetjen e NDI-së në kuadër të Programit të Mbështetjes Parlamentare, të mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Në ngjarjen "Parlamenti 2024-2028: Përpjekje të reja në luftën kundër korrupsionit" kushtuar rolit të Kuvendit në forcimin e luftës kundër korrupsionit, që u mbajt më 5 korrik 2024, i organizuar nga Instituti për Demokraci në Shkup, kryerevizori shtetëror theksoi në fjalimin e tij se pret që bashkëpunimi me Kuvendin të vazhdojë, të intensifikohet dhe të shqyrtohen raporte të caktuara në komisionet amë të Kuvendit.

Në vitin 2024, u shqyrtuan disa raporte përfundimtare të revizorit ose u organizua debati publik nga komisionet dhe trupat në Kuvend. Më 22 tetor 2024, për herë të parë që nga themelimi i ESHR-së, raporti përfundimtar i revizorit për revizionin e suksesit u shqyrtua në seancë plenare të Kuvendit. Ky aktivitet po zbatohet si rezultat i Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar midis ESHR-së dhe Kuvendit, i cili parashikon shqyrtimin e raporteve individuale dhe përfundimtare të revizorit të ESHR-së.

Në kuadër të vizitës së kryetarit të Gjykatës së Revizionit të Republikës së Sllovenisë (mars), kryetarit të Zyrës Supreme të Revizionit të Republikës së Polonisë (mars), kryetarit të ISR-së së Republikës Çeke (shtator), kryetarit të Bordit Ndërkombëtar të Revizorëve të NATO-s (tetor), u zhvilluan takime pune me Kryetarin dhe nënkryetarin e Kuvendit të RMV-së, në të cilat u shqyrtuan praktikat pozitive të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe mundësitë për avancimin e bashkëpunimit dhe ndarjen e përvojave profesionale dhe shkëmbimin e ekspertizës. Më 27 nëntor 2024, në ceremoninë e shënimit të 25-vjetorit të ESHR-së, Kryetari i Kuvendit të RMV-së mbajti fjalim.

Programi Vjetor i Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2025 u përgatit dhe iu dorëzua Kuvendit në dhjetor 2024, për shkak të informimit.

Në periudhën e ardhshme, ESHR-ja do të vazhdojë bashkëpunimin efektiv me Kuvendin duke vendosur mekanizëm të rregullt për shqyrtimin e raporteve të revizorit nga Kuvendi me qëllim të rritjes së shkallës së zbatimit të rekomandimeve të revizorit.



⁹ - në Mbledhjen e Katërt të Komisionit për Çështje Ekonomike, Punë dhe Politikë Energjetike, u diskutua Raporti Përfundimtar i Revizorit të Autorizuar Shtetëror për revizionin e kryer të suksesit me temë "Efektiviteti i masave për të parandaluar largimin e kuadrove profesionale dhe me arsim të lartë" (08.10.2024);

- në Mbledhjen e Dytë të Komisionit për Mundësi të Barabarta të Femrave dhe Meshkujve, u organizua debati publik me temë "Barazia gjinore e grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës" (14.10.2024);

- Klubi për Çështje dhe Politika Rinore mbajti mbledhje me temë: Raporti përfundimtar për revizionin e kryer të suksesit nga Enti Shtetëror i Revizionit me temë "Efektiviteti i masave, politikave dhe projekteve për përmirësimin e kushteve në të cilat funksionojnë konviktet shtetërore të studentëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe zhvillimi i standardit të studentëve" (4.11.2024).

¹⁰ „Efektiviteti i masave për të parandaluar largimin e kuadrove profesionale dhe me arsim të lartë”.

2.2.2

PROKURORIA PUBLIKE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Një hap i rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit me Prokurorinë Publike është nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit në vitin 2022, i cili rregullon mënyrën e komunikimit, konsultimit dhe dorëzimit të raporteve përfundimtare të revizorit në Prokurorinë Publike, për veprimin e tyre të mëtejshëm, për shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve me qëllim të veprimit më efikas sipas parregullsisive të konstatuara.

Në vitin 2024, të dy institucionet zbatuan udhëzimet e brendshme dhe të detyrueshme të miratuara për veprimin e mëtejshëm sipas raporteve të revizorit, duke kontribuar kështu në komunikimin dhe bashkëpunimin më efikas midis ESHR-së dhe PPRM-së. Në mënyrë plotësuese, u mbajtën më shumë takime pune midis prokurorëve publikë dhe revizorëve shtetërorë, në drejtim të ofrimit të informacioneve shtesë për parregullsitë e konstatuara dhe të përmbajtura në raportet e dorëzuara të revizorit.

Në vitin 2024, nëpërmjet punëtorive të zhvilluara në të cilat revizorët shtetërorë dhe prokurorët publikë diskutuan së bashku në mënyrë aktive procedurat në lëndët individuale në prokuroritë publike, të formuara në bazë të raporteve përfundimtare të revizorit të Entit Shtetëror të Revizionit, u mundësua komunikimi shtesë midis revizorëve shtetërorë dhe prokurorëve publikë kompetentë, në drejtim të propozimit të aktiviteteve për koordinim më të ngushtë në veprimin dhe sigurimin e dëshmive për procedurën e mundshme penale. Këto punëtori

organizohen me mbështetjen e VFD-së. Në mënyrë plotësuese, u zhvilluan më shumë takime pune midis prokurorëve publikë dhe revizorëve shtetërorë, në drejtim të ofrimit të më shumë informacioneve për parregullsitë e konstatuara dhe të përmbajtura në raportet e dorëzuara të revizorit.

Në të njëjtën kohë, në periudhën nga 29 deri më 30 tetor 2024, delegacioni i Entit Shtetëror të Revizionit, i udhëhequr nga kryerevizori shtetëror, së bashku me delegacionet e Prokurorisë Publike dhe Fondacionit Westminster për Demokraci, zhvilluan vizitë studimore në Zyrën Nacionale të Revizionit dhe Prokurorinë Nacionale të Republikës së Polonisë. Vizita kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në lidhje me veprimin e raporteve të revizorit, përmirësimin e koordinimit midis institucioneve të revizionit dhe prokurorive publike, si dhe forcimin e sundimit të së drejtës. U zhvilluan takime me udhëheqësinë e të dy institucioneve në Poloni, gjatë të cilave u prezantuan mekanizmat për komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve, si dhe roli i institucionit të revizionit në procedurat penale. Vizita u organizua me mbështetjen e Fondacionit Westminster për Demokraci, në kuadër të projektit "Praktikoni Demokracinë", të financuar nga Ambasada Britanike në Shkup.



2.2.3

KRYQI I KUQI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Si rezultat i bashkëpunimit të suksesshëm në periudhën e mëparshme, më 30 shtator 2024, në ambientet e Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR), u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit midis Entit Shtetëror të Revizionit dhe Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Memorandumi është bazë për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis dy institucioneve, në drejtim të mbështetjes së kategorive të cënueshme të popullsisë dhe promovimit të vlerave humanitare. Bashkëpunimi përfshin aktivitete që lidhen me dhurimin e gjakut, ofrimin e ndihmës së shpejtë, mbështetjen psikosociale dhe organizimin e ngjarjeve publike me rëndësi shoqërore.

Si institucion me përgjegjësi shoqërore që i avancojnë vazhdimisht aktivitetet në interes të qytetarëve, ESHR-ja ka organizuar aksione për dhurimin e gjakut edhe në periudhën e kaluar me pjesëmarrjen aktive të punonjësve. Në mënyrë plotësuese, në vitin 2024, ESHR-ja siguroi ndihmë financiare në shumën prej 100.000 denarë për t'u përballur me pasojat e zjarreve që e prekën vendin.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi dhe si pjesë e festimit të 25-vjetorit të Entit Shtetëror të Revizionit, u organizua edhe aksioni tradicional i dhurimit të gjakut, që i bashkon punonjësit e ESHR-së në përpjekjet e tyre për të treguar humanizëm dhe solidaritet, duke i mbështetur kategoritë më të prekura në shoqërinë tonë.



U nënshkrua **Memorandumi** i Bashkëpunimit me **Kryqin e Kuq**

Si pjesë e festimit të **25-vjetorit të Entit Shtetëror të Revizionit**, u organizua aksioni tradicional i **dhurimit të gjakut**.



2.2.4

MINISTRIA E SHËNDETËSISË



Gjatë vitit 2024, me qëllim të avancimit të bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët në fushën e shëndetësisë, Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR), e përfaqësuar nga kryerevizori shtetëror, dhe Ministria e Shëndetësisë, e udhëhequr nga ministri i Shëndetësisë, nënshkruan Memorandum të Bashkëpunimit.

Zbatimi i këtij Memorandumi ishte bazë për zhvillimin e modulit të veçantë të dedikuar për nevojat e revizionit. Ky modul mundëson marrjen e informacioneve dhe raporteve relevante mbi punën e institucioneve shëndetësore, si dhe qasjen në të dhënat e anonimizuara mbi shërbimet e kryera shëndetësore përmes aplikacionit "Termini Im". Moduli përdoret nga ESHR-ja për nevojat e revizionit gjatë ndjekjes dhe analizës së punës së institucioneve shëndetësore dhe shërbimeve të kryera. Zbatimi i tij mundëson identifikimin më të shpejtë dhe më efikas të parregullsive dhe dobësive në sistemin shëndetësor.

2.2.5

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS DHE UNIVERSITETI "SHËN KIRILI DHE METODI" - SHKUP



Duke e njohur rëndësinë e avancimit të vazhdueshëm të njohurive dhe aftësive të punonjësve, Enti Shtetëror i Revizionit njihet si institucion që mëson, duke ndërtuar kulturë organizative të bazuar në edukim, inovacione dhe shkëmbim përvojash. Këto përpjekje synojnë forcimin e kapaciteteve institucionale, por edhe sigurimin e kontributit në arsim, shkencë dhe zhvillimin e sektorit publik. Në këtë drejtim, më 1 nëntor 2024, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit midis ESHR-së, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Universitetit "Shën Kirili dhe

Metodi". Memorandumi i hedh themelet për një partneritet afatgjatë përmes zhvillimit të platformës së përbashkët për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave. Bashkëpunimi parashikon zbatimin e mësimit praktik për studentët, organizimin e ngjarjeve edukative, trajnimeve dhe shkëmbimin e praktikave të mira. Kjo qasje kontribuon në avancimin e shërbimeve publike dhe përgatitjen e kadrove të reja profesionale në fushën e revizionit dhe administratës publike.

2.2.6

KËSHILLI FISKAL I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Më 08.02.2024, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit midis Entit Shtetëror të Revizionit dhe Shërbimit Profesional të Këshillit Fiskal, me qëllim të avancimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit të ndërsjellë në fushat me interes të përbashkët.

Memorandumi përfshin:

- /// komunikimin dhe koordinimin e rregullt në fushën e makroekonomisë, politikës fiskale dhe menaxhimit të financave publike;
- /// shkëmbimin e të dhënave, analizave, raporteve dhe opinioneve me interes të ndërsjellë;
- /// vendosjen e kushteve për bashkëpunim të vazhdueshëm, duke përfshirë edhe mbështetjen hapësinore dhe teknike.

Paraprakisht ishte mbajtur takimi fillestar midis përfaqësuesve të të dy institucioneve, në të cilin u shpreh gatishmëria për të punuar së bashku dhe për të ndarë përvoja dhe informacione. Në përputhje me Ligjin për buxhete, një nga anëtarët e Këshillit Fiskal zgjidhet me propozim të Entit Shtetëror të Revizionit.

Këshilli Fiskal, si trup i pavarur i sapothemeluar, ka mandatin për t'i mbikëqyr politikat makroekonomike dhe fiskale në vend, ndërsa vendosja e tij është hap i rëndësishëm drejt forcimit të disiplinës fiskale dhe transparencës.

2.2.7

PUBLIKU I PËRGJITHSHËM

ESHR-ja është institucion i pavarur që u mundëson qytetarëve të ndjekin se si shpenzohen paratë publike, nëpërmjet informimit mbi punën e institucioneve publike dhe mbi masat që duhet të ndërmerren për të siguruar menaxhim të përgjegjshëm dhe transparent të mjeteve publike. Në këtë drejtim, në përputhje me Ligjin për qasje të lirë të informacionet me karakter publik, gjatë vitit 2024, janë marrë 10 kërkesa për informacione me karakter publik, 9 prej të cilave janë përgjigjur

pozitivisht brenda afatit të përcaktuar me ligj, dhe një kërkesë është me karakter informativ. Në të njëjtën kohë, ESHR-ja, në përputhje me Planin Nacional të Veprimit për Partneritetin e Hapur Qeveritar dhe angazhimin për "Publikimin proaktiv të informacioneve me karakter publik në ueb-faqet e institucioneve", i publikon me kohë në ueb-faqen e vet të gjitha dokumentet që janë lëndë interesi për publikun e përgjithshëm.

2.3

BASHKËPUNIMI ME ORGANET KOMPETENTE PËR REVIZIONET DHE EFEKTET E TYRE

Për të arritur qëllimin themelor të revizionit shtetëror, përkatësisht kujdesin për mjetet publike dhe avancimin e menaxhimit të tyre, zbulimin në kohë të lëshimeve nga standardet e pranuar dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë, efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomizimit në menaxhimin e mjeteve publike, ESHR-ja jep rekomandime të qarta dhe efektive, me qëllim të ndërmarrjes së hapave për t'i parandaluar ose për t'i vështirësuar lëshimet dhe shkeljet në të ardhmen. Masat korrigjuese për zbatimin e rekomandimeve i mundësojnë udhëheqësisë së subjektit që është lëndë e revizionit, të përmirësojë efektivitetin, efikasitetin dhe ekonomizimin në punë.

Enti Shtetëror i Revizionit edhe në vitin 2024 përmes informacioneve të qarta, reale, objektive dhe në kohë mbi parregullsitë e konstatuara, mosharmonizimin e rregullave ligjore, veprimin e paligjshëm me mjetet publike dhe rastet e mundshme të korrupsionit dhe abuzimit të detyrës zyrtare, kontribuoi në përmbushjen e një pjese të kompetencave të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

ESHR-ja i kushton vëmendje të duhur përpunimit dhe analizës së informacioneve që rezultojnë nga Raportet Përfundimtare të Revizorit të revizorëve të autorizuar shtetërorë. Këto të dhëna përpunohen rregullisht me aplikacionin softuerik të integruar, autonom dhe funksional për përpunimin dhe analizën e të dhënave nga Raportet Përfundimtare të Revizorit. Në këtë mënyrë, ofrohen informacione të sigurta, të përditësuara, në kohë dhe relevante për nevojat e ESHR-së, organeve kompetente dhe palëve të tjera të interesuara. Duke i dorëzuar rregullisht raportet përfundimtare të revizorit në Kuvend dhe organet kompetente, ESHR-ja e tërheq vëmendjen ndaj dobësive të konstatuara në punën e subjekteve të reviduara.

Vazhdimisht i evidentojmë, ndjekim dhe analizojmë informacionet e marra kthyes nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, MF-ja - Drejtoria e Policisë Financiare, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Zëvendëskryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut i ngarkuar për qeverisjen e mirë, për veprimin sipas Raporteve Përfundimtare të Revizorit të dorëzuara atyre.

Efektet e gjendjeve të konstatuara që i tregojnë parregullsitë dhe paligjshmëritë në punën e subjekteve në menaxhimin më të mirë të mjeteve publike mund të pritët vetëm nëse institucionet kompetente i marrin masat e nevojshme për t'i tejkaluar. Ndjekja dhe informimi për aktivitetet e ndërmarrja nga institucionet kompetente për t'i tejkaluar parregullsitë dhe paligjshmëritë e konstatuara në punën e subjekteve është një nga qëllimet strategjike të ESHR-së. Aktivitetet e ESHR-së në lidhje me parandalimin e korrupsionit kryhen në përputhje me autorizimet dhe detyrimet e përcaktuara me Ligjin për revizion shtetëror, Ligjin për Prokurorinë Publike, Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, memorandumet e bashkëpunimit të lidhura, si dhe rregullativën tjetër ligjore relevante.

Në kuadër të realizimit të Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2024, raportet e revizorit janë dorëzuar në institucionet kompetente si në vijim:

- /// Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë dorëzuar 39 raporte të revizorit për 32 subjekte të reviduara (revizione);
- /// Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit janë dorëzuar 24 raporte të revizorit për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore me detyrë zyrtare në përputhje me ndryshimet në nenin 85-b të Kodit Zgjedhor;¹¹;



¹¹ Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 40/06, 136/08, Korrigj. 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, Korrigj. 30/14, 31/15, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 57/17, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19, "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 98/19, 146/19, 42/20, Dispozitat e Dekretit me fuqinë e ligjit për çështjet që lidhen me zgjedhjet për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 15 korrik 2020 "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 160/20, 74/21, 215/21, 58/24



- /// Zëvendëskryetarin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, i ngarkuar për qeverisje të mirë, jështë dorëzuar 1 raport i revizorit për 1 subjekt të reviduar (revizion).

Në dhjetor 2024 **dhe maj 2025**, ESHR-ja u dorëzoi kërkesë organeve kompetente për të siguruar informacione kthyesë mbi aktivitetet e ndërmarra pas dorëzimit të raporteve përfundimtare të revizorit të lëshuara në 5 vitet e fundit. Në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit të lidhur, **janë siguruar informacione kthyesë nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut.**

Enti Shtetëror i Revizionit bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjitha organet shtetërore në drejtim të parandalimit dhe zvogëlimit të korrupsionit, në kuadër të Protokollit për Bashkëpunim për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave. Enti Shtetëror i Revizionit merr pjesë në realizimin e Programit Nacional për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) përmes aktiviteteve të parashikuara në Kapitullin 3.23. Gjyqësori dhe të drejtat themelore, Fushën – Politika kundër korrupsionit dhe Kapitullin 3.32 Kontrolli financiar, Fushën – Revizioni i jashtëm, si dhe në punën e organeve dhe trupave të tjerë për parandalimin e korrupsionit.

RAPORTET E REVIZIONIT TË DORËZUARA TE ORGANET KOMPETENTE

38

RAPORTE TË REVIZORIT janë dorëzuar te Prokuroria publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut për 32 subjekte të reviduara (revizione);

24

RAPORTE TË REVIZORIT janë dorëzuar te Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore sipas detyrës zyrtare në përputhje me ndryshimet në nenin 85-b të Kodit Zgjedhor;

1

RAPORT I REVIZORIT është dorëzuar te Zëvendëskryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, i ngarkuar për politikën për qeverisje të mirë për 1 subjekt të reviduar (revizion);

2.4

KONTRIBUTI I ESHR-SË NË STRATEGJINË NACIONALE TË ZHVILLIMIT 2024-2044

Strategjia Nationale e Zhvillimit (SNZH) për periudhën 2024–2044 është dokumenti më i lartë strategjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me vizion për zhvillimin e përgjithshëm të vendit në dy dekadat e ardhshme. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut e miratoi Strategjinë Nationale të Zhvillimit më 29 tetor 2024, pas një procesi gjithëpërfshirës konsultativ që i përfshinte të gjithë faktorët shoqërorë relevantë, me qëllim të arritjes së konsensusit ndërbreza, ndëretnik, ndërpartiak dhe gjinor.

Shtyllat kryesore të SNZH-së janë:

1. Ekonomia e qëndrueshme, inovative dhe konkurruese;
2. Zhvillimi i qëndrueshëm lokal dhe rajonal;
3. Zhvillimi social dhe kulturor;
4. Shoqëria e sigurt, e mbrojtur dhe rezistente;
5. Transformimi i gjelbër;
6. Sundimi i së drejtës dhe qeverisja e mirë.

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) mori pjesë aktive në përgatitjen e Strategjisë Nationale të Zhvillimit 2024-2044 përmes pjesëmarrjes në trupat e punës dhe në trupin këshillëdhënës të themeluar për këtë qëllim. Kryerevizori shtetëror është anëtar i Trupit Këshillëdhënës, me anë të të cilit ESHR-ja ka dhënë kontribut të rëndësishëm në drejtim të sigurimit të transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së procesit të planifikimit strategjik.

Duke marrë parasysh rëndësinë e Strategjisë Nationale të Zhvillimit 2024-2044, ESHR-ja, në procesin e përgatitjes së Programit Vjetor të Punës për vitin 2025, si kriter shtesë në përzgjedhjen e revizioneve që do të ishin pjesë përbërëse e Programit Vjetor të Punës së ESHR-së, i përcaktoi edhe qëllimet e Strategjisë Nationale të Zhvillimit dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm, dhe në të njëjtën kohë i lidhi revizionet me qëllimet dhe aktivitetet e SNZH-së dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Me këtë forcohet orientimi i aktiviteteve të revizorit në vlerësimin e efektivitetit dhe shkallës së zbatimit të strategjisë, duke ofruar kështu mbështetje në arritjen e qëllimeve të përcaktuara dhe përmirësimin e menaxhimit të burimeve publike.

Në drejtim të mbështetjes së zbatimit të masave të përcaktuara në Strategjinë Nacionale të Zhvillimit, si dhe harmonizimin me Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ), gjatë vitit 2024, ESHR-ja mori

pjesë edhe në përgatitjen e Hartës së Investimeve, e cila ka për qëllim t'i identifikojë fushat prioritare për investime me potencial dhe ndikim të lartë.



KAPACITETET ADMINISTRATIVE

03



3.1.

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE

Enti Shtetëror i Revizionit në funksion të përmbushjes së kompetencave dhe detyrave të veta, i kushton vazhdimisht vëmendje ndërtimit të sistemit modern, efikas dhe funksional të menaxhimit të burimeve njerëzore, i cili lidhet drejtpërdrejt me efikasitetin dhe efektivitetin organizativ dhe siguron zhvillimin e vazhdueshëm të tyre përmes:

- /// Përmirësimit permanent të kushteve të punës;
- /// Specializimit të njësive të brendshme organizative;
- /// Përparimit të vazhdueshëm në karrierë të punonjësve nëpërmjet avancimit;


- /// Shpërblimit përkatës në përputhje me rezultatet e arritura;
- /// Sistemit të punonjësve në vende pune në përputhje me kualifikimet e tyre profesionale, përvojën e punës dhe aftësitë e fituara, dhe
- /// Sigurimit të kuadrove të reja të kualifikuara në revizionin shtetëror.

Aspektin gjinor të të punësuarve në Entin Shtetëror të Revizionit do ta paraqesim grafikisht si më poshtë:

STRUKTURA GJINORE E UDHËHEQËSVE TË EKIPEVE TË REVIZORËVE



BURIMET NJERËZORE 126 PUNONJËS NË ESHR



STRUKTURA GJINORE E REVIZORËVE SHTETËRORË / NËPUNËSVE ADMINISTRATIVË / PERSONAVE NDIHMËS TEKNIKË



STRUKTURA UDHËHEQËSE NË ESHR



3.2.

RRITJA E NJOHURIVE DHE AFTËSIVE TË REVIZORËVE SHTETËRORË

Puna e revizorit shtetëror në përputhje me standardet dhe udhëzimet profesionale dhe zbatimin e tyre është thelbësore për besueshmërinë, cilësinë dhe profesionalizmin e revizionit në sektorin publik. Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (ISSAI), të zhvilluara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI), kanë për qëllim të promovojnë revizionin e pavarur dhe efektiv nga institucionet supreme të revizionit.

Duke marrë parasysh se një nga detyrat e rëndësishme të revizionit të sektorit publik - revizionit shtetëror është të inkurajojë dhe zbatojë ndryshime pozitive që do të kontribuojnë për një standard më të mirë jetese të qytetarëve që janë shfrytëzues të mjeteve publike dhe shërbimeve publike, është e pakontestueshme nevoja për përsosje të vazhdueshme profesionale të revizorëve shtetërorë. Ky aktivitet është në përputhje edhe me kërkesat e ISSAI-së. Enti Shtetëror i Revizionit kujdeset dhe zbaton trajnime relevante dhe cilësore në fusha të ndryshme me interes për revizorët shtetërorë, dhe sigurisht në funksion të nevojave të subjekteve që janë lëndë e revizionit. Në vitin 2024, Enti Shtetëror i Revizionit zbatoi trajnime, punëtori dhe shkëmbim njohurish dhe përvojash me qëllim të rritjes së njohurive, zgjerimin e njohurive dhe aftësive të revizorëve

shtetërorë, si dhe shkëmbimin e praktikave të mira midis kolegëve nga ISR-të e tjera. Përmes mënyrave të ndryshme të arritjes së njohurive dhe aftësive në vitin 2024, bazuar në Planin Vjetor të miratuar për Përsosjen e Vazhdueshme Profesionale për vitin 2024, janë planifikuar dhe zbatuar më shumë aktivitete që janë me interes për ruajtjen dhe plotësimin e njohurive dhe aftësive të revizorëve shtetërorë. Programi Vjetor i PVP-së së ESHR-së për vitin 2024 zbatohet nga prezantuesit dhe trajnerët, punonjësit e ESHR-së, si dhe ligjëruesit që i përkasin komunitetit akademik, kolegët nga ISR-të e tjera, me shkëmbimin e njohurive, përvojave dhe praktikave të mira nga revizionet e kryera, rregullave ligjore dhe ndryshimeve të tyre, standardeve të kontabilitetit dhe zhvillimit të aftësive të nevojshme.

Në drejtim të rritjes së njohurive dhe aftësive të revizorëve shtetërorë, Enti Shtetëror i Revizionit në vitin 2024 krijoi dhe publikoi Platformë për e-mësimin, ku vizitorët dhe revizorët shtetërorë kanë mundësinë të mësojnë dhe të marrin certifikatë në fushën e revizionit të suksesit. Platforma është bërë vegël aktive për nxënien e njohurive për të gjitha palët e interesuara për revizionin e suksesit.



Për punonjësit e rinj, ofrohet trajnimi në pjesën e njohjes me sistemin e informacioneve, përdorimit të duhur të burimeve të TI-së, përdorimit të mjeteve softuerike, aplikacioneve dhe Sistemit të Menaxhimit të Proceseve të Revizionit (AMS) që përdoren në mënyrë aktive në procesin e revizionit, si dhe njohjes me politikat dhe procedurat e TI-së - baza për përdorim të suksesshëm, të saktë dhe të sigurt të mjeteve dhe të të dhënave.

EDUKIMET E REVIZORËVE SHTETËRORË NË KUADËR TË INICIATIVAVE TË IDI – INTOSAI NË VITIN 2024

PROGRAMI LOTA PIONEERS (2023-2024)



Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) edhe në vitin 2024 vazhdoi të marrë pjesë në mënyrë aktive në iniciativat e Iniciativës për Zhvillim të Institucioneve Supreme të Revizionit (IDI – INTOSAI Development Initiative), përmes tre programeve kryesore: LOTA Pioneers, SAI Young Leaders (SYL) dhe PESA (Professional Education for SAI Auditors).

LOTA Pioneers (2023-2024) është një nga mjetet kryesore për arritjen e vizionit të LOTA-së. Kjo është iniciativë që ka për qëllim të lehtësojë transformimin e revizorëve të ISR-së në bartës të ndryshimeve që fusin teknologjinë në botën e revizionit në ISR, duke i skanuar mjediset e tyre të brendshme dhe të jashtme të revizorit për të hartuar dhe ndërtuar strategji për shfrytëzimin e teknologjisë në revizionet dhe revidimin e përdorimit të teknologjisë nga qeveritë. Fillimisht, kjo iniciativë ofrohet në gjuhën angleze për deri në 25 ISR. Çdo ISR kërkohet të emërojë dy persona nga nivele të ndryshme të lideritshpimit brenda ISR-së. Programi e bazon konceptin e tij në ndarjen e mëposhtme - derisa njëri do të veprojë si LOTA Pioneer ("Strategjia"), tjetri do të veprojë si LOTA Pioneer ("Revizioni").

Kjo iniciativë është e rëndësishme për punën e Institucioneve Supreme të Revizionit, sepse u referohet ndryshimeve në ndryshimin dhe përparimin e vazhdueshëm teknologjik që ndodh çdo ditë dhe ISR-të duhet të mbeten relevante duke përdorur teknologji të reja dhe të përparuara, si në sistemet e tyre të TI-së, ashtu edhe gjatë kryerjes së revizionit të teknologjive të reja.

Koncepti është zhvilluar në atë mënyrë që ISR-të të fitojnë aftësi dhe njohuri të reja për t'u përballur me këto fusha të reja të revizionit dhe zbatimitin e tij. Është e domosdoshme që revizorët t'i kuptojnë ndryshimet teknologjike, t'i vlerësojnë implikimet e këtij ndryshimi për punën e revizorit dhe sigurisht të shfrytëzojnë përparimin teknologjik në revizionet në mënyrë që të jenë në gjendje të kryejnë revizion mbi teknologjitë dhe efektet e zbatimit të tyre, të cilat i përdorin subjektet që janë lëndë e revizionit.

Në këtë drejtim, ESHR-ja ka filluar përditësimin e strategjisë së TI-së së Entit Shtetëror të Revizionit (2023 - 2027) me versionin e fundit 2.0, ku ishte futur edhe përcaktimi strategjik për t'i zhvilluar burimet e veta të kuadrit në përputhje me këtë iniciativë, si dhe kryerjen e revizionit të teknologjive të reja dhe hartimin e programeve të reja të revizionit për to.

ESHR-ja ka parashikuar dhe ka kryer pilot-revizion me qëllim të zbatimit të programeve dhe mjeteve të reja për revizionin e teknologjive të përparuara në subjektet, në përputhje me programin IDI LOTA Pioneers në vitin 2024. Një nga qëllimet e revizionit është të vlerësojë sigurinë e konfigurimeve të serviseve të autentifikimit dhe bazave të të dhënave. Revizioni ishte kryer në koordinim me IDI-në dhe u mentorua nga ISR-ja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Xhamajkës. Brenda kuadrit të këtij programi, dy revizorë të ESHR-së morën certifikatat për LOTA Pioneers.

PROGRAMI SAI YOUNG LEADERS (SYL) 2024-2025

INTOSAI ka krijuar vizionin që vlerëson se liderët e rinj të ISR-së bëjnë dallimin në statusin, kryerjen e detyrave dhe profesionalizmin e ISR-së. Liderhipi është cilësi që shtrihet në çdo fushë të funksionimit dhe kryerjes së aktiviteteve të ISR-së. Duke e pasur parasysh rëndësinë kritike të liderhipit, udhëheqësia e IDI-së e lançoi Programin "Liderët e rinj të ISR-së" - SYL (The SAI's Young Leaders Program), si kontributin e vet në iniciativat e vazhdueshme të liderhipit në komunitetin e INTOSAI-t. Qëllimi i Programit është të kultivojë dhe zhvillojë liderë të rinj të ISR-së në mënyrë që të rrisë kontributin e tyre në kapacitetin dhe suksesin e punës së ISR-së në ofrimin e vlerave dhe përfitimeve për qytetarët. Programi synon të zhvillojë liderë të rinj të ISR-së me potencialin për t'u bërë liderë të së nesërme, të cilët demonstrojnë vizion, i udhëheqin ekipet e tyre, e udhëheqin ISR-në e tyre, janë efektivë në mjedisin e tyre dhe shtojnë vlerë dhe e kthejnë në komunitetin e tyre.

Në kuadër të iniciativës për forcimin e kapaciteteve dhe aftësive udhëheqëse në ISR, ESHR-ja merr pjesë në gjeneratën e katërt të programit "Liderët e rinj të ISR-së (SAI Young Leaders - SYL)" për vitet 2024-2025, të organizuar nga Iniciativa për Zhvillim e ISR-së (IDI - INTOSAI Development Initiative). Programi SYL ka për qëllim të nxisë ndryshime pozitive përmes zhvillimit personal dhe

profesional të liderëve të rinj dhe kontributit të tyre në zhvillimin e institucioneve nga të cilat vijnë. Mbi 50 kandidatë nga ISR të ndryshme aplikuan në thirrjen për pjesëmarrje, ndërsa u përzgjedhën 22 liderë të rinj nga 20 institucione, në mesin e të cilëve edhe përfaqësuesi i ESHR-së. Takimi i parë i punës i gjeneratës së re SYL u mbajt në Kigali, Ruanda, në periudhën nga 30 shtator deri më 4 tetor 2024. Gjatë takimit, pjesëmarrësit u njohën me komponentët kryesorë të programit dhe morën pjesë në disa punëtori interaktive, përfshirë edhe punëtorinë mbi inteligjencën emocionale, si element thelbësor i liderhipit efektiv.




Në kuadër të kërkesave të kësaj iniciative, përfaqësuesi i ESHR-së hartoi Strategjinë për Liderët e Rinj, e cila u miratua nga kryerevizori shtetëror. Një pjesë e aktiviteteve të parashikuara në Strategji tashmë janë realizuar me sukses, ndërsa pjesa tjetër është në proces të zbatimit. Aktivitetet e planifikuara në këtë Strategji janë aktivitetet që synojnë ndërtimin e urave me palët e interesuara me qëllim të zbatimit të revizioneve me ndikim të rëndësishëm dhe afatgjatë, me këtë edhe stimulimin e inovacioneve dhe zhvillimit në institucion.

PESA - PLATFORMA PËR ARSIMIMIN PROFESIONAL TË REVIZORËVE TË ISR-SË

IDI-INTOSAI vendosi Learning Management System (LMS) - platformë online për arsimin digjital, për kurse e-mësim, si dhe për punë online, arsimin e integruar dhe aktivitete për mbështetjen e revizionit (IEAS - Integrated Education & Audit Support Framework) ndër të tjera. Për nevojat e institucioneve supreme të revizionit, është zhvilluar edhe platforma PESA - Professional Education for SAI Auditors ose Platforma për Arsimimin Profesional të Revizorëve të ISR-së.

Kjo platformë është hartuar me tre module sipas llojeve të revizioneve për të cilat janë të interesuar revizorët shtetërorë, përkatësisht për revizionin e raporteve financiare, për revizionin e suksesit dhe për revizionin e pajtueshmërisë (në përputhje me ISSAI 100). Revizorët shtetërorë të ESHR-së kanë mundësinë të marrin certifikatë profesionale për një ose më shumë lloje të revizioneve përmes procesit afatgjatë të trajnimeve online dhe provimit përfundimtar të certifikimit. Duke filluar nga viti 2024, nga ESHR-ja marrin pjesë dy revizorë shtetërorë për revizionin e raporteve financiare dhe revizionin e suksesit, si dhe një trajner i autorizuar i cili do t'i udhëheq gjatë gjithë procesit të trajnimit dhe certifikimit. Edukimi pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2025.

Plani Vjetor për Përsosjen e Vazhdueshme Profesionale për vitin 2024 është zbatuar në tërësi dhe janë zbatuar trajnime në fushat e mëposhtme:

	Revizioni, trajnimet metodologjike – niveli bazë dhe niveli i avancuar
	Revizioni i TI-së
	Kontabiliteti dhe njoftimi financiar
	Zbatimi praktik i standardeve të revizorit të ISR (INTOSAI)
	Parandalimi i mashtrimit, korrupsionit dhe integritetit
	Teknologjia informatike
	Analiza e të dhënave
	Zhvillimi i aftësive të buta dhe zhvillimi personal
	Rregullativa ligjore
	Prokurimet publike
	Tatimet dhe kontributet
	Revizioni i njësive të vetëqeverisjes lokale
	Planifikimi strategjik dhe vjetor
	Lloje të tjera të trajnimeve



3.3.

BURIMET E TI-SË

Enti Shtetëror i Revizionit investon vazhdimisht në përmirësimin e teknologjisë informatike, bazuar në analizat e hollësishme të zgjidhjeve moderne në teknologjinë informatike dhe zbatimin e tyre në procesin e kryerjes së revizionit dhe në sistemin e informacioneve. Në vitin 2024, u realizuan prokurimet e planifikuara në pjesën e TIK-së dhe sigurisë së TIK-së. Ishte zbatuar me sukses prokurimi i licencave për një grup më të madh përdoruesish, si faza e dytë e programit për transferimin e plotë të përdoruesve të veglave dhe serviseve "Microsoft Office 365". U zbatua edhe prokurimi i pajisjeve shumëfunksionale të printimit, të cilat rritën kapacitetin e printimit, të cilat janë integruar plotësisht në sistemin e printimit elektronik të zyrave të implementuar me sukses, me profile dhe role të përkufizuara të përdoruesve.

Gjithashtu, u realizuan prokurime për nevojat e revizionit, si për shembull prokurimi i laptopëve për punonjësit e rinj, me karakteristika që e mbulojnë procesin e revizionit dhe i ndjekin zgjidhjet moderne të TI-së dhe përmirësimet e sistemeve operative. U prokuruan edhe skanerë të rinj për të gjitha ekipet e revizorëve, duke mbuluar dy fusha - unifikimin në përdorimin e pajisjeve dhe rritjen e mundësive për konvertimin e dokumenteve të skanuara.

Si rezultat i rritjes së kapacitetit në pjesën e burimeve njerëzore, përkatësisht në pjesën e stacioneve të punës dhe serverëve, ESHR-ja realizoi prokurimin e zgjidhjes antivirus të dimensionuar në mënyrë përkatëse për mbrojtjen e plotë të stacioneve të punës dhe serverëve. Gjatë prokurimit, vëmendje e veçantë iu kushtua cilësisë së zgjidhjes, në përputhje me standardet dhe vlerësimet e njohura globalisht ("Kvadranti Gartner i zgjidhjeve në fushën e mbrojtjes kundër virusit").

Burimet financiare u siguruan përmes Buxhetit të Entit Shtetëror dhe me donacion nga NDI-ja dhe donacion nga UN Women.

Implementimi i zgjidhjes së re për administrimin e centralizuar të burimeve të TI-së ka përfunduar me sukses. Testimi dhe rezultate të shkëlqyera, ndërsa me kontrollin vjetor të stacioneve të punës, plotësisht ka përfunduar procesi i automatizuar i shpërndarjes së aplikacioneve softuerike, pakove të përmirësimit dhe copave të mbylljes.

Në pjesën e infrastrukturës së TI-së, u realizuan prokurime për shërbimet në pjesën e internetit në ambientet e ESHR-së, si dhe internetit të lëvizshëm, që i përfshin pajisjet për shërbimet e internetit në terren. Duke ofruar internet me shpejtësi më të lartë dhe kapacitet më të madh, është arritur qëllimi - lidhja e qëndrueshme me serverët dhe aplikacionet, pavarësisht se ku ndodhet përdoruesi. Është kryer prokurimi i lidhjes sekondare të internetit, si dhe prokurimi i shërbimeve të telefonisë fikse, të cilat ndihmojnë në mënyrë aktive në kryerjen e rregullt dhe të pandërprerë të aktiviteteve të revizionit.

Për punonjësit që i mbulojnë detyrat e administrimit të sistemit të TI-së, ESHR-ja siguroi mjete financiare me të cilat u realizua prokurimi publik i shërbimit - trajnimi i specializuar i administrimit, në dy fusha të TI-së (gjithsej tre kurse). Kurset janë pjesë e Programit të Microsoftit të edukimit të TI-së.

Praktika e shfrytëzimit të platformës profesionale përkatëse për mbajtjen e video-konferencave dhe takimeve me palët e brendshme dhe të jashtme vazhdoi edhe këtë vit. Pajisjet e video-konferencave shfrytëzohen në mënyrë aktive, të cilat përbëhen nga pajisje për shfrytëzim në sallë konferencash, si dhe pako të lëvizshme shtesë për video takime - për shfrytëzim në salla më të vogla.

Në pjesën e veglave softuerike specifike (CAATs) me ndihmën e të cilave revizori kryen një sërë testesh të automatizuara për vlerësimin e sistemit të informacioneve të subjektit ose të dhënave elektronike, ESHR-ja në vitin 2024 kreu prokurim për rinovimin e licencave për shfrytëzimin e softuerit IDEA. Në këtë mënyrë, ESHR-ja i siguroi edhe një herë versionet më të reja të kësaj vegle dhe të gjitha kapacitetet e tij - aktiviteti vendimtar që i mundëson institucionit të jetë në hap me zgjidhjet më moderne të TI-së.


Burime dhe kapacitete të mjaftueshme sigurohen vazhdimisht për funksionimin e papapuar të infrastrukturës dhe aplikacioneve të sistemit të informacioneve, duke u kujdesur për parimet dhe rregullat për: disponueshmërinë e të dhënave të përdoruesit të autorizuar, konfidencialitetin, integritetin, ruajtjen e sigurt të të dhënave në lokacionin qendror, harmonizimin me ligjet, ruajtjen e rregullt të kopjeve rezervë (backup), mbrojtjen nga qasja fizike dhe logjike e të dhënave. Gjithashtu, në mënyrë konsekuente zbatohet

Politika e Sigurisë së Sistemit të Informacioneve e Entit Shtetëror të Revizionit, me vëmendje të veçantë në zbatimin e procedurave të sigurisë së TI-së dhe procedurave të TI-së për zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Procesit të Revizionit.

Në vitin 2024, Enti Shtetëror i Revizionit iu bashkua iniciativës "pICTure" të IDI-së për të forcuar aspektin e menaxhimit të TIK-së në Institutet Supreme të Revizionit, dhe së bashku me 5 ISR të tjera, mori pjesë në programin e sigurisë së informacioneve. Me këtë aktivitet është realizuar me sukses vlerësimi i kapaciteteve të TI-së, në pjesën e përmbushjes së kërkesave të standardit ISO 27001:2022.

Vlerësimi mesatar për fushat e mbuluara nga vetëvlerësimi është i lartë, gjë që e tregon përkushtimin serioz të institucionit ndaj sigurisë së informacioneve dhe burimeve. Fushat e identifikuara për përmirësim janë mbuluar tashmë duke themeluar grupe pune për t'i reviduar procedurat ekzistuese të TI-së, si dhe duke zhvilluar politikë të re të TI-së.

Në kuadër të këtij Programi, në periudhën nga 27 deri më 30 gusht 2024, ESHR-ja organizoi punëtorinë mbi sigurinë e informacioneve, në të cilën morën pjesë 6 ISR nga Evropa dhe Afrika. Përfaqësuesi i ESHR-së mori pjesë edhe në punëtorinë me temë "pICTure workshop on Leading digital change" të organizuar nga IDI-ja, e cila u mbajt në Toledo, Portugali, në periudhën nga 16 deri më 20 shtator 2024.



3.4.

MJETET FINANCIARE PËR PUNËN E ESHR-SË

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) është Institucion Suprem i Revizionit i pavarur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili për më shumë se 25 vjet i ka informuar në mënyrë transparente, në kohë dhe objektive institucionet kompetente dhe publikun për gjendjet e konstatuara nga revizionet e kryera.

Enti Shtetëror i Revizionit e kreu punën e vet të rregullt në vitin 2024 përmes llogarive të mëposhtme:

- /// Mjetet nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut - 020021504063710
- /// Llogaria e të ardhurave - 020021504063119
- /// Llogaria e donatorit – projekti i ri i EUROSAI-t - 020021504078579

Buxheti i Entit Shtetëror të Revizionit është pjesë integrale e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Buxheti i miratuar fillimisht për vitin 2024 i Entit Shtetëror të Revizionit është në shumën totale prej 188.087 mijë denarë, nga të cilat 184.137

mijë denarë u miratuan për llogarinë e buxhetit themelor (637), ndërsa 3.000 mijë denarë u miratuan për llogarinë e buxhetit themelor (631).

Në bazë të analizave të kryera të Planit Vjetor të Prokurimeve Publike dhe procedurave të zbatuara të prokurimeve publike gjatë vitit 2024 dhe nevojave për mjetet financiare shtesë për Entin Shtetëror të Revizionit, Ministria e Financave gjatë vitit 2024 miratoi mjete financiare shtesë për ESHR-në.

Pas miratimit të mjeteve shtesë, buxheti i përgjithshëm i ESHR-së për vitin 2024 është 192.549 mijë denarë, nga të cilat për llogarinë e buxhetit themelor (637) të buxhetit të përcaktuar është 188.599 mijë denarë, ndërsa për llogarinë e buxhetit themelor (631) të buxhetit të përcaktuar është 3.000 mijë denarë dhe për llogarinë e sapohapur të buxhetit të donacioneve (785) është planifikuar buxhet në shumën prej 950 mijë denarë.



Duke siguruar mjete të mjaftueshme financiare për kryerjen e papenguar të kompetecave të Entit Shtetëror të Revizionit, është e mundur që Enti Shtetëror i Revizionit të sigurojë kthimin e drejtpërdrejtë të mjeteve në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes evazionit të përcaktuar tatimor.

Pra, me revizionet e kryera në kuadër të Programit Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024, vlera e shtuar nga revizionet e kryera nga

Enti Shtetëror i Revizionit siguron kthim në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe komunave në raportin 1:18 operkatësisht 1 buxhet i ESHR-së siguron kthim në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe komunave në shumën e të paktën 18 buxhete të ESHR-së, përkatësisht mjetet e paarkëtuara / më pak të llogaritura dhe të paguara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe komunave janë 3,515 milion denarë, përkatësisht 57 milion euro.

LLOGARIA E BUXHETIT THEMELOR TË ESHR-SË PËR VITIN 2024 - (020021504063710)

Mjetet e planifikuara për Llogarinë e Buxhetit Themelor të Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024 janë 188.599 mijë denarë, ndërsa janë realizuar mjete në shumën prej 178.024 mijë denarë ose 94,4%.

Rrogat, mëditjet dhe kompensimet


Pozicioni i rrogave, mëditjeve dhe kompensimeve, në përputhje me buxhetin e miratuar për vitin 2024 nga Ministria e Financave, është planifikuar në shumën totale prej 151.197 mijë denarë dhe është realizuar në shumën prej 141.467 mijë denarë, përkatësisht shkalla e realizimit e shprehur në përqindje është 94%.

Mallrat dhe shërbimet

Pozicioni i mallrave dhe shërbimeve për vitin 2024 ishte projektuar në shumën totale prej 28.950 mijë denarë me realizim prej 28.380 mijë denarë, përkatësisht shkalla e realizimit e shprehur në përqindje është 98.

Shpenzimet kapitale

Në këtë pozicion të shpenzimeve kapitale, janë planifikuar dhe miratuar mjetet nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024 për prokurimin e pajisjeve, makinave, mobiljeve për zyra, softuerëve, licencave dhe automjeteve në shumën prej 7.815 mijë denarë, ndërsa janë realizuar mjetet në shumën totale prej 7.729 mijë denarë ose 99%.


**LLOGARIA E BUXHETIT THEMELOR TË ESHR-SË PËR VITIN 2024 - (020021504063119)**

Enti Shtetëror i Revizionit ka llogarinë e vet 631 në punën e vet, nëpërmjet së cilës janë realizuar të ardhura nga arkëtimi i kompensimeve nga institucionet që janë lëndë e revizionit nga Enti Shtetëror i Revizionit në përputhje me tarifën e botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 30 nga 19.04.2000.

Tarifa e arkëtitimit përcaktoi procedurën për llogaritjen dhe faturimin e kompensimeve për kryerjen e revizionit shtetëror të subjekteve që janë lëndë e revizionit në përputhje me Ligjin për revizion shtetëror.

Me heqjen e arkëtitimit për revizionin e kryer në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 66 të vitit 2010, u ndërpre faturimi për revizionin e kryer të subjekteve, me këtë edhe evidentimi i kontabilitetit të të ardhurave në këtë llogari.

Në Llogarinë e Buxhetit Themelor (631) për vitin 2024 janë planifikuar mjetet në shumën totale prej 3.000 mijë denarë. Në periudhën raportuese nuk ka pasur realizim të mjeteve përmes kësaj llogarie.




LLOGARIA E BUXHETIT TË DONACIONEVE TË ESHR-SË PËR VITIN 2024 – EUROSAT – (020021504078579)

Mjetet e planifikuara në Llogarinë e Buxhetit të Donacioneve të Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024 (020021504078579) janë në shumën totale prej 950 mijë denarë, ndërsa janë realizuar shpenzimet në shumën prej 757 mijë denarë.

Mjetet e mësipërme janë donacion nga "EUROSAT" dhe janë të dedikuara për organizimin e ngjarjes dhe mbajtjen e konferencës me temë "Shkëmbimi i përvojave në procesin e komunikimit të ISR-ve me palët e interesuara - mundësitë dhe sfidat".

Projekti është zbatuar plotësisht deri në dhjetor 2024 dhe, në përputhje me mënyrën e mbajtjes së kontabilitetit për buxhetet dhe shfrytëzuesit buxhetorë dhe rregulloren për punën e thesarit, Llogaria është mbyllur.



Raporti i revizionit të kryer të punës materiale dhe financiare të ESHR-së nga revizori i pavarur është pjesë përbërëse e Raportit Vjetor për Revizionet

e Kryera dhe për Punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024.

3.5.

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE MBROJTJA E MJEDISIT JETËSOR

Bota moderne përballlet me një sërë sfidash që e rrezikojnë mbijetesën e mjedisit natyror dhe cilësinë e jetës së njerëzve. Ndryshimet klimatike, ndotja, shkatërrimi i ekosistemeve dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i burimeve kërkojnë përgjigje sistematike dhe të koordinuara, ndërsa Institucionet Supreme të Revizionit (ISR), përmes revizioneve të politikave dhe financave publike, kontribuojnë në "ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet" për menaxhimin efikas të programeve dhe aktiviteteve për të arritur Agjendën 2030 dhe për menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.


Në këtë drejtim, në disa vitet e fundit, ESHR-ja me revizionet i ka mbuluar Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe progresin e tyre. Përmes rekomandimeve konkrete dhe të qarta drejtuar institucioneve kompetente, ESHR-ja përfshihet në grupin e ISR-ve që marrin pjesë aktive në mbrojtjen e mjedisit jetësor, përmirësimin e kushteve sociale dhe ekonomike të jetës së njerëzve, uljen e varfërisë dhe mbështetjen e udhëzimeve për zhvillim të qëndrueshëm dhe për një të ardhme më të mirë për brezat e ardhshëm. Në përputhje me dokumentet strategjike dhe Programin Vjetor



të Punës për vitin 2024, janë zbatuar 11 revizione të suksesit dhe një revizion i pajtueshmërisë në lidhje me Strategjinë Nacionale të Zhvillimit 2024-2044 dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm:



Enti Shtetëror i Revizionit është thellësisht i përkushtuar për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme në të gjithë punën e vet. Çdo ditë, punonjësit punojnë për të krijuar zgjidhje që kontribuojnë për një të ardhme më të gjelbër dhe më të shëndetshme, me bindjen se çdo veprim i vogël mund të kontribuojë për një ndikim më të madh pozitiv, duke i ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme:



BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

04



4.1.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Gjatë vitit 2024, Enti Shtetëror i Revizionit vazhdoi me bashkëpunimin ndërkombëtar aktiv, i cili është segmenti kryesor në avancimin e kapaciteteve institucionale, shkëmbimin e praktikave të mira dhe harmonizimin me standardet ndërkombëtare të revizionit. Përmes pjesëmarrjes në konferenca, trajnime, takime bilaterale dhe multilaterale, rrjete dhe iniciativa projektesh, ESHR-ja ka forcuar pozicionin e vet si partner i besueshëm dhe i njohur në komunitetin ndërkombëtar të revizionit.

Aktivitetet ndërkombëtare kishin për qëllim forcimin e pavarësisë dhe dukshmërisë së institucionit, avancimin e proceseve të revizionit, zhvillimin e revizionit të TI-së, integrimin e perspektivës klimatike dhe gjinore në revizionet, si dhe forcimin e llogaridhënies publike dhe mbikëqyrjes parlamentare. Veçanërisht i rëndësishëm është bashkëpunimi me:

- /// Gjykatën Evropiane të Revizorëve (ESA),
- /// Komisionin Evropian,
- /// Këshillin Ndërkombëtar të Revizorëve të NATO-s (IBAN),
- /// Iniciativën për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI),
- /// Trupat e punës së EUROSAT-t dhe INTOSAI-t,
- /// Trupin e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women),
- /// Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP),
- /// Institutin Kombëtar Demokratik (NDI),
- /// Fondacionin Westminster për Demokraci (WFD),
- /// Bankën Botërore,
- /// OECD-SIGMA,
- /// Qendrën e Ekselencës në Financa (CEF),

- /// Institutin e Autorizuar për Financat Publike dhe Kontabilistët (CIPFA),
- /// Zyrën për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE – ODIHR),

si dhe me institucione të shumta supreme të revizionit nga Bashkimi Evropian dhe rajoni.

Përmes këtyre aktiviteteve, ESHR-ja kontribuon drejtpërdrejt në arritjen e prioritetëve nacionale të përmbytura në dokumentet strategjike dhe qëllimet globale për zhvillimin e qëndrueshëm.

ESHR-ja mori pjesë në ngjarje të shumta ndërkombëtare në vitin 2024, duke përfshirë:

KOMITETIN E KONTAKTIT TË BE-SË



Përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në takimet e rregullta brenda Komitetit të Kontaktit të BE-së, të cilat kishin të bëjnë me:

- /// Takimin e Pranverës së Oficerëve të Lidhjeve – 14 - 15 shkurt 2024, Bruksel, Belgjikë;
- /// Takimin e Komitetit të Kontaktit të ISR-ve nga vendet anëtare të BE-së – 15 - 17 tetor 2024, Pafos, Qipro.

Këto takime janë me rëndësi thelbësore për koordinimin midis institucioneve supreme të revizionit të vendeve anëtare dhe kandidatëve për anëtarësim në BE, shkëmbimin e praktikave të mira dhe informacioneve, realizimin e projekteve të përbashkëta dhe thellimin e bashkëpunimit.

Rrjetin e ISR-ve të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale për anëtarësim në BE.

Rrjeti i ISR-ve të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale për anëtarësim në BE është platformë për bashkëpunim, shkëmbim përvojash dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve supreme

të revizionit në procesin e integritetit evropian. Në vitin 2024, ESHR-ja mori pjesë aktive në aktivitetet e Rrjetit në kuadër të ngjarjeve të mëposhtme:

- /// Konferencën me temë "Llogaria Përfundimtare e Buxhetit Shtetëror" - 27 shkurt - 1 mars 2024, Budva, Mali i Zi, të organizuar me mbështetjen e OECD - SIGMA-së;
- /// Trajnimet për revizionin e suksesit për BLOK 5B - Faza e Raportimit - 19 - 23 shkurt 2024, online dhe për BLOK 6 - Punëtorja Përfundimtare - 13 - 17 maj 2024, Stokholm, Suedi, të organizuara nga Zyra Nacionale Suedeze e Revizionit;
- /// Punëtorinë mbi revizionin e avancuar të suksesit - 16 - 20 shtator 2024, Ankara, Turqi, të organizuar nga Zyra Nacionale Suedeze e Revizionit;
- /// Punëtorinë gjysmërajonale për revizionin e mbrojtjes - 4 - 5 nëntor 2024, Podgoricë, Mali i Zi, të organizuar nga Zyra Nacionale Suedeze e Revizionit;
- /// Punëtorinë mbi praktikën e njoftimit për rritjen e ndikimit - 7 - 8 nëntor 2024, Lubjanë, Slloveni, me mbështetjen e OECD - SIGMA-së në bashkëpunim me CEF, Lubjanë.

Përmes aktiviteteve të Rrjetit, ESHR-ja kontribuon në harmonizimin e proceseve të revizorit me praktikën më të mirë të BE-së, ndërtimin e kapaciteteve dhe mbështetjen e reformave institucionale për sundimin e së drejtës dhe qeverisjen e mirë.

Trajnimet për revizionin e suksesit, të zbatuara si një seri me mbështetjen e Zyrës Nacionale Suedeze të Revizionit (SNAO), kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve institucionale përmes shkëmbimit të përvojave praktike dhe vendosjes së rrjetit të qëndrueshëm rajonal për bashkëpunim profesional. Në kuadër të aktiviteteve të kryera në bashkëpunim me SNAO-në në vitin 2024, shtatë punonjës të ESHR-së morën certifikatë për trajnimin profesional të përfunduar për revizionin e suksesit.

Punëtorja kushtuar revizionit të sektorit të

mbrojtjes mundësoi avancimin e njohurive dhe praktikave në fushën e revizionit financiar përmes shkëmbimit të përvojave me institucionet e tjera supreme të revizorit dhe diskutimit mbi përballjen me sfidat kryesore në këtë fushë.

Punëtorja mbi praktikën e njoftimit për rritjen e ndikimit kontribuoi në përmirësimin e raporteve të revizorit, me fokus në forcimin e kuptimit dhe kuptueshmërisë së tyre nga perspektiva e lexuesit.



Në drejtim të forcimit të bashkëpunimit me Gjykatën Evropiane të Revizionit, u realizua:

- /// Takimi bilateral me kryetarin e Gjykatës Evropiane të Revizionit, z. Toni Marfi - 3 tetor 2024, Luksemburg.


Takimi me kryetarin, z. Toni Marfi dhe përfaqësuesit e Gjykatës Evropiane të Revizionit u përqendrua në shkëmbimin e përvojave mbi revizionet e mjetëve të BE-së, veçanërisht në kontekstin e Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor dhe Agjendës së Reformave. U diskutuan mundësitë për bashkëpunim institucional përmes stazhimeve, trajnimeve dhe mbështetjes nga ekspertët.



Me qëllim të forcimit të bashkëpunimit me trupat e BE-së, në vitin 2024 u realizua:

- /// Vizita zyrtare e Drejtorive të Përgjithshme të Komisionit Evropian për Politikën Rajonale dhe Urbane (DG REGIO), për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (DG AGRI) dhe për Negociatat e Fqinjësisë dhe Zgjerimit (DG NEAR) dhe Zyrën Evropiane për Luftën kundër Mashtrimeve (OLAF) - 28 janar - 1 shkurt 2024, Bruksel, Belgjikë.

Vizita ishte me rëndësi të jashtëzakonshme për forcimin e bashkëpunimit institucional të ESHR-së me trupat evropiane të mbikëqyrjes dhe luftës kundër mashtrimeve. Diskutimet me përfaqësuesit e OLAF-it dhe Komisionit Evropian kontribuan në avancimin e mekanizmave të transparencës dhe integritetit.



Përmes pjesëmarrjes në aktivitetet e IDI-së që kanë të bëjnë me:

- /// Punëtorinë për sigurinë e TI-së – 27 - 30 gusht 2024, Shkup, të organizuar nga ESHR-ja;
- /// Konferencën Ndërkombëtare të Revizorëve për vitin 2024 – 10 - 13 prill 2024, Bernë, Zvicër;
- /// Uebinarin e Tregut të Inovacioneve të ISR-së me temë: "Revizioni i laboratorit të QZHQ-ve nga ISR-ja e Tajlandës: Opinione mbi dizajnimin e qasjes për forcimin e revidimit inovativ për Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm" – 8 maj 2024, online;
- /// Pjesëmarrjen në punëtorinë "pICTure workshop on Leading digital change" – 16 - 20 shtator 2024, Toledo, Spanjë;
- /// Takimin e liderëve të rinj të ISR-së – 30 shtator – 4 tetor 2024, Kigali, Ruanda;
- /// Samitin global mbi kontributin e revizioneve të ISR-ve në digjitalizim dhe qëndrueshmëri – 18 dhe 19 nëntor 2024, online;
- /// Uebinarin me temë: Revizioni i suksesit: Revizionet si imput për zhvillimin e politikave sektoriale dhe dialogut – 17 dhjetor 2024, online;

ESHR-ja siguron përmirësimin e vazhdueshëm të njohurive të revizorëve, veçanërisht në fushat e pavarësisë së ISR-së, bashkëpunimit midis revizionit të brendshëm dhe të jashtëm, sigurisë

së TI-së, lidhshimit dhe transformimit digjital. Këto aktivitete kontribuojnë në rritjen e gatishmërisë dhe efikasitetit të ESHR-së për t'u përballur me sfidat moderne në fushën e revizionit dhe teknologjisë.

BORDI NDËRKOMBËTAR I REVIZORËVE TË NATO-S (IBAN)



Bashkëpunimi me Bordin Ndërkombëtar të Revizorëve të NATO-s (IBAN) është forcuar ndjeshëm nëpërmjet pjesëmarrjes në:

- /// Takimin vjetor të IBAN-it – 14 - 15 maj 2024, Bruksel, Belgjikë;
- /// Takimin bilateral për nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit – 10 tetor 2024, Shkup.

Pjesëmarrja e ESHR-së në ngjarjet e IBAN-it paraqet kontribut të rëndësishëm në forcimin e mbikëqyrjes financiare në fushën e mbrojtjes. Përmes pjesëmarrjes në takimet dhe formalizimit të bashkëpunimit bilateral, ESHR-ja fiton qasje në standardet dhe praktikatat më të larta për revizionin e buxheteve të mbrojtjes dhe sigurisë. Nënshkrimi i Memorandumit në mënyrë plotësuese e forcoi bashkëpunimin me IBAN-in.

GRUPI I PUNËS SË INTOSAI-T PËR BORXHIN PUBLIK




ESHR-ja si anëtar aktiv i Grupit të Punës së INTOSAI-t për borxhin publik, mori pjesë në:

- /// Takimin Vjetor të Grupit të Punës së INTOSAI-t për borxhin publik (WGPD) – 5 - 7 qershor 2024, Baku, Azerbajxhan.

Në takim u shqyrtuan sfidat moderne në menaxhimin e borxhit publik dhe roli i ISR-së në sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies,


gjë që mundëson shqyrtimin e qasjeve dhe përmirësimin e mjeteve për revizionin e borxhit publik dhe disiplinës fiskale.



Pjesëmarrja e ESHR-së në:

- /// Kongresin e XII të EUROSAI-t - 27 dhe 28 maj 2024, online,

ishte mundësi e rëndësishme për t'u përfshirë në drejtimet strategjike të organizatës evropiane të ISR-ve për periudhën e ardhshme. Kongresi shënoi fillimin e kryesimit të ri të EUROSAI-t në udhëheqjen e ISR-së së Izraelit dhe miratoi zyrtarisht Planin e ri Strategjik të EUROSAI-t për vitet 2024-2030. Kongresi i trajtoi rezultatet e arritura në periudhën e mëparshme, përzgjedhjen e anëtarëve të rinj të Bordit Drejtues dhe revizorit të organizatës, si dhe miratimin e Deklaratës së Jerusalemit. Theksojmë se ESHR-ja kandidoi për herë të parë për revizor të EUROSAI-t për periudhën 2024-2026 dhe mori mbështetjen nga një numër i konsiderueshëm i ISR-ve, ndërsa Gjykata Holandeze e Revizionit u zgjodh për këtë pozicion.



ESHR-ja ofron mbështetje për brezat e rinj të revizorëve përmes pjesëmarrjes në:

- /// - Kongresin e 6-të të Rinjve të EUROSAI-t - 24 dhe 28 qershor 2024, Goławice, Poloni.

Pjesëmarrja e ESHR-së në Kongresin e 6-të të Rinjve të EUROSAI-t, kushtuar temës së inteligjencës artificiale, është hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të brezit të ri të revizorëve të përgatitur për sfidat e epokës digjitale. Kongresi inkurajoi diskutimin mbi integrimin e mjeteve të reja digjitale në proceset e revizorit dhe konfirmoi interesin dhe kapacitetin e revizorëve të rinj për të kontribuar në transformimin digjital.

GRUPI I PROJEKTIT TË EUROSAI-T PËR QËLLIMIN STRATEGJIK 1 "KLUBI UDHËTUES I EKSPERTËVE"



ESHR-ja mori pjesë në aktivitetet e Grupit të Projektit të EUROSAI-t për Qëllimin Strategjik 1 "Klubi Udhëtues i Ekspertëve", i cili i referohet:

- /// Uebinarit me temë "Përsosja e teknikave të përzgjedhjes së ekzemplarit" - 30 prill 2024, online;
- /// Takimit final të Grupit të Projektit - 5 qershor 2024, formati hibrid.

Këto aktivitete kishin për qëllim forcimin e kapaciteteve për zbatimin e metodologjive për përzgjedhjen e ekzemplarit dhe përmirësimin e procesit të revizorit. Përmes shkëmbimit të praktikave të mira, ESHR-ja përmirëson praktikën e revizorit të bazuar në vlerësimin e rreziqeve dhe ofrimin e dëshmimeve të revizorit.

GRUPI I PROJEKTIT TË EUROSAI-T PËR QËLLIMIN STRATEGJIK 1 MBI PËRFITIMET DHE METODOLOGJITË E REVIZIONIT NË KOHË REALE



Revizioni në kohë reale, si qasje që mundëson ndjekjen dhe vlerësimin në kohë të aktiviteteve aktuale për të rritur efektivitetin dhe llogaridhënien, ishte në fokus të:

- /// Takimit të Grupit të Projektit të EUROSAI-t mbi përfitimet dhe metodologjitë e revizionit në kohë reale - 4 - 5 qershor 2024, Budapest, Hungari.

Përfitimet e pjesëmarrjes në takimin e Grupit të Projektit të revizionit në kohë reale shihen në avancimin e njohurive metodologjike, shkëmbimin e përvojave me ISR të tjera, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe iniciimin e aktiviteteve për zhvillimin e qasjeve dhe standardeve të përbashkëta në fushën e revizionit në kohë reale.

GRUPI I PROJEKTI TË EUROSAT PËR REZISTENCËN DHE PËRGATITJEN



ESHR-ja mori pjesë në punën e Grupit të Projektit të EUROSAT-t për rezistencën dhe përgatitjen, në kuadër të:

- /// Takimit të Grupit të Projektit të EUROSAT-t për rezistencën dhe përgatitjen me temë "Përgatitja për krizat e ardhshme shëndetësore" - 22 - 23 janar 2024, Pragë, Çeki;
- /// Uebinarit me temë "Dezinformatat dhe rëndësia e besimit të publikut në të dhënat" - 12 shtator 2024, online.

Përfshirja e ESHR-së në aktivitetet e Grupit të Projektit të EUROSAT-t për rezistencën dhe përgatitjen, siç janë krizat shëndetësore dhe lufta kundër dezinformatave, kontribuon në ndërtimin e kapaciteteve institucionale për t'u përballur me gjendjet e krizës dhe sfidat me të cilat përballet sektori publik.

GRUPI I PUNËS SË EUROSAT PËR REVIZIONET E TI-SË



Me qëllim të forcimit të kapaciteteve të revizionit të TI-së, përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në:

- /// Seminarin elektronik: "Shpenzimet qeveritare për TI-në - A janë nën kontroll?" - 24 prill 2024, online;
- /// Takimin e 17-të të Grupit të Punës së EUROSAT-t për revizionet e TI-së - 24 - 25 shtator 2024, Oslo, Norvegji.

Këto aktivitete mundësuan diskutim mbi sfidat që lidhen me shpenzimet e TI-së dhe veglat për mbikëqyrjen e mjeteve publike në epokën digjitale, gjë që kontribuon në forcimin e kapaciteteve të revizionit të sistemeve të TI-së dhe prokurimeve publike që lidhen me teknologjinë e TI-së.

GRUPI I PUNËS SË EUROSAT PËR REVIZIONIN E KOMUNAVE



ESHR-ja jep kontribut të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve të revizionit të komunave përmes pjesëmarrjes në aktivitetet e Grupit të Punës së EUROSAT-t për revizionin e komunave, të zbatuara përmes:

- /// Seminarit të 7-të "Projektet infrastrukturore të vetëqeverisjes lokale" dhe Takimit të 8-të Vjetor të Grupit të Punës së EUROSAT-t për revizionin e komunave (WGMA) - 2 - 5 tetor 2024, Tbilisi, Gjeorgji;
- /// Masterklasit të 5-të mbi përzgjedhjen e ekzemplarit dhe përcaktimin e fushëveprimit të revizionit - 18 dhjetor 2024, online.

Në takimin vjetor të Grupit të Punës së EUROSAT-t për revizionin e komunave dhe seminarin mbi projektet infrastrukturore në nivel lokal, ESHR-ja i ndau përvojat e veta nga revizionet e projekteve komunale dhe prezantoi aktivitetet që lidhen me metodologjinë dhe bashkëpunimin me autoritetet lokale. Në takim u prezantua edhe përmbajtja e numrit 7 të revistës EUROSAT WGMA, e cila publikoi artikull mbi Raportin Përmbledhës mbi revizionet e rregullshme të njëjësive të vetëqeverisjes lokale nga ESHR-ja, aktivitetet e planifikuara në të ardhmen për vitin 2025 dhe iniciativat e reja për zbatimin e revizioneve kooperative.

Masterklasi për përzgjedhjen e ekzemplarit dhe përcaktimin e fushëveprimit të revizionit ofroi shembuj dhe vegla praktike për përzgjedhjen e ekzemplarit në revizionet e buxheteve dhe projekteve komunale.

**GRUPET E PUNËS PËR
REVIZIONIN E MJEDISIT
JETËSOR - INTOSAI DHE
EUROSAI WGEA**



Avancimi i revizionit të mjedisit jetësor është prioritet i lartë për ESHR-në, për arritjen e të cilit përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në më shumë ngjarje ndërkombëtare relevante, të tilla si:

- /// E-Seminari me rastin e Ditës Botërore të Ujit, në kuadër të EUROSAI WGEA - 22 mars 2024, online;
- /// Takimi i përbashkët i ISR-së së INTOSAI-t, i organizuar nga Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale i Kombeve të Bashkuara (UNDESA) dhe ISR-së së Brazilit me temë "Thirrja globale ClimateScanner: Angazhimi i Institucioneve Supreme të Revizionit në vlerësimin e aktiviteteve klimatike nacionale" - 25 - 26 mars 2024, Nju Jork, SHBA;
- /// Simpoziumi i 26-të i KB-së/INTOSAI-t me temë "Zbatimi i QZHQ 13 mbi veprimin klimatik", me pjesëmarrjen e INTOSAI WGEA - 16 - 18 prill 2024, Vjenë, Austri;
- /// Sesioni Pranveror i EUROSAI WGEA në vitin 2024 - 15 - 16 maj 2024, Floriana, Maltë;
- /// Punëtorja mbi përdorimin e mjetit ClimateScanner, në kuadër të INTOSAI WGEA - 3 - 7 qershor 2024, Pragë, Çeki;
- /// Takimi Vjetor i EUROSAI WGEA - 3 - 4 tetor 2024, online.

Pjesëmarrja aktive në ngjarjet brenda kornizës së Grupeve të Punës së INTOSAI-t dhe EUROSAI-t për revizionin e mjedisit jetësor e forcon rolin e ESHR-së në përpjekjet globale për të monitoruar dhe reviduar çështjet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe përballjen me ndryshimet klimatike. Përmes pjesëmarrjes në simpoziume, trajnime dhe punëtori, ESHR-ja ofron qasje të drejtpërdrejtë në mjetet më të reja, të tilla si ClimateScanner dhe metodologjitë ndërkombëtare për vlerësimin e politikave ekologjike, dhe e rrit rëndësinë në përmbushjen e detyrimeve nacionale dhe ndërkombëtare që lidhen me Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm, veçanërisht QZHQ 13 - Veprimi Klimatik.

ESHR-ja iu bashkëngjiti 141 ISR-ve nga e gjithë bota dhe iu përgjigj detyrës së Skanerit Klimatik¹² rezultatet e së cilës u prezantuan në Konferencën Botërore të Klimës KOP29 të mbajtur në Baku, Azerbajxhan, ku morën pjesë shefat e shteteve dhe qeverive nga 200 vende, përfshirë edhe vendin tonë. Bazuar në gjendjet dhe rreziqet e konstatuara në aspektin e zbutjes së ngrohjes globale dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, ESHR-ja e zbatoi revizionin e suksesit në vitin 2024 me temë "Gatishmëria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në përballjen me ndryshimet klimatike".



¹² ClimateScanner (Skaneri Klimatik) është iniciativë e udhëhequr nga ISR-ja e Brazilit brenda INTOSAI WGEA, e cila ka për qëllim të zhvillojë dhe promovojë mjetin inovativ për vlerësim të shpejtë të aktiviteteve qeveritare në lidhje me ndryshimet klimatike.

BASHKËPUNIMI BILATERAL DHE RAJONAL ME ISR-TË

ZYRA NACIONALE E REVIZIONIT E NORVEGJISË
(NAON, PARAPRAKISHT OAGN)

Memorandumi i Bashkëpunimit i nënshkruar në vitin 2022 midis Entit Shtetëror të Revizionit dhe Zyrës Nacionale të Revizionit të Norvegjisë (NAON, parapraakisht OAGN), krijoi kornizë formale për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe shkëmbimin e përvojave dhe njohurive, veçanërisht në fushat e revizionit të suksesit dhe revizionit të TI-së, me qëllim të avancimit të kapaciteteve të revizorit, zbatimit të metodave inovative dhe avancimit të praktikave të revizorit në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në vitin 2024, u zbatuan më shumë aktivitete në bashkëpunim me Zyrën Nacionale të Revizionit të Norvegjisë, që kanë të bëjnë me:

TI-NË DHE LABORATORIN INOVATIVE

- /// Trajnimi për kontrollet e përgjithshme dhe të zbatueshme për revizorët financiarë – 19 - 23 shkurt 2024, Shkup;
- /// Trajnimi për revizionin e konfigurimit të Windows dhe Active Directory (AD) – 26 - 28 shkurt 2024, Shkup;
- /// Sesionet e punës së Laboratorit Inovativ – 10 - 14 qershor 2024, Oslo, Norvegji;
- /// Punëtorja për sigurinë e TI-së – 26 shtator – 1 tetor 2024, Oslo, Norvegji;
- /// Punëtorja për revizionin e Active Directory dhe MS SQL dhe trajnimi QS08 – 11 - 15 nëntor 2024, Shkup;

- /// Punëtorja për ueb-aplikacionin në kuadër të Laboratorit Inovativ – 19 - 21 nëntor 2024, Shkup.

Ngjarjet në fushën e TI-së dhe Laboratorit Inovativ janë investim vendimtar në forcimin e kapaciteteve të TI-së së ESHR-së, veçanërisht në kontekstin e rëndësisë në rritje të revizionit të TI-së, sigurisë së shtuar të të dhënave dhe aftësisë për t'u përballur me rreziqet që lidhen me mjedisin digjital.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të ESHR-së në sesionet e punës në kuadër të Laboratorit Inovativ solli përfitime të konsiderueshme përmes zhvillimit dhe avancimit të ueb-aplikacionit për revizionin e prokurimeve publike, duke siguruar kështu realizimin e idesë së dhënë në Hakatonin e organizuar në vitin 2023, si ngjarje që mundëson zhvillimin e ideve inovative për mjetet dhe qasjet që mund t'i përmirësojnë proceset e revizorit.

REVIZIONET E SUKSESIT

Në kuadër të aktiviteteve për rritjen e njohurive dhe aftësive të punonjësve të ESHR-së në fushën e RS-së dhe shkëmbimin e përvojave të ndërsjella me punonjësit e Zyrës Nacionale të Revizionit të Norvegjisë, u organizuan ngjarjet e mëposhtme:

- /// Mbështetja për pilot-revizionet e suksesit – faza e njoftimit – shkurt 2024, online;
- /// Punëtorja për pilot-revizionet e suksesit – faza e planifikimit – 22 - 26 prill 2024, Shkup;
- /// Punëtorja për pilot-revizionet e suksesit – faza e zbatimit – 10 - 14 qershor 2024, Oslo, Norvegji;
- /// Punëtorja për pilot-revizionet e suksesit – faza e njoftimit – 17 - 20 shtator 2024, Shkup.

Aktivitetet e pilot-revizioneve të suksessit të zbatuara në bashkëpunim me Zyrën Nacionale të Revizionit të Norvegjisë janë me rëndësi strategjike për avancimin e qasjes së ESHR-së ndaj revizionit të suksessit. Përmes trajnimeve të fokusuara dhe mbështetjes praktike në zbatimin e dy revizioneve të suksessit në përputhje me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2024, të cilat lidhen me tema të tilla si partneriteti privat publik dhe pajisjet mjekësore moderne, ekipet e revizorit i avancuan qasjet e tyre metodologjike dhe teknikat e revizorit, ndërkohë që ndanë përvojat me partnerët me përvojë.

PLANIFIKIMI I AKTIVITETEVE TË PROJEKTIT DHE TAKIMI VJETOR

Në kuadër të aktiviteteve për përkufizimin dhe konfirmimin e aktiviteteve në kuadër të projektit të bashkëpunimit në nivel vjetor, u mbajtën ngjarjet e mëposhtme:

- /// Takimi online për planifikimin e aktiviteteve të projektit për vitin 2024 – 28 shkurt 2024, online;
- /// Takimi vjetor i projektit me Zyrën Nacionale të Revizionit të Norvegjisë – 3 prill 2024, Shkup;
- /// Misioni për planifikimin e aktiviteteve të projektit për vitin 2025 – 3 - 4 dhjetor 2024, Shkup.

Takimet për planifikimin e aktiviteteve të projektit dhe takimi vjetor me Zyrën Nacionale të Revizionit të Norvegjisë mundësojnë koordinimin e prioriteteve, vlerësimin e rezultateve të deritanishme dhe përcaktimin e drejtimeve të ardhshme për bashkëpunim.

GJYKATA E REVIZIONIT TË HOLANDËS



**Netherlands
Court of Audit**

Bashkëpunimi rajonal me Gjykatën e Revizionit të Holandës u realizua në kuadër të Programit të Konstituencës për vitin 2024 përmes ngjarjeve të mëposhtme:

- /// Takimi i parë online me temë: Etika (në marrëdhëniet me palët e interesuara) dhe Brendimi i ISR-së – 5 prill 2024;
- /// Takimi i dytë online me temë "Programi i revizionit - angazhimi i palëve të interesuara në Programin e revizionit dhe rrjedha e revizioneve" – 26 prill 2024;
- /// Punëtorja me temë "Rritja e ndikimit të revizionit nëpërmjet angazhimit të palëve të interesuara" – 3 - 7 qershor 2024, Hagë, Holandë.

Bashkëpunimi me Gjykatën e Revizionit të Holandës kishte për qëllim avancimin e rëndësisë së ISR-së nëpërmjet angazhimit të palëve të interesuara dhe promovimit të transparencës. Përfitimet për ESHR-në janë të dukshme nëpërmjet rritjes së ndërveprimit me publikun dhe forcimit të komunikimit me palët e interesuara në përgatitjen dhe zbatimin e revizioneve dhe njoftimin mbi rezultatet e revizioneve të zbatuara, të përshkruara në detaje në pjesën 2. Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesuara të këtij Raporti Vjetor.

GJYKATA E REVIZIONIT TË REPUBLIKËS SË SLOVENISË



**REPUBLIC OF SLOVENIA
COURT OF AUDIT**

Bashkëpunimi me Gjykatën e Revizionit të Republikës së Sllovenisë në vitin 2024 u realizua nëpërmjet:

- /// Vizitës bilaterale të Delegacionit të Gjykatës së Revizionit të Republikës së Sllovenisë të udhëhequr nga kryetarja, znj. Jana Ahçin – 5 - 7 mars 2024, Shkup;
- /// Pjesëmarrjes në 30-vjetorin e themelimit të Gjykatës së Revizionit të Republikës së Sllovenisë – 8 - 9 dhjetor 2024, Lubjanë, Slloveni.


Bashkëpunimi i forcuar bilateral me Gjykatën e Revizionit të Republikës së Sllovenisë ka mundësuar shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në fushën e revizionit, veçanërisht në kontekstin e luftës kundër korrupsionit, revizionit të fondeve të BE-së dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, dhe është bazë për aktivitetet e përbashkëta në të ardhmen.



Bashkëpunimi me Zyrën Nacionale të Revizionit të Maltës u forcua nëpërmjet:

- /// Vizitës bilaterale të Delegacionit të ESHR-së në Maltë – 20 - 23 mars 2024, Valeta, Maltë;
- /// Takimit për të prezantuar zgjidhjen e TI-së për ndjekjen e aktiviteteve të revizorit të Zyrës Nacionale të Revizionit të Maltës - 6 qershor 2024, online;
- /// Vizitës bilaterale të Delegacionit të Zyrës Nacionale të Revizionit të Maltës, i udhëhequr nga kryerevizori shtetëror, z. Çarls Deguara – 22 - 25 tetor 2024, Shkup dhe Ohër.

Gjatë vizitës bilaterale në Maltë në mars të vitit 2024, ishte nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit, i cili përcaktoi kornizën për shkëmbimin profesional, aktivitetet e përbashkëta dhe avancimin e praktikave të revizorit. Vizita e dytë bilaterale iu kushtua shkëmbimit të përvojave mbi metodologjitë e vlerësimit të rreziqeve në planifikimin e revizioneve, revizionet e vetëqeverisjes lokale dhe ndjekjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Të dy institucionet e konfirmuan angazhimin e tyre për thellimin e bashkëpunimit, me qëllim të avancimit të efektivitetit, efikasitetit dhe llogaridhënies në shfrytëzimin e mjeteve publike.



Në bashkëpunim me Zyrën Supreme të Revizionit të Republikës së Polonisë (NIK), në vitin 2024 u zbatua procedura e kontrollit profesional të cilësisë së punës së ESHR-së (peer review), në kuadër të së cilës u zbatuan një sërë aktivitete që kanë të bëjnë me:

1. Vizitën bilaterale të Delegacionit të Zyrës Supreme të Revizionit të Republikës së Polonisë, të udhëhequr nga kryetari z. Marian Banash – 27 mars 2024, Shkup;

2. Vizitën bilaterale të Delegacionit të ESHR-së dhe nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për zbatimin e peer review – 17 - 21 korrik 2024, Goławice, Poloni;
3. Misionin peer review (1) mbi "Zbatimin e metodologjive për revizionin financiar, revizionin e pajtueshmërisë dhe revizionin e suksesit" – 8 - 11 korrik 2024 - Shkup;
4. Misionin peer review (2) mbi "Zbatimin e metodologjive për revizionin financiar, revizionin e pajtueshmërisë dhe revizionin e suksesit" – 19 - 22 gusht 2024 - Ohër;
5. Misionin peer review mbi "Komunikimin dhe bashkëpunimin me palët e interesuara" – 22 - 25 korrik 2024 - Shkup;
6. Misionin peer review mbi "Pavarësinë dhe menaxhimin e burimeve njerëzore" – 29 korrik - 1 gusht 2024, Shkup.

Kontrolli profesional i cilësisë së punës (peer review) ishte zbatuar në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar midis dy institucioneve, si dhe Udhëzimet INTOSAI GUID 1900 për kryerjen e peer review. Disa misione u kryen në korrik dhe gusht 2024, të cilat rezultuan në hartimin e Raportit të Kontrollit Profesional të Cilësisë së Punës (peer review).

Konkluzioni i përmbajtur në Raport është se puna e ESHR-së është harmonizuar me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të institucioneve supreme të revizionit, ndërsa në drejtim të arritjes së pavarësisë së plotë, jepet rekomandimi për përpjekjet e mëtejshme për të miratuar draft-ndryshimet e Kushtetutës dhe Ligjin e ri të propozuar për revizion shtetëror, si parakushte pa të cilat Enti Shtetëror i Revizionit nuk do të jetë në gjendje të ruajë progresin e arritur.



Interesi për thellimin e bashkëpunimit me Gjykatën e Revizionit të Republikës së Italisë (Corte dei conti) rezultoi me:

- /// Vizitën bilaterale të Delegacionit të ESHR-së në Itali – 10 - 11 prill 2024, Romë, Itali.

Në kuadër të vizitës bilaterale, u shkëmbyen përvoja dhe qëndrime mbi zhvillimin institucional, sfidat dhe udhëzimet strategjike të të dy institucioneve. Takimi rezultoi me nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit me Gjykatën e Revizionit të Republikës së Italisë (Corte dei conti), i cili vendosi kornizë për shkëmbimin e informacioneve, praktikave të mira dhe mbështetjes profesionale.

ZYRA SUPREME E REVIZIONIT TË REPUBLIKËS SLOVAKE



Një rol të rëndësishëm ka bashkëpunimi i forcuar me Zyrën Supreme të Revizionit të Republikës Slovake si kryesues i ardhshëm i EUROSAT-t, i cili në vitin 2024 u realizua nëpërmjet:

- /// Vizitës bilaterale në Institutin Suprem të Revizionit të Republikës Slovake, me mbështetjen e UNDP-së - 15 - 18 prill 2024, Bratisllavë, Sllovaki;
- /// Seminarit online me temë "Trendet aktuale në njoftimin për ESG (Environment, Social and Government) dhe shembujt praktikë në Republikën Slovake", të organizuar nga Zyra Supreme e Revizionit të Republikës Slovake në bashkëpunim me institucionet e tjera - 4 shtator 2024, online;
- /// Konferencës mbi revizionin e partive politike dhe financimin e fushatave zgjedhore - 27 nëntor 2024, Bratisllavë, Sllovaki.

Gjatë vizitës bilaterale nga Delegacioni i ESHR-së, u zhvilluan takime të rëndësishme me kryetarin e Zyrës Supreme të Revizionit të Republikës Slovake dhe kryesuesin e ardhshëm të EUROSAT-t për periudhën 2027-2030, z. Lubomir Andrashi dhe përfaqësuesit e UNDP-së, të cilët u përqendruan në shkëmbimin e përvojave nga revizionet që lidhen me fondet e BE-së, projektet infrastrukturore dhe shëndetësore, si dhe shfrytëzimin e veglave softuerike në praktikën e revizionit dhe mundësitë për trajnime të përbashkëta.

Fokusi i Konferencës mbi revizionin e partive politike dhe financimin e fushatave zgjedhore ishte llogaridhënia politike dhe transparencja financiare, si dhe shkëmbimi i praktikave të mira në monitorimin e financimit të fushatave zgjedhore.

ZYRA SUPREME E REVIZIONIT TË REPUBLIKËS ÇEKE



Thellimi i bashkëpunimit me Zyrën Supreme të Revizionit të Republikës Çeke, si kryesues i fundit i EUROSAT-t për periudhën 2021-2024, është me rëndësi thelbësore për ESHR-në, sepse në vitin 2024 u realizua:

- /// Vizita bilaterale nga kryetari i Zyrës Supreme të Revizionit të Republikës Çeke, z. Miroslav Kala - 15 - 16 shtator 2024, Shkup.

Takimi kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave, avancimin e bashkëpunimit bilateral dhe rritjen e pjesëmarrjes së ESHR-së në iniciativat e EUROSAT-t.

GJYKATA E REVIZIONIT TË RUMANISË



Me ftesën e kryetarit të Gjykatës së Revizionit të Rumanisë, z. Mihai Busuioc, Delegacioni i ESHR-së mori pjesë në ngjarjen solemne me rastin e:

- /// 160-vjetorit të themelimit të Gjykatës së Revizionit të Rumanisë - 17 - 18 shtator 2024, Bukuresht, Rumani.

Në kuadër të ngjarjes u mbajtën panel-diskutime mbi temat relevante, si dhe takime bilaterale me përfaqësuesit e më shumë ISR-ve për t'i konstatuar mundësitë e bashkëpunimit.

ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT I REPUBLIKËS SË KROACISË



Delegacioni i ESHR-së mori pjesë në ngjarjen solemne me rastin e:

- /// 30-vjetorit të Entit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Kroacisë – 21 nëntor 2024, Zagreb, Kroaci.

Në konferencën solemne me rastin e 30-vjetorit, u prezantuan sukseset e rëndësishme të Entit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Kroacisë në punën dhe bashkëpunimin me komunitetin akademik dhe ndërkombëtar.

INSTITUCIONI SHTETËROR I REVIZIONIT I REPUBLIKËS SË SERBISË



Në vitin 2024, u mbajtën më shumë ngjarje të përbashkëta me Institucionin Shtetëror të Revizionit të Republikës së Serbisë për të zbatuar revizione paralele në lidhje me Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm, përkatësisht:

- /// Takimi bilateral për të diskutuar raportin e përbashkët të revizionit paralel të gatishmërisë për zbatimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2023 dhe temat për zbatimin e revizionit të ri bashkëpunues - 28 - 29 mars 2024, Beograd, Serbi, me mbështetjen e UNDP-së;
- /// Ngjarja promovuese e raportit të përbashkët të revizorit nga revizioni paralel me Institucionin Shtetëror të Revizionit të Republikës së Serbisë mbi gatishmërinë për zbatimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2023 - 22 maj 2024, Shkup, me mbështetjen e UNDP-së;
- /// Konferenca me rastin e 180-vjetorit të themelimit të parë të ISR-së në Republikën e Serbisë - 24 - 26 korrik 2024, Beograd, Serbi;

- /// Takimi bilateral i punës mbi revizionin bashkëpunues të suksesit me temë "Planifikimi urbanistik i infrastrukturës së gjelbër në qytetet" - 26 - 27 shtator 2024, Beograd.

Bashkëpunimi midis ESHR-së dhe Institucionit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Serbisë përmes zbatimit të revizioneve bashkëpunuese/ paralele të suksesit mbi temat që lidhen me Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ) është hap i rëndësishëm drejt avancimit rajonal të llogaridhënies publike dhe cilësisë së politikave publike. Këto aktivitete janë shembull i bashkëpunimit konstruktiv që inkurajon harmonizimin e praktikës së revizorit me standardet globale dhe kontribuon në arritjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm në rajon.

Gjatë shënimit të 180-vjetorit të themelimit të parë të ISR-së në Republikën e Serbisë, në shenjë të bashkëpunimit jashtëzakonisht të mirë midis Entit Shtetëror të Revizionit dhe Institucionit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Serbisë dhe aktiviteteve të përbashkëta të zbatuara me sukses, kryetari i Institucionit Shtetëror të Revizionit, z. Dushko Pejoviq, i dorëzoi Fletëmirënjohjeje kryerevizorit shtetëror, mr. Maksim Acevski, me pritshmëri të sigërta që ky bashkëpunim i suksesshëm të vazhdojë edhe në të ardhmen.

ZYRA E REVIZIONIT TË INSTITUCIONEVE TË BOSNJË DHE HERCEGOVINËS



Në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit të nënshkruar me Zyrën e Revizionit të Institucioneve të Bosnjë e Hercegovinës, në vitin 2024 u realizua:

- /// Vizita bilaterale e Delegacionit të Zyrës së Revizionit të Institucioneve të Bosnjë dhe Hercegovinës, i udhëhequr nga kryerevizori shtetëror, z. Hrvoje Tëvrtković - 30 - 31 maj 2024, Shkup.

Gjatë vizitës bilaterale u shkëmbyen përvojat në lidhje me luftën kundër korrupsionit, praktikat e komunikimit, revizionin e fondeve të BE-së, buxhetin themelor, projektet kapitale dhe zhvillimin profesional të punonjësve, si dhe u shqyrtuan mundësitë për aktivitetet e përbashkëta në të ardhmen.

INSTITUCIONI SHTETËROR I REVIZIONIT I MALIT TË ZI



Thellimi i bashkëpunimit me Institucionin Shtetëror të Revizionit të Malit të Zi u realizua nëpërmjet:

- /// Nënshkrimi të Memorandunit të Bashkëpunimit me Institucionin Shtetëror të Revizionit të Malit të Zi - 27 shkurt - 1 mars 2024, Budva, Mali i Zi;
- /// Pjesëmarrjes në punëtorinë mbi hartimin e procedurave të brendshme për rrjetet sociale - 18 - 19 qershor 2024, Podgoricë, Mali i Zi, me mbështetjen e Fondacionit Vestminster për Demokraci (WFD).

Nënshkrimi i Memorandunit të Bashkëpunimit me Institucionin Shtetëror të Revizionit të Malit të Zi përcaktoi kornizën për shkëmbim profesional, aktivitete të përbashkëta dhe avancimin e praktikave të revizorit.

Me mbështetjen e Fondacionit Vestminster për Demokraci (WFD), përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në punëtorinë ku ndanë përvojat e tyre me kolegët nga Institucioni Shtetëror i Revizionit të Malit të Zi mbi bashkëpunimin me palët e interesuara dhe zbatimin e strategjisë së komunikimit në drejtim të forcimit të transparencës dhe llogaridhënies publike.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT



Në kuadër të bashkëpunimit bilateral me Institucionin Suprem të Revizionit të Shqipërisë, Delegacioni i ESHR-së i udhëhequr nga kryerevizori shtetëror, mr. Maksim Acevski, realizoi:

- /// Vizitë bilaterale në Institucionin Suprem të Revizionit të Shqipërisë - 12 - 14 qershor 2024, Tiranë, Shqipëri, me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të OECD - SIGMA-së.

Temat e vizitës bilaterale kishin për qëllim shkëmbimin e përvojave nga revizionet e suksesit që lidhen me menaxhimin e burimeve natyrore dhe praktikave të komunikimit. Të dy institucionet e konfirmuan angazhimin për bashkëpunimin e mëtejshëm përmes shkëmbimit të praktikave të mira dhe aktiviteteve të përbashkëta.



ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

INSTITUTI I AUTORIZUAR PËR FINANCAT PUBLIKE
DHE KONTABILISTËT (CIPFA)

Në vitin 2024, CIPFA organizoi ngjarje që ka të bëjë me:

- /// Uebinarin me temë: "Kultura, ndryshimet klimatike dhe korrupsioni" - 16 maj 2024, online.
- /// Punëtori kundër korrupsionit 29 nëntor 2024, në Shkup.

Ngjarja e organizuar nga CIPFA ofroi perspektiva të reja mbi lidhjen midis kulturës organizative, politikës klimatike dhe rreziqeve të korrupsionit në sektorin publik, gjë që është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e menaxhimit të burimeve publike dhe ndjekjes së zbatimit të Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

TRUPI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR BARAZINË
GJINORE DHE FUQIZIMIN E GRAVE -
UN WOMEN

ESHR-ja dhe Trupi i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave - UN Women vazhduan në vitin 2024 me zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit, nëpërmjet organizimit të më shumë ngjarjeve që kanë të bëjnë me:

- /// Takimin me Zyrën Rajonale të UN Women për Evropën dhe Azinë Qendrore - 12 - 15 shkurt 2024, Stamboll, Turqi;
- /// Takimin rajonal të punës mbi revizionin bashkëpunues "Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës" - 19 - 22 shkurt 2024, Tiranë, Shqipëri;

- /// Pjesëmarrjen në Komisionin e 68-të për Statusin e Grave (CSW) të Kombeve të Bashkuara (KB) - organizimi i ngjarjes anësore "ISR-ja si nxitës për rritjen e llogaridhënies ndaj financimit të barazisë gjinore" - 10 - 14 mars 2024, Nju Jork, SHBA;
- /// Prezantimin e metodologjisë PEFA për barazinë gjinore - 25 - 29 mars 2024, Stamboll, Turqi;
- /// Prezantimin e raportit të përbashkët të revizionit bashkëpunues "Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës" - 17 korrik 2024, Shkup.

Bashkëpunimi me UN Women dhe pjesëmarrja e ESHR-së si koordinatore në revizionin bashkëpunues mbi barazinë gjinore me pjesëmarrjen e ISR-së së Shqipërisë dhe Kosovës, e konfirmon përkushtimin për përmbushjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm, veçanërisht Qëllimit 5 - Barazia Gjinore, dhe e pozicionon ESHR-në si shembull të mirë në rajon për zbatimin e perspektivës gjinore në revizionet, por në të njëjtën kohë edhe si bartëse ose koordinatore e aktiviteteve të revizionit.

Bashkëpunimi me UN Women kontribuoi në marrjen e mbështetjes profesionale dhe mjeteve për analizë dhe njoftim në lidhje me çështjet gjinore.

Pjesëmarrja e ESHR-së në Komisionin e 68-të për Statusin e Grave të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork i mundësoi ESHR-së, për herë të parë në 25 vitet e funksionimit të tij, të prezantojë përvojën në Kombet e Bashkuara dhe të forcojë reputacionin në përmasa ndërkombëtare. Në kuadër të Komisionit për Statusin e Grave, Enti Shtetëror i Revizionit, me mbështetjen e UN Women, organizoi ngjarje anësore me temë: "Institucionet Supreme të Revizionit si nxitës për rritjen e llogaridhënies drejt financimit të barazisë gjinore", Revizioni i QZHQ 5 - Përvojat nga Ballkani Perëndimor. Në këtë ngjarje, kryerevizori shtetëror, mr. Maksim Acevski, i prezantoi përvojat e deritanishme dhe rezultatet e arritura të Entit Shtetëror të Revizionit në zbatimin e revizioneve gjinore, si dhe gjetjet e konstatuara kryesore nga revizioni i kryer i suksesit me temë "Barazia gjinore e grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun

e punës", të cilin ESHR-ja, si koordinatore, e zbatoi së bashku me Institucionet Supreme të Revizionit të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Përmes revizioneve gjinore, ESHR-ja e rrit ndërgjegjësimin e institucioneve publike rreth rëndësisë së qasjes së barabartë në burimet dhe shërbimet, veçanërisht për grupet e marginalizuara, siç janë gratë në zonat rurale.

PROGRAMI I ZHVILLIMIT I KOMBEVE TË BASHKUARA - UNDP



Me mbështetjen e Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), në vitin 2024, u realizuan më shumë aktivitete që janë në drejtim të arritjes së qëllimeve dhe aktiviteteve strategjike dhe programore, përkatësisht:

- /// Takimi bilateral i delegacioneve të ESHR-së dhe Institucionit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Serbisë, me mbështetjen e UNDP-së, për të diskutuar raportin e përbashkët të revizionit paralel të gatishmërisë për zbatimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2023 dhe mundësitë për zbatimin e revizionit të ri bashkëpunues - 28 - 29 mars 2024, Beograd, Serbi;
- /// Vizita bilaterale në Institucionin Suprem të Revizionit të Republikës Sllovake - 15 - 18 prill 2024, Bratisllavë, Sllovaki, me mbështetjen e UNDP-së;
- /// Ngjarja promovuese e raportit të përbashkët të revizorit nga revizioni paralel me Institucionin Shtetëror të Revizionit të Republikës së Serbisë mbi gatishmërinë për zbatimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2023 - 22 maj 2024, Shkup, me mbështetjen e UNDP-së;

- /// Akademia mbi financimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm, të organizuar bashkërisht nga UNDP IRH dhe UNDP-Mali i Zi - 19 - 21 qershor 2024, Bar, Mali i Zi;
- /// NEC 2024 - Konferenca mbi kapacitetet nacionale të vlerësimit (UNDP) - 14 - 18 tetor 2024, Pekin, Kinë.

Bashkëpunimi i ESHR-së me UNDP-në gjatë vitit 2024 është me rëndësi thelbësore për thellimin e kapaciteteve institucionale në fushën e revizioneve që lidhen me Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ). Duke mbajtur takime bilaterale, duke marrë pjesë në revizione paralele, akademi rajonale dhe konferenca ndërkombëtare, ESHR-ja kontribuon në mënyrë aktive në ndjekjen e progresit të vendit në zbatimin e Agjendës 2030 të KB-së dhe në thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me partnerët dhe institucionet kryesore.

Prania e Delegacionit të ESHR-së të udhëhequr nga kryerevizori shtetëror, mr. Maksim Acevski, në Konferencën e Kapaciteteve Nacionale të Vlerësimit (NEC 2024), që u mbajt nga 14 - 18 tetor 2024 në Pekin, Republika e Kinës me mbështetjen e UNDP-së, ishte veçanërisht e rëndësishme për ndarjen e përvojave dhe praktikave të ndryshme të vendeve lidhur me forcimin e sistemeve nacionale të vlerësimit dhe rolit të tyre në arritjen e QZHQ-ve, veçanërisht në fushën e mjedisit të qëndrueshëm jetësor dhe ndryshimeve klimatike, përfshirjes dhe rëndësisë së zërit të qytetarit. Kryerevizori shtetëror, mr. Maksim Acevski, e shfrytëzoi praninë në NEC 2024 për të zhvilluar disa takime bilaterale me përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe ndërkombëtare, përfshirë edhe UNDP-në, Entin Nacional të Revizionit dhe institucionet e tjera të njohura të Republikës së Kinës.

INSTITUTI DEMOKRATIK NACIONAL (NDI)



Në drejtim të rritjes së bashkëpunimit të ESHR-së me shërbimet dhe trupat në Kuvend, me mbështetjen e Institutit Demokratik Nacional (NDI), u organizua:

- /// Vizita studimore në Shërbimin Parlamentar dhe Zyrën e Revizionit të Zvicrës - 19 - 20 shkurt 2024, Bernë, Zvicër.

Duke marrë pjesë në vizitën studimore të organizuar nga Instituti Demokratik Nacional (NDI) së bashku me përfaqësuesit e Kuvendit, si dhe duke marrë pjesë në punëtoritë e organizuara nga NDI-ja me përfaqësuesit e Kuvendit, më hollësisht të shpjeguara në pjesën 4.1. Aktivitetet e Projektit të këtij Raporti Vjetor, ESHR-ja e thëllon bashkëpunimin me pushtetin legjislativ si segment kryesor për rritjen e efektivitetit të raporteve të revizorit dhe forcimin e llogaridhënies demokratike.

FONDACIONI VESTMINSTER PËR DEMOKRACI - WFD



Bashkëpunimi me Fondacionin Vestminster për Demokraci (WFD) në vitin 2024 rezultoi me pjesëmarrjen në ngjarjet e mëposhtme:

- /// Vizitën e Delegacionit të ESHR-së në Institucionin Shtetëror të Revizionit të Malit të Zi, të organizuar nga WFD - 4 - 6 mars 2024, Podgoricë, Mali i Zi;
- /// Punëtorinë për hartimin e procedurave të brendshme për rrjetet sociale - 18 - 19 qershor 2024, Podgoricë, Mali i Zi;
- /// Vizitën studimore për shkëmbimin e praktikave të komunikimit të ISR-ve dhe Prokurorive Publike, të organizuar nga WFD - 29 - 30 tetor 2024, Varshavë, Poloni..

Pjesëmarrja në këto ngjarje të organizuara me mbështetjen e WFD-së i mundësoi ESHR-së t'i forcojë kapacitetet e veta institucionale në fushat e komunikimit, transparencës dhe llogaridhënies parlamentare. Përmes vizitave studimore në Mal të Zi dhe Poloni, pjesëmarrësit e ESHR-së patën mundësinë të shkëmbejnë përvoja mbi qasjet e ndryshme për komunikimin e gjetjeve të revizorit, avancimin e marrëdhënieve me publikun, si dhe koordinimin me institucionet e tjera kompetente për veprimin e raporteve të revizorit, siç janë prokuroritë publike.

ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË - ZYRA PËR INSTITUCIONET DEMOKRATIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT - OSBE - ODIHR



Me ftesën e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë - Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut - OSBE - ODIHR, përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në:

- /// Konferencën me temë "Shkëmbimi rajonal për të forcuar sistemet dhe praktikave të financimit të fushatave" - 21 - 22 shkurt 2024, Varshavë, Poloni.

Pjesëmarrja në konferencën e organizuar nga OSBE-ODIHR-ja kontribuoi në shkëmbimin e njohurive në fushën e financimit të fushatave politike, e cila është me rëndësi të veçantë për menaxhimin demokratik dhe parandalimin e korrupsionit.

QENDRA E EKSELENCËS NË FINANCAT (CEF)

Connect. Learn. Act.

Bashkëpunimi i vendosur shumëvjeçar me Qendrën e Ekselencës në Financat (CEF) nga Sllovenia, në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit të nënshkruar, mundësoi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ESHR-së në ngjarjet e organizuara nga CEF, si në vijim:

- /// Uebinari me temë "Roli i ISR-ve në menaxhimin e mjeteve publike" – 21 maj 2024, online;
- /// Punëtorja me temë: "Forcimi i kapaciteteve të kontabilitetit dhe revizionit përmes rrjetit të ekspertëve rajonalë" – 29 - 30 maj 2024, Podgoricë, Mali i Zi;
- /// Punëtorja me temë "Avancimi i menaxhimit të mjeteve në sektorin publik: Ndarja e praktikave të mira dhe inkurajimi i bashkëpunimit" – 24 - 25 shtator 2024, Lubjanë, Slloveni.

Pjesëmarrja në ngjarjet e organizuara nga CEF, Sllovenia e inkurajon shkëmbimin e përvojave midis institucioneve të revizionit dhe atyre financiare në rajon, në drejtim të arritjes së qëllimeve strategjike për të kontribuar në shoqëri.

BANKA BOTËRORE (WB)

Me mbështetjen e Bankës Botërore, përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në:

- /// Konferencën me temë "Kontrolli i shpenzimeve si vegël për forcimin e menaxhimit fiskal" - 3 - 4 prill 2024, Vjenë, Austri;
- /// Ngjarjen për të mësuar - Platforma për Menaxhimin Financiar Publik për Veprimin Klimatik (PFM4CA) - 11 - 13 dhjetor 2024, Vjenë, Austri, të organizuar nga Banka Botërore dhe Shkolla Austriake e Menaxhimit.

Pjesëmarrja në ngjarjet e organizuara nga Banka Botërore kushtuar menaxhimit fiskal dhe veprimit klimatik kontribuoi në forcimin e kapaciteteve për analizën e shpenzimeve publike dhe integrimin e aspekteve klimatike në financat publike.

(OECD - SIGMA)

Përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në ngjarjet e organizuara në vitin 2024 me mbështetjen e OECD-SIGMA-së në kuadër të aktiviteteve të Rrjetit të ISR-ve të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale për anëtarësim në BE, të cilat kanë të bëjnë me:

- /// Konferencën me temë "Llogaria Përfundimtare e Buxhetit të Shtetit" – 27 shkurt – 1 mars 2024, Budva, Mali i Zi;
- /// Punëtorinë për praktikën e njoftimit për rritjen e ndikimit – 7 - 8 nëntor 2024, Lubjanë, Slloveni, në bashkëpunim me CEF, Lubjanë..

Mbështetja nga OECD-SIGMA është me rëndësi thelbësore për avancimin e kapaciteteve institucionale dhe harmonizimin me standardet ndërkombëtare të revizionit.

PROGRAMI EKZEKUTIV I UNIVERSITETIT LUIS

Në kuadër të iniciativës së bashkëpunimit me Universitetin Luis, Itali, u realizua:

- /// Pjesëmarrja e përfaqësuesit të ESHR-së në Programin Ekzekutiv të Universitetit Luis: Menaxhimi efektiv dhe kontrollet kundër mashtrimeve në shfrytëzimin e instrumenteve të financimit të BE-së – dy module online dhe moduli i tretë me prani fizike - 8 - 14 shtator 2024, Romë, Itali.

Programi ofroi njohuri dhe përvoja praktike në fushën e menaxhimit të mjeteve të BE-së dhe kontrolleve kundër korrupsionit, të cilat janë me rëndësi të veçantë për avancimin e praktikës së revizorit dhe aktiviteteve aktuale të ESHR-së në këtë fushë.

Në takimet me ekspertët në kuadër të misionit të vlerësimit, u prezantuan rezultatet kryesore të Tvinging Projektit të cilat kanë të bëjnë me kornizën e përmirësuar juridike, kapacitetet e forcuara institucionale dhe bashkëpunimin e avancuar me Kuvendin. Tvinging Projekti i financuar nga fondet e BE-së me vlerë prej 1,5 milion euro u zbatua në bashkëpunim me ISR-në e vendeve anëtare të BE-së si tvinging partnerë, në periudhën shkurt 2021 - tetor 2022. Misioni i vlerësimit theksoi rëndësinë e miratimit të Ligjit të ri për revizion shtetëror si hap vendimtar për forcimin e pavarësisë së ESHR-së dhe përmirësimin e statusit të punonjësve, si dhe për shqyrtimin efektiv të raporteve të revizorit në Kuvend dhe veprimi sipas tyre nga Prokuroria Publike.

MISIONI I VLERËSIMIT PËR TVINGING PROJEKTIN E ESHR-SË



Për të vlerësuar efektet e Tvinging Projektit të zbatuar "Përmirësimi i revizionit të jashtëm dhe mbikëqyrjes parlamentare", u realizua:

- /// Misioni i vlerësimit TAIEX për të vlerësuar qëndrueshmërinë dhe ndikimin e rezultateve të Tvinging Projektit - 24 - 28 qershor 2024, Shkup.



4.2.

AKTIVITETET E PROJEKTIT

4.2.1.

PROGRAMI I ZHVILLIMIT I KOMBEVE TË BASHKUARA



Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) nënshkruan Memorandum të Mirëkuptimit në mars 2022, i cili përkufizon më shumë aktivitete që do të zbatohen në dy vitet e ardhshme.

Gjatë vitit 2024, u realizuan një sërë aktivitete që synonin përsosjen dhe edukimin e vazhdueshëm të punonjësve të ESHR-së. U organizuan më shumë punëtori me temë: "Analiza e raporteve financiare dhe përcaktimi i treguesve individualë, si dhe analiza e rreziqeve, revizioni i Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm, si dhe përgatitja e Programit Vjetor të Punës së ESHR-së me fokus në Strategjinë Nacionale të Zhvillimit."

Segmenti vendimtar i bashkëpunimit ishte zbatimi i revizionit kooperativ të suksesit "Gatishmëria e vendit për t'i zbatuar Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030", në bashkëpunim me ISR-në e Serbisë, për të cilin njoftuam në Raportin Vjetor për Revizionet e Kryera dhe për Punën e ESHR-së për vitin 2023. Për zbatimin e këtij revizioni, UNDP-ja ofroi mbështetje teknike dhe nga ekspertët, duke përfshirë pjesëmarrjen e revizorëve në punëtoritë, si në vend, ashtu edhe jashtë vendit, por edhe pjesëmarrjen në takimet rajonale dhe vizitat studimore për t'i shkëmbyer përvojat dhe praktikave të mira me institucionet e tjera supreme të revizionit (ISR). Si rezultat i këtij bashkëpunimi, në vitin 2024 ishte hartuar raporti i parë nacional i revizionit të suksesit me temë: **"Gatishmëria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për t'i zbatuar Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030"**, si dhe raporti i përbashkët i revizionit mbi të njëjtën temë me ISR-në e Republikës së Serbisë. Me të, Republika e Maqedonisë së Veriut është ndër 74 vendet në botë që kanë zbatuar revizion në lidhje me Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ).

Më 22 maj 2024, në Shkup u mbajt ngjarja promovuese për t'i prezantuar raportet nacionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Serbisë, si dhe raportin e përbashkët të këtij revizioni. Në ngjarjen morën pjesë dhe mbajtën fjalim kryetari i ISR-së së Republikës Sllovaqe, z. Lubomir Andrashi, i cili e prezantoi përvojën sllovaqe në zbatimin e revizioneve të lidhura me QZHQ-në, dhe përfaqësuesi i përhershëm i UNDP-së në vend, z. Armend Grigorian, i cili foli mbi rëndësinë e revizioneve të zhvillimit të qëndrueshëm si vegël për përmirësimin e politikave publike dhe llogaridhënies.

Në këtë ngjarje morën pjesë mbi 90 përfaqësues nga sektorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe institucionet e revizionit, agjencitë shtetërore, organizatat ndërkombëtare, institucionet akademike dhe sektorin civil.

UNDP-ja ofroi edhe mbështetje në zbatimin e revizionit të ri paralel të suksesit me temë: "Planifikimi urbanistik i infrastrukturës së gjelbër në qytetet, i cili po zbatohet në bashkëpunim me ISR-në e Serbisë dhe i cili është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Në drejtim të avancimit të njohurive dhe aftësive të punonjësve të ESHR-së në fushën e analizës së raporteve financiare, analizës së kost-benefitit dhe revizionit të QZHQ-ve, gjatë vitit 2024 u organizuan edukimet e specializuara në të cilat morën pjesë më shumë punonjës.

Në kuadër të projektit "Strategjia Nacionale e Zhvillimit (SNZH) - Sistemi i Ndjekjes dhe Harta e Investimeve për SNZH-në dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm", i financuar nga Ministria e Financave e Republikës Sllovaqe, është ofruar mbështetja për përmirësimin e praktikave të revizorit nëpërmjet harmonizimit me procedurat e brendshme të ESHR-së me qëllimet strategjike të përcaktuara në Strategjinë Nacionale të Zhvillimit dhe duke përfshirë analizën e kost-benefitit në proceset e revizorit.

Gjatë vitit 2024, u realizuan tri vizita studimore në institucionet e njohura supreme të revizionit dhe trupat publikë në Sllovaki, Kinë dhe Itali. Këto vizita kishin për qëllim avancimin e bashkëpunimit rajonal, shkëmbimin e përvojave dhe mbështetjen e kapaciteteve të revizionit të ESHR-së. Pra, në prill 2024, delegacioni i udhëhequr nga kryerevizori shtetëror, mr. Maksim Acevski, realizoi vizitë dypalëshe në ISR-në e Sllovakisë, ku në takimet e punës u diskutuan shembujt praktikë nga revizionet e fondeve të BE-së, projektet infrastrukturore kapitale dhe sektorit shëndetësor, me fokus të veçantë në zbatimin e veglave softuerike në punën e revizorit.

Delegacioni i ESHR-së, në qershor 2024, mori pjesë në Akademinë për Financimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Bar, Republika e Malit të Zi, ku u shkëmbyen përvojat dhe strategjitë për integrimin e QZHQ-ve në financat publike, zbatimin e mekanizmave inovativë të financimit dhe ekonominë e gjelbër.

Në Konferencën e Kapaciteteve Nacionale të Vlerësimit NEC 2024 në Pekin, Kinë, delegacioni i ESHR-së e prezantoi rolin e institucioneve supreme të revizionit në avancimin e sistemeve nacionale të vlerësimit dhe zbatimin e QZHQ-ve, ndërsa u arrit edhe bashkëpunimi i rëndësishëm dypalësh me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare.

Mbështetja totale e ofruar nga UNDP-ja arriti në 30.000 dollarë amerikanë, mjete që u dedikuan edhe për pjesëmarrjen e revizorëve shtetërorë në punëtoritë nacionale dhe ndërkombëtare, takimet rajonale dhe vizitat studimore, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira me institucionet e tjera supreme të revizionit (ISR).



4.2.2.

INSTITUTI DEMOKRATIK NACIONAL



Gjatë vitit 2024, Instituti Demokratik Nacional (NDI), përmes Programit të Mbështetjes Parlamentare (PSP), zbatoi një sërë aktivitete që synonin mbështetjen e punës dhe zhvillimit institucional të Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR).

Në drejtim të avancimit të transparencës dhe disponueshmërisë së raporteve të revizorit, NDI-ja ofroi mbështetje duke angazhuar disenjues grafik për t'i vizualizuar të dhënat nga analizat dhe raportet e ESHR-së. Kjo qasje synon t'i thjeshtojë informacionet vendimtare për një kuptim dhe përdorim më të lehtë nga institucionet relevante dhe publiku i gjerë.

Për t'i forcuar kapacitetet teknike, PSP-ja siguroi dhjetë laptopë profesionalë për punonjësit e ESHR-së, si dhe tetë bursa për mësimin e gjuhës angleze, me qëllim të avancimit të aftësive të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në kuadër të komponentit rajonal të PSP-së, në periudhën nga 19 deri më 20 shkurt 2024, pesë përfaqësuesit e ESHR-së, së bashku me përfaqësuesit e shërbimit parlamentar të mbikëqyrjes buxhetore, realizuan vizitë studimore në Bernë të Zvicrës. Vizita mundësoi shkëmbim përvojash me Shërbimin Parlamentar Zviceran, Ministrinë e Financave dhe Zyrën Federale Zvicerane të Revizionit, me fokus në avancimin e mbikëqyrjes buxhetore përmes bashkëpunimit efektiv midis parlamenteve dhe institucioneve të revizionit.

Si vazhdim i këtij shkëmbimi, më 26 dhe 27 shtator 2024, përfaqësuesit e institucioneve zvicerane realizuan vizitë kthimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku ishte mbajtur punësoria dyditore me pjesëmarrjen e Zyrës Parlamentare të Buxhetit, këshilltarëve të Komisionit për Financim dhe Buxhet, si dhe përfaqësuesve të ESHR-së. Temat e punëtorisë ishin praktikat e bashkëpunimit midis zyrave të revizorit dhe parlamentit, përgatitja e raporteve të revizorit, si dhe sistemet e menaxhimit të cilësisë, duke përfshirë edhe harmonizimin me standardin e ri ISSAI 140 - Menaxhimi i Cilësisë për ISR-në, i cili do të zbatohet nga viti 2025.

Në mënyrë plotësuese, më 25 tetor 2024, me mbështetjen e Fondacionit Nacional për Demokraci (NED), NDI-ja organizoi punëtorinë e parë strategjike për anëtarët e Grupit Parlamentar Ndërpatriak kundër Korrupsionit, të sapothemeluar (mandati 2024–2028). Në punëtorinë morën pjesë edhe përfaqësuesit e ESHR-së, Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Platformës Qytetare kundër Korrupsionit dhe shërbimit parlamentar.

Qëllimi i punëtorisë ishte përkufizimi i prioritetëve kryesorë dhe fushave të interesit të grupit, si dhe shqyrtimi i sfidave më të rëndësishme që lidhen me korrupsionin. Më pas ishin marrë parasysh gjendjet e konstatuara dhe rekomandimet nga raportet e revizorit dhe raportet e trupave të tjerë mbikëqyrës si bazë për hartimin e Planit të Veprimit për vitin 2025. Në konkluzionet e punëtorisë ishte theksuar nevoja për mbështetjen e mëtejshme për ESHR-në nga Kuvendi, duke përfshirë edhe miratimin e Ligjit të ri për revizion shtetëror, i cili do të mundësonte diskutim parlamentar më esencial dhe të rregullt mbi raportet e revizorit dhe do të kontribuonte në forcimin e mbikëqyrjes dhe luftën kundër korrupsionit.

Mbështetja totale e ofruar nga NDI-ja arriti në 35.353 dollarë amerikanë, mjete që ishin të dedikuara edhe për pjesëmarrjen e revizorëve shtetërorë në punëtoritë nacionale dhe ndërkombëtare, takimet rajonale dhe vizitat studimore, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira me institucionet e tjera supreme të revizionit (ISR).

4.2.3.

FONDACIONI PËR DEMOKRACI VESTMINSTER



Rezultatet e bashkëpunimit të suksesshëm shumëvjeçar midis ESHR-së dhe Fondacionit për Demokraci Vestminster (WFD) vazhduan edhe me zbatimin e projektit të ri "Praktikoni Demokracinë", i cili filloi në mars 2023, vazhdoi në vitin 2024 dhe do të zgjasë deri më 31 mars 2025, ndërsa financohet nga Ambasada Britanike në Shkup. Qëllimi i këtij bashkëpunimi të përbashkët është të mbështesë institucionin në zbatimin e praktikave transparente dhe të përgjegjshme që do të kontribuojnë në punë të koordinuar dhe të përgjegjshme, duke u përqendruar në:

- /// Avancimin e praktikave të komunikimit të ESHR-së;
- /// Zhvillimin e strategjisë së komunikimit të ESHR-së;
- /// Zhvillimin e aktiviteteve për t'i forcuar praktikat Value for Money në punën e ESHR-së;
- /// Ofrimin e mbështetjes nga ekspertët për revizionet e suksesit për t'i hartuar raportet më me ndikim të revizorit;

Gjatë vitit 2024, me mbështetjen e WFD-së, u realizuan më shumë aktivitete që kanë të bëjnë me zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë së Komunikimit të ESHR-së për vitet 2024-2027, duke u përqendruar në komunikimin dhe bashkëpunimin e ESHR-së me institucionet kompetente dhe organizatat qytetare (palët e interesuara). Të udhëhequr nga qëllimet strategjike të përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit 2023-2027, Enti Shtetëror i Revizionit, si institucion që investon vazhdimisht në zhvillimin individual të punonjësve, WFD-ja ofroi mbështetje në realizimin e Planit Vjetor për Përsosjen e Vazhdueshme Profesionale për vitin 2024, me qëllim të forcimit të aftësive të revizorëve shtetërorë për performancën publike, zhvillimin e e-trajnitimit mbi praktikën e komunikimit, si dhe mbështetjen teknike përmes pajisjes së qendrës së shtypit të ESHR-së.

Duke e njohur rëndësinë dhe ndikimin e revizioneve të kryera të suksesit, WFD-ja ofroi edhe mbështetje nga ekspertët në kryerjen e revizioneve të suksesit "Shfrytëzimi i pajisjeve mjekësore moderne" dhe "Siguria në komunikacionin rrugor në Republikën e Maqedonisë së Veriut", të cilat janë pjesë përbërëse e këtij raporti.

Në drejtim të avancimit të bashkëpunimit në fushën e sundimit të së drejtës dhe luftës kundër korrupsionit, Fondacioni për Demokraci Vestminster (WFD) siguroi mbështetje strategjike për organizimin e takimeve koordinuese dhe punëtorive midis Entit Shtetëror të Revizionit dhe Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në mënyrë plotësuese, u organizuan edhe vizitat studimore për të forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe shkëmbimin e praktikave të mira në drejtim të veprimit më efikas mbi gjetjet e raporteve të revizorit në pjesën e zbulimit të korrupsionit.

Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë, janë zbatuar edhe aktivitete të tjera që janë me rëndësi thelbësore për rritjen e njohurive dhe aftësive të punonjësve të ESHR-së.

Gjatë vitit 2024, për t'i mbështetur plotësisht aktivitetet e planifikuara, Fondacioni për Demokraci Vestminster (WFD) ofroi mbështetje financiare në shumën prej 56.000 funta.

4.2.5.

TRUPI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR BARAZINË
GJINORE DHE FUQIZIMIN E GRAVE

Enti Shtetëror i Revizionit dhe Trupi i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) vazhduan të zbatojnë Memorandumin e Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit edhe në vitin 2024, me qëllim që të dyja palët të bashkëpunojnë në avancimin e zbatimit të detyrimeve për barazinë gjinore në përputhje me ligjet dhe politikat nacionale, si dhe detyrimet ndërkombëtare të ndërmarra dhe të promovojnë menaxhimin me përgjegjësi gjinore të mjeteve publike dhe llogaridhënien përmes zbatimit sistematik të buxhetimit me përgjegjësi gjinore si vegël për hartimin e politikave.

Në drejtim të përmbushjes së qëllimeve të përcaktuara, UN Women ofroi mbështetje për revizorët shtetërorë për pjesëmarrjen në punëtoritë në vend dhe jashtë vendit, si dhe mbështetjen në zbatimin e revizionit të parë kooperativ gjinor të suksesit "Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave në zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës", nga Institucionet Supreme të Revizionit të Maqedonisë së Veriut, si koordinatore, dhe ISR-së së Shqipërisë dhe Kosovës.

Rezultatet e këtij revizioni kooperativ u prezantuan në ngjarjen shoqërore, të organizuar nga ESHR-ja me mbështetjen e UN Women, në kuadër të Komisionit të 68-të për Statusin e Grave, që u mbajt në mars 2024 në Kombet e Bashkuara në Nju Jork, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky aktivitet është prezantimi i parë i rezultateve të revizionit të caktuar brenda kornizës së Kombeve të Bashkuara nga ESHR-ja në njëzetepesëvjetorin e ekzistencës.

ESHR-ja, si koordinatore e revizionit kooperativ ndërkombëtar, organizoi edhe ngjarjen promovuese për Raportin e Përbashkët të Revizorit nga revizioni kooperativ rajonal i suksesit me temë "Barazia gjinore e grave në zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës", që u mbajt në Shkup, në korrik 2024. Në ngjarjen morën pjesë edhe Institucionet Supreme të Revizionit të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së

Kosovës, ajo u mbështet nga UN Women - Trupi i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave.

Mbështetja nga UN Women nuk synon vetëm mbështetjen e revizioneve konkrete, por ajo është gjithëpërfshirëse, duke përfshirë edhe sigurimin e pajisjeve për ndërtimin e mëtejshëm të kapaciteteve për punonjësit e ESHR-së, që do të punojnë në revizionet e suksesit me fokus të veçantë në barazinë gjinore.

Duke e njohur rëndësinë dhe ndikimin e revizioneve të kryera të suksesit, UN Women ofroi edhe mbështetje nga ekspertët në kryerjen e revizionit të suksesit "Zbatimi i Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) me fokus në shërbimet e specializuara për gratë viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje", si dhe mbështetjen nga ekspertët për hartimin e metodologjisë së revizorit për përfshirjen e barazisë gjinore dhe buxhetimit me përgjegjësi gjinore në revizionet.

Përfaqësuesit e Entit Shtetëror të Revizionit morën pjesë në Kampin e Inovacionit të të Dhënave Gjinore (Bootcamp), të mbajtur në Izmir të Turqisë. Kjo ngjarje u organizua në bashkëpunim me zyrën e UN Women në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit për rëndësinë e përpunimit dhe analizimit të të dhënave gjinore në drejtim të sigurimit të barazisë gjinore dhe në të njëjtën kohë përmbushjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Pjesëmarrja në këtë kamp jo vetëm që i përmirësoi aftësitë e pjesëmarrësve, por gjithashtu hapi edhe rrugën për fazën e dytë të projektit përmes së cilës u zhvillua partneriteti me rrjetin e entuziastëve të të dhënave gjinore që përfunduan me sukses kampin.

Në aktivitetet e financuara nga UN Women, theksojmë edhe pjesëmarrjen e punonjësve të ESHR-së në:

- /// ngjarjen rajonale të organizuar nga UN Women, në partneritet me Sekretariatit e PEFA-së, që u mbajt në Stamboll, Turqi, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe avancimit të njohurive mbi zbatimin e metodologjisë së PEFA-së për vlerësimin e menaxhimit me përgjegjësi gjinore të financave publike;
- /// takimin vjetor të Grupit Këshillëdhënës në Financimin Transformues për Barazinë Gjinore drejt Menaxhimit Transparent, Gjithëpërfshirës dhe Llogaridhënës në Ballkanin Perëndimor, që u mbajt gjithashtu në Turqi.

Gjatë vitit 2024, për t'i mbështetur plotësisht aktivitetet për të përfshirë perspektivën gjinore në revizionet e suksesit, UN Women ofroi mbështetje financiare në shumën prej 70.000 dollarë amerikanë.

Enti Shtetëror i Revizionit si ISR në Republikën e Maqedonisë së Veriut, vazhdimisht bën përpjekje për të vendosur bashkëpunim me një numër më të madh organizatash ndërkombëtare me qëllim që të ofrojë mbështetje për aktivitetet e veta.

4.2.4.

BANKA BOTËRORE



WORLD BANK GROUP

Në vitin 2024, Banka Botërore ofroi mbështetje me ndihmë teknike në kuadër të "Projektit për Forcimin e Mbikëqyrjes, Transparencës dhe Llogaridhënies së Shpenzimit të Investimeve Publike" përmes grantit të investimeve në infrastrukturën e cilësisë (QII). Ky projekt u hartua për të ofruar ndihmë teknike për ESHR-në, me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve / njohurive dhe aftësive të punonjësve të ESHR-së në zbatimin e revizioneve të suksesit të investimeve publike dhe ofrimin e rekomandimeve përkatëse dhe cilësore për përmirësimin e proceseve të investimeve publike.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve të projektit, Banka Botërore ofroi mbështetje në zbatimin e dy pilot-revizioneve:

- /// "Investimet publike për t'i siguruar kapacitetet dhe kushtet për mbrojtjen e fëmijëve në kopshte" dhe
- /// "Efektet e investimeve publike për zhvillimin e barabartë rajonal".

Zbatimi i pilot-revizioneve të lartpërmendura, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij raporti, është bazë për zbatimin praktik të Udhëzimit për Revizionin e Suksesit të Menaxhimit të Investimeve Publike si aneks i Doracaktit ekzistues të revizionit të suksesit të ESHR-së.

4.3.

INTEGRIMI NË BE

Në tetor 2024, Komisioni Evropian e miratoi Agjendën e Reformave të Maqedonisë së Veriut, si pjesë e Planit të Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor 2024–2027. Ky është një hap i rëndësishëm në procesin e integritimit evropian dhe mundëson qasje në Fondin e Reformave dhe Rritjes së BE-së. Në kuadër të procesit të reformave, Enti Shtetëror i Revizionit njihet si institucion i pavarur, objektiv dhe transparent dhe ka mandat për të kryer revizion të Agjendës së Reformave dhe Programit shumëvjeçar të Punës sipas Instrumentit të Reformave dhe Rritjes. Si institucion suprem i revizionit, ESHR-ja ka rol vendimtar në revizionin e sistemit për zbatimin, ndjekjen, njoftimin dhe vlerësimin e Instrumentit dhe sistemit të kontrollit të brendshëm për zbatimin e Instrumentit.

Enti Shtetëror i Revizionit bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjitha organet shtetërore në drejtim të parandalimit dhe reduktimit të korrupsionit, në kuadër të Protokollit të Bashkëpunimit për Parandalimin dhe Represionin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave dhe merr pjesë në realizimin e Programit Nacional për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) përmes aktiviteteve të parashikuara në Kapitullin 23 - Gjyqësori dhe të Drejtat Fundamentale, Fusha - Politika e Antikorrupsionit dhe Kapitullin 32 - Kontrolli Financiar, Fusha - Revizioni i Jashtëm, si dhe në punën e organeve dhe trupave të tjerë për parandalimin e korrupsionit. Enti Shtetëror i Revizionit është pjesë e familjes së organeve të tjera shtetërore që përbëjnë "Trupin Ndërrësor për Koordinimin e Aktiviteteve kundër Korrupsionit". Ky trup ka për detyrë t'i koordinojë aktivitetet e të gjitha organeve kompetente për luftën kundër korrupsionit, të forcojë bashkëpunimin reciprok dhe njoftimin e ndërsjellë, të shkëmbejë informacione dhe të dhëna dhe t'i realizojë rekomandimet e përmbajtura në raportet e GREKO-s së Këshillit të Evropës dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.



REVIZIONET E KRYERA

05



Rezultatet e aktiviteteve të revizorit të përcaktuara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2024 janë të përmbajtura në pasqyrat e poshtëshënuara grafike:


REVIZIONET PËRMES NUMRAVE
PROGRAMI VJETOR I ESHR-së PËR 2024

116	10	2
Raportet e revizorit për Revizionin e Rregullshmërisë	Raportet e revizorit për Revizionin e Suksesit	Revizioni i pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizionit
4	132	38
Revizioni i TI-së	Raportet e revizorit të dorëzuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut	Raportet e revizorit të dorëzuara te Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut
24	1	239
Raportet e revizorit të dorëzuara në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në përputhje me nenin 85-b të Kodit Zgjedhor	Raportet e revizorit të dorëzuara në Qeverinë e RMV-së – Zëvendëskryetari i Qeverisë i ngarkuar për politikën e qeverisjes së mirë	Subjektet e përfshira me revizionin
1.240¹	882	451.728
Gjetjet dhe çështjet në raportet e revizorit	Rekomandimet në raportet e revizorit	Të ardhurat publike të përfshira me revizionin (në milion)
227.774	24	38
Shpenzimet publike të përfshira me revizionin (në milion)	Kontrollet e kryera për të përcaktuar statusin e rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizorit (follow up)	Raportet e lëshuara mbi kontrollet e zbatuara për të përcaktuar statusin e rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizorit (follow up)

¹⁵ Në numrin e gjetjeve dhe çështjeve në raportet e revizorit përmbahen edhe 11 çështje të tjera që përsëriten në raportet përfundimtare të revizorit për të gjithë 17 pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, 12 çështje të tjera që përsëriten në raportet përfundimtare të revizorit për të gjithë 7 pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore për zgjedhjet presidenciale të vitit 2024, dhe 4 çështje të tjera që përsëriten në raportet përfundimtare të revizorit për të gjitha 6 partitë politike mbi llogaritë për financim të rregullt.

161.587	2.000	942	275
Aktiva / pasiva e reviduar nga Bilanci i Gjendjes (në milion)	Taksat/ kompensimet publike të paguara/ më pak të paguara në Buxhetin e Shtetit (në milion)	Kërkesat nga shteti (në milion)	Kompensimet e paguara / më pak të paguara në Buxhetin e komunave të reviduara (në milion)
6.203	1	4.081	8.609
Shfrytëzimi i paligjshëm i mjeteve (në milion)	Kontribute më shumë të llogaritura të TVSH-së (në milion)	Regjistrimet korrigjuese në Bilancin e Gjendjes (në milion)	Gjendjet e konstatuara që ndikojnë në veprimtarinë e subjektit që është lëndë e revizionit, detyrimet e paguara dhe investimet kapitale (në milion)
86	5.681	8.860	1.400
Detyrimet sipas kredisë së marrë (organe të tjera shtetërore) (në milion)	Grantet e anuluarra / të humbura (në milion)	Anulimi / ngecja e granteve të investimeve (në milion)	Provizionet e paguara / të llogaritura për mjetet e patërhequra nga kreditë / huatë (në milion)
2.769	801	13.763	6.618
Kërkesat e vjetruara (në milion)	Masat e pandërmarrja të arkëtimit (në milion denarë)	Detyrimet e paguara ndaj furnitorëve	Vlera e kërkesës së padisë në procedurat gjyqësore në të cilat subjekti që është lëndë e revizionit paraqitet në rolin e të paditurit dhe të paditësit (në milion)
197	12	1.240	651
Shuma e procedurave të humbura gjyqësore (në milion)	Shuma e shpenzimeve të avokatëve, noterëve dhe shpenzimeve të përmbauesve (në milion)	Efektet financiare të revizionit / mjetet e paguara gjatë revizionit / kamatat e zvogëluara (në milion)	Vlera tjetër e shtuar e revizionit / kompensimet e paguara jo në kohë (në milion)
14.763	10.668	2.059	1.780
Shuma totale e prokurimeve publike (në milion)	Fushëveprimi i prokurimeve publike me revizion (në milion)	Vlera totale e prokurimeve publike që janë lëndë e revizionit - realizimi (në milion denarë)	Shuma totale e parregullsive të konstatuara në prokurimet publike (në milion denarë)
1.427	470	16	
Vlera totale e kontratave të lidhura në të cilat u konstatuan parregullsi (në milion denarë)	Realizimi total i kontratave të lidhura në të cilat u konstatuan parregullsi (në milion denarë)	Prokurimet e kryera për të cilat nuk u zbatua procedura e prokurimeve publike (në milion)	

REVIZIONET PËRMES NUMRAVE



² Numri i opinionëve mbi pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat është më i ulët se numri i opinionëve mbi raportet financiare, duke pasur parasysh se në raportet përfundimtare të revizorit mbi revizionet e kryera të raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë së llogarive të të ardhurave të buxhetit të dotacioneve (930) për 5 njësi të vetëqeverisjes lokale, opinioni mbi pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat për shfrytëzues shprehet në raportet e revizorit gjatë revizionit të shfrytëzuesit përkatës të dotacioneve me dedikim.

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET

GJITHSEJ 447.515 MILION DENARË të ardhura publike të reviduara dhe 227.777 MILION DENARË shpenzime publike të reviduara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2024.

Pjesëmarrjen më të madhe në të ardhurat e reviduara e kanë Buxheti Qendror me 260.125 milion denarë (58%), Buxhetet e Fondeve me 149.216 milion denarë (33%) dhe të Ardhurat Publike të Mbuluara me Revizionet e Suksesit me 23.355 milion denarë (5%).

Struktura e shpenzimeve të reviduara përfshin shpenzimet e mbuluara me revizionet e rregullshmërisë, suksesit dhe pajtueshmërisë, ku vëllim më të madh kanë shpenzimet e Buxheteve të Fondeve me 145.363 milion denarë (64%), Buxheti Qendror me 59.574 milion denarë (26%), si dhe Shpenzimet Publike të Mbuluara me Revizionet e Suksesit në shumën prej 8.302 milion denarë (4%).

Krahasuar me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2023, u arrit rritja e konsiderueshme e të ardhurave publike të reviduara në shumën totale prej 82.490 milion denarë (23%), veçanërisht në:

- /// buxhetin qendror për 56.951 milion denarë, përkatësisht 28% më shumë se vitin e kaluar;
- /// buxhetet e fondeve për 13.412 milion denarë, ose 10% më shumë se vitin e kaluar;
- /// shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së për 1.656 milion denarë, përkatësisht 96% më shumë se vitin e kaluar;
- /// partitë politike dhe pjesëmarrësit në fushatat zgjedhore për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare në vitin 2024 për 1.267 milion denarë, që janë reviduar për 68 herë më shumë se vitin e kaluar; dhe
- /// ndërmarrjet e tjera publike, institucionet e tjera të financuara nga mjetet publike dhe personat juridikë në të cilët shteti është aksionar dominues për 3.170 milion denarë, të cilat janë reviduar për 3 herë më shumë se vitin e kaluar.

Krahasuar me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2023, ka rritje të dukshme të shpenzimeve publike të reviduara për llojet e subjekteve dhe revizioneve si në vijim:

- /// buxheti qendror prej 43.955 milion denarë, i cili është reviduar pothuajse 4 herë më shumë se vitin e kaluar;
- /// buxhetet e fondeve për 15.734 milion denarë, përkatësisht 12% në krahasim me vitin e kaluar;
- /// shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së për 1.640 milion denarë, përkatësisht pothuajse dyfish më shumë se vitin e kaluar;
- /// partitë politike dhe pjesëmarrësit në fushatat zgjedhore për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare në vitin 2024 për 1.052 milion denarë, që është reviduar për 56 herë më shumë se vitin e kaluar; dhe
- /// ndërmarrjet e tjera publike, institucionet e tjera të financuara nga mjetet publike dhe personat juridikë në të cilët shteti është aksionar dominues për 3.271 milion denarë, të cilat janë reviduar për 3 herë më shumë se vitin e kaluar.

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË REVIDUARA

GJITHSEJ **451.728 MILION DENARË** të ardhura publike të reviduara dhe **227.777 MILION DENARË** shpenzime publike të reviduara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2024

	Të ardhurat publike të reviduara	Shpenzimet publike të reviduara
Buxheti Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut	264.348 203.174	59.574 15.619
Buxhetet e fondeve	149.216 135.804	145.363 129.629
Buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale	4.073 5.243	3.760 4.888
Shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së	3.386 1.730	3.360 1.720
Partitë politike dhe pjesëmarrësit në fushatat zgjedhore	1.276 19	1.067 19
Ndërmarrjet publike	1.381 14.681	1.534 10.947
Ndërmarrjet dhe institucionet e tjera publike / Personat juridikë në të cilat shteti është aksionar dominues	4.693 1.523	4.811 1.539
Të përfshira me Revizionet e Suksesit	23.355 2.851	8.302 181.154
Të përfshira me Revizionet e Pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizioneve	0 0	3 50.446


 Programi Vjetor 2024


 Programi Vjetor 2023


në 000.000 denarë

Mbulimi i shpenzimeve të reviduara të Buxhetit të RMV-së për vitin 2023 është 90%, që është për 6% më shumë krahasuar me vitin e kaluar. Struktura e shpenzimeve të reviduara përfshin shpenzimet me revizionet e rregullshmërisë në shumën prej 209.363 milion denarë, përkatësisht 66%, shpenzimet me revizionet e suksesit të zbatuara në përputhje me


Programet Vjetore të Punës së ESHR-së për vitet 2023 dhe 2024 në shumën totale prej 76.295 milion denarë, përkatësisht 24%, dhe shpenzimet për revizionet e përputhshmërisë të zbatuara në përputhje me Programet Vjetore të Punës së ESHR-së për vitet 2023 dhe 2024 në shumën prej 16 milion denarë.

MBULIMI I BUXHETEVE PËRMES SHPENZIMEVE TË REVIDUARA			
Shpenzimet e reviduara sipas lojeve të buxheteve (në milion denarë)	Realizimi i buxhetit për vitin 2023	I reviduar	Pjesëmarrja në %
1	2	3	4
Shpenzimet e Buxhetit të RMV-së për vitin 2023 (Llogaria Përfundimtare e Buxhetit të RMV-së për vitin 2023, Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 169/2024)	318.575	285.674	90
Buxhetet e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale	42.000	3.760	9


2024



2023



2022



5.1

VLERA E SHTUAR NGA REVIZIONET

Programi Vjetor i Punës i ESHR-së për vitin 2024 përcakton aktivitetet prioritare në dejtim të arritjes së qëllimeve dhe detyrave të ESHR-së, përkatësisht arritjen e qëllimeve strategjike të institucionit.

Aktivitetet e ndërmarra për t'i arritur qëllimet strategjike sigurojnë mbulim adekuat të mjeteve publike të reviduara, rrisin njohuritë dhe aftësitë e punonjësve, kryejnë revizion të suksesit të programeve dhe projekteve të ndryshme që janë në funksion të arritjes së llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë, shqyrtojnë rezultatet në aspektin e ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve të sektorit publik, informojnë palët e interesuara dhe publikun rreth gjendjeve të konstatuara në raportet përfundimtare të revizorit dhe përmirësojnë cilësinë e shërbimeve që sektori publik është i detyruar t'u ofrojë personave juridikë dhe fizikë. Rezultatet kryesore të punës së ESHR-së për vitin 2024 pasqyrohen në:

- /// konstatimin e gjendjeve të evazionit tatimor, mospagesës së taksave dhe kompensimeve në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me çka ESHR-ja siguron kthimin e mjeteve të investuara nga Buxheti në ESHR;
 - /// revizionin e dhënies së kontratave të PP-së me theks të veçantë në dhënien e kontratave të PP-së në kushtet e krizës energjetike;
 - /// dhënien e udhëzimeve mbi mënyrën e planifikimit të investimeve kapitale, sigurimin e mjeteve të nevojshme dhe ndjekjen e realizimit të tyre në nivel qendror dhe lokal (me vështrim të veçantë për mjetet e siguruar nga kreditorët ndërkombëtarë), dhe përcaktimin e efekteve të investimeve të lartpërmendura;
 - /// ndjekjen e servisimit të borxhit publik dhe kontributin në mënyrën e menaxhimit të financave publike.
- /// mbështetjen e Kuvendit në përmbushjen e kompetencave të tij nëpërmjet identifikimit dhe prezantimit të parregullsive, rasteve të punës së paligjshme dhe rasteve të mundshme të korrupsionit dhe abuzimit të detyrës;
 - /// ofrimin e rekomandimeve të qarta dhe efektive institucioneve shtetërore dhe institucioneve të tjera të sektorit publik për të avancuar menaxhimin e mjeteve publike;
 - /// ofrimin e kontributit në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në shfrytëzimin e mjeteve publike / mjeteve të tatimpaguesve, dhe në këtë mënyrë edhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes ofrimit të shërbimeve me respektimin e parimeve të sigurisë në ofrimin e shërbimeve, vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimit, transparencës, disponueshmërisë dhe shërbimit universal, mbrojtjes së përdoruesve dhe qytetarëve;

në 000 denarë

Aktiva / pasiva e reviduar nga Bilanci i Gjendjes	161.587.443
Taksat / kompensimet publike të papaguara / më pak të paguara në Buxhetin e Shtetit	2.000.186
Kërkesat nga shteti	942.206
Kompensimet e papaguara / më pak të paguara në Buxhetin e komunave të reviduara	275.059
Shfrytëzimi i paligjshëm i mjeteve	6.203.277
Më shumë kontribute të llogaritura të TVSH-së	1.135
Regjistrimet korrigjuese në Bilancin e Gjendjes	4.081.229
Gjendjet e konstatuara që ndikojnë në veprimtarinë e subjektit që është lëndë e revizionit, detyrimet e papaguara dhe investimet kapitale	8.608.961
Detyrimet sipas kredisë së marrë (organet e tjera shtetërore)	86.093
Grantet e anuluar / të humbura	5.680.570
Anulimi / ngecja e granteve të investimeve	8.859.690
Provizionet e paguara / llogaritura për mjetet e patërhequra nga kreditë / huatë	1.400.077
Kërkesat e vjetruara	2.769.475
Masat e pandërmarra të arkëtimit	801.314
Detyrimet e papaguara ndaj furnitorëve	13.762.539
Vlera e kërkesës së padisë në procedurat gjyqësore në të cilat subjekti që është lëndë e revizionit paraqitet në rolin e të paditurit dhe të paditësit	6.617.820
Shuma e procedurave të humbura gjyqësore	196.808
Shuma e shpenzimeve të avokatëve, noterëve dhe shpenzimeve të përmbauesve	12.042
Efektet financiare të revizionit / mjetet e paguara gjatë revizionit / kamatat e zvogëluara	1.240.228
Vlera tjetër e shtuar e revizionit / kompensimet e paguara jo në kohë	650.837
Shuma totale e prokurimeve publike	14.762.907
Fushëveprimi i prokurimeve publike me revizion	10.668.017
Vlera totale e prokurimeve publike që janë lëndë e revizionit - realizimi	2.058.771
Shuma totale e parregullsive të konstatuara në prokurimet publike	1.779.860
Vlera totale e kontratave të lidhura në të cilat u konstatuan parregullsi	1.426.548
Realizimi i përgjithshëm i kontratave të lidhura në të cilat u konstatuan parregullsi	470.421
Prokurimet e kryera për të cilat nuk është zbatuar procedura e prokurimeve publike	16.202

5.2

REVIZIONET E RREGULLSHMËRISË

(REVIZIONET E RAPORTEVE FINANCIARE DHE REVIZIONET E PAJTUESHMËRISË)

5.2.1

BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

5.2.1.1.

BUXHETI THEMELOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2023

Menaxhimi i financave publike është një nga prioritetet kryesore të shtetit, duke mundësuar sigurinë financiare dhe qëndrueshmërinë e financave publike. Duke pasur parasysh rëndësinë ekonomike, sociale dhe politike të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, planifikimi, përgatitja, miratimi dhe realizimi i tij është detyrim prioritar kryesisht i Ministrisë së Financave dhe ka për qëllim të ruajë stabilitetin makroekonomik dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik nacional, si dhe të përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.


Kemi konstatuar se gjatë përgatitjes dhe miratimit të Buxhetit për vitin 2023, afatet e përcaktuara për aktivitetet kryesore dhe për miratimin e dokumenteve themelore të planifikimit janë përmbushur, me periudhë të parëndësishme vonese në miratimin e Vendimit për përcaktimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë në vitin 2023.



Duke analizuar plotësinë e dokumentacionit të 26% të shfrytëzuesve buxhetorë, në bazë të së cilës e shprehin lartësinë e mjeteve të nevojshme, konstatuam se te 20% të tyre, gjatë përgatitjes së Buxhetit Themelor për vitin 2023, ashtu si edhe në vitet e kaluara, planifikimi kryhet në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në mënyrë të paplotë. Kjo tregon se ende ekziston nevoja për të forcuar vazhdimisht aktivitetet për të plotësuar kërkesat buxhetore nga shfrytëzuesit buxhetorë me planet strategjike, me qëllim të harmonizimit me qëllimet strategjike të Qeverisë dhe avancimit të cilësisë së procesit të përgjithshëm të planifikimit të buxhetit të shtetit.

Buxheti Themelor i miratuar për vitin 2023 është 261.552.000 mijë denarë dhe në krahasim me vitin 2022 është për 33,4% më i lartë dhe 52% më i lartë se shumatat maksimale të mjeteve/shpenzimeve të miratuara.





Në mënyrë plotësuese, me dy Vendime për rishpërndarjen e mjeteve midis shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe midis fondeve, Buxheti Themelor për vitin 2023 është rritur për 0,3% dhe është 262.551.901 mijë denarë. Në këtë rast, të ardhurat dhe shpenzimet totale dhe deficitit buxhetor mbeten të pandryshuara, ndërsa ndryshon vetëm struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas shfrytëzuesve buxhetorë.

Theksuam nevojën për të forcuar procedurën për harmonizimin e propozimeve të kërkesave buxhetore midis MF-së dhe shfrytëzuesve buxhetorë, me qëllim të minimizimit të rrezikut



që mjetet e planifikuara mos t'i pasqyrojnë nevojat reale të shfrytëzuesve buxhetorë, si dhe nevojën për të informuar Qeverinë për arsyet e mosharmonizimit midis mjeteve të kërkuara dhe të miratuara të shfrytëzuesve buxhetorë.

Ligji për buxhetin gjyqësor, Ligji për Prokurorinë Publike dhe Ligji për zhvillim të barabartë rajonal janë ligje që rregullojnë në mënyrë më konkrete lartësinë e mjeteve që duhet të sigurohen çdo vit nga Buxheti për funksionimin e papenguar të pushtetit gjyqësor, prokurorisë publike dhe inkurajimin e zhvillimit të barabartë rajonal.

PUSHTETI LIGJOR		0,8% NGA BPV		0,3% NGA BPV
PROKURORIA PUBLIKE	SIPAS LIGJIT	MË SË PAKU 0,4% NGA BUXHETI I SHTETIT	MJETET E SIGURU-ARA ME BUXHET	0,2% NGA MJETET E BUXHETIT
ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL		MË SË PAKU 1% NGA BPV		0,09% NGA BPV

Ashtu si edhe në vitet e kaluara, kemi konstatuar se edhe me Buxhetin Themelor për vitin 2023 nuk

janë siguruar mjetet e përcaktuara me ligj për:




Nënprogramin OA - Zhvillimi i barabartë rajonal nevojitet që të sigurohen të paktën 1% e BPV-së, dhe këto të realizohen përmes programeve vjetore të parashikuara në buxhetet e Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale dhe Byrosë së Zhvillimit Rajonal. Konstatuam se pjesëmarrja e mjeteve të miratuara për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal përmes këtij nënprogrami në vitin 2023 është 0,09% të BPV-së dhe është gjithashtu në të njëjtin nivel si në vitin 2022.

- /// **deficiti i pushtetit të përgjithshëm për vitin përkatës nuk duhet** të kalojë nivel prej 3% të BPV-së nominale,
- /// **borxhi total i pushtetit të përgjithshëm nuk duhet** të kalojë nivel prej 60% të BPV-së nominale dhe
- /// **borxhi publik i garantuar nuk duhet** të kalojë 15% të BPV-së nominale.

Me Ligjin e ri për buxhete, që nga 1 janari 2023, janë futur rregulla të reja fiskale në lidhje me deficitin dhe borxhin total të pushtetit të përgjithshëm, ashtu që:

Deficiti buxhetor i pushtetit të përgjithshëm, sipas treguesve makroekonomikë të publikuar nga MF-ja për vitin 2023 është 4,8% të BPV-së dhe është më i lartë krahasuar me vitin 2022 kur ishte 4,4% të BPV-së dhe si rezultat i krizës ekonomike është më i lartë se niveli i përcaktuar me ligj me rregullat fiskale, si dhe nga përqindja e projektuar në strategjitë fiskale.



Burimi: Ministria e Financave


Të ardhurat dhe të hyrat totale në vitin 2023 u realizuan në shumën prej 260.125.128 mijë denarë, 29% më shumë krahasuar me vitin 2022, që kryesisht i detyrohet rritjes së huamarrjes së

brendshme dhe huamarrjes së jashtme. Grafiku më poshtë tregon strukturën e Buxhetit për vitet 2023 dhe 2022 sipas llojeve të të ardhurave dhe të hyrave.

TË ARDHURAT DHE TË HYRAT TOTALE NË BUXHETIN THEMELOR NË VITIN 2023


në 000 denarë

LLOJET E TË ARDHURAVE	2023	2022	2023/2022
Të ardhura tatimore	154.405.427	139.074.197	11%
Të ardhura jotatimore	6.780.481	7.975.217	-15%
Të ardhurat kapitale	2.060.314	2.219.926	-7%
Transfertat dhe donacionet	14.651.839	15.184.119	-4%
Huamarrja e brendshme	36.156.026	14.680.857	146%
Huamarrje jashtë vendit	44.795.663	21.983.196	104%
Të ardhura nga shlyerja e huasë	1.275.378	906.379	41%
GJITHËSEJ:	260.125.128	202.023.891	29%



Të ardhurat tatimore në vitin 2023, ashtu si edhe në vitin 2022, kanë pjesëmarrjen më të madhe në strukturën e të ardhurave të Buxhetit Themelor.

Të ardhurat tatimore kanë pjesëmarrjen prej 59,36% në të ardhurat totale të Buxhetit Themelor në vitin 2023, ndërsa pjesëmarrja individuale e tatimeve sipas llojeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:




Tatimi i solidaritetit si tatim i ri i njehershëm u fut në fuqi në shtator të vitit 2023 në përputhje me Ligjin për tatimin mbi solidaritetin, si të ardhura në Buxhet është realizuar shuma prej 2.942.980 mijë denarë. Qëllimi i këtij tatimi është që, në kushte të rrethanave të paparashikueshme dhe të pafavorshme ekonomike, secili të marrë pjesë në shlyerjen e shpenzimeve publike në përputhje me mundësitë e tyre ekonomike. Mjetet nga të ardhurat e arkëtuara përdoren përmes Ndarjes Qeveria, nënprogrami P1 - Masat për t'u përballur me krizën e Kovid-19 dhe masat e tjera kundër krizës për t'i mbështetur qytetarët, institucionet dhe ekonominë, me qëllim të tejkalimit të gjendjeve të caktuara të paparashikuara.

Një pjesë e këtyre mjeteve në shumën prej 962.913 mijë denarë në nëntor të vitit 2023, me vendim të Qeverisë, u janë miratuar Hekurudhave të RMV-së - Transporti në pronësi shtetërore për të rritur kapitalin bazë, të cilat mjete HRMV - Transporti i ka shfrytëzuar për t'i shlyer detyrimet ndaj SHA Elektranat e Maqedonisë së Veriut. Në Raport, theksuam se në përputhje me Vendimet e

Qeverisë të miratuara mbi ekzistencën e gjendjes së krizës në furnizimin me energji elektrike, afati për ekzistencën e gjendjes së krizës përfundon më 30 prill 2023.


Në shkurt të vitit 2025, Gjykata Kushtetuese e RMV-së miratoi vendim me të cilin e anuloi Ligjin për solidaritetin, kështu që ekziston detyrimi që mjetet e paguara mbi këtë bazë t'u kthehen firmave që ishin tatimpagues për këtë tatim.

Të hyrat totale nga huamarrja e **brendshme dhe jashtme** në vitin 2023 marrin pjesë me 31% në të ardhurat totale të Buxhetit Themelor për vitin 2023. Evidente është rritja e të hyrave, si nga huamarrja e brendshme, ashtu edhe nga ajo e jashtme në vitin 2023. Rritja e huamarrjes së jashtme me 104% krahasuar me vitin 2022 është për shkak të të hyrave të mjeteve nga euroobligacioni i emetuar nga shteti në tregun ndërkombëtar të kapitalit në vitin 2023.




Shpenzimet dhe të dalat totale të Buxhetit Themelor për vitin 2023 në shumën prej

249.364.054 mijë denarë janë për 29,76% më të larta krahasuar me vitin 2022.



Në kuadër të shpenzimeve dhe të dalave individuale, rritja më e ndjeshme ishte në shpenzimet për shlyerjen e kryegjësë për 284,58%, shpenzimet kapitale për 68,38%, transfertat rrjedhëse për njësitë e vetëqeverisjes lokale për 17,52%, për beneficionet sociale për 15,41% dhe për rrogat, qiramarrjet dhe kompensimet për 14,38%, ndërsa ulja më e madhe prej 78,72% u shënua te shpenzimet për rezervat dhe shpenzimet e pacaktuara dhe subvencionet dhe transfertat për 16,53%.

Pjesëmarrja e llojeve individuale të shpenzimeve dhe të dalave të tjera lidhur me totalin e shpenzimeve dhe të dalave të realizuara në Buxheti Themelor për vitin 2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



PJESËMARRJA E LLOJEVE INDIVIDUALE TË SHPENZIMEVE DHE TË DALAVE NË TOTALIN E SHPENZIMEVE DHE TË DALAVE TË REALIZUARA NË BUXHETIN THEMELOR PËR VITIN 2023

Për mbulimin e deficitit të Fondit Pensional nga Buxheti Themelor u paguan 16.515.500 mijë denarë, përkatësisht 21% të totalit të mjeteve të Fondit për pagesën e pensioneve. Struktura e burimeve të mjeteve nga të cilat **Fondi i SPIMV-së** siguron shumat e nevojshme për pagesën e pensioneve

dhe në vitin 2023 nuk shënon dallim krahasuar me vitin 2022, kështu që ende ekziston nevoja për mbështetjen financiare të Fondit të SPIMV-së për pagesën e pensioneve në shtet me mjetet e Buxhetit.


STRUKTURA E BURIMEVE TË MJETEVE PËR PAGESAT E PENSIONEVE


	Transferet nga Buxheti Themelor-detyrim ligjor	Transferet nga Buxheti Themelor-deficit	Mjetet e Fondit për SPIMV
2021	21%	29%	51%
2022	20%	22%	58%
2023	19%	21%	60%

Në NJVL si **Transfere Rrjedhëse** gjatë vitit 2023 janë paguar dotacione në shumën prej 27.458.466 mijë denarë ose 11% të shpenzimeve totale të Buxhetit Themelor që krahasuar me vitin 2022 shënojnë rritje prej 17,5%. Pjesëmarrjen më të madhe në transfertat e kanë bllok-dotacionet - 85%, dotacionet nga TVSH-ja - 13% dhe dotacionet

me dedikim - 2%. Konstatuam se 11 komuna, përfundimisht deri më 04.04.2024, vepruan në përputhje me Ligjin për realizimin e buxhetit dhe kishin kthyer në Buxhet 29.124 mijë denarë mjete të pashfrytëzuara, ndërsa 28 komuna nuk kishin kthyer mjete në shumën prej 28.059 mijë denarë.

Shpenzimet kapitale në Buxhetin Themelor për vitin 2023 u realizuan në shumën prej 37.649.990 mijë denarë, që është 15% i shpenzimeve totale të Buxhetit Themelor dhe krahasuar me vitin 2022, ato janë rritur për 68% dhe vazhdimisht rriten duke filluar nga viti 2019.





STRUKTURA E SHPENZIMEVE KAPITALE NË VITIN 2023

Pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve bie mbi subvencionet **kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare**, ndërsa 94% e tyre

realizohen përmes Ndarjes 13001 - Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.



Subvencionet kapitale

Subvencione kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare **15.146.647** mijë denarë

programi **2M** – Investime përmes infrastrukturës rrugore

Koridori **10D** – Segment i autostradës Prilep – Manastir

Koridori **8** – Segmenti Tetovë – Gostivar – Bukojçani dhe Projekti për autostradën Trebenishtë – Strugë – Qafëthanë

94%

të realizuara nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve

REALIZIMI I SUBVENCIONEVE KAPITALE PËR NDËRMARRJET DHE ORGANIZATAT JOQEVERITARE NË VITIN 2023

Investimet dhe mjetet jofinanciare: në vitin 2023, për këtë dedikim u realizuan 9.143.879 mijë denarë, 14% më pak krahasuar me vitin 2022, nga të cilat

55% e tyre, përkatësisht 5.041.869 mijë denarë, u realizuan përmes Qeverisë.

962.913 mijë denarë

Për rritjen e kryegjës themelore të HRMV Transport në pronësi shtetërore, për shlyerjen e detyrimeve mbi bazë të marrëveshjeve gjyqësore, aktgjykimeve të formës së prerë dhe të zbatueshme, si dhe marrëveshjeve të arritura me SHA Termocentralet e Maqedonisë së Veriut



3.874.700 mijë denarë


Për SHA Elektrani të Maqedonisë së Veriut për ballafaqim me gjendjen e krizës në furnizimin me energji elektrike

REALIZIMI I INVESTIMEVE DHE MJETEVE JOFINANCIARE NË VITIN 2023

Theksuam se është e nevojshme që baza për ndarjen e mjeteve nga programet dhe nënprogramet e Qeverisë të korrespondojë me qëllimet.

Borxhi publik më 31.12.2023 si shumë e borxhit shtetëror dhe borxhit të ndërmarrjeve publike të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, si dhe shoqërive tregtare që janë në pronësi të plotë ose dominuese të shtetit ose të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, sipas të dhënave të MF-së është 8.476.800.000 euro, ndërsa më 31.12.2022 ishte në shumën 7.702.900.000 euro, që tregon rritje në shumën absolute prej 773.900.000 euro, përkatësisht prej 10%. Gjendja e borxhit publik lidhur me BPV-në më 31.12.2023 është 62,1% dhe është rritur krahasuar me vitin 2022 për 5,07%, kur ishte 59,1%.

Borxhi shtetëror më 31.12.2023 është 7.256.200.000 euro dhe, përkundër gjendjes së borxhit shtetëror të vitit të kaluar, i cili ishte në shumën 6.581.000.000 euro është rritur në shumën prej 675.200.000 euro. Gjendja e borxhit shtetëror më 31.12.2023 është 53,1% të BPV-së dhe është rritur krahasuar me vitin 2022 për 5,14%, kur ishte 50,5% të BPV-së.



GJENDJA E BORXHIT SHTETËROR DHE PUBLIK SI PËRQINDJE E PJESËMARRJES NË BPV-NË 2014-2023

Borxhi publik si % e BPV

Borxhi shtetëror si % e BPV

Burimi: Ministria e Financave

Konstatuam gjendje të pafavorshme në aspektin e huamarrjes së subjekteve të sektorit publik, dinamikës së realizimit të projekteve, shfrytëzimit të kredive dhe huave, shpenzimeve të paguara dhe të krijuara nga organet shtetërore, institucionet, shoqëritë aksionare dhe ndërmarrjet publike. Të dhënat e dorëzuara nga MF-ja mbi realizimin

e projekteve të financuara me mjetet e huave, shpenzimet e bëra për realizimin e tyre, si dhe ndikimi i tyre në arritjen e qëllimeve të investimit në periudhat e ardhshme, tregojnë për shfrytëzimin joefikas të mjeteve dhe gjenerimin e shpenzimeve të paparashikuara:

PASQYRË E HUAMARRJES ME HUA/GRANTE, MJETET E PËRGJITHSHME TË TËRHEQURA DHE TË PATËRHEQURA DHE SHPENZIME PËR PROVIZION TË MJETEVE TË PATËRHEQURA PËR PROJEKTET RRJEDHËSE, NGA INSTITUCIONET KOMPETENTE, ME GJENDJE 31.12.2023

000 denarë

								Dinamika e realizimit, në përputhje me periudhën e huamarrjes me hua/grant
Ministria e Financave	3.068.601	277.049	2.791.551	9%	91%	8.266	2 projekte nga viti 2021 dhe 2023 me dinamikë të rregullt të realizimit	
Ministria e Transportit dhe Lidhjes	8.498.609	4.171.167	4.327.442	49%	51%	36.588	2 projekte nga vitet 2019-2023 me dinamikë të rregullt të realizimit dhe 1 projekt nga viti 2019 me dinamikë të ngadalte të realizimit	
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	6.456.975	0	6.456.975	0%	100%	0	2 projekte nga vitet 2022 dhe 2023 me dinamikë të ngadalte të realizimit	
Ministria e Shëndetësisë	1.656.519	830.183	826.336	50%	50%	0	1 projekt nga viti 2015, i cili ka shënuar ngecje	
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	2.613.538	1.406.994	1.206.544	54%	46%	21.719	2 projekte nga vitet 2018 dhe 2020 me dinamikë të rregullt të realizimit	
Ministria e Drejtësisë - Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve	2.828.770	1.291.395	1.537.375	46%	54%	0	1 projekt nga viti 2010, i cili ka shënuar ngecje	
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit	7.994.350	302.776	7.691.574	4%	96%	44.849	1 projekt nga viti 2019 që ka shënuar ngecje dhe 1 projekt nga vitet 2021/2022 me dinamikë të rregullt të realizimit	
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	4.875.635	2.689.050	2.186.585	55%	45%	15.801	3 projekte nga vitet 2011/2022 dhe 2021 me dinamikë të rregullt të realizimit dhe 1 projekt nga viti 2019 me dinamikë të ngadalte të realizimit	
SHA Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut	9.224.250	3.964.091	5.260.59	43%	57%	0	1 projekt nga viti 2023, me dinamikë të rregullt të realizimit.	
Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore - NPPRRSH	77.579.604	45.542.819	32.036.785	59%	41%	613.680	6 projekte nga vitet 2014-2022 me dinamikë të ngadalte të realizimit dhe 1 projekt nga periudha 2014/2019 që është në ngecje	
NP për Infrastrukturë Hekurullorë HRMV Shkup	46.684.472	5.014.016	41.670.456	11%	89%	459.227	2 projekte nga vitet 2012 dhe 2014/2018 me dinamikë të ngadalte të realizimit dhe 1 projekt nga viti 2023 me dinamikë të rregullt të realizimit	
SHA Elektroa e Maqedonisë së Veriut - ESM	8.571.552	1.302.939	7.268.612	15%	85%	65.226	4 projekte nga vitet 2015 - 2023 me dinamikë të rregullt të realizimit dhe 1 projekt nga periudha 2018/2019 me dinamikë të ngadalte të realizimit	
SHA MEPSO	4.550.630	2.602.641	1.947.989	57%	43%	131.295	2 projekte nga vitet 2013 dhe 2015/2016 me dinamikë të ngadalte të realizimit	
SHA NOMAGAS Shkup	2.559.668	0	2.559.668	0	100%	0	1 projekt nga viti 2021 me dinamikë të ngadalte të realizimit.	
M-NAV SHA SHKUP	600.806	129.227	471.579	22%	78%	3.426	1 projekt nga viti 2022 me dinamikë të ngadalte të realizimit	
Qyteti i Shkupit	4.304.650	0	4.304.650	0	100%	0	1 projekt nga viti 2021, i cili ka shënuar ngecje	
NP Ujësjellësi dhe Kanalizimi Shkup	12.039.754	922.425	11.117.329	8%	92%	0	1 projekt nga periudha 2019/2023 me dinamikë të ngadalte të realizimit	

204.108.382

70.446.770

133.661.612

1.400.077



Institucioni kompetent



Shuma totale e huave / granteve investuese



Shuma e mjeteve të tërhequra



Shuma e mjeteve të patërhequra



% e mjeteve të tërhequra




% e mjeteve të pa tërhequra



Shpenzimet e provizioneve për mjetet patërhequra

Pjesa më e madhe, përkatësisht 38% e shumës së huave dhe granteve, realizohet përmes NPRRSH-së për financimin e shtatë projekteve, realizimi i të cilave është me dinamikë të ngadalësuar, si dhe përmes NPHRMV Infrastruktura, kompetente për realizimin e tri projekteve që përbëjnë 23% të shumës totale të huave dhe granteve të miratuara, dy prej të cilave janë me dinamikë të ngadalësuar të realizimit.

Ligji për evidencën dhe paraqitjen e detyrimeve parashikon që subjektet e sektorit publik në bazë mujore nëpërmjet Sistemit Elektronik për Evidencën dhe Paraqitjen e Detyrimeve (SEEPD) në MF t'i paraqesin detyrimet në përputhje me evidencën e tyre të kontabilitetit, më së voni deri në ditën e 10-të të muajit, për muajin paraprak. Deri në dhjetor të vitit 2023, revizioni konstatoi se nga gjithsej 1.382 subjekte, në SEEPD të dhëna kanë dorëzuar 1.157 subjekte, përkatësisht detyrime të maturuara, ndërsa të papaguara, në shumën totale prej 25.142.221 mijë denarë, që është për 686.780 mijë denarë ose 2,66% më pak krahasuar me vitin 2022. Pjesëmarrjen më të madhe në totalin e detyrimeve e kanë ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi shtetërore me 40,97%, ndërmarrjet publike komunale me 18,61%, si dhe institucionet shëndetësore publike me 14,99%.




PAQËNDRUESHMËRIA FINANCIARE E NJVL-SË

Paqëndrueshmëria financiare e komunës ndodh nëse llogaria e komunës është e bllokuar për më shumë se gjashtë muaj ose nëse, gjatë periudhës prej gjashtë muaj, vazhdimisht çdo muaj, me gjendjen në fund të muajit, shuma totale e detyrimeve të papaguara mbi 60 ditë, në vitin 2023


tejkalon 70% (60% nga 01.01.2024) të të ardhurave të realizuara të buxhetit themelor të komunës në vitin paraprak.

SISTEM ELEKTRONIK PËR RAPORTIMIN DHE EVIDENTIMIN E DETYRIMEVE NË MF
31.12.2023



3.612.801
mijë denarë

Shuma e përgjithshme e detyrimeve të raportuara nga NJVL



1.628.87
mijë denarë

urdhëresave të paarkëtuara për realizim
31.12.2023



13

Komuna me llogari të bllokuara



68

Komuna me llogari të pabllokuara

GJENDJA E DETYRIMEVE TË PARAQITURA DHE URDHËRESAVE TË PAARKËTUARA PËR REALIZIM NË NJVL

Edhe pse të dhënat tregojnë përqindje të lartë të huamarrjes së komunave në kushtet kur realizimi i të ardhurave shënoi trend në rënie, deri në periudhën e revizionit nuk është shpallur paqëndrueshmëria financiare e asnjë komune, kështu që komunat mund të gjenerojnë detyrime të reja mbi baza të ndryshme dhe të fillojnë projekte të reja kapitale, gjë që ndikon në përkeqësimin e mëtejshëm të likuiditetit të tyre dhe gjendjes së përgjithshme financiare, ndërsa me këtë edhe mundësia e nevojës shtesë për të ndarë mjetet e Buxhetit si mbështetje financiare për to dhe të dala të mjeteve buxhetore.

Programi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2022-2025¹ është dokument strategjik i Qeverisë për zhvillimin e sistemit të menaxhimit të financave publike në përputhje me reformat e financave publike të nisura në vitin 2018, të cilat synojnë përmirësimin e kornizës fiskale, forcimin e procesit të planifikimit, realizimit dhe njoftimit mbi financat publike, rritjen e arkëtimit të të ardhurave, përmirësimin e sistemit të prokurimeve publike dhe forcimin e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm duke rritur transparencën dhe llogaridhënien në punë.

Duke marrë parasysh se Ligji i ri për buxhete, i cili hyri në fuqi më 27.02.2022 me zbatim të anuluar nga 01.01.2025, një pjesë e madhe e aktiviteteve për të siguruar parakushtet e nevojshme për funksionimin e sistemeve dhe trupave të caktuara fillojnë me hyrjen në fuqi të ligjit - 27.09.2022, ndërsa të gjitha aktet nënligjore duhet të miratohen deri më 27.09.2024, në Raport zbuluam një ritëm të ngadalësuar të aktiviteteve të caktuara që mund të kenë ndikim në zbatimin në kohë të ligjit.



¹ në nëntor 2024 është bërë harmonizimi i Programit të Reformës së MFP-së me prioritetet e Programit të ri të Qeverisë 2024-2028, në mënyrë që Programi i Reviduar i Reformës së MFP-së të mbulojë periudhën 2025-2028.

5.2.1.2.

MINISTRIA E FINANCAVE –


FUNKSIONET E SHTETIT

Funksionet e shtetit është Ndarje e veçantë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në kuadër të Ministrisë së Financave, ndërsa pagesa e mjeteve nga kjo Ndarje rregullohet me Ligjin për realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për çdo vit kalendarik. Këto mjete shfrytëzohen pa miratimin e planit financiar, ndërsa në rast se Qeveria miraton mjete nga kjo Ndarje në Ndarjen e shfrytëzuesit tjetër buxhetor, ato miratohen si plan financiar, përkatësisht e drejtë për të shpenzuar.

Mjetet e siguruar në kuadër të kësaj Ndarjeje shfrytëzohen për:

- /// servisimin në kohë të detyrimeve, shlyerjen e kryegjësë dhe kamatës në bazë të huamarrjes së brendshme dhe të jashtme të shtetit;
- /// pagesën e rregullt të shpenzimeve operative ndaj shtetit sipas dokumentacionit të dorëzuar paraprakisht të pagesës;
- /// pjesëmarrjen në kapitalin e institucioneve financiare ndërkombëtare;
- /// pagesën e TVSH-së në bazë të investimeve kapitale të financuara nga donacionet, financimin e projekteve nga komponentët individualë të IPA-së dhe
- /// mbulimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe financimin e shpenzimeve të paparashikuara gjatë vitit fiskal.

Në pjesën e raportit të revizorit që i kushtohet theksimit të çështjeve, bëme prezantimin e më shumë gjendjeve që lidhen me mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve, përkatësisht:



Për shkak të dëmeve të pësuar nga fatkeqësitë natyrore - breshëri, nga rezerva e përhershme e Buxhetit të 18 komunave, në bazë të më shumë vendimeve të Qeverisë, janë paguar mjete në shumën prej 50.718 mijë denarë. Edhe pse komunat ishin të detyruara brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së mjeteve në Qeveri dhe në Komisionin për Vlerësimin dhe Përcaktimin e Lartësisë së Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore të dorëzonin Raport mbi realizimin e mjeteve të miratuara, ndërsa mjetet e pandara t'i kthenin në Buxhet, vetëm tri komuna i përmbushën detyrimet e tyre. Për shkak të mosveprimit të 15 komunave të mbetura, Qeveria nuk ka informacione të plota mbi shfrytëzimin me dedikim të mjeteve të ndara dhe për lartësinë e mjeteve të pashfrytëzuara, prandaj theksuam nevojën që personat përgjegjës nga MF-ja dhe Qeveria të ndërmarrin masa dhe aktivitete në mënyrë që komunat t'i dorëzojnë njoftimet e nevojshme.

Gjatë vitit 2023, nga mjetet e Ndarjes MF - Funksionet e Shtetit janë paguar 827.865 mijë denarë, bazuar në 28 vendimet e Qeverisë, të cilat vendime nuk janë botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Konstatuam se kjo nuk është në përputhje me nenin 3 të Ligjit për botimin e ligjeve dhe rregullave e akteve të tjera në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shkak se nuk është siguruar transparenca e institucioneve si një nga parimet e qeverisjes së mirë dhe nuk mundëson disponueshmërinë e informacionit për të gjitha palët e interesuara dhe publikun e gjerë.

3Për t'i arritur qëllimet e efikasitetit energjetik dhe për të mbështetur politikën në fushën e energjetikës, në tetor 2023 ishte themeluar Fondi për Efikasitetin Energjetik. Kapitali fillestar i Fondit duhet të sigurohet nga shteti - 10 milion euro dhe 5 milion euro - me mjete nga një pjesë e huas në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore nga viti 2021. Edhe pse në dhjetor 2023, për këtë dedikim nga Funksionet e Shtetit në Fond u paguan mjete në shumën prej 600.000 mijë denarë, ai ende nuk është funksional, sepse Banka Botërore ende nuk i ka miratuar kushtet e kontratës që do të lidhet midis Ministrisë së Financave dhe Fondit, pasi kontrata është lëndë e harmonizimit midis palëve kontraktuese.

Në janar të vitit 2023, nga mjetet e Funkcionit të Shtetit u paguan 378.446 mijë denarë, bazuar në aktgjykimet gjyqësore të vitit 2022, me të cilat të paditurit, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Komuna e Karposhit, në mënyrë solidare e detyruan paditësin të paguajë çmimin e shitblerjes, kompensimin për dëmin e shkaktuar gjatë blerjes së tokës ndërtimore në territorin e Komunës së Karposhit. Edhe pse aktgjykimet bëjnë fjalë për pagesë solidare të dëmeve të konstatuara, deri në ditën e kryerjes së revizionit, asnjë institucion nuk kishte ndërmarrë aktivitete për t'i kthyer mjetet në Buxhet, prandaj theksuam nevojën për të intensifikuar komunikimin dhe koordinimin midis Ministrisë së Financave, Avokatisë Shtetërore dhe Komunës së Karposhit për të ndërmarrë aktivitete për t'i kthyer mjetet në Buxhet, si dhe për të ndërmarrë masa juridike për t'i kthyer mjetet në Buxhet dhe nga Qyteti i Shkupit.

I theksojmë përsëri gjendjet që, megjithëse janë konstatuar edhe me revizionet e mëparshme dhe është treguar nevoja për tejkalimin e tyre, ato edhe më tutje përsëriten, ndërsa kanë të bëjnë me:

- /// paraqitjen jo të plotë të shpenzimeve në llogarinë përfundimtare të Ndarjes MF - Funkcionet e Shtetit për vitin 2023 për shkak të mosparaqitjes së mjeteve për shlyerjen e borxhit të jashtëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut në shumën prej 38.890.521 mijë denarë, të cilat janë paraqitur në Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit dhe
- /// pamundësinë e institucioneve për t'i kthyer mjetet nga personat juridikë që kanë marrë mjete nga fondet e IPA-së së Komisionit Evropian, dhe për të cilat, për shkak të parregullsive në ndarjen e tyre të përcaktuara nga OLAF, RMV-ja është e detyruar që mjetet e shfrytëzuara në mënyrë joligjore t'i kthejë në fondet e Komisionit Evropian. Në vitin 2023, mbi këtë bazë, Komisionit Evropian iu kthyen 36.937 mijë denarë, përkatësisht 600.000 euro.


5.2.1.3.

AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E PRONËS SË SEKUESTRUAR

Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Sekuestruar menaxhon pronën e konfiskuar dhe dobinë pronësore dhe sendet e sekuestruara përgjithmonë; me pëlqimin e gjykatës, menaxhon edhe pronën e sekuestruar përkohësisht dhe dobinë pronësore dhe sendet e sekuestruara përkohësisht; zbaton procedurën për kryerjen e konfiskimit të pronës dhe dobisë pronësore si kontribut të veprës penale; mban regjistër të pronës së sekuestruar përkohësisht, sendeve të sekuestruara përkohësisht, sendeve të sekuestruara përgjithmonë dhe pronës së konfiskuar; mban dhe ruan pronën e sekuestruar; kryen vlerësim të pronës së sekuestruar; jep me qira pronën e konfiskuar; mban evidencë për të gjithë pronën e sekuestruar; shet pronën e sekuestruar dhe kryen kompetenca të tjera në përputhje me ligjin. Për punën e vet, Agjencia përgjigjet para Qeverisë.


Kryem revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Agjencisë për Menaxhimin e Pronës së Sekuestruar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë të cilit konstatuam më shumë parregullsi që kanë ndikim në raportet financiare për periudhën raportuese, si dhe në harmonizimin e punës me aktet ligjore, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme ekzistuese, të paraqitura në infografik:






Një pjesë e magazinave dhe parcelave, të cilat Agjencia i përdor që nga viti 2009 për strehimin dhe ruajtjen e pronës së konfiskuar, edhe pas 14 vjetësh përdoren pa vendim të Qeverisë për transferimin e të drejtës së përdorimit

Dobësi të konstatuara në zbatimin e regjistrimit vjetor si dhe mospërputhje e evidencës kontabël me gjendjet e konstatuara në regjistrim



Dobësi në lidhje me llogaritjen dhe pagesën e pagave të punonjësve për faktin se Agjencia nuk disponon dosje të plota dhe të kompletuara për punonjësit, Rregullorja për pagat dhe kompensimet e tjera për llogaritjen dhe pagesën e pagave për personat teknikë ndihmës, dhe nuk është bashkangjitur dokumentacion i besueshëm dhe i konfirmuar për pagesën e punës jashtë orarit

Janë evidentuar shpenzime në vlerë prej 1.168 mijë denarë pa u vërtetuar të njëjtit se janë në kuadër të limitit të përcaktuar në përputhje me aktet e brendshme të Agjencisë dhe vendimet e Qeverisë dhe pa u siguruar dokumentacion i plotë



Janë blerë mallra në vlerë prej 695 mijë denarësh për të cilat nuk janë zbatuar procedurat përkatëse në pajtim me Ligjin për prokurim publik

Sa i përket menaxhimit të pronës së sekuestruar, Agjencia nuk vepron në përputhje me parimet e ligjshmërisë, ekonomizimit, efikasitetit, transparencës, veprimit me vëmendjen e nikoqirit të mirë, përgjegjësisë, profesionalizmit dhe përditësimit:

- /// aktet nënligjore që e rregullojnë mënyrën e veprimit dhe evidentimit të pronës së sekuestruar, nuk janë botuar në Gazetën Zyrtare. Edhe pse janë publikuar në ueb-faqen, ato nuk përmbajnë numër arkivor, datën e miratimit të tyre dhe nënshkrimin e kryetarit të BD-së si konfirmim të vlefshmërisë së tyre;
- /// aktet nënligjore që përcaktojnë mënyrën e pranimit të sendeve të sekuestruara dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës së të dhënave mbi pronën dhe sendet e sekuestruara nuk zbatohen plotësisht;

/// për sendet e sekuestruara për të cilat Agjencia nuk ka kushtet për t'i marrë menjëherë në depot e saj, nuk mbahet evidencë me të dhënat mbi llojin e pronës së tundshme dhe subjektin ku ndodhen ato, as nuk bëhet regjistrimi i tyre. Konstatuam se përfundimisht më 31.12.2023, në zyrat doganore ndodhen 46 mjete motorike, ndërsa në MPB 689 mjete motorike pa vlerë të parashkuar;

/// praktika e vendosur e transferimit të sendeve dhe mjeteve motorike të sekuestruara nuk mundëson barazi të institucioneve në përdorimin e tyre, sepse Agjencia nuk i informon institucionet e pushtetit qendror dhe lokal, si dhe NP-të dhe SHA-të e themeluara nga ana e tyre, për sendet e sekuestruara që ka në dispozicion;

ambientet e magazinës nuk janë të mbrojtura me mjete dhe pajisje të përshtatshme elektrike dhe teknike (gardhe sigurie përreth objekteve, sisteme elektronike, alarme, sensorë të zbulimit të lëvizjes, kamera mbikëqyrjeje me video), me qëllim të zbulimit dhe parandalimit të veprimeve dhe aktiviteteve të paligjshme;



depot dhe ambientet e magazinës nuk i plotësojnë kushtet themelore të domosdoshme për mbrojtjen e llojeve të veçanta të mallrave (barna, sende të ndezshme, tekstile, mobilje, këpucë, ushqime, mjete motorike) nga zjarri, lagështia, ndryshimet ekstreme të temperaturës, dëmtuesit, etj.;

një pjesë e magazinave dhe placeve kanë pajisje të vjetruara dhe të papërdorshme (vinç pirunë) për menaxhimin e mallrave të sekuestruara dhe nuk kanë pajisjet e domosdoshme për transportimin e mjeteve motorike të sekuestruara;

sendet e sekuestruara nuk klasifikohen sipas llojit, vitit të marrjes dhe datës së kohëzgjatjes, duke bërë dallimin midis sendeve të sekuestruara përfundimisht dhe përkohësisht;



pjesa më e madhe e mjeteve motorike të sekuestruara kanë qenë të ruajtura në placin në Milladinovci, por edhe në oborret e depove të tjera për më shumë se 7-8 vjet.


Nuk janë krijuar kushte të përshtatshme për ruajtjen e tyre, prandaj pjesa më e madhe e tyre janë të mbuluara me bimësi, nuk janë në gjendje të mirë për t'u vozitur dhe janë dëmtuar, si nga kushtet e motit të jashtëm, ashtu edhe nga vjedhjet;

një pjesë e madhe e sendeve dhe automjeteve janë të papërdorshme, sepse kanë qenë të ruajtura për një periudhë të gjatë për shkak të kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore dhe mosmiratimit të aktgjyqimeve gjyqësore të formës së prerë. Për shkak të papërdorshmërisë së tyre, edhe sendet që kanë aktgjykim gjyqësor të formës së prerë nuk mund të shiten, as t'u transferohen organeve të tjera.

nuk ka transparencë në procedurën për shitjen e pronës së patundshme, sendeve të sekuestruara dhe pronës së konfiskuar.

Të ardhurat nga shitja e sendeve dhe pronës së patundshme të sekuestruara në përputhje me aktgjykimet gjyqësore të formës së prerë ose aktet administrative është e nevojshme të paguhet drejtpërdrejt në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Analiza e të ardhurave të realizuara nga shitja e pronës së sekuestruar dhe mjetet e paguara në Buxhetin e Shtetit të realizuara nga Agjencia në periudhën nga viti 2011


deri më 30 shtator 2024 tregon se nga të ardhurat totale të realizuara në shumën prej 1.649.956 mijë denarë, në Buxhetin e Shtetit janë paguar 1.204.816 mijë denarë, përkatësisht janë paguar më pak mjete se 445.140 mijë denarë. Gjendja e mjeteve të pashfrytëzuara monetare në llogarinë depozituese të Agjencisë më 31.12.2023 është 40.721 mijë denarë dhe ato nuk janë paguar në Buxhetin e Shtetit.



TË ARDHURAT E REALIZUARA DHE MJETET E PAGUARA NË BUXHETIN E RMV-SË

Në periudhën nga viti 2013 deri më 30.09.2024, nga të ardhurat e realizuara gjithsej janë shpenzuar 10.519 mijë denarë për baza të ndryshme. Qëllimi

i mjeteve të shpenzuara në shumën prej 4.771 mijë denarë për vitin 2023 është paraqitur në Grafikon më poshtë:



Mënyra e tillë e shfrytëzimit të mjeteve nga shitja e sendeve dhe pronës së patundshme të sekuestruara pas aktgjykimeve gjyqësore të formës së prerë ose atyre administrative nuk është në përputhje me nenet 29 dhe 34 të Ligjit për buxhete, sepse shkakton shpenzime më të larta lidhur me shumat maksimale të mjeteve të miratuara për shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror, që i përcakton çdo vit.

Në pjesën e raportit për theksimin e çështjeve, zbuluam gjendjet në lidhje me burimet në dispozicion të Agjencisë në lidhje me përmbushjen e kompetencave të saj.

5.2.2.

GJYQËSORI DHE SUNDIMI I SË DREJTËS

5.2.2.1

AVOKATIA E SHTETIT

Република Северна Македонија
Државно Правобранителство



Republika e Maqedonisë së Veriut
Avokatura e Shtetit

Avokatia e Shtetit është organ shtetëror që ndërmerr masa dhe mjete juridike për mbrojtjen juridike të të drejtave dhe interesave pronësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe ligj tjetër, ndërsa kompetencat e veta i ushtron në bazë të Kushtetutës, ligjit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara.

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare të Avokatit të Shtetit për vitin 2023, së bashku me revizionin epajtueshmërisë, në të cilin konstatuam se:

- /// ekziston mosharmonizimi i evidencës materiale dhe financiare në pjesën e vlerës së prokurimit dhe amortizimit të vlerës së pajisjes,
- /// mënyra e kryerjes së regjistrimit nuk është në përputhje me rregullativën ligjore,
- /// evidentimi joadekuatë i mjeteve afatgjata, vlera e prokurimit e të cilave është më e madhe se 300 euro në kundërvlerë me denarë,
- /// mënyra e papërkufizuar e përdorimit dhe disponimit me pronën e patundshme dhe mënyra e parregulluar e shlyerjes së shpenzimeve të përbashkëta të ngrohjes,

- /// prona e patundshme në të cilën ndodhet Avokatia e Shtetit për zonën e Tetovës nuk është e siguruar nga zjarret dhe fatkeqësitë e tjera.

Janë konstatuar parregullsi në procesin e zbatimit të procedurave për ndarjen e kontratave të prokurimeve publike.

Revizioni konstatoi gjendjen në lidhje me realizimin e të ardhurave që, në përputhje me Ligjin për Avokatinë e Shtetit, janë të ardhura të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në evidencën e kontabilitetit të ASHRMV-së në vitin 2023 janë evidentuar të ardhura në shumën prej 200 mijë denarë mbi baza të ndryshme për të cilat ASHRMV-ja nuk ka të dhëna të sakta për shumën e shpenzimeve të përfaqësimit që duhet të jenë të ardhura të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në Avokatinë e Shtetit nuk është emëruar kontabilisti përgjegjës.

Janë konstatuar dobësi në pjesën e kontrolleve të brendshme, përkatësisht theksojmë se nuk janë emëruar personat për të kryer kontrollin financiar ex-ante dhe ex-post, nuk është siguruar departamenti funksional i revizionit të brendshëm, si dhe nuk është siguruar ekipimi i kuadrit.



5.2.2.2

GJYQËSORI

Gjatë vitit 2024, u krye revizioni i raporteve financiare, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2023, në pesë gjykata, përkatësisht:

- /// **Gjykatën Themelore Civile Shkup,**
- /// **Gjykatën Themelore Penale Shkup,**
- /// **Gjykatën Themelore Gostivar,**
- /// **Gjykatën Themelore Prilep dhe**
- /// **Gjykatën e Apelit Gostivar, me ç'rast u konstatuan gjendjet e mëposhtme:**

Në pjesën e evidentimit të pronës në Gjykatën Themelore Civile të Shkupit, ka mungesë të dokumenteve të besueshme, të vërteta dhe të rregulluara të kontabilitetit për të konfirmuar vlerën e prokurimit të ndërtesës në të cilën vepron gjykata, si dhe të sendeve të patundshme që nuk janë evidentuar në evidencën e kontabilitetit të gjykatës për shkak të moskryerjes së pranim-dorëzimit të tyre.

Në Gjykatën Themelore Penale, ka mungesë të dokumenteve të besueshme, të vërteta dhe të rregulluara të kontabilitetit për të konfirmuar të drejtën e shfrytëzimit të ndërtesës së vjetër, si dhe të sendeve të patundshme që nuk janë evidentuar në evidencën e kontabilitetit të Gjykatës Themelore Penale të Shkupit për shkak të moskryerjes së pranim-dorëzimit të tyre.

Në Gjykatën Themelore të Gostivarit, revizionit nuk i ishte prezantuar dokumentacioni që do të konfirmonte të drejtën e pronësisë ose shfrytëzimit të pronës së patundshme - objektit në të cilin vepron gjykata, ndërsa në Gjykatën e Apelit të Gostivarit nuk ka dokumentacion të besueshëm të kontabilitetit për të konfirmuar të drejtën e shfrytëzimit të lokaleve afariste në të cilat vepron gjykata.

Në gjykatat e reviduara, ka parregullsi në zbatimin e regjistrimit të pronës dhe detyrimeve, gjendja që ka vazhduar prej vitesh dhe nuk mundëson harmonizimin e gjendjes së mjeteve dhe detyrimeve midis evidencës së kontabilitetit dhe gjendjes faktike të përcaktuar me regjistrimin.

Në të gjitha gjykatat e reviduara, Rregullorja për Sistemimin e Vendeve të Punës nuk parashikon Departament të Revizionit të Brendshëm në përputhje me kriteret për buxhetin/planin financiar mesatar vjetor në tre vitet e fundit, gjë që nuk është në përputhje me dispozitat nga neni 30 të Ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik¹⁵. Neni 17 i Ligjit për buxhetin¹⁶ gjyqësor parashikon që revizioni i brendshëm i realizimit të planeve financiare në njësitë individuale kryhet nga revizori i brendshëm i emëruar nga Këshilli i Buxhetit Gjyqësor. Duke inspektuar punën dhe dokumentacionin, konstatuam se nuk është kryer revizioni i brendshëm prej tyre në 5 vitet e fundit në gjykatat e reviduara.

Theksojmë se këto gjendje do të tejkalohen me miratimin e Ligjit të ri për sistemin e kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik¹⁷ i cili përcakton mënyrën e organizimit të revizionit të brendshëm sipas të cilit duhet të vendoset ajo edhe në gjyqësor. Pra, njësia funksionale e revizionit të brendshëm detyrimisht vendoset tek shfrytëzuesit buxhetorë amë, dhe ajo kryen revizion edhe tek shfrytëzuesit buxhetorë nëse nuk është themeluar tek ata. Neni 32 i Ligjit parashikon numrin minimal të të punësuarve në njësitë e revizionit të brendshëm tek shfrytëzuesi buxhetor amë dhe varet nga realizimi mesatar i buxhetit/planit financiar në tre vitet e fundit, përkatësisht deri në 500 milion denarë: të paktën një revizor dhe udhëheqës, nga 500 milion deri në 2 miliard denarë ose të paktën 80 të punësuar me të paktën dy revizorë dhe udhëheqës dhe mbi 2 miliard denarë ose të paktën 150 të punësuar me të paktën tre revizorë dhe udhëheqës.



¹⁵ Ligji për kontrollin e brendshëm financiar publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 90/09, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 188/13, 192/15 dhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë U.nr. 64/2016, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 147/17

¹⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 60/03, 37/06, 103/08 dhe 145/10

¹⁷ Gazeta Zyrtare nr. 255 nga 17.12.2024



Në pjesën e llogarisë depozituese, përveç në Gjykatën Themelore Civile të Shkupit dhe Gjykatën e Apelit të Gostivarit, u konstatua se nuk janë ndërmarrë aktivitete për të kryer regjistrimin dhe harmonizimin e kontabilitetit me gjendjen faktike të mjeteve monetare dhe detyrimeve bazuar në depozitat gjyqësore.

Në Gjykatën Themelore Civile të Shkupit, Gjykatën Themelore të Gostivarit dhe Gjykatën Themelore të Prilepit, depozitat kanë strukturë të përcaktuar të moshës nga vitet e kaluara, por nuk është konstatuar statusi i lëndëve të depozitave gjyqësore - të përfunduara/të papërfunduara, gjë që ndikon në marrjen e masave për kthimin eventual të depozitës gjyqësore ose pagesën e mjeteve në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në pjesën e sekuestrimit të mjeteve monetare dhe sendeve me vlerë dhe sekuestrimit të sendeve të tjera, konstatuam evidencë të pavendosur për sekuestrimin e mjeteve monetare dhe nuk është zbatuar regjistrimi i tyre.

Komisioni për Kontrollin e Punës së Përgjithshme nuk ka kryer kontroll të plotë të mjeteve të depozitave për vitin 2023, dhe nuk është zbatuar mbikëqyrja e punës së përgjithshme financiare dhe materiale.

Në pjesën Theksimi i Çështjeve të Pasigurisë dhe Vazhdimësisë, theksohen gjendjet që lidhen me procedurat gjyqësore në të cilat Gjykatat paraqiten si të paditura nga punonjësit, përkatësisht: në bazë të stazhit të llogaritur gabimisht dhe bazës së rrogës, shtesave të rrogës dhe kërkesës për rrogën shtesë.

Lidhur me lëvizjen e lëndëve në gjykatat, duke pasur parasysh numrin e lëndëve të pazgjidhura

nga perioda e mëparshme, lëndëve të pranuar, totalin e lëndëve në punë, lëndëve të zgjidhura, lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës dhe dallimin e lëndëve të pazgjidhura në fillim dhe në fund të vitit 2023, konstatuam se gjykatat në vitin 2023 nuk arritën të përballojnë fluksin e lëndëve dhe e rritën pjesën e mbetur të lëndëve të pazgjidhura.

Ministria e Drejtësisë në nëntor 2020 miratoi formularët për vlerësimin e nëpunësve gjyqësorë, por ato nuk vlejné edhe për policinë gjyqësore. Gjithashtu, për shkak të mospërputhjes së akteve me Ligjin për shërbimin gjyqësor, vlerësimi i administratorit gjyqësor nga Kryetari i Gjykatës nuk zbatohet.

Gjykata Themelore Penale e Shkupit, Gjykata Themelore e Gostivarit dhe Gjykata Themelore e Prilepit kanë zbuluar gjendjen se Gjykatat Themelore në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Sekuestruar duhet të zbatojnë aktivitete konkrete për të marrë përsipër sendet e sekuestruara me vendim të formës së prerë në procedurën e kundërvajtjes dhe penale.

Raportet e nxjerrin në pah gjendjen me mjetet e ndara nga Buxheti për vitin 2023 për financimin e Pushtetit Gjyqësor, të cilat nuk e arrijnë përqindjen e përcaktuar me ligj prej 0.8% të bruto prodhimit vendor të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht mjetet e miratuara në shumën prej 2.690.800 mijë denarë paraqesin 0,3% të BPV-së.



¹⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 42/2020

5.2.3.

TRAFIKU, TRANSPORTI DHE KOMUNIKIMET


5.2.3.1

SHA POSTA E MAQEDONISË SË VERIUT



Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Shoqërisë Aksionare për Komunikacionin Postar "Posta e Maqedonisë së Veriut" - Shkup, për vitin 2023.

Revizioni konstatoi se shoqëria ndodhet në pozicion të pafavorshëm financiar duke filluar që nga viti 2017, duke pësuar vazhdimisht humbje nga puna, ndërsa humbja më e madhe në shumën prej 229.883 mijë denarë ose 3.726.000 euro është paraqitur në vitin 2022.



REZULTATET E REALIZUARA FINANCIARE NGA PUNA NË PERIUdhËN 2013-2023


Shoqëria po përballet me borxhe të larta bazuar në hua, kredi dhe kamata të llogaritura, të cilat nuk servisohe në kohë, gjë që përkeqëson më tej gjendjen financiare dhe prish likuiditetin. Detyrimet totale për kreditë dhe huat afatshkurtra në **fund të vitit 2023 janë 219.650 mijë denarë**, dhe kanë të bëjnë me huan afatshkurtër të marrë nga MEPSO - SHA për transmetimin e energjisë elektrike në shumën prej 100.000 mijë denarë dhe dy kredi afatshkurtra nga bankat afariste

në shumën totale prej 119.650 mijë denarë. **Për kreditë e maturuara, por të papaguara në vitin 2024, është llogaritur kamatë ndëshkuese kontraktuese prej 24,45% ose 6.670 mijë denarë.**

Në bazë të analizës së kryer të cilësisë së shërbimeve të mbuluara nga shërbimi universal dhe periudhës së dorëzimit të dërgesave, ndër të tjera, u konstatua dorëzimi jo në kohë i dërgesave. Në vitin 2023, 59,7% e dërgesave ishin dorëzuar ditën e parë, ndërsa 30,5% ishin dorëzuar në

periudhë më të gjatë se tri ditë. Këto rezultate tregojnë devijim nga qëllimet e vendosura nga Unioni Postar Botëror, i cili përcakton standardin minimal prej 75% dhe standardin maksimal prej 88% për dërgesat e dorëzuara me sukses dhe në kohë.

Në vitin 2023, Agjencia e Postave zbatoi kërkimin mbi kënaqësinë e shfrytëzuesve të shërbimeve postare, me qëllim të vlerësimit të shpejtësisë dhe cilësisë së dorëzimit, ndërsa rezultatet paraqiten në fotografiminë e mëposhtme:




Me Planin Vjetor të Prokurimeve Publike për vitin 2023, shoqëria planifikoi të blinte makinë për klasifikimin e dërgesave postare me vlerë të parashikuar prej 30.000 mijë denarë, e cila do të mundësonte klasifikim më të shpejtë dhe më fleksibil të postës, duke e përmirësuar procesin e përgjithshëm të shërbimit nga fillimi deri në fund, por kjo nuk është zbatuar.

Gjithashtu, revizioni i kryer konstatoi se mungojnë evidenca të sakta dhe të harmonizuara për tokën dhe objektet ndërtimore të SHA Posta e Maqedonisë së Veriut, gjë që ndikon në cilësinë e të dhënave të paraqitura në librat tregtarë. Një pjesë e objekteve, si dhe dy pushimore në Ohër

me vlerë totale të blerjes prej 6.375 mijë denarë (vlera aktuale 2.782 mijë denarë), janë në gjendje të keqe dhe kanë nevojë për rinovim, ndërsa për një rëndësi pushimore është konstatuar shfrytëzimi jologjor.

Procesi për ndarjen e pronës midis SHA Postës së Maqedonisë së Veriut dhe Telekomit të Maqedonisë, që filloi në vitin 1996, ende nuk ka përfunduar, ndërsa që nga viti 2017 është ndërprerë, dhe deri në ditën e revizionit nuk janë dhënë udhëzime për veprimin e mëtejshëm të pronës së përbashkët të të dy shoqërive.



Ligji për shërbimet postare përcakton që ofruesit e shërbimeve postare duhet të paguajnë kompensim vjetor për Agjencinë e Postave. Për shkak të vështirësive financiare, shoqëria e pagoi me kohë kompensimin për vitin 2023 në shumën prej 23.461 mijë denarë, për të cilin pagoi kamatë në shumën prej 1.990 mijë denarë. Të gjitha detyrimet ndaj Agjencisë së Postave u paguan në prill 2024. Ofruesit e shërbimeve postare e paguajnë kompensimin në llogari të veçantë - Fondin e Kompensimit për Financimin e Shërbimit Universal, i cili menaxhohet nga Agjencia e Postave. Në rast se shpenzimet janë më të larta se të ardhurat e realizuara nga ofrimi i shërbimit universal në vitin paraprak, SHA Posta e Maqedonisë së Veriut ka të drejtë të kompensimit nga Fondi i Kompensimit, por për të ushtruar këtë të drejtë, ajo duhet të mbajë kontabilitet të veçantë për shërbimin universal, shërbimet e rezervuara, si dhe për shërbimet e tjera postare që i ofron. Është konstatuar se nuk është vendosur kontabilitet i veçantë, prandaj deri më tani nuk është parashtruar kërkesë në Agjenci për të ushtruar të drejtën e kompensimit për shpenzimet neto.

Në pjesën e prokurimeve publike, është konstatuar se SHA Posta e Maqedonisë së Veriut, pa zbatimin e procedurës së prokurimit publik, ka ndërmarrë detyrime për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve, në shumën totale prej 3.702 mijë denarë ose afërsisht 60.000 euro, që është tejkalim prej 36.000 euro mbi pragun e vlefshëm të lejuar me ligj prej 24.000 mijë euro në kundërvlerë me denarë.

Në procedurat për ndarjen e kontratës kornizë me një operator ekonomik për prokurimin e shërbimeve të sigurimit të pronës me procedurë të hapur në vitet 2022 dhe 2023, u lidhën dy kontrata kornizë, me realizim total në shumën prej 28.169 mijë denarë (nga të cilat 16.207 mijë denarë në vitin 2023). Nga inspektimi i kryer i mënyrës së zbatimit të procedurave është konstatuar se nuk është shfrytëzuar mundësia e dhënë me Ligjin për prokurime publike për të formuar prokurimin publik në pjesë, gjë që ndikon në konkurrencën dhe shfrytëzimin racional të mjeteve publike. Përveç kësaj, është konstatuar pagesa jo në kohë e premive (një muaj para skadimit të vlefshmërisë së polisës, premia nuk është paguar), gjë që e rrezikon sigurinë e mjeteve materiale dhe monetare, ndërsa në mënyrë plotësuese mund të çojë në rritjen e premive në të ardhmen për shkak të rejtungut të përkeqësuar të shoqërisë.

Revizioni konstatoi ndryshime të shpeshta në aktin e sistematizimit, veçanërisht në lidhje me numrin e realizuesve, përvojën e punës, shkallën e arsimit dhe llojin e përgatitjes profesionale. Ka parregullsi në plotësimin e vendeve të punës dhe evidentimin e orarit të punës, si dhe në llogaritjen e shtesave, kompensimeve dhe shpërblimeve për një pjesë të punonjësve. Shoqëria ka lidhur kontrata edhe me 276 postierë, por një pjesë prej tyre, në vend që të ofrojnë shërbimet e kontraktuara, janë angazhuar për të kryer detyra të tjera administrative.

Në shtator 2023, pavarësisht rezultatit të vazhdueshëm financiar negativ, shoqëria rriti rrogën mujore neto të drejtorëve të sektorëve, zëvendës drejtorit të përgjithshëm dhe drejtorit të përgjithshëm me përkatësisht 42% deri në 58%, gjë që nuk është në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare. Sipas ligjit, "në rast të uljes së fitimit ose përkeqësimit të ndjeshëm të gjendjes financiare të shoqërisë, kompensimi i rrogës dhe beneficijet e tjera të parashikuara në kontratën e menaxhimit mund të ulen".

Revizorët theksojnë nevojën për bashkëpunim më të madh ndërinstitucional për të rindërtuar pjesët e rrënuara të ndërtesës ku ndodhet Drejtoria e SHA Postës së Maqedonisë së Veriut. Në vitin 2013, ndërtesa ishte djegur, duke dëmtuar rëndë "Sallën e Sporteve" dhe pjesë të tjera. Një pjesë e ambienteve janë rinovuar dhe përshtatur për punë, por rreth 40% e ndërtesës nuk është restauruar ende dhe mbetet me shkallë të ndryshme të dëmtimit. "Salla e Sporteve" dhe një pjesë e ndërtesës, e cila ka rëndësi të madhe kulturore dhe nacionale, janë të braktisura dhe të papërdorshme. Në vitin 2021, ndërtesa u vendos në listën e shtatë monumenteve më të rrezikuara në Evropë. Edhe pse pati disa iniciativa të restaurimit, ato nuk u realizuan.



Objekti në periudhën kur ka ndodhur zjarri nuk ka qenë i siguruar. Shkatërrimi i kupolës mbi sallën e sporteve ka mundësuar që pjesa qendrore e ndërtesës, gjatë 10 viteve të fundit, të jetë vazhdimisht e ekspozuar ndaj kushteve të pafavorshme të motit të jashtëm, me çka që gjendja në këtë pjesë të ndërtesës është vazhdimisht duke u përkeqësuar.

Me zjarrin është shkaktuar dëmtimi i madh i objektit dhe pajisjeve më së shumti u shkatërruan çatia e objektit dhe afresket/muralet murale.



Ministria e Transportit nuk ka përgatitur Strategji për Zhvillimin e Shërbimeve Postare, e cila duhet të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, prandaj nuk është e mundur të përcaktohen prioritetet, qëllimet dhe politikat për zhvillimin e shërbimeve postare dhe të drejtohen në mënyrë përkatëse aktivitetet në nivel vjetor dhe shumëvjeçar.

Në vitin 2021, Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ka lidhur kontratë për të zbatuar incizimin e thelluar të punës së SHA Postës së Maqedonisë së Veriut dhe për të përgatitur studim fizibiliteti, për të cilin u paguan 795.000 euro në kundërvlerë me denarë. Qëllimi i studimit ishte të përcaktoheshin mundësitë për ristrukturimin dhe rehabilitimin e shoqërisë. Edhe pse SHA Posta e Maqedonisë së Veriut e ka përgatitur studimin, ai nuk po zbatohet. Me revizionin e kryer të raporteve financiare për vitin

5.2.3.2.

NDËRMARRJA PUBLIKE E KOMUNIKACIONIT SHKUP

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2023 në Ndërmarrjen Publik të Komunikacionit Shkup, gjatë të cilit konstatuam më shumë gjendje, si në vijim:

NPK "SHKUP", duke e respektuar detyrimin ligjor për transportin publik urban falas për studentët e rregullt në universitetet shtetërore, dhe pavarësisht faktit se Qeveria nuk ka miratuar vendime për lejimin e mjeteve nga buxheti i MASH-it, të dedikuara për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve për transportin urban falas për studentët e rregullt në universitetet shtetërore, për vitet akademike 2022/2023 dhe 2023/2024, dhe në buxhetin e MASH-it për vitet 2022 dhe 2023, ajo e kryen shërbimin pa kompensim. Mbi këtë bazë, u evidentuan të ardhurat të cilat, për shkak të pasigurisë së arkëtimit të tyre, krijojnë rezultat / fitim financiar joreal në shumën prej 31.805 mijë denarë, i cili është lëndë e tatimit.

NPK "SHKUP" nuk kryen pagesa me kohë të kompensimit për transportin e kryer ndaj transportuesve të linjës dhe më 31.12.2023 ka detyrime të papaguara në shumën totale prej 93.254 mijë denarë, për shkak të të cilave subjektet private (transportuesit) punojnë me vëllim të reduktuar, përkatësisht nuk ofrojnë

2021, së bashku me revizionin e përputhshmërisë me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, revizori i autorizuar shtetëror zbuloi se kontrata e lartpërmendur ishte lidhur pa procedurë të zbatuar të prokurimit në përputhje me Ligjin për prokurime publike. Për kontratën e lartpërmendur gjatë vitit 2022 u iniciua procedurë hetimore para Prokurorisë Themelore Publike për ndjekjen e krimit dhe korrupsionit të organizuar.

Revizioni i kryer konstatoi edhe gjendje, parregullsi dhe mospërputhje të tjera të natyrave të ndryshme, të cilat ndikojnë në punën e shoqërisë.



transport të linjës në vëllimin e rënë dakord dhe nuk e plotësojnë kapacitetin e linjës së besuar me të paktën 80% gjatë muajit kalendarik.

Për shkak të pagesës jo në kohë të faturave pas çdo dërgese suksese të derivateve të naftës / karburantit, është lidhur kontratë për pagesën e borxhit në këste, gjë që është e dëmshme, për shkak të llogaritjes së planifikuar të kamatës ndëshkuese të dakorduar prej 50% më të lartë se shkalla e kamatës ndëshkuese ligjore, pa qenë e parashikuar dispozitë e tillë në kontratën e prokurimit publik. Gjatë revizionit, me kërkesë të NPK "SHKUP", kreditori dorëzoi miratim për uljen e kamatës së llogaritur në shumën prej 50% ose 12.583 mijë denarë.

Edhe pse operatori ekonomik sipas kontratës me vlerë prej 142.466 mijë denarë, përkatësisht 2.3 milion euro, e cila është zbatuar plotësisht që nga 31.01.2024, dhe ka të bëjë me sigurimin e infrastrukturës së komunikacionit dhe platformës E-Cloud për sistemin e kontrollit dhe menaxhimit të transportit urban publik, nuk i ka përmbushur plotësisht detyrimet e tij në lidhje me ndjekjen e vazhdueshme 24/7 të vendndodhjes automatike të mjeteve dhe funksionimin e pandërprerë të aplikacionit për telefonat e mençur të pajtueshëm me Apple iOS, NPK "SHKUP", nuk ka ndërmarrë


aktivitete për llogaritjen e dëmeve dhe arkëtimin e dënimit të rënë dakord.

Për shkak të dobësive të konstatuara në ndërtimin e objektit "Kryqi i Mijëvjeçarit" në Vodno, edhe pas dhjetë vitesh, nuk janë ndërmarrë aktivitete për pranimin teknik dhe vënien e tij në funksion, megjithëse ai ka qenë në përdorim për një kohë të gjatë.

Gjithashtu, është evidentuar vlera e tokës (165.767 mijë denarë), e cila është më e ulët se vlera e tregut e parashikuar nga vlerësuesi i autorizuar (773.800 mijë denarë) për 608.033 mijë denarë, si dhe janë evidentuar objekte ndërtimore për të cilat nuk është siguruar e drejta e pronësisë. Regjistrimi i mjeteve dhe detyrimeve nuk është zbatuar plotësisht dhe është kryer shlyerja e detyrimeve prej 2.788 mijë denarë pa vendim të BD-së.

Mënyra e llogaritjes dhe pagesës së rrogave nuk është në përputhje me rregullat ligjore në fuqi, në lidhje me: punonjësit që kanë statusin e nëpunësve administrativë dhe ushtruesit të detyrës drejtor dhe shtesën e rrogës për stazhin e punës, ndërsa një pjesë e punonjësve nuk i plotësojnë kërkesat për llojin e arsimit për vendin e punës në të cilin janë sistemuar.


Për shkak të pëlqimit të pasiguarur të Planeve Vjetore të Punësimit nga Këshilli i Qytetit të Shkupit, ndërmarrja publike në vitin 2023 angazhoi 221 persona, ofrues të shërbimeve / shoferë dhe evidentoi shpenzime në shumën prej 81.805 mijë denarë, gjë që tregon paqëndrueshmërinë e burimeve njerëzore që duhet t'i kryejnë detyrat e rregullta të punës në ndërmarrje.



Revizioni konstatoi mungesë transparence në procedurat për dhënien me qira të sendeve të patundshme, përkatësisht kontratat e qirasë u lidhën pa: marrë pëlqimin nga Këshilli i Qytetit të Shkupit, zbatimin e procedurës për ankandin publik elektronik, publikimin e thirrjes publike, formimin e komisionit dhe kryerjen e vlerësimit për të përcaktuar çmimin fillestar për ankandin publik.

Edhe pse treguesit financiarë të NPK Turs "SHKUP" tregojnë për ekzistencën e pasigurisë materiale në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vazhduar punën fitimprurëse, NPK "SHKUP" si themelues i saj, vazhdimisht mbulon shpenzimet e rregullta të punës së saj përmes huave, por ato nuk janë shlyer, dhe në fund të vitit 2023, NPK "SHKUP" mbi këtë bazë ka paraqitur kërkesa prej 21.731 mijë denarë.

SHPENZIMET PËR KM në raport me TË ARD-



Edhe pse mosha mesatare e mjeteve të lëvizjes më 31.12.2023 është 12,05 vjet, në vitet 2022 dhe 2023 nuk është bërë asnjë investim në përmirësimin e mjeteve të lëvizjes, të cilat janë bazë për veprimtarinë e ndërmarrjes dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët.

Subvencionimi nga themeluesi - Qyteti i Shkupit në shumën totale prej 673.870 mijë denarë, ose 11 milion euro, nuk është i mjaftueshëm që NPK "SHKUP" t'i arrijë qëllimet strategjike për sistemin e qëndrueshëm të transportit urban dhe zhvillimin e transportit urban publik në Shkup.

Revizioni thekson se nevojiten aktivitete që synojnë eliminimin e vështirësive dhe problemeve që kanë qenë të pranishme në punën e ndërmarrjes për një kohë të gjatë, sigurimin e vazhdimësisë në funksionimin e veprimtarisë, përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit në kryerjen e transportit publik, rritjen e standardeve ekologjike, përkatësisht arritjen e misionit të ndërmarrjes, ofrimin e shërbimeve cilësore, në kohë, të sigurta dhe të vazhdueshme për qytetarët.

5.2.4

CILËSIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE GRUMBULLIMI, SHPENZIMI DHE SHFRYTËZIMI I MJETEVE DHE BURIMEVE PUBLIKE

5.2.4.1.

REGJISTRI QENDROR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



ЦЕНТРАЛЕН РЕГИСТАР
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Në përputhje me Programin Vjetor të Punës për vitin 2024, Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023.

Revizioni i kryer konstatoi se evidenca e kontabilitetit është vendosur në mënyrë joadekuate për një pjesë të objekteve ndërtimore me vlerë të prokurimit prej 186.635 mijë denarë, të cilat iu caktuan Regjistrit Qendror me transformimin e kryer të ish-Entit të Qarkullimit Pagesor. Arsyeja për këtë gjendje është trajtimi joadekuat i objekteve ndërtimore si mbështetje shtetërore, gjë që ndikon në të dhënat e paraqitura në raportet financiare.

Evidentimi joadekuat është përcaktuar edhe për investimet e përfunduara në ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve ndërtimore në shumën prej 15.185 mijë denarë, për të cilat nuk janë ndërmarrë aktivitete për vënien e tyre në përdorim, megjithëse Regjistri Qendror i ka objektet në posedim dhe ka listë pronësie.



Mobilje që nuk janë vënë në përdorim

Edhe pse kanë kaluar pesë vjet që kur është blerë mobilja me vlerë prej 1.360 mijë denarë, ajo nuk është vënë në përdorim, prandaj ekziston rreziku që të dëmtohet dhe të humbasë cilësinë e saj.

Në vitin 2023, në librat afaristë të Regjistrit Qendror nuk është evidentuar toka në të cilën u ndërtua objekti administrativ Pallati "Lazar Pop Trajkov" dhe e cila, me Vendim të Qeverisë në vitin 2013, u ishte ndarë për përdorim të përhershëm gjashtë institucioneve shtetërore. Për këtë tokë, pas përfundimit të revizionit, përfaqësuesi ligjor ndërmori aktivitete për ta futur atë në evidencën e Regjistrit Qendror.

Është kryer shitja e automjeteve të pasagjerëve pa u siguruar pëlqimi nga Qeveria, duke zbatuar Rregulloren e brendshme që nuk është harmonizuar me procedurën e tjetërsimit të parashikuar në Ligjin për shfrytëzim dhe disponim me sende në pronësi shtetërore dhe me sende në pronësi komunale.

Në vitin 2023, Regjistri Qendror ka realizuar të ardhura në total prej 367.738 mijë denarë bazuar në shërbimet e ofruara për regjistrim, shënim, përpunim, ruajtje, mbajtje, përdorim dhe shpërndarje të të dhënave. Për shërbimet e ofruara brenda fushëveprimit të punës së tij, Regjistri Qendror arkëton kompensim përkatës që përcaktohet me Listën Tarifore të miratuar nga Bordi Drejtues, pas pëlqimit të marrë nga Qeveria. Revizioni i kryer konstatoi se të dhënat mbi numrin dhe llojin e shërbimeve të ofruara të marra nga sektori kompetent në Regjistrin Qendror nuk korrespondojnë me të ardhurat e deklaruara në evidencën e kontabilitetit, prandaj nuk është e mundur të konfirmohet besueshmëria, saktësia dhe plotësia e të ardhurave të deklaruara. Për gjendjen e theksuar, janë konstatuar më shumë arsye, përkatësisht: mungesa e zgjidhjes softuerike që lidh shërbimet e kryera me lartësinë e kompensimit të arkëtuar, mungesa e kontrolleve në realizimin

dhe evidentimin e në përdorim ardhurave, si dhe mënyra e vendosur e ofrimit të shërbimit duke aplikuar zbritje dhe duke ofruar shërbime falas në rastet e caktuara.

Revizioni i kryer konstatoi se ekziston detyrimi i pashërbyer për kredinë afatgjatë të mallrave në shumën prej 86.093 mijë denarë, i cili rrjedh nga kontrata e lidhur me Ministrinë e Ekonomisë në vitin 2007, dhe ka të bëjë me shfrytëzimin e një pjese të mjeteve të miratuara nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, në kuadër të Projektit për Reformën e Mjedisit Afarist dhe Forcimin Institucional. Kjo kredi duhej të shlyhej deri në tetor 2021. Pas udhëzimeve nga Qeveria, në vitin 2020 u formua grupi i punës për të përcaktuar statusin dhe trajtimin e detyrimit, por ende nuk është miratuar konkluzioni konkret për të vepruar.

Janë konstatuar mosharmonizime të dispozitave të Ligjit për Regjistrin Qendror dhe Ligjit për nëpunësit administrativë në pjesën e llogaritjes së rrogave të nëpunësve administrativë të punësuar, si dhe parregullsi në zbatimin e procedurave të punësimit të nëpunësve administrativë. Edhe pse u arrit rezultati financiar negativ nga puna, gjatë

vitit 2023, rrogat e punonjësve u rritën dy herë për totalin prej 22%.

Ekzistojnë paqartësi ligjore në lidhje me përkufizimin e statusit të Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përcaktimin e vlerës së kryegjësë themelore, emërimin e saktë të mbajtësit të së drejtës së pronësisë (themeluesit) dhe mënyrën e njoftimit financiar, të cilat ndikojnë në mënyrën e kryerjes së veprimtarisë.

Raporti thekson se tre nga regjistrat e vendosur, përkatësisht: regjistri i vlerënotë premtimit, regjistri fiduciar dhe regjistri për shitjen e sendeve të tundshme me mbajtjen e së drejtës së pronësisë nuk funksionojnë në praktikë dhe nuk realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht faktit se janë krijuar mundësitë dhe kushtet teknike për shfrytëzimin e tyre.




Arsyeja e mosfunksionimit të këtyre regjistrave është moszbatimi në praktikë i vlerënotë premtimit / kontratave për sigurimin e kërkesave në marrëdhëniet debitor - kreditor.

Revizioni i kryer konstatoi edhe një sërë gjendjesh, parregullsish dhe mosharmonizimesh të tjera me natyrë të ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me: regjistrimin e kryer jo të plotë të mjeteve dhe

detyrimeve, llogaritjen joadekuate të amortizimit të mjeteve, mosndërmarrjen e aktiviteteve për tjetërsimin ligjor të mjeteve të shpenzuara, megjithëse ato janë hequr nga evidenca e kontabilitetit, nuk është vendosur ndjekja e zbatimit të projekteve në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit 2023 - 2027 të miratuar.

5.2.4.2.

BYROJA E PROKURIMEVE PUBLIKE



E realizuam revizionin e raporteve financiare të Ministrisë së Financave - Byrosë së Prokurimeve Publike për llogaritë e buxhetit themelor 603 dhe 631 për vitin 2023, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë.

Me revizionin e kryer, i konstatuam gjendjet e mëposhtme:

- /// mjetet jomateriale dhe materiale në raportin financiar të Bilancit të gjendjes më 31.12.2023 nuk paraqiten në mënyrë reale dhe objektive;
- /// regjistrimi i mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve nuk është zbatuar brenda afateve të përcaktuara me ligj, nuk ka qenë i plotë dhe nuk është hartuar raport, prandaj nuk është bërë harmonizimi i vlerës së kontabilitetit me gjendjen faktike të përcaktuar me regjistrimin;
- /// kërkesat dhe detyrimet afatshkurtra ndaj furnitorëve nuk janë paraqitur plotësisht në raportet financiare;
- /// nuk janë ndërmarrë masa dhe aktivitete për

t'i arkëtuar kërkesat të cilat, sipas strukturës së moshës, burojnë nga vitet e kaluara;

- /// sistemi i dizajnuar i kontrollit të brendshëm nuk mund t'i parandalojë rreziqet e evidentimit të transaksioneve të pasakta dhe të paplota.

Në pjesën Theksimi i çështjeve njoftojmë mbi prokurimet publike të zbatuara për mirëmbajtjen parandaluese dhe mirëmbajtjen/përmirësimin adaptiv të sistemeve të zbatuara si prokurime të pandashme.

Kemi konstatuar parregullsi në Ligjin për prokurime publike dhe ato i kemi theksuar në pjesën Çështje të tjera. Me ndryshimet në Ligjin për prokurime publike nga janari 2025, katër nga dobësitë e konstatuara janë tejkaluar, ndërsa dy mbeten për t'u tejkaluar në periudhën e ardhshme.



5.2.5.

ARSIMI

5.2.5.1.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS



Realizuar revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e përputhshmërisë së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të llogarisë së buxhetit themelor, të llogarive për mjetet e buxhetit të huave të Bankës Botërore dhe Bankës ¹⁹ и të Këshillit të Evropës, për Zhvillim të Këshillit të Evropës ²⁰, si dhe të llogarisë së buxhetit të donacioneve ²¹, për vitin 2023.

Janë konstatuar gjendje, parregullsi dhe mosharmonizime që ndikojnë në opinionin e lëshuar nga revizori i autorizuar shtetëror mbi realitetin dhe objektivitetin e raporteve financiare në llogarinë e buxhetit themelor, si dhe harmonizimi me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e përcaktuara, përkatësisht:

- /// mbi bazën e kredive studentore të dhëna studentëve të regjistruar në studimet deridiplomike në universitetet publike dhe private dhe institucionet e arsimit të lartë në periudhën 1998 - 2010 të evidentuar si kredi dhe huamarrje afatgjata të dhëna në vend, në shumën prej 1.106.023 mijë denarë, nuk janë ndërmarrë masa për arkëtimin e tyre, si dhe për shlyerjen në bazë të parashkrimit të tyre;
- /// gjendjet fillestare të pozicioneve të Bilancit të gjendjes nuk janë harmonizuar me gjendjet përfundimtare në fund të vitit fiskal paraprak;
- /// detyrimet ndaj furnitorëve nuk paraqiten kronologjikisht, përkatësisht nuk e pasqyrojnë me saktësi afatin kohor të ndodhjes së tyre;

- /// regjistrimi i mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve është zbatuar në mënyrë të paplotë dhe nuk është kryer harmonizimi i gjendjes së kontabilitetit me gjendjen faktike.

Programet për ndërtimin dhe rikonstruksionin e shkollave fillore dhe të mesme për vitin 2023 realizohen pa qëllime, prioritete dhe tregues të suksesit të përcaktuar, si dhe pa rregulluar mënyrën dhe procedurën për ndarjen e mjeteve dhe kriteret për përzgjedhjen e projekteve për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve shkollore. Mjetet e siguruara buxhetore për financimin e aktiviteteve ndërtimore për ndërtimin dhe rikonstruksionin e shkollave fillore dhe të mesme dhe realizimin e tyre u prezantuan si më poshtë:



¹⁹ Projekti për avancimin e arsimit fillor.

²⁰ Projekti për ndërtimin dhe pajisjen e 145 sallave shkollore dhe rehabilitimin e shkollave fillore dhe të mesme.

²¹ Mjetet nga Komisioni Evropian - Programi i Bashkimit Evropian Horizont Evropa.

BUXHETI I MIRATUAR DHE REALIZIMI I MJETEVE BUXHETORE PËR INVESTIMET KAPITALE NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME NË VITIN 2023

në 000 denarë

Emri i nënprogramit	Buxheti i miratuar	Buxheti me ribalans / ridedikimet	Realizimi i buxhetit	% e realizimit
Ndërtimi i shkollave fillore	91.675	475.675	466.859	98%
Rikonstruksioni i shkollave fillore	241.920	142.482	110.060	77%
Ndërtimi i shkollave të mesme	432	432	0	0%
Rikonstruksioni i shkollave të mesme	74.742	60.098	40.643	68%
Gjithsej	408.769	678.687	617.562	

Konvikti Shtetëror i Studentëve "Tetova" në Tetovë është ndërtuar me mjetet buxhetore në shumën totale prej 212.407 mijë denarë dhe ai është vënë në përdorim pa inspektim të kryer teknik të ndërtimit dhe pa leje për përdorimin e objektit, ndërsa pajisjet e prokuruar për kuzhinën në konvikt nuk janë vënë në përdorim për shkak të mosrealizimit të ventilimit.



Konvikti Studentor "Tetova", Tetovë

Në bazë të bursave për studentët që studiojnë në një nga 100 universitetet e para jashtë vendit, për të cilat në vitin 2023 u paguan mjete në shumën prej 179.852 mijë denarë. Konstatuam se nuk është vendosur sistemi për angazhimin e këtyre personave në vend pas përfundimit të studimeve, gjë që nuk siguron shfrytëzim efikas të mjeteve të paguara për këtë dedikim. Si rezultat i dallimeve në kursin në vitin 2023, është paguar shumë më e madhe në emër të taksës së regjistrimit sesa shumës së kontraktuar prej 3.801 mijë denarë për 66 studentët që paraqiten për arsye se llogaritja dhe pagesa e taksës së regjistrimit nuk është kryer në përputhje me dispozitat e kontratave të lidhura midis MASH-it dhe studentëve - me kursin e mesëm në ditën e shpalljes së konkursit, por me kursin në ditën e pagesës. Në vitin 2025, u iniciuan aktivitetet për t'i tejkaluar gjendjet e konstatuara.

Konstatuam dobësi në zbatimin e procedurave dhe realizimin e kontratave të prokurimeve publike për investimet kapitale në konviktet studentore, shkollat e mesme dhe fillore, të cilat u realizuan përmes llogarisë së buxhetit themelor dhe llogarisë për mjetet nga buxheti i huave - Projekti për ndërtimin dhe pajisjen e 145 sallave shkollorë dhe rehabilitimin e shkollave fillore dhe të mesme.

Në prokurimin e përkthimit, redaktimit profesional, redaktimit grafik dhe teknik të librave shkollorë për arsimin fillor dhe të mesëm për vitet shkollorë 2022/2023, 2023/2024 dhe 2024/2025, është konstatuar që librat shkollorë në gjuhën maqedonase, pasi të jenë redaktuar grafikisht dhe teknikisht, redaktohen përsëri pas përkthimit në të katër gjuhët, me çmimin për faqe për këtë shërbim që është më i lartë se ai për përkthim, lekturë dhe redaktim. Edhe pse dorëshkrimet / librat shkollorë që MASH-i i dorëzon operatorit ekonomik për redaktim profesional, redaktim grafik dhe teknik ishin redaktuar tashmë nga autorët (veçanërisht për librat shkollorë të arsimit fillor), operatori arkëton për numër faqesh sipas çmimit të kontraktuar nga prokurimi publik, në vend vetëm për faqet e redaktuara në të vërtetë, gjë që çon në shfrytëzimin joadekuat të mjeteve buxhetore. Kjo praktikë është aplikuar prej vitesh, pasi MASH-i vepron si botuese edhe pse nuk ka veprimtari të regjistruar botuese. Me Ligjin e ri për librat shkollorë në arsimin fillor dhe të mesëm, të miratuar në janar 2025, janë ndërmarrë masat për t'i tejkaluar këto gjendje.

Për prokurimin në pjesën e shërbimeve të konsultantëve brenda llogarisë së mjeteve të buxhetit të huave - Projekti i avancimit të arsimit fillor, të cilat zbatohen sipas rregullave të Bankës Botërore, në kushtet e mungesës së kriterëve dhe ofertave financiare konkurruese, revizioni nuk ishte në gjendje të bindet në lartësinë e kompensimeve të konsultantëve dhe nëse shërbimet e kryera ofrojnë vlerë të plotë për paratë.

Në pjesën Theksimi i Çështjeve i zbuluam gjendjet e mëposhtme:

- /// shpërndarja e bllok-dotacioneve për arsimin fillor dhe të mesëm kryhet në kushtet e mungesës së kriterëve reale, gjë që vë në pikëpyetje sigurimin e mjeteve për realizimin efikas dhe të papenguar të kompetencave të transferuara dhe servisimin e rregullt të detyrimeve të shkollave;
- /// aktivitetet e filluara ndërtimore për ndërtimin e objekteve për Fakultetin e Arsimit Fizik, Sportit dhe Shëndetit dhe Fakultetin e Shkencave Informatike dhe Inxhinierisë Kompjuterike në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi" Shkup, për të cilat janë paguar mjete në shumën totale prej 179.320 mijë denarë në periudhën 2016-2019 dhe pasiguria e përfundimit të tyre. Theksojmë se, bazuar në analizën e kryer në përputhje me projektet dhe vlerësimin e kryer për përfundimin e objekteve, do të nevojiteshin mjetet financiare në shumën totale prej 1.349.720 mijë denarë dhe afatin e pritur real prej 3 vite për ekzekutimin e të gjitha pozicioneve ndërtimore për objektet;
- /// procedurat gjyqësore në të cilat MASH-i është i paditur mund të kenë implikime të rëndësishme financiare në periudhën e ardhme;
- /// pagesa për redaktim grafik dhe teknik dhe përkthim të librave shkollorë që më parë, si materiale mësimore (me të njëjtën përmbajtje), tashmë ishin redaktuar dhe përkthyer grafikisht dhe teknikisht përmes projektit për Përmirësimin e shërbimeve në arsimin fillor në kuadër të MASH-it, për të cilat u paguan mjetet në shumën prej 25.395 mijë denarë (fonde në të cilat përfshihet edhe shtypja e materialeve mësimore), përmes projektit në vitin 2021 dhe përmes llogarisë së MASH-it në vitin 2022 në shumën prej 5.535 mijë denarë, megjithëse librat shkollorë nuk dallohen nga materialet mësimore në redaktimin e tyre grafik (përveç kopertinës, e cila u ndryshua nga autori).

Në pjesën mbi çështjet e tjera, njoftuam për:

- /// zgjidhjet ligjore që nuk e rregullojnë mënyrën e përcaktimit të lartësisë së rrogës së këshilltarëve të veçantë në sektorin publik;
- /// librat shkollorë të gjuhëve të huaja për arsimin fillor që nuk janë siguruar prej gjashtë vite.

Në pjesën që ka të bëjë me kontrollet e brendshme, konstatuam dobësi në sistemin e vendosur të kontrolleve të brendshme në procesin e pagesës dhe ekipit të pamjaftueshëm të kuadrit në Departamentin e Revizionit të Brendshëm.



Objekte të nisura por të papërfunduara të Fakultetit të Edukimit Fizik, Sportit dhe Shëndetit dhe Fakultetit të Shkencave Informatike dhe Inxhinierisë Kompjuterike pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup

5.2.5.2.

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Byrosë së Zhvillimit të Arsimit për vitin 2023.

Revizioni i kryer i konstatoi gjendjet e mëposhtme:

/// Drejtori i Byrosë, me propozim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, me shpalljen e konkursit publik emërohet dhe shkarkohet nga Qeveria me mandat katërvjeçar. Gjatë vitit 2023, Byroja menaxhohet nga dy u.d. drejtorë, ku drejtori i mëparshëm e ushtronte funksionin u.d. drejtor, që përfundon më 18.07.2023, në kohëzgjatje prej 5 vjet e 3 muaj, gjë që nuk është në përputhje me mënyrën e përcaktuar me ligj për zgjedhjen e drejtorit.

/// Në bazë të rregullave të brendshme për pagesën e kompensimeve për bashkëpunëtorët e jashtëm profesionalë të angazhuar për hartimin e planeve mësimore, programeve dhe doracakëve mësimorë për të mësuar, Byroja në vitin 2023 ka paguar mjete në shumën prej 13.160 mijë denarë bazuar në rregulloret e miratuara në periudhë të mëparshme nga drejtori i Byrosë, megjithëse kjo ishte kompetencë e ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Për më tepër, konkurset e shpallura për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm përmbajnë kritere që këta persona duhet t'i plotësojnë, të cilat janë të ndryshme nga kriteret e theksuara në aktet e brendshme, ndërsa paraqiten edhe dobësi dhe mangësi që lidhen me llogaritjen e kompensimeve të personave të angazhuar që lidhen me ekzistencën e dy akteve në të cilat kjo problematikë është përcaktuar në mënyrë të ndryshme.

/// - Në përputhje me rregullat ligjore, mësimsdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë obligohen të kushtojnë të paktën 60 orë gjatë tre viteve shkollore, nga të cilat të paktën 40 orë janë nga pjesëmarrja në programet e akredituara të trajnimit. Çdo mësimsdhënës dhe bashkëpunëtor profesional, brenda 3 viteve, duhet të kalojë edhe 20 orë trajnim mbi programet prioritare të përcaktuara nga ministri, për të cilat mjetet sigurohen në buxhetin e Byrosë. Konstatuam se në vitin 2023 është zbatuar një procedurë për akreditimin e trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve dhe ajo është zbatuar për nevojat e trajnimit të mësimsdhënësve në shkollat e mesme, me ç'rast me këtë trajnim ishin përfshirë 2.925 mësimsdhënës nga shkollat e mesme në vend, ky është trajnimi i vetëm i akredituar i zbatuar gjatë vitit 2023. Në këtë mënyrë, u mbuluan vetëm 41,5% ²² % të numrit të përgjithshëm të mësimsdhënësve në shkollat e mesme dhe ai ishte në kohëzgjatje prej 8 orë nga 60 orët e planifikuara gjatë një periudhe trevjeçare. Në pjesën e zbatimit të trajnimeve të akredituara për mësimsdhënësit në shkollat fillore, gjatë vitit 2023 u zbatuan 18 trajnime, me të cilat u përfshinë 13.744 mësimsdhënës, përkatësisht 73% ²³ të numrit të përgjithshëm të mësimsdhënësve në shkollat fillore. Në përputhje me projeksionet e bëra nga shërbimet profesionale, në buxhetin e Byrosë nevojiten të parashihen të paktën 62.000 mijë denarë për trajnim tetorësh për mësimsdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore në vend. Për këtë dedikim, në buxhetin e Byrosë për vitin 2023 është siguruar shuma në lartësinë prej 5.940 mijë denarë, përkatësisht vetëm 9,5% të mjeteve të nevojshme.

Pjesëmarrja më të madhe në realizimin e këtyre aktiviteteve është zbatuar nga njësia e projekteve të Bankës Botërore që funksionon në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, përmes së cilës gjatë vitit 2023 u realizuan mjetet në shumën prej 37.114 mijë denarë.

²² Numri i mësimsdhënësve në arsimin e mesëm 7.051 (Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, makstat.mk)

²³ Numri i mësimsdhënësve në arsimin fillor 18.831 (Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, makstat.mk)

5.2.6.

VEPRIMTARITË KOMUNALE PUBLIKE

5.2.6.1.

VEPRIMTARITË KOMUNALE PUBLIKE NË NIVEL LOKAL

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e përputhshmërisë për vitin 2023 në NPVK "Komunalec" të themeluar nga Komuna e Gjevgjelisë, NPK "Bregallnica" të themeluar nga Komuna e Dellçevës, NPVK "Komunaleci i Ohrit" të themeluar nga Komuna e Ohrit dhe NPK "Isar" të themeluar nga Komuna e Shtipit.

Me revizionin e kryer në ndërmarrjet publike janë konstatuar gjendje të caktuara, më të rëndësishmet prej të cilave janë:

NPK "Bregallnica" Dellçevë dhe NPVK "Komunaleci i Ohrit" Ohër nuk kanë miratuar politika të kontabilitetit që zbatohen në përgatitjen, prezantimin dhe zbulimin e raporteve financiare. Për vitin 2023, NPVK "Komunaleci i Ohrit" Ohër nuk ka hartuar raport gjashtëmujor për punën e saj, ndërsa NPK "Isar" Shtip nuk ka plan të detajuar financiar dhe program të investimeve, gjë që e zvogëlon transparencën në informimin mbi llojin dhe vëllimin e veprimtarisë dhe punës financiare.

Ndërmarrjet e reviduara publike nuk e kanë rregulluar të drejtën e pronësisë së tokës, objekteve ndërtimore dhe infrastrukturore (rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve). Toka në pronësi të NPK "Bregallnica" Dellçevë nuk është e evidentuar në librat e punës, një pjesë e objekteve infrastrukturore të ndërtuara nga komuna nuk i janë dhënë për ekonomizim NPK "Komunalec" Gjevgjeli, ndërsa evidentimi i gabuar i mjeteve materiale, mosharmonizimi i kontabilitetit të tyre me evidencën materiale dhe llogaritja e gabuar e amortizimit janë konstatuar në NPVK "Komunaleci i Ohrit" Ohër.

Për shkak të mospërshtimit të dokumentacionit të plotë (leja e ndërtimit / rikonstruksionit, raporti përfundimtar mbi mbikëqyrjen teknike, cilësore dhe sasiore gjatë ndërtimit të objekteve dhe vënies në përdorim të ndërtesave), ndërtesat e përfunduara në NPK "Isar" Shtip dhe NPK "Bregallnica" Dellçevë, megjithëse janë vënë në përdorim, ende nuk janë evidentuar siç duhet, nuk llogaritet amortizimi dhe kjo ka ndikim në vlerën e tyre objektive, përkatësisht në cilësinë e të dhënave dhe informacioneve të cilat i japin raportet financiare.

Në regjistrin tregtar unik dhe regjistrin e personave të tjerë juridikë në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk është bërë regjistrimi i kryegjësë kryesore të NPVK "Komunalec" Gjevgjeli dhe NPK "Bregallnica" Dellçevë, ndërsa në NPVK "Komunaleci i Ohrit" Ohër ka mosharmonizim midis vlerës së kontabilitetit të kryegjësë themelore me kryegjësë e regjistruar në Regjistrin Qendror.

Ndërmarrjet e reviduara publike nuk ndërmarrin masa në kohë për arkëtimin e kërkesave dhe nuk bëhet vlerësimi i shkalës së arkëtueshmërisë për vlerësimin e duhur të tyre në pozicionet e bilancit në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Vlerësimi joreal i pozicioneve të bilancit në raportet financiare u konstatua te NPVK "Komunaleci i Ohrit" Ohër për shkak të mosharmonizimit të kërkesave të evidentuara me "sistemin e bilingut", detyrimeve të evidentuara sipas vendimeve ekzekutive dhe detyrimeve të pa-evidentuara ndaj komunës në bazë të kompensimit për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në shumën prej 253.776 mijë denarë. Detyrimet e deklaruara në mënyrë joreale ekzistojnë edhe në NPVK "Komunalec" Gjevgjeli

(bazuar në kompensimin për përdorimin dhe shkarkimin e ujërave) dhe NPK "Isar" Shtip bazuar në kreditë.

Në ndërmarrjet e reviduara publike, ka parregullsi në pjesën e regjistrimit të mjeteve dhe detyrimeve, gjë që nuk mundëson harmonizimin midis evidencës së kontabilitetit dhe gjendjes faktike.

Dobësi në menaxhimin e rezervave të materialeve, pjesëve rezervë dhe inventarit të vogël (vjetërimi, sasi të tepërta dhe ruajtja joadekuate) janë të pranishme në NPK "Bregallnica" Dellçevë dhe NPVK "Komunaleci i Ohrit" Ohër.

Mënyra e llogaritjes dhe pagesës së rrogës nuk janë harmonizuar me rregullat ligjore në fuqi, në lidhje me: nëpunësit administrativë dhe vlerën e përcaktuar të pikave (NPVK "Komunalec" Gjevgjeli dhe NPK "Bregallnica" Dellçevë), ndërsa NPK "Isar" Shtip e llogarit rrogën sipas konceptit neto dhe punonjësit i paguhet shtesë e rrogës bazë në lartësinë prej 1%, por jo më shumë se 20% për të gjithë stazhin e punës, në vend të 0,5% për çdo vit të përfunduar të stazhit të punës. Në NPK "Bregallnica" Dellçevë dhe NPVK "Komunaleci i Ohrit" Ohër, për çdo futje të punës jashtë orarit të punës, punës së natës dhe punës të dielave, nuk është njoftuar inspektori shtetëror i punës.

Në NPK "Bregallnica" Dellçevë, nëpërmjet agjencisë private të punësimit, janë angazhuar personat vazhdimisht dhe për periudhë më të gjatë se dy vjet për të kryer detyra të rregullta të punës, për të cilat në vitin 2023 janë bërë shpenzime në shumën prej 3.184 mijë denarë.

Humbja e ujit në sistemin e furnizimit me ujë është gjendja që ka qenë e pranishme prej vitesh në ndërmarrjet publike, e cila për vitin 2023 lëviz nga:

/// **54%** në NPVK "Komunalec" Gjevgjeli;
 /// **61%** në NPK "Bregallnica" Dellçevë dhe
 /// **60%** në NPK "Isar" Shtip, ndërsa është

rezultat i rrjetit të vjetër dhe të rrënuar të ujësjellësit, lidhjeve të paligjshme, matësve të ujit që nuk funksionojnë mirë dhe nuk janë të saktë, konsumit të pafaturuar, ujitjes së sipërfaqeve të gjelbra publike për të cilat nuk ka instaluar matës të rrjedhjes, huamarrjes paushalle të ujit të konsumuar, etj. Gjendja e mësipërme ka ndikim negativ, si në punën aktuale të ndërmarrjeve publike në aspektin e të ardhurave të gjeneruara

në mënyrë të pamjaftueshme, por në të njëjtën kohë, edhe në të ardhurat tatimore të realizuara më pak (TVSH-ja dhe tatimi mbi fitim) dhe kompensimet në Buxhetin e Shtetit.

Te ndërmarrjet publike mungon planifikimi dhe investimi afatgjatë për të minimizuar dhe eliminuar shkaqet e humbjeve të ujit në sistemin e furnizimit me ujë dhe për të ndërmarrë aktivitete kontrolluese përkatëse.

Për shkak të mospagesës në kohë të detyrimeve të kompensimit për shfrytëzimin e ujit dhe për derdhjen në ujë nga NPK "Bregallnica" Dellçevë, janë realizuar më pak të ardhura në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për 3.858 mijë denarë, ndërsa si rezultat i mospagesës në kohë të detyrimeve të kompensimit të paarkëtuar për mirëmbajtjen e pastërtisë publike nga NPK "Bregallnica" Dellçevë, NPVK "Komunaleci i Ohrit" Ohër dhe NPK "Isar" Shtip, janë realizuar më pak të ardhura në buxhetin e Komunës së Dellçevës (11.624 mijë denarë), buxhetin e Komunës së Ohrit (233.162 mijë denarë) dhe Komunën e Shtipit (10.420 mijë denarë).

Shkarkimin e ujërave të zeza, NPK "Bregallnica" Dellçevë e kryen pa marrë të drejtën ujore (leje) për derdhjen e ujërave për sistemet që i ka, ndërsa NPK "Isar" Shtip nuk posedon leje për ushtrimin e veprimtarisë së deponimit dhe trajtimit të mbeturinave. NPVK "Komunalec" Gjevgjeli e ekonomizon objektin e Tregut të Qytetit pa vendim të Këshillit të Komunës së Gjevgjelisë për dhënien në shfrytëzim dhe menaxhim.

Ndërmarrjet e reviduara publike nuk e përcaktojnë në mënyrë reale çmimin e kompensimit për menaxhimin e mbeturinave komunale, ndërsa NPK "Bregallnica" Dellçevë, NPVK "Komunaleci i Ohrit" Ohër dhe NPK "Isar" Shtip nuk kryejnë matjen dhe evidencën për identifikimin, transportin dhe trajtimin e mbeturinave.

Pa dokumentacion përkatës të mbështetjes, tre ndërmarrje publike kanë raportuar shpenzime në shumën prej 22.034 mijë denarë, përkatësisht: 17.466 mijë denarë në NPVK "Komunaleci i Ohrit" Ohër për karburantin e shpenzuar dhe prokurimin e pjesëve rezervë për riparimin e automjeteve, 3.968 mijë denarë në NPK "Bregallnica" Dellçevë për pjesët rezervë të lëshuara dhe karburantin e shpenzuar dhe huat e dhëna pa bazë nga NPVK "Komunalec" Gjevgjeli në shumën prej 600 mijë denarë.

Edhe pse ndërmarrjet publike e kryejnë punën e tyre përmes programeve, aktivitetet e realizuara nga NPVK "Komunalec" Gjevgjeli dhe NPK "Bregallnica" Dellçevë nuk mbështeten nga dokumentacioni mbi vëllimin e shërbimeve të ofruara, ndërsa NPK "Bregallnica" Dellçevë nuk ka lidhur kontratë për rregullimin e ndërsjellë të të drejtave dhe detyrimeve me komunën.

Në ndërmarrjet e reviduara publike, mungon / nuk funksionon njësia e revizionit të brendshëm si mekanizëm për përmirësimin e punës së subjektit, ndërsa për sa u përket kontrolleve të brendshme, nuk janë miratuar procedurat e shkruara për rrjedhën e dokumentacionit, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi të personave të përfshirë në proceset dhe sistemi për ndjekjen dhe kontrollin gjatë pranimit dhe lëshimit të dokumentacionit të kontabilitetit, miratimit dhe pagesës së tij.

Transporti dhe deponimi i mbeturinave komunale në deponitë ilegale jostandarde "Bukovë" dhe "Maucker" (në zonën e Komunës së Ohrit) dhe deponinë me karakter të përkohshëm "Treshtena Skala" (në zonën e Komunës së Shtipit) nuk janë të siguruara dhe janë subjekt i ndezjeve dhe zjarreve të shpeshta, të cilat ndikojnë negativisht në shëndetin dhe jetën e njerëzve dhe mjedisin jetësor.



Deponia ilegale
"Bukovë"



Deponia ilegale e
mbetjeve ndërtimore
"Maucker"

Deponia "Treshтена Skala"



Për këto arsye, është e nevojshme të intensifikohen aktivitetet për të vendosur sistem të integruar të menaxhimit të mbeturinave në Rajonin Jugperëndimor, Rajonin Lindor dhe Rajonin Verilindor, që përfshin ndërtimin e kapaciteteve

qendrore dhe lokale të menaxhimit të mbeturinave dhe deponinë rajonale, si dhe në drejtim të menaxhimit të organizuar të mbeturinave në përputhje me standardet nacionale dhe të BE-së.

Revizioni njofton edhe për paqëndrueshmërinë financiare dhe likuiditetin e zvogëluar të NPVK "Komunaleci i Ohrit" Ohër, e cila ka funksionuar me llogari të bllokuar për 18 vitet e fundit, detyrime të papaguara për vitin 2023 prej 104.215 mijë denarë, përkatësisht 1.689.000 euro, dhe humbje nga puna e vazhdueshme që nga viti 2021, dhe të NPK "Isar" Shtip, e cila në mënyrë të parregullt i shlyen detyrimet e saj sipas kontratës me MF-në për borxhin e riprogramuar në shumën prej 25.227 mijë denarë dhe detyrime për mjetet e vetëkontributit lokal në shumën prej 16.797 mijë denarë që ishin të dedikuara për ndërtimin e rezervuarëve të furnizimit me ujë.

Në NPK "Isar" Shtip, është vendosur praktikë për emërimin e ushtruesit të detyrës drejtor në vazhdimësi për më shumë se dy vjet, pa zbatuar shpallje publike, e cila nuk siguron transparencë dhe konkurrencë në përzgjedhjen e personit për të ushtruar këtë funksion dhe ka ndikim në menaxhimin dhe udhëheqjen e ndërmarrjes.

Gjendjet e konstatuara në ndërmarrjet publike të lartpërmendura në pjesën e kryerjes së veprimtarisë me interes publik kanë ndikim në zbatimin e parimeve themelore të përcaktuara në dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike në pjesën e: sigurisë në ofrimin e shërbimeve, vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimit, transparencës, disponueshmërisë dhe shërbimit universal, mbrojtjes së shfrytëzuesve dhe konsumatorëve.

5.2.7.

VETËQEVERISJA LOKALE DHE ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL

Gjatë vitit 2024, u krye revizioni i raporteve financiare, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2023, në pesë njësi të vetëqeverisjes lokale, përkatësisht në Komunën e Gjevgjelisë, Komunën e Dellçevës, Komunën e Mavrovës dhe Rostushës, Komunën e Negotinës dhe Komunën e Qendrës, si dhe revizionin e pajtueshmërisë me temë "Prokurimi publik i makinës së shënimit të sinjalizimit horizontal" në Komunën e Velesit, gjatë të cilit u konstatuan gjendjet e mëposhtme:

Në komunat e reviduara, revizionet e kryera të rregullshmërisë, janë konstatuar dobësi në administrimin e tatimeve të pronës dhe tatimeve të trashëgimisë dhe dhuratave, të cilat kanë të bëjnë me: regjistrin e papërditësuar të pronës së patundshme, kontrollet e pavendosura gjatë pranimit dhe përpunimit të fletëparaqitjeve, aktivitetet e pandërrmarra për të llogaritur dhe arkëtuar kamatën mbi tatimin e papaguar brenda afatit të përcaktuar me ligj, huamarrjen joadekuate të tatimit të pronës për tatimpaguesit që kanë fituar pronë shtesë ose pronë të re në vitet e mëparshme, përcaktimin joadekuat të vlerës së tregut të pronës së patundshme, ndërsa në vendimet e trashëgimisë dhe kontratat e dhuratave të shkallës së parë të trashëgimisë, nuk bëhet huamarrja e tatimpaguesve të rinj.

Komuna e Mavrovës dhe Rostushës, për shkak të humbjes së bazës së të dhënave të tatimpaguesve dhe fshirjes së sistemit të evidencës, nuk ka lëshuar aspak vendime për tatimin mbi pronë në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2018.

Në administrimin e taksave dhe kompensimeve komunale janë konstatuar dobësi në taksat komunale për: firmën, përkatësisht emrin e lokalit afarist, përdorimin e hapësirës përpara lokaleve afariste për kryerjen e veprimtarisë, përdorimin e hapësirës për parkimin e automjeteve, përdorimin e muzikës në vendet publike, qëndrimin e përkohshëm, vendosjen e reklamave dhe shpalljeve në vendet publike.



Në Komunën e Gjevgjelisë, vendosja e tabelave reklamuese kryhet me kërkesë të parashtruar, pa ankand publik, dhe nuk arkëtohet kompensimi për hapësirën për vendosjen e tabelave reklamuese, ndërsa në Komunën e Negotinës, llogaritjet për taksën komunale për përdorimin e hapësirës përpara lokaleve afariste përgatiten vetëm në bazë të kërkesës së parashtruar për përdorimin e hapësirës pa kryer inspektimin në vend nga personi zyrtar, të matet hapësira dhe të hartohet procesverbali me skicë për të konfirmuar sipërfaqen e treguar për hapësirën në kërkesë.

Komuna e Dellçevës nuk realizon të ardhura në bazë të taksës komunale për: përdorimin e muzikës në vendet publike, përdorimin e hapësirës para lokaleve afariste, vendosjen e reklamave, njoftimeve dhe shpalljeve në vendet publike, vendosjen e vitrinave për ekspozimin e mallrave jashtë lokaleve afariste dhe vendbanimit të përkohshëm. Komuna e Mavrovës dhe Rostushës nuk ka vendosur dhe arkëtuar taksë komunale për përdorimin e hapësirës para lokaleve afariste dhe shfaqjen e reklamave, njoftimeve dhe shpalljeve në vendet publike, ndërsa Komuna e Negotinës nuk realizon të ardhura nga taksa komunale për përdorimin e muzikës në vendet publike.

Nga ndërmarrjet publike që janë kompetente për mirëmbajtjen dhe ekonomizimin e hapësirave publike të parkimit nuk janë paguar mjetet nga taksa e arkëtuar komunale për përdorimin e hapësirave të parkimit për automjetet në buxhetin e Komunës së Qendrës (16.940 mijë denarë) dhe Komunës së Negotinës (973 mijë denarë), ndërsa për vitet 2022 dhe 2023, Komuna e Qendrës nuk ka shprehur kërkesë mbi këtë bazë.

Dobësitë e konstatuara në procedurat për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave komunale dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike kanë të bëjnë me mjetet më pak të paguara në shumën prej 11.624 mijë denarë në buxhetin e Komunës së Dellçevës dhe 443 mijë denarë në Komunën e Negotinës, ndërsa Komuna e Mavrovës

dhe Rostushës nuk realizon të ardhura mbi këtë bazë. Komuna e Dellçevës dhe Komuna e Mavrovës dhe Rostushës nuk kanë lidhur kontrata me ndërmarrjet publike për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella për vitin 2023.

Komuna e Dellçevës dhe Komuna e Negotinës arkëtojnë kompensim nga operatorët e instalimeve kur parashtrojnë kërkesë për marrjen e lejes ekologjike B-të integruar, por nuk llogarisin dhe nuk arkëtojnë kompensim vjetor për posedimin e lejes ekologjike B-të integruar dhe për mbikëqyrjen e rregullt të instalimit, ndërsa Komuna e Gjevgjeliës nuk llogarit dhe nuk arkëton fare kompensim bazuar në marrjen dhe posedimin e lejes ekologjike B-të integruar.

Në Komunën e Gjevgjeliës nuk janë miratuar programe për aktivitetet që janë në kompetencë të komunës në fushën e mjedisit jetësor dhe pastërtisë publike, Komuna e Mavrovës dhe Rostushës nuk ka programe për mirëmbajtjen e pastërtisë publike dhe instalimin e pajisjeve urbane, ndërsa Komuna e Dellçevës dhe Komuna e Negotinës nuk kanë program për propagandë të përgjithshme turistike dhe veprimtarinë informative për përmirësimin e kushteve për qëndrim.

Sa i përket zbatimit të kompetencës për menaxhimin e gjelbërimit, komunat urbane nuk kanë hartuar Strategji për Zhvillimin e Gjelbërimit, program vjetor për krijimin dhe mirëmbajtjen e gjelbërimit, dhe nuk realizojnë të ardhura mbi bazën e kompensimit për mirëmbajtjen e gjelbërimit publik urban.

Në Komunën e Gjevgjeliës, Komunën e Dellçevës, Komunën e Mavrovës dhe Rostushës, u konstatuan parregullsi në mënyrën dhe procedurën e dhënies me qira të pronës komunale, përkatësisht kontratat e lidhura ishin pa procedura të zbatuara të ankandit publik dhe vlerësimit për të përcaktuar çmimin fillestar për ankandin publik.

Në komunat e reviduara janë konstatuar dobësi në procedurat për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje në aspektin e mosrespektimit të afateve të përcaktuara me ligj dhe në aspektin e mosdorëzimit të raporteve vjetore në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve mbi shfrytëzimin e mjeteve të realizuara nga kompensimi mbi këtë bazë, të cilat duhet të shfrytëzohen me dedikim për miratimin e dokumentacionit urbanistik të planit që do të integrojë objektet pa leje dhe për rregullimin infrastrukturor të zonës në të cilën ato ndodhen.

Komuna e Mavrovës dhe Rostushës nuk ka filluar procedurë për miratimin e planeve urbanistike në pesë vitet e fundit, ndërsa në lidhje me vendimet e lëshuara nga inspektori i ndërtimit për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje nuk ka filluar zbatimin administrativ.

Gjatë angazhimit të personave përmes agjencive private të punësimit, kontratave në vepër dhe kontratave për kryerjen e shërbimeve, u konstatuan parregullsi në Komunën e Gjevgjeliës, Komunën e Dellçevës dhe Komunën e Qendrës, ndërsa dobësitë në lidhjen e kontratave për shërbimet e avokatëve në të cilat në mënyrë paushalle përcaktohet kompensimi mujor janë të pranishme në Komunën e Negotinës dhe Komunën e Qendrës.

Në Komunën e Dellçevës dhe Komunën e Qendrës janë paguar mjetet për klubet sportive, shoqatat e qytetarëve, fondacionet, nxënësit e talentuar dhe beneficionet sociale, pa programe të miratuara dhe kriteret të përcaktuara saktësisht për shpërndarjen e mjeteve për mbrojtjen sociale, sportin, arsimin dhe mbështetjen e organizatave qytetare në shumën totale prej 18.855 mijë denarë. Për objektet sportive që janë në pronësi të komunave, këshillat komunale nuk kanë miratuar akt për kategorizimin e objekteve sportive në përputhje me kriteret që sigurojnë kushte për realizimin e interesit lokal dhe Listë Tarifore që përcakton lartësinë e kompensimit për shfrytëzimin e objekteve sportive.

Pa vendim të Këshillit të Komunës së Negotinës, janë paguar 5.748 mijë denarë si subvencion për NP "Parkingjet Negotinë", ndërsa pa dokumentacion përkatës të mbështetjes në Komunën e Dellçevës, Komunën e Mavrovës dhe Rostushës dhe Komunën e Qendrës, janë paguar gjithsej 6.999 mijë denarë, përkatësisht: 1.057 mijë denarë në Komunën e Dellçevës për karburant të konsumuar, riparim dhe servisim të mjeteve motorike të mallrave dhe pasagjerëve dhe transportit të mjeteve të dedikuara për NJTZ-në, 1.723 mijë denarë në Komunën e Mavrovës dhe Rostushës për reprezentim dhe shpenzime udhëtimi dhe ditore dhe 4.219 mijë denarë në Komunën e Qendrës për paushallin e paguar, pa u kryer punë efektive në automjetet për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, karburantin e konsumuar dhe hapësirën afariste të marrë me qira të dedikuar për sallat e leximit që nuk funksionojnë.

Gjendjet që kanë ndikim në paraqitjen reale dhe objektive të kërkesave në raportet financiare i

konstatuam në të gjitha komunat e reviduara dhe kanë të bëjnë me mosharmonizimin e evidencës tatimore dhe me evidencën e kontabilitetit të kërkesave, përcaktimin e strukturës së moshës, bazën juridike për ekzistencën e tyre, si dhe evidentimin joadekuat të kërkesave që janë të parashkuara dhe nuk ka mundësi për arkëtimin e tyre.

Në Komunën e Gjevgjelisë, Komunën e Dellçevës, Komunën e Negotinës, Komunën e Mavrovës dhe Rostushës, ka dobësi në zbatimin e regjistrimit të pronës dhe detyrimeve, gjendje që është aktuale me vite dhe nuk mundëson harmonizimin e gjendjes së mjeteve dhe detyrimeve midis evidencës së kontabilitetit dhe gjendjes faktike të konstatuar me regjistrimin.

Prona që është në pronësi të komunave nuk është evidentuar plotësisht në librat e punës, ndërsa për pjesën më të madhe të pronës së patundshme nuk është siguruar dëshmia për pronësinë e komunave.

Për shkak të mbajtjes së papërditësuar dhe të parregullt të librave të punës, konstatuam mosharmonizim në pozicionet e bilancit në raportet financiare të Komunës së Mavrovës dhe Rostushës dhe mosharmonizim në bazën elektronike të të dhënave me të dhënat nga raportet financiare të Komunës së Gjevgjelisë. Komuna e Gjevgjelisë nuk ka evidentuar detyrime për kreditë afatgjata në shumën prej 110.774 mijë denarë dhe depozitë jomonetare prej 265 mijë denarë ndaj Fondacionit për Zhvillim Lokal dhe Teknologjitë Informatike, ndërsa ditari dhe libri kryesor nuk janë nënshkruar nga personi i autorizuar dhe kontabilisti përgjegjës. Shpenzimet kapitale në Komunën e Qendrës në shumën prej 70.894 mijë denarë nuk mbahen në mjetet materiale në fazën e përgatitjes, ndërsa pas përfundimit të ndërtimeve do të transferohen tek individët shfrytëzues, ndërsa në Komunën e Negotinës evidentohen drejtpërdrejt në mjetet materiale, gjë që nuk siguron gjurmueshmëri të depozitimit të investimeve në objektin e caktuar dhe për periudhë të caktuar.

Këshilli i Komunës së Qendrës nuk ka miratuar vendim për dhënien në shfrytëzim të objekteve / shkollave fillore dhe kopshteve, megjithëse ato janë evidentuar në evidencën e kontabilitetit dhe materiale të individëve shfrytëzues.

Në Komunën e Dellçevës, Komunën e Mavrovës dhe Rostushës dhe Komunën e Negotinës, u

konstatuan dobësi edhe në evidentimin e rezervave me materiale dhe inventar të vogël (materiale të zyrës, materialet për AOP, produktet ushqimore dhe pijet, mjetet për mbajtjen e higjienës, etj.).

Komuna e Gjevgjelisë dhe Komuna e Negotinës gjatë vitit 2023 përdorin pagesa me llogaritje (kontrata të cesionit) që realizohen jashtë sistemit të thesarit, ndërsa faqja e internetit e papërditësuar e Komunës së Gjevgjelisë tregon transparencë të pamjaftueshme të pushtetit lokal në informimin publik në lidhje me buxhetin, aktivitetet e realizuara dhe shërbimet e siguruar publike për personat juridikë dhe qytetarët.

Në [3] tri nga komunat e reviduara, u konstatuan dobësi në procedurat e prokurimeve publike në aspektin e: pandashmërisë së procedurës, megjithëse specifikimi teknik dhe parallogaritja përbëhen nga zëra të ndryshëm që përbëjnë pjesë të veçanta (Komuna e Dellçevës - 10.530 mijë denarë për rikonstrukcionin e objektit, Komuna e Negotinës - 2.300 mijë denarë për mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe ndërrurbane, dhe Komuna e Qendrës - 11.651 mijë denarë për rikonstrukcionin e fasadës dhe çatisë së kopshtit) dhe kushti i paraparë joproportional në kushtet për përzgjedhjen cilësore (Komuna e Qendrës - 113.295 mijë denarë për prokurimin e sistemit të administratës, digjitalizimit dhe rikonstrukcionit të ndriçimit publik).

Me revizionin e përputhshmërisë me temë "Prokurimi publik i makinës për shënimin e sinjalizimit horizontal" në Komunën e Velesit, konstatuam se në vitin 2023 është lidhur kontratë për prokurimin publik me vlerën totale prej 2.596 mijë denarë përfshirë TVSH-në. Me aktivitetet e ndërmarra të revizorit në pjesën e mënyrës së zbatimit të procedurës së prokurimit publik dhe realizimit të saj, konstatuam mungesë të hulumtimit të plotë mbi lëvizjet e tregut, rregullimi jo i plotë i marrëdhënieve të ndërsjella midis Komunës së Velesit dhe NPK "Derven" Veles, së cilës i ishte dhënë makina për shfrytëzim të përhershëm dhe mungesa e aktiviteteve të planifikuara për shënimin e sinjalizimit horizontal në Planin Vjetor të Punës për vitin 2024 të NPK-së.

Gjatë realizimit të projekteve, u konstatuan dobësi që kanë të bëjnë me: ndryshimet e projektit themelor gjatë ndërtimit pa plotësimin e projektit dhe pëlqimin e siguruar nga projektuesi (Komuna e Qendrës) dhe prokurime të paraportuara nën



pragun e vlerës në evidencën tremujore (Komuna e Gjevgjelisë), ndërsa pas ndryshimit të kontratës / anekseve të lidhura, nuk i është parashtruar kërkesë ofertuesit për të dorëzuar garanci bankare shtesë (Komuna e Dellçevës).

Pa procedurën e prokurimit publik janë prokuruar mallra dhe shërbime dhe u kryen punë për të cilat u paguan mjete në shumën totale prej 2.761 mijë denarë (Komuna e Gjevgjelisë – 1.876 mijë denarë dhe Komuna e Mavrovës dhe Rostushës – 885 mijë denarë).

Në Komunën e Gjevgjelisë, Komunën e Dellçevës, Komunën e Mavrovës dhe Rostushës, u konstatuan dobësi në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, në aspektin e procedurave të shkruara, ndarjes së detyrave dhe mekanizmave të përcaktuar të kontrollit në proceset e punës, ndërsa mungesa / mosfunksionimi i revizionit të brendshëm është i pranishëm në të gjitha komunat e reviduara.

Në pjesën Theksimi i Çështjeve të Pasigurisë dhe Vazhdimësisë, theksohen gjendjet që kanë të bëjnë me procedurat gjyqësore. Komunat e reviduara janë të paditura në procedurat e bazuara në borxh në shumën totale prej 495.558 mijë denarë, ndërsa vlera e kontesteve në të cilat paraqiten si paditëse janë në lartësinë prej 158.667 mijë denarë.

Revizioni thekson se me prolongimin e gjendjeve të miratimit të Ligjit për rishpalljen e Parkut Nacional të Mavrovës dhe miratimin e zonave të mbrojtura, Komuna e Mavrovës dhe Rostushës nuk mund t'i qaset hartimit të planeve të reja urbanistike, ndërsa mungesa e planeve urbanistike që u shfuqizuan me Vendim të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe pamundësia për të lëshuar leje ndërtimi kanë kontribuar në ndërtimin e një numri të madh të objekteve të ndërtuara pa leje në territorin e komunës dhe lënë hapësirë që numri i tyre të rritet.

Duke pasur parasysh se Komuna e Dellçevës është në bllokadë të përhershme që nga viti 2008, me borxh të përgjithshëm në vitin 2024 prej 162.218 mijë denarë, kryetarët e komunave nuk kanë miratuar Vendim për shpalljen e jostabilitetit financiar, as Plan të masave për tejkalimin e tij. Në vitet 2012 dhe 2013, janë kryer ekzekutime mbi objektet në pronësi të komunës, të cilat janë me interes publik për shkak të mosdorëzimit të kundërshtimeve në gjykatën themelore të urdhrave të ekzekutimit.

Gjendjet e lartpërmendura kanë ndikim, si në anën e të ardhurave, ashtu edhe në atë të shpenzimeve të komunave, si dhe në mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve publike, përkatësisht mjeteve të tatimpaguesve.



5.2.8.

PARTITË POLITIKE DHE PROCESET ZGJEDHORE

5.2.8.1.

PARTITË POLITIKE - LLOGARITË PËR PUNËN E RREGULLT


Enti Shtetëror i Revizionit, si organ kompetent për mbikëqyrjen e punës financiare dhe materiale të partive politike, vazhdimisht kryen revizion të llogarive për punën e rregullt të partive më të mëdha në vend. Me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024, u planifikuan dhe u kryen revizione të raporteve financiare të gjashtë partive politike: VMRO-DPMNE, LSDM, BDI, Lëvizja Besa, Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa, me të cilat mbuluam 66% të gjithë burimeve publike të financimit të partive politike në vitin 2023.

Partitë politike i sigurojnë mjetet për aktivitetet e tyre nga burimet publike dhe private të financimit:

- /// burimet publike të financimit - mjetet financiare të parashikuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- /// burimet private të financimit - anëtarësimi, kredia, donacionet, dhuratat, kontributet, dotacionet, sponsorizimet, trashëgimia, shitja e materialeve promovuese dhe propagandistike.

Të ardhurat totale në vitin 2023 të partive politike që ishin lëndë e revizionit janë në shumën prej 434.135 mijë denarë, nga të cilat 279.114 mijë denarë ose 64% janë siguruar nga burimet publike, përkatësisht mjete nga Buxheti i Shtetit që janë planifikuar në shumë të caktuar çdo vit fiskal në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë, nga ku u paguhen partive.

Shpenzimet totale në vitin 2023 janë në shumën prej 222.565 mijë denarë, nga të cilat 48% janë shpenzime materiale, shërbime dhe amortizime, 32% janë shpenzime të tjera, 17% janë rroga dhe kompensime, 3% janë shpenzime kapitale dhe 1% janë tatime dhe kontribute.




Në drejtim të arritjes së qëllimeve dhe kryerjes së aktiviteteve të përcaktuara me statutin e partisë dhe me ligj, partitë politike kanë të drejtë të zotërojnë pronë të patundshme, pajisje, mjete transportuese dhe pronë tjetër të tundshme.

Revizionet e kryera kanë konstatuar gjendje që tregojnë nevojën për t'i forcuar aktivitetet e personave përgjegjës të partive politike për tejkalimin e tyre, veçanërisht në pjesën e evidentimit të plotë të pronës, vendosjes së evidencës së mjeteve materiale dhe vlerësimit të pozicioneve të veçanta të bilancit të përmbajtura në librin kryesor, të cilat duhet të zbatohen në përputhje me parimin e kontabilitetit të ndodhjes së modifikuar të ndryshimeve/transaksioneve afariste.

Në pjesën Theksimi i Çështjeve u zbuluan gjendjet që lidhen me të ardhurat e parealizuara nga anëtarësimi dhe detyrimet e papaguara ndaj furnizuesve që burojnë nga vitet e kaluara.

Me revizionet e kryera, vazhdimisht nxjerrim në pah dobësitë e caktuara sistemore në Ligjin për financimin e partive politike, të paraqitura në detaje në pjesën "Dobësitë Sistemore" të këtij raporti, për tejkalimin e të cilave është e nevojshme të ndërmerren aktivitete.



5.2.8.2.

ZGJEDHJET E VITIT 2024

Fushata zgjedhore, si prezantimi publik i kandidatëve të konfirmuar nga organet zgjedhore kompetente dhe programet e tyre, është procesi që ndikon në formimin e qëndrimit të elektoratit mbi zgjedhjen e kandidatit të caktuar. Enti Shtetëror i Revizionit është kompetent për revizionin e raporteve të përgjithshme financiare të llogarive të "fushatës zgjedhore" të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore me qëllim të konfirmimit të saktësisë dhe ligjshmërisë së financimit të fushatës dhe mënyrës së shpenzimit të mjeteve.

Gjatë vitit 2024, në Republikën e Maqedonisë së Veriut u organizuan dhe u zbatuan Zgjedhjet për President të Shtetit dhe Zgjedhjet për Deputetë në Kuvend.

Në bazë të Programit Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024 dhe nenin 85 të Kodit Zgjedhor, realizuam revizionin e raportit të përgjithshëm financiar për llogaritë transaksionale "të fushatës zgjedhore" të të gjithë shtatë pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore për zgjedhjen e presidentit, përkatësisht:

- /// z. Stevo Pendarovski,
- /// znj. Gordana Siljanovska Davkova,
- /// z. Stevço Jakimovski,
- /// z. Bujar Osmani,
- /// znj. Biljana Vankovska Cvetkovska,
- /// z. Arben Taravari dhe
- /// z. Maksim Dimitrievski,

si dhe të shtatëmbëdhjetë pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore për zgjedhjen e deputetëve në Kuvend

- /// Koalicioni "Për të Ardhmen Evropiane" i udhëhequr nga LSDM-ja;
- /// Koalicioni "Maqedonia Jote" i udhëhequr nga VMRO – DPMNE-ja;


- /// Koalicioni "Me guxim për Maqedoninë" i udhëhequr nga Opsioni Qytetar për Maqedoninë - GROM;
- /// Koalicioni "Fronti Evropian" i udhëhequr nga BDI-ja;
- /// PP E MAJTA;
- /// Koalicioni VLEN i udhëhequr nga Alternativa;
- /// Lëvizja ZNAM - Për Maqedoninë Tonë;
- /// Maqedonia e Vetme;
- /// PP Alternativa e Re Shkup;
- /// PP AVAJA;
- /// Lëvizja Qytetare Evropiane;
- /// Epoka e Tretë Maqedonase / Listat e Pavarura Maqedonase;
- /// Partia Jote;
- /// Rodina Maqedonia;
- /// PP E DJATHTA;
- /// PP DEMOKRATËT Shkup dhe
- /// Partia e Punëtorëve.

Fushëveprimi i përfshinte: të ardhurat totale të realizuara nga burimet dhe shpenzimet totale sipas dedikimeve, si dhe respektimin e afateve për hapjen dhe mbylljen e llogarisë transaksionale "të fushatës zgjedhore", regjistrimin dhe fshirjen e pjesëmarrësit në regjistrin e subjekteve juridike. E vlerësuam transparencën dhe llogaridhënien përmes raporteve të dorëzuara financiare mbi të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara për fushatën zgjedhore në Entin Shtetëror të Revizionit.

ZGJEDHJET PRESIDENCIALE 2024


Për të shtatë kandidatët, të ardhurat totale u realizuan në shumën prej 461.470 mijë denarë. Të ardhurat më të larta i realizuan kandidatët

znj. Gordana Siljanovska Davkova dhe z. Stevo Pendarovski, të cilët morën pjesë edhe në rrethin e dytë të votimit.



PJESËMARRJA E SECILIT NGA KANDIDATËT NË TË ARDHURAT TOTALE TË REALIZUARA

Shuma dhe pjesëmarrja e të ardhurave të realizuara nga burimet në total për të shtatë kandidatët është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



TË ARDHURAT SIPAS BURIMEVE DHE PJESËMARRJA E TYRE NË TË ARDHURAT TOTALE NGA TË GJITHË KANDIDATËT

Nga të ardhurat totale të realizuara, 354.257 mijë denarë ose 77% janë për reklamimin e paguar politik dhe të publikuar dhe sigurohen nga Buxheti i Shtetit, ndërsa përmes Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve u paguhen drejtpërdrejt mediave që transmetojnë reklamimin e paguar politik. Shuma më e madhe e mjeteve për reklamimin e paguar politik iu pagua znj. Gordana Siljanovska Davkova (36%), e ndjekur nga z. Stevo Pendarovski (35%), z. Bujar Osmani (12%), z. Arben Taravari (11%) dhe për z. Stevço Jakimovski, znj. Biljana Vankovska Cvetkovska dhe z. Maksim Dimitrievski me nga 2%.

Për financimin e fushatës zgjedhore të të shtatë pjesëmarrësve u shpenzuan mjete në total prej 461.470 mijë denarë, nga të cilët:

- 105.463 mijë denarë janë pagesa nga llogaritë transaksionale për prokurimin e materialeve, shërbimeve komunale, shërbimeve të transportit, reklamimit dhe propagandës, përfaqësimit, shërbimeve intelektuale, shërbimeve të kontabilitetit, mbajtjes së tubimeve parazgjedhore, marrjes me qira të hapësirës gjatë fushatës zgjedhore, provizioneve për qarkullimin pagesor dhe shpenzimeve të tjera,

- 1.123 mijë denarë janë shpenzime të bazuara në donacionet e pranuar në mjetet jomonetare dhe
- 354.257 mijë denarë janë shpenzime për publikimin e RPP-së.

Mjetet e pashfrytëzuara financiare nga llogaritë transaksionale "të fushatës zgjedhore", të cilat, në përputhje me raportet financiare, janë paraqitur si shpenzime në shumën totale prej 627 mijë denarë, janë kthyer në llogaritë për punën e rregullt të partive politike.


Asnjë nga pjesëmarrësit nuk ka realizuar shpenzime më shumë se maksimumi i përcaktuar me ligj.

Pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore Zgjedhjet Presidenciale të vitit 2024 në përgjithësi siguruan respektimin e afateve për hapjen dhe mbylljen e llogarive transaksionale, regjistrimin dhe fshirjen nga regjistri i subjekteve juridike, transparencën e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara në fushatën zgjedhore përmes dorëzimit të raporteve të parashikuara mbi donacionet e pranuar dhe raportit të përgjithshëm financiar.

ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2024

Për financimin e fushatës zgjedhore për pjesëmarrësit në Zgjedhjet Parlamentare të vitit

2024 u realizuan të ardhura totale në shumën prej 386.710 mijë denarë.



TË ARDHURAT SIPAS BURIMEVE DHE PJESËMARRJA E TYRE NË TË ARDHURAT TOTALE

Buxheti shtetëror është burimi dominues i financimit të fushatave zgjedhore për pjesëmarrësit në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2024. Nga të ardhurat dhe shpenzimet totale të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, në shumën

prej 368.710 mijë denarë, 244.769 mijë denarë, 63% u siguruan nga Buxheti i Shtetit dhe përmes Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve u paguan drejtpërdrejt mediave që transmetuan reklamimin e paguar politik të pjesëmarrësve.

 KOALICIONI PËR ARDHËMI EUROPIAN - LSDM 62.121	 Koalicioni "MAQEDONIA JOTË" VMRO-DPMNE 67.328	 Koalicioni GUXMSHËM PËR MAQEDONINË - GROM 7.319	 Koalicioni FRONTI EUROPIAN - BDI 48.118
 Partia Politike e MAJTA 9.148	 KOALICIONI VLEN 45.464	 Lëvizja ZNAM 671	 PP MAQEDONIA E VETME 711
 PP ALTERNATIVA E RE 354	 PP AVAJA 449	 LËVIZJA QYTETARE EUROPIANE 565	 Epoka e Tretë Maqedonase 468
 PP PARTIA JOTË 269	 PP ATDHEU MAQEDONIA 579	 PP DEMOKRATËT 646	 PP PARTIA PUNËTORE 559

MJETET E PAGUARA PËR RPP-NË PËR PJESËMARRËS NË 000 DENARË

Shpenzimet totale të bëra në fushatën zgjedhore për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë në shumën prej 386.710 mijë denarë, nga të cilat:

- /// 140.241 mijë denarë janë pagesa nga llogaritë transaksionale për prokurimin e materialeve, shërbimeve komunale, shërbimeve të transportit, reklamimit dhe propagandës, përfaqësimit, shërbimeve intelektuale, shërbimeve të kontabilitetit, mbajtjes së tubimeve parazgjedhore, marrjes me qira të hapësirës gjatë fushatës zgjedhore, provizioneve për qarkullimin pagesor dhe shpenzimeve të tjera,
- /// 963 janë shpenzime të bazuara në donacionet e pranuar në mjetet jomonetare dhe
- /// 244.769 mijë denarë janë shpenzime për publikimin e RPP-së.

Mjetet e pashfrytëzuara financiare nga llogaritë transaksionale "të fushatës zgjedhore", të cilat, në përputhje me raportet financiare, janë paraqitur si shpenzime në shumën totale prej 717 mijë denarë, janë kthyer në llogaritë për punën e rregullt të partive politike.

Asnjë nga pjesëmarrësit nuk ka realizuar shpenzime më shumë se maksimumi i përcaktuar me ligj.

Pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore në përgjithësi siguruan respektimin e afateve për hapjen dhe mbylljen e llogarive transaksionale, regjistrimin dhe fshirjen nga regjistri i subjekteve juridike.

Të gjithë pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore siguruan transparencë në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara në fushatën zgjedhore përmes dorëzimit të raportit të përgjithshëm financiar në Entin Shtetëror të Revizionit, përveç PP Alternativa e Re, Lëvizjes Qytetare Evropiane dhe Epokës së Tretë Maqedonase.

5.2.9

SIGURIA DHE MBROJTJA SHTETËRORE

5.2.9.1.

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM



Me revizionin e kryer të raporteve financiare, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, për vitin 2023, konstatuam më shumë gjendje që ndikojnë në raportet financiare dhe përputhshmërinë e punës me aktet ligjore, përkatësisht:

Kemi konstatuar se DMSH-ja përballet me sfida serioze në funksionimin e vet, për **shkak të mungesës së Strategjisë Nacionale për Mbrojtje dhe Shpëtim, mungesës së personalit të kualifikuar dhe menaxhimit joadekuat të pronës dhe pajisjeve**. Kjo krijon rreziqe të konsiderueshme për sigurinë e vendit, veçanërisht në kushtet e fatkeqësive natyrore dhe të tjera, ku reagimi i shpejtë dhe efektiv është me rëndësi vendimtare.

Me vendimet e Qeverisë, në vitin 2005, DMSH-së i janë ndarë për shfrytëzim gjithsej 198 objekte (100 strehimore dhe 98 lokale të punës - zyra, depo, garazhe, etj.). Në librat e punës u evidentuan 24 objekte ndërtimore (12% e numrit të përgjithshëm të objekteve të ndara), por për to nuk u prezantuan listat pronësore, si dhe dokumentacioni mbi metodologjinë e përdorur sipas së cilës është kryer vlerësimi i vlerës së tyre. Në vitin 2019, DMSH-ja ka dorëzuar kërkesë në Byronë e Ekspertizave Gjyqësore për kryerjen e vlerësimit të 32 objekteve ndërtimore. Byroja ka dorëzuar Vlerësim të Vlerës, por deri në ditën e njoftimit nga revizioni i kryer, objektet e punës nuk ishin evidentuar në librat e punës së DMSH-së. Për 142 objektet e mbetura ndërtimore (72% e numrit të përgjithshëm të dhëna në shfrytëzim), **nuk është filluar procedurë për vlerësimin e vlerës dhe evidentimin në librat e punës së DMSH-së, megjithëse për këtë gjendje është dhënë rekomandimi edhe në Raportin Përfundimtar të Revizorit të Autorizuar Shtetëror për revizionin e kryer për vitin 2010.**

Duke vizituar një pjesë të strehimoreve të cilat i janë ndarë DMSH-së, të vendosura në komunat Gjorçe Petrov, Karposh, Qendër, Aerodrom, Gazi Babë, Veles dhe Shtip, konstatuam se DMSH-ja nuk kryen mirëmbajtjen e tyre aktuale. **Një pjesë e madhe e strehimoreve janë të bllokuara ose të mbyllura nga pengesat e bëra nga drunjtë dhe mbetjet kaba, një pjesë e tyre janë të hapura dhe u ngjajnë depove, ndërsa disa janë magazina për pajisjet e vjetra.** Disa strehimore nuk janë në funksion për shkak të sistemeve të ventilimit të dëmtuara dhe mungesës së energjisë elektrike dhe ujit. **Në të njëjtën kohë, një strehimore shfrytëzohet nga një person juridik privat, për të cilin nuk na ishte dhënë dokumentacioni i qirasë, as nuk kemi konstatuar të ardhura përkatëse mbi këtë bazë.**





Një pjesë e pajisjeve të DMSH-së të vendosura në magazinat janë jofunksionale, të papërdorshme dhe teknologjikisht të vjetruara, të papajtueshme, të pakontrolluara, të paservisuar për një periudhë të gjatë, me afat të skaduar të përdorimit. Një pjesë e pajisjeve që i janë ndarë MM-së në përputhje me bilancin e ndarjes qysh në vitin 2005 janë më të vjetra se 40 vjet.



Në DMSH janë sistemuar shtatë vende pune për pilotë, por tre janë plotësuar deri në qershor 2024. Pas daljes në pension të dy pilotëve, në vitin 2024 DMSH-ja mbeti me një pilot aktiv. Duke marrë parasysh se në gjysmën e parë të korrikut 2024, më shumë se 10 vatra zjarri në natyrë ishin aktive në territorin e Republikës, DMSH-ja lidhi kontrata në vepër me pilotët e pensionuar për periudhë prej tre muajve. Për shkak të mungesës së pilotëve, avionët e DMSH-së nuk do të jenë në gjendje të shfrytëzohen, gjë që do të ketë ndikim në procesin e përgjithshëm të mbrojtjes nga zjarret.


DMSH-ja çdo vit lidh kontrata për NP për sigurimin e avionëve. Në vazhdimësi të kontratës, angazhohet eksperti i jashtëm / shoqëria brokere për të cilën për dy vjet janë paguar mjete në shumën prej 25% të vlerës së kontratave të lidhura ose 12.787 mijë denarë. Detyrimet e shoqërisë përfshijnë edhe ndërmjetësimin në dakordimin e mbulimit të sigurimit dhe risigurimit për të gjitha klasat e sigurimit, si dhe përfshirjen në përgatitjen e specifikimit teknik për NP për sigurim. Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për të njëjtën lëndë të sigurimit, avionë që janë prokuruar në vitin 2010 dhe sigurimi i tyre kryhet vazhdimisht, nuk na ishin prezantuar dëshmitë e mjaftueshme bindëse për nevojën dhe justifikimin e brokerit në procedurën për NP-në dhe nuk ishin dorëzuar dokumente nga të cilat do të mund të konfirmim se shoqëria brokere e ka realizuar lëndën e kontratës.



DMSH-ja nuk ka miratuar kriteret të shkruara për përcaktimin e nevojave dhe prioriteteve për prokurimin e pajisjeve zjarrfikëse dhe mjeteve për shuarjen e zjarreve për departamentet e zjarrfikëseve. **Në vitin 2023, u prokuruan 40 aparate të izoluar të frymëmarrjes dhe 20 kamera termale dore për zjarrfikësit, por ato nuk u shpërndanë në NJZFT nëpër komunat, por u ruajtën në magazinat e DMSH-së. Në mënyrë plotësuese, në mars 2024, u prokuruan edhe 40 aparate të izoluar të frymëmarrjes, të cilat ndodhen gjithashtu në magazinat e DMSH-së.**

Për periudhën pas vitit 2018 nuk është miratuar Strategjia Nacionale për Mbrojtje dhe Shpëtim, megjithëse në vitin 2021 u hartua Draft-Strategjia Nacionale për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Plani i Veprimit për periudhën 2022-2025, por ato ende nuk janë miratuar, gjë që krijon rrezik për aktivitetet

e pakoordinuara në nivelin lokal, nacional, rajonal dhe ndërkombëtar në përballjen me rreziqet e fatkeqësive natyrore dhe të tjera dhe ndikon në sistemin e përgjithshëm të mbrojtjes dhe shpëtimit në vend.



5.2.10

MEKANIZMAT E KONTROLLIT DHE FUNKSIONIMI I TYRE NË SISTEMIN SHTETËROR

5.2.10.1.

INSPEKTORATI SHTETËROR I ARSIMIT



Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Inspektoratit Shtetëror të Arsimit për vitin 2023.

Janë konstatuar dobësi dhe parregullsi në zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese, të cilat ndikojnë në efektivitetin dhe ligjshmërinë e kontrolleve në konviktet studentore dhe institucionet edukativo-arsimore.

Në përputhje me dispozitat ligjore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit është i detyruar të kryejë mbikëqyrje inspektuese të paktën një herë në vit në konviktet studentore dhe t'i dorëzojë raport MASH-it dhe Qeverisë brenda 60 ditëve pas përfundimit të akomodimit të studentëve.

Revizioni konstatoi se mbikëqyrja e fundit inspektuese ishte kryer në vitin 2019, pas së cilës nuk ishin kryer kontrole / mbikëqyrje të reja, as nuk ishin hartuar procesverbale për mbikëqyrjet e kryera. Mungesa e kontrolleve të rregullta dhe të jashtëzakonshme në procesin e pranimit, evidentimit dhe akomodimit të studentëve, si dhe saktësia e të dhënave në dokumentacionin e konvikteve studentore, e pamundëson funksionimin e tyre të duhur dhe përmbushjen e qëllimit të sigurimit të kushteve përkatëse për studentët. Gjithashtu, revizioni konstatoi se mbikëqyrja inspektuese nuk ishte kryer as në vitin 2024, gjë që tregon për mosveprimin sipas rekomandimeve të revizorit të autorizuar shtetëror, të theksuara në Raportin Përfundimtar të revizionit të suksesit të Entit Shtetëror të Revizionit me temë "Efikasiteti i masave, politikave dhe projekteve për përmbushjen e kushteve në të cilat funksionojnë konviktet studentore shtetërore".

Inspektorati Shtetëror i Arsimit ka gjithashtu detyrim ligjor të zbatojë mbikëqyrje inspektuese të rregullta, të jashtëzakonshme dhe kontrolluese, si dhe vlerësim integral të punës së institucioneve edukativo-arsimore. Në vitin 2023, janë planifikuar gjithsej 7.691 mbikëqyrje inspektuese, nga të cilat janë kryer vetëm 4.446, ose 58% të atyre të planifikuara. Nga ana tjetër, ISHA-ja ka 138 vende të sistemuara pune, 100 prej të cilave janë plotësuar, që do të thotë se 27,5% të burimeve të nevojshme njerëzore nuk janë siguruar. Mungesa më e theksuar është në Sektorin e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Vlerësimit të Cilësisë, ku ka mungesë inspektorësh arsimorë, gjë që e vështirëson realizimin e veprimtarisë themelore. Për shkak të daljes në pension dhe largimit të inspektorëve, njësi të caktuara rajonale, si në: Ohër, Gostivar, Kavadar dhe Resnjë, janë plotësisht jofunksionale. Gjithashtu, një pjesë e inspektorëve të sapopunësuar nuk kanë përfunduar trajnimin e domosdoshëm, gjë që bart rrezik për gabime dhe dobësi në punën e tyre. Së bashku me mungesën e kuadrit teknik dhe administrativ, këto probleme e dëmtojnë efikasitetin e mbikëqyrjes inspektuese dhe e bëjnë të vështirë zbatimin e plotë të saj.


VENDET E PUNËS TË SISTEMUARA, TË PLOTËSUARA DHE STRUKTURA E MOSHËS E INSPEKTORËVE TË PUNËSUAR NË PERIUDHËN NGA VITI 2021 DERI NË VITIN 2024

Numri rendor	Viti	Numri i inspektorëve sipas sistematizimit	Numri i inspektorëve të punësuar	Kërkesat për punësimin e inspektorëve	Miratime nga MF për punësime të reja	Inspektorëte rinjë të punësuar gjatë vitit	Largimi i inspektorëve të punësuar		Moshë mesatare e inspektorëve	Moshë mesatare e numrit të përgjithshëm të punonjësve
							Pensionimi	Arsye tjetër		
1	2021	76	65	5	5	0	4	0	50 - 60	46 - 55
2	2022	76	61	5	5	0	5	0	50 - 60	46 - 55
3	2023	75	56	2	1	1	2	1	50 - 60	46 - 55
4	Nëntor 2024	75	53	4	0	0	6	0	50 - 60	46 - 55
				16	11	1	17	1	50 - 60	46 - 55

Ligji për inspeksionin arsimor e rregullon procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, ku një nga metodat është vlerësimi integral i institucioneve edukativo-arsimore. Është konstatuar se një pjesë e shkollave fillore dhe të mesme nuk përfshihen nga vlerësimi integral çdo të tretin vit shkollor, siç parashihet në nenin 20 të Ligjit. Arsyet për këtë gjendje janë pandemia e Covid-19 në periudhën e mëparshme, si dhe mungesa e burimeve njerëzore, e

shkaktuar nga largimi i vazhdueshëm i inspektorëve të arsimit për shkak të daljes në pension ose arsyeve të tjera. Kjo gjendje ndikon në organizimin dhe realizimin e mësimit, kushtet në institucionet edukativo-arsimore, si dhe në përmbushjen dhe vlerësimin e detyrave të punës së mësimeve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë.

NUMRI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE - EDUKATIV



VLERËSIMET INTEGRALE TË REALIZUARA NË PERIUDHËN 2021 - 2023

Edhe pse në periudhën nga viti 2021 deri në vitin 2023, numri i vlerësimeve integrale të realizuara shënon rritje të lehtë, ende nuk është i mjaftueshëm për mbulimin e plotë të shkollave siç parashihet me rregullativën ligjore.

Theksojmë se Inspektorati Shtetëror i Arsimit përballet edhe me kushte joadekuate të punës, mungesë të softuerëve dhe pajisjeve moderne të TI-së (harduer dhe softuer), si dhe automjeteve zyrtare të nevojshme për t'i kryer aktivitetet në terren.



KUSHTET PËR PUNËN E INSPEKSIONIT ARSIMOR

5.2.10.2.

INSPEKTORATI SHTETËROR PËR INSPEKSIONIN TEKNIK

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e përputhshmërisë së Inspektoratit Shtetëror për Inspeksionin Teknik për vitin 2023 (ISHIT).


Revizioni i kryer i konstatoi gjendjet e mëposhtme:

- /// dobësi në mënyrën e zbatimit të regjistrimit të mjeteve dhe harmonizimit të pakryer të gjendjes së kontabilitetit me gjendjen faktike;
- /// lëndët për të cilat realizohen të ardhurat në përputhje me ligjin nuk janë anuluar siç duhet dhe nuk janë plotësisht të arritshme;
- /// planifikimi i mbikëqyrjeve kryhet pa mënyrën përkatëse të vlerësimit të rrezikut në përputhje me rregullativat;



- /// dobësi dhe parregullsi në mënyrën e zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese, zbatimin e duhur të ligjeve, akteve nënligjore dhe akteve të tjera të përgjithshme në pjesën e kryerjes së punëve gjatë shfrytëzimit të lëndëve të para minerale dhe kërkimeve të hollësishme gjeologjike.

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizionin e suksesit me temë: **"Efikasiteti i procedurave për dhënien e së drejtës për shfrytëzimin e lëndëve të para minerale dhe realizimin e kontratave të lidhura, me referencë të veçantë mermerin"** të lëshuar në vitin 2024. Raporti, ndër të tjera, nxjerr në pah dhe konstaton gjendjet që lidhen me punën dhe kompetencën e ISHIT-së, kryesisht në mënyrën se si kryhet mbikëqyrja inspektuese, të cilën gjendje me revizionin e kryer konstatoam se nuk është tejkaluar.



NUMRI TOTAL I MBIQËQYRJEVE TË KRYERA INSPEKTUESE MBI SHFRYTËZIMIN E LËNDËVE TË PARA MINERALE DHE PAJISJEVE TEKNIKE NË PERIUDHËN 2020 - 2023

Të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm tregojnë se ISHIT-ja kryen numrin më të madh të mbikëqyrjeve inspektuese të rregullta.

Sektori i Mbiqëqyrjes së Shfrytëzimit të Lëndëve të Para Minerale dhe Kërkimeve të Hollësishtme Gjeologjike, nga 130 vendimet e lëshuara me parregullsi të konstatuara në periudhën nga viti 2020 deri në vitin 2023, ka kryer vetëm 44 mbikëqyrje kontrolluese ose vetëm 34%.

Sektori i Mbiqëqyrjes së Pajisjeve Teknike, nga 46 vendimet e lëshuara me parregullsi të konstatuara në periudhën nga viti 2020 deri në vitin 2023, ka kryer vetëm 14 mbikëqyrje kontrolluese ose 30%.

Për vitet 2020, 2021 dhe 2022, revizionit nuk i janë prezantuar lëndët me mbikëqyrje të kryera kontrolluese. Këto gjendje nuk janë në përputhje me Ligjin për mbikëqyrjen inspektuese, sipas të cilit mbikëqyrja inspektuese e kontrollit duhet të kryhet me qëllim që të kontrollohet nëse subjektet kanë vepruar sipas aktit - vendimit të miratuar të inspeksionit, plotësisht, pjesërisht apo nuk kanë vepruar dhe përbëjnë bazë për masë inspektuese në përputhje me ligjin dhe nuk janë në funksion të përmirësimit të parregullsive të konstatuara nga inspektorati.

Në përputhje me Ligjin për lëndët e para minerale, për shfrytëzimin e duhur të lëndëve të para minerale, koncesionari është i detyruar të kryejë incizim gjeodezik ose matje minerare një herë në vit në periudhën nga 15 shtatori deri më 15 dhjetor të vitit aktual dhe të hartojë elaborat gjeodezik me llogaritjen e sasive të nxjerra të lëndëve të para minerale, në të cilin do të përcaktohen saktësisht sasi të sasishë së nxjerrë të lëndëve të para minerale. Koncesionari më së voni deri më 31 janar të vitit aktual për vitin paraprak, elaboratin gjeodezik duhet ta dorëzojë në Ministrinë e Ekonomisë²⁴ dhe ISHIT.

Konstatuam se ISHIT-ja nuk mban evidencë dhe as nuk ka ndërmarrë masa për t'u koordinuar me Ministrinë e Ekonomisë për të ndërmarrë aktivitete konkrete (dërgimin e vërejtjeve) ndaj koncesionarëve që nuk kanë dorëzuar elaborate gjeodezike, përveç kur në rastin e mbikëqyrjes inspektuese përcaktohet se tregtari/subjekti nuk ka dorëzuar, atëherë inspektori ia shqipton gjobën.

Në përputhje me Ligjin për lëndët e para minerale, moskryerja e matjeve gjeodezike dhe mosdorëzimi i njoftimit brenda afatit dhe mënyrës së lartpërmendur përbën kundërvajtjen për të cilën shqiptohet gjobë. Gjendja e lartpërmendur ndikon në cilësinë dhe mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese dhe kontrollit mbi shfrytëzimin e lëndëve të para minerale, si dhe në mjetet e arkëtuara në bazë të gjobave në Buxhet.



²⁴ Ministrinë e Ekonomisë dhe Punës, - Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore, i miratuar në qershor 2024.

Me miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore të miratuar në qershor 2024, ISHIT-ja duhet të vazhdojë të funksionojë si organ brenda Ministrisë së Energjetikës, Minierave dhe Lëndëve të Para Minerale.

Në pjesën Theksimi i Çështjeve njoftojmë për mungesën e punonjësve në Departamentet brenda Sektorëve të Mbikëqyrjes Inspektuese për shkak të daljes në pension dhe largimit nga vendi i punës, gjë që mund të ndikojë në realizimin cilësor të kompetencës së ISHIT-së.

5.2.10.3.

KOMISIONI PËR LETRA ME VLERË

Realizuar revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Komisionit për Letra me Vlerë për vitin 2023, gjatë të cilit kemi konstatuar gjendje të caktuara, si në vijim:

Gjendjet që lidhen me respektimin konsekuent të orarit të punës, ndërkohë që nuk është dorëzuar dokumentacioni për t'i justifikuar mungesat, ndërsa për dispozitat e Marrëveshjes Kolektive në nivel të punëdhënësit që e rregullojnë punën në distancë nuk është prezantuar dhe miratuar akti.

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me ç'rast në pjesën e çështjeve të tjera e kemi theksuar nevojën për rregullimin me ligj të rrogës dhe kompensimit të kryetarit dhe komisionerëve (anëtarëve) të Komisionit për Letra me Vlerë. Pra, në Ligjin për letrat me vlerë rregullohet se lidhur me ushtrimin e të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës së kryetarit dhe komisionerëve (anëtarëve)

të Komisionit zbatohet Ligji për marrëdhënie pune, pa u saktësuar mënyra e llogaritjes së rrogave të komisionerëve që e ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë profesionale.

Është miratuar Vendimi për përcaktimin e vlerës dhe lartësisë së pikave për pozicionet e punës në Komision, i cili parashikon që punonjësit në vendet e punës në të njëjtin nivel të mund të kenë pika të ndryshme. Me vendimin e lartpërmendur, as me akt tjetër nuk është dhënë arsytimi për llojin, kompleksitetin, vëllimin dhe përgjegjësinë e punëve për vendet e punës brenda të njëjtit nivel, si rezultat i të cilave janë përcaktuar pikat e ndryshme për të njëjtat nivele të vendeve të punës. Për shkak të gjendjeve të lartpërmendura, theksojmë nevojën që rroga e punonjësve në Komisionin për Letra me Vlerë të rregullohet me ligj ose me Marrëveshje Kolektive me saktësimin e llojit, kompleksitetit, vëllimit dhe përgjegjësisë së punëve për vendet e punës brenda të njëjtit nivel.



5.2.11

EKONOMIA

5.2.11.1.

AGJENCIA PËR PROMOVIMIN DHE MBËSHTETJEN E TURIZMIT



Agjencia për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit në Republikën e Maqedonisë së Veriut është institucion i themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për t'i promovuar burimet turistike të vendit në tregjet e huaja, si dhe për t'i menaxhuar dhe mbështetur projektet që synojnë zhvillimin e turizmit në përgjithësi²⁵.

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare të Agjencisë për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit për vitin 2023, së bashku me revizionin e përputhshmërisë në të cilin konstatuam dobësi në:

- /// mënyrën e zbatimit të regjistrimit të mjeteve dhe detyrimeve dhe moskryerjen e harmonizimit të kontabilitetit me gjendjen faktike;
- /// mosvendosjen e evidencës materiale dhe të kontabilitetit për materialet promovuese të prokuruar dhe të lëshuara;
- /// mospërbushjen e qëllimeve dhe kompetencave të Këshillit në drejtim të dhënies së opinionit profesional dhe mbështetjes në hartimin e Programit Vjetor;
- /// zbatimin konsekuent të dispozitave të Ligjit për prokurime publike;
- /// në kuadër të projektit "ABOVE",²⁶ me buxhetin total prej 167.803 euro (85% financim nga BE-ja, 15% bashkëfinancim nacional), revizioni konstatoi se APMT-ja nuk ka siguruar dokumentacion dhe mjete në kohë për pagesën e të gjitha faturave para

afatit përfundimtar të projektit (31.12.2023), për arsye se nuk janë tërhequr të gjitha mjetet nga BE-ja, ndërsa detyrimet e mbetura në shumën prej 5.888 do të duhet të shlyhen nga buxheti i vet, gjë që do të ndikojë negativisht në gjendjen financiare të APMT-së, dhe

- /// janë evidentuar detyrimet për faturë për transmetimin e spoteve në televizion, pa dokumentacionin mbështetës përkatës.

Në pjesën Theksimi i Çështjeve, i konstatuam disa gjendje, përkatësisht:

- /// procedurat gjyqësore në të cilat APMT-ja është e paditur, që mund të ketë implikime financiare;
- /// përbushja jo e plotë e kompetencave të APMT-së, të përcaktuara me Ligjin për themelimin e APMT-së. Agjencia merr pjesë aktive në subvencionimin e qarkullimit të jashtëm turistik dhe në vitin 2023 realizoi 42 milion denarë për këtë dedikim. Megjithatë, nuk ndërmori aktivitete të mjaftueshme për t'i promovuar rajonet e pazhvilluara turistike, nuk analizon tregun vendas të turizmit, nuk ka sistem funksional të informacioneve turistike dhe ka bashkëpunim të dobët me vetëqeverisjet lokale. Mungesa e mjeteve dhe moskoordinimi midis institucioneve kontribuojnë në përputhjen e aktiviteteve dhe efikasitetin e pamjaftueshëm në turizëm

²⁵ Ligji për themelimin e Agjencisë për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit në Republikën e Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare" nr. 103/2008, 156/2010, 59/2012, 187/2013, 41/2014, 83/18 dhe 3/25)

²⁶ Përmes Programit të Bashkëpunimit Tejkufitar Interreg IPA CBC midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Greqisë 2014-2020, APMT-ja ka lidhur kontratë të donacionit për zbatimin e projektit ABOVE.

/// Dobësitë e konstatuara në zbatimin e kompetencave të APMT-së të përcaktuara me Ligjin për shtigjet malore, i cili rregullon kushtet për përdorimin, mirëmbajtjen dhe kategorizimin e tyre. APMT-ja ka më shumë kompetenca, duke përfshirë edhe propozimin e Rrjetit Nacional të Shtigjeve dhe mbajtjen e regjistrit. APMT-ja ka filluar aktivitetet për vendosjen e këtij rrjeti dhe është dorëzuar propozimi në institucionet kompetente, prej të cilave një pjesë kanë dhënë opinion pozitiv, ndërsa të tjerat nuk kanë dorëzuar përgjigje ose janë dorëzuar vërejtje. Për shkak të procedurës së papërfunduar dhe mungesës së elaborateve, detyrimet e APMT-së nuk janë realizuar. Në vitin 2021, MMJPH-së

ka filluar procedurë për ndryshimin e Ligjit, por deri më tani nuk është arritur zgjidhja konkrete.

/// Ligji për zonat zhvillimore turistike (i miratuar në vitin 2012) synon të stimulojë zhvillimin ekonomik nëpërmjet tërheqjes së investimeve në turizëm. APMT-ja është kompetente për themelimin, zhvillimin dhe ndjekjen e këtyre zonave, por zbatimi është i pamjaftueshëm. Janë miratuar vetëm tri vendime për themelimin e zonave, ku vetëm një (në Dojran) është bërë shpallja e konkursit për ankandin publik për tjetërsimin e tokës, por nuk kishte asnjë ofertë të parashtruar.



ZONA ZHVILLIMORE TURISTIKE SARAJ - LIQENI I TRESKËS (E FOTOGRAFUAR ME DRON)

/// Zona e Sarajit - Liqeni i Treskës ka hasur në pengesa ligjore dhe administrative, ndërsa Qeveria nuk ka dhënë udhëzime të mëtjshme. Mungesa e mjeteve financiare dhe kuadrit e pengon APMT-në në përmbushjen e kompetencave të saj, gjë që rrezikon realizimin e qëllimeve të ligjit - zhvillimin e turizmit, rritjen e konkurrueshmërisë dhe punësimin.

/// Ligji për autokampe rregullon themelimin, përdorimin dhe menaxhimin e autokampeve, me qëllim të zhvillimit të turizmit nëpërmjet tërheqjes së investimeve vendase dhe të huaja. Kompetencat për zbatimin e ligjit i takojnë APMT-së. Qeveria ka miratuar dy vendime për themelimin e autokampeve - në Komunën e Velesit dhe Komunën e Petrovecit. Dokumentacioni urbanistik është përgatitur për Velesin, por procedura për tjetërsimin e tokës nuk është filluar,

ndërsa i njëjti dokumentacion është duke u përgatitur për Petrovecin.

/// APMT-ja po përballet me probleme në zbatimin e ligjit, veçanërisht në lidhje me harmonizimin me Ligjin për tokën ndërtimore, përkufizimin e kompetencave, procedurën e ankandit publik dhe kategorizimin e autokampeve. Bazuar në këtë, Qeveria miratoi informacionin e dorëzuar nga APMT-ja dhe e ngarkoi Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve të formojë grup pune për ndryshimin e ligjit. Edhe pse grupi është formuar, deri më tani nuk janë ndërmarrë aktivitete konkrete. Këto gjendje e pengojnë përmbushjen e qëllimit të ligjit - zhvillimin e turizmit përmes autokampeve.



AUTOKAMPET NË LIQENIN E OHRIT

- /// për shkak të buxhetit të pamiruar nga ministria kompetente, Agjencia për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit nuk është në gjendje t'i shfrytëzojë mjetet që ka në llogarinë e saj, të ndara me Ligjin për lojërat e fatit dhe për lojërat argëtuese;
- /// nevoja për të futur digjitalizimin e procedurës së subvencionimit, për shkak të vështirësisë së ndjekjes dhe kontrollit nga ata që janë përgjegjës për kontrollin dhe nënshkrimin e dokumentacionit, si dhe ruajtjen e dokumentacionit.

Në pjesën që lidhet me dobësitë e kontrolleve të brendshme, njoftojmë për mungesën e procedurave të shkruara që do të përcaktojnë procesin e marrjes, miratimit, evidentimit dhe pagesës së dokumenteve financiare, mosvendosjen e kontrollit ex-ante dhe ex-post dhe sistemit të nënshkrimit të dyfishtë, mosvendosjen e revizionit të brendshëm dhe nevojën për të vendosur sistem përkatës të ndarjes së detyrave në procedurën administrative të shkallës së parë.




5.2.11.2.

SHOQËRIA E TURIZMIT, HOTELIERISË,
REKREACIONIT DHE SPORTIT "ELEM TURS"
SHPKNJP SHKUP

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Shoqërisë së Turizmit, Hotelierisë, Rekreacionit dhe Sportit ELEM TURS SHPKNJ Shkup, për vitin 2023.

Raporti i revizorit njofton për gjendjen e pavoritshme financiare në të cilën ndodhet shoqëria që nga themelimi i saj në vitin 2012, me ç'rast vazhdimisht **realizon humbje nga puna dhe ajo e akumuluar deri në vitin 2023 është 1.196.650 mijë denarë dhe paraqet 92% të kryegjësë themelore.**



Edhe pse në vitin 2023 u raportua humbja më e vogël në gjashtë vitet e fundit, e cila është për shkak të ndryshimeve statusore në shoqëri dhe aktivitetit të saj të zvogëluar, përsëri shoqëria vazhdimisht raporton rezultat financiar negativ nga puna, nuk është likuide dhe është në gjendje të dobët financiare. Për të vazhduar kryerjen e veprimtarisë së saj dhe shlyerjen e detyrimeve në mënyrë të vazhdueshme, lidh kontrata me themeluesin për marrjen e borxhit. Për këtë qëllim, në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2023 (me përjashtim të vitit 2020), kontrata trepalëshe për marrjen e borxhit ishin lidhur vazhdimisht midis SHA ESM Shkup (marrësi i borxhit), ELEM TURS SHPKNJ Shkup (debitori) dhe kreditorëve konkretë, me shumën më

të lartë prej 180.902 mijë denarë që arriti në vitin 2023. Detyrimet e deklaruar për kthimin e borxhit ndaj themeluesit janë vazhdimisht në rritje dhe në vitin 2023 është 268.382 mijë denarë.

Në gusht të vitit 2022, ELEM TURS SHPKNJ Shkup lidhi kontratë me subjektin juridik - shoqëria e menaxhimit nga Shkupi për prokurimin e shërbimeve të outsorsingut në shumën totale prej 20.000 mijë denarë me kohëzgjatje deri në fund të vitit 2022. Subjekti juridik u themelua menjëherë para lidhjes së kontratës, ndërsa kontrata kishte vlefshmëri retroaktive prej dy muaj. Revizioni i kryer konstatoi se zbatimi i kontratës vazhdoi në vitin 2023 dhe u paguan gjithsej 34.052 mijë

denarë, **që paraqet tejkalim prej 70% të vlerës së kontratës.** Në të njëjtën kohë, analiza e kryer e numrit të realizuesve të angazhuar sipas kontratës së autorsingut, aktiviteteteve të tyre të punës dhe numrit të personave të punësuar rregullisht në Filialin e Kodrës së Diellit, krahasuar me shumën e ulët të të ardhurave të realizuara nga kapacitetet e akomodimit në periudhën maj - shtator 2023, nuk mundësoi siguri në lidhje me nevojën dhe justifikimin për angazhimin e realizuesve të jashtëm gjatë asaj periudhe, gjë që ndikon në shpenzimin racional dhe ekonomik të mjeteve publike.

Revizioni i kryer konstatoi se ELEM TURS SHPKNJ Shkup ka objekte dhe pajisje ndërtimore në shumën prej 284.377 mijë denarë, të cilat për shkak të kryerjes së veprimtarisë janë të ekspozuara ndaj rreziqeve dhe për to personi përgjegjës nuk ka zbatuar procedurë për sigurimin e pronës dhe mjeteve të shoqërisë nga vjedhjet, zjarri dhe fatkeqësitë e tjera natyrore, të cilat mund të shkaktojnë dëme në pronën dhe mjetet e shoqërisë në rast të ndodhjes së rreziqeve.

Që nga viti 2018, në ELEM TURS SHPKNJ Shkup filloi realizimi i projektit "Shujta e Ftohtë", me të cilin punonjësit e SHA ESM Filiali KEM Manastir furnizohen me shujtë. Mbi këtë bazë, shoqëria, vetëm në dy muajt e parë të vitit 2023, realizoi të ardhura nga SHA ESM Shkup në shumën prej 11.217 mijë denarë (36% e të ardhurave totale të realizuara të shoqërisë). Për realizimin e këtij projekti,

vazhdimisht janë prokuruar mallra pa procedurë të zbatuar më parë për ndarjen e kontratës për prokurimin publik, **gjë që nuk është në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe mund të ndikojë në shfrytëzimin ekonomik, efikas dhe efektiv të mjeteve publike.**

Inspektimi i kryer në terren i kapaciteteve ekzistuese të akomodimit të Hotelit "Molika" - Manastir, Hotelit "Kodra e Diellit" - Tetovë, Hotelit "Sllavia" - Tetovë, Pushimores "Shën Stefani" - Ohër, Pushimores "Mavrovë" - Mavrovi Anovi dhe Autokampit "Livadhishtë" - Strugë konstatoi se, me përjashtim të Hotelit "Molika" - Manastir, **ato janë të vjetruara dhe në pjesën më të madhe nuk i ofrojnë kushtet teknike minimale për akomodim.** Kapaciteti i akomodimit në Pushimoren "Shën Stefani" - Ohër nuk mund të shfrytëzohet për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike, ndërsa po rrjedhë procesi i rinovimit të kapaciteteve të akomodimit dhe të hotelierisë në Autokampin "Livadhishtë" - Strugë. Prandaj, për shfrytëzim më të madh të kapaciteteve ekzistuese, nevojitet një analizë gjithëpërfshirëse e gjendjeve, investime që do të rrisin atraktivitetin e tyre, do të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve dhe do të mundësojnë arritjen e standardeve në fushën e turizmit.



HOTEL SLLAVIJA TETOVË



PUSHIMORE SHËN STEFANI - OHËR



PUSHIMORJA "MAVROVË" - MAVROVI ANOVI



AUTOKAMPI "LIVADHISHTË" - STRUGË



Gjatë tetorit dhe nëntorit 2022, bazuar në miratimin paraprak dhe vendimin e BM-së së SHA ESM - Shkup, BD-ja e themeluesit miratoi vendim për themelimin e dy shoqërive të reja:

- /// Shoqëria e Turizmit, Hotelierisë, Rekreacionit dhe Sportit ESM MOLIKA SHPKNJ - Manastir dhe
- /// Shoqëria e Turizmit, Hotelierisë, Rekreacionit dhe Sportit QENDRA E SKIJIMIT KODRA E DIELLIT SHPKNJ - Tetovë.

Ristrukturimi i shoqërisë u ndoq me dobësi të caktuara. Pra, sendet e patundshme u transferuan te shoqëritë e reja, por ky nuk ishte rast edhe me sendet e tundshme, vlera e kontabilitetit e të cilave është 190.735 euro, vlerësimi i pasiguaruar i vlerës

së tyre nga vlerësuesi i autorizuar. Në mënyrë plotësuese, gjatë transferimit të punonjësve nga filiali i Kodrës së Diellit dhe Molikës te shoqëritë e sapothemeluara, ristrukturimi u trajtua në mënyra të ndryshme, gjë që çoi në iniciimin e procedurave gjyqësore.

Revizioni i kryer konstatoi edhe gjendje të tjera që lidhen me regjistrimin e kryer, pagesa pa dokumentacion mbështetës, evidentim joadekuatë dhe parregullsi e mospërputhje të tjera të natyrave të ndryshme që tregojnë shfrytëzimin dhe veprimin joadekuatë të mjeteve publike dhe moskryerjen e veprimtarisë për të cilën është themeluar shoqëria

5.2.12

BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE EKONOMIA E UJËRAVE

5.2.12.1.

DREJTORIA E PUNËVE HIDROMETEOROLOGJIKE



Revizioni i kryer i raporteve financiare, së bashku me revizionin e përputhshmërisë së Drejtorisë së Punëve Hidrometeorologjike (DPHM) për vitin 2023 konstatoi gjendje, parregullsi dhe mospërputhje që ndikojnë në opinionet e lëshuara nga revizori i autorizuar shtetëror mbi realitetin dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe harmonizimin me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Konstatuam parregullsi në pjesën e mënyrës së zbatimit të regjistrimit, përkatësisht:

- /// u përcaktua se toka ishte evidentuar vetëm në një vendndodhje me vlerën prej 782 mijë denarë, ndërsa në 18 vendndodhje të tjera nuk ishte evidentuar dhe vlerësuar;
- /// katër objekte ndërtimore nuk janë evidentuar për shkak të statusit të pazgjidhur juridik të objekteve të ndërtuara pa leje;
- /// ekziston mosharmonizimi midis evidencës financiare dhe materiale të mjeteve ekzistuese në shumën prej 16.229 mijë denarë, për shkak të evidentimit dhe harmonizimit të parregullt të të dhënave;
- /// në mënyrë plotësuese, nga dymbëdhjetë mjetet motorike të shfrytëzuara nga DPHM-ja, nëntë nuk janë evidentuar në evidencën materiale dhe të kontabilitetit, gjë që tregon lëshime në evidencën e pronës dhe

Me revizionin e kryer konstatuam se për shkak të evidentimit të papërditësuar dhe të pasaktë të prokurimeve dhe lëshimit të materialeve, si dhe evidentimit të gabuar të mjeteve ekzistuese si teprica, ekziston dallimi prej 5.901 mijë denarë midis evidencës financiare dhe materiale të tepricave të materialeve dhe pjesëve rezervë, të cilat vlerësohen

në 1.978 mijë denarë. Komisioni i Regjistrimit më 31 dhjetor 2023 nuk i konstatoi këto dallime.

DPHM-ja deri në ditën e revizionit nuk kishte vepruar sipas vendimit të Qeverisë, me të cilin më 25 nëntor 2022 ishte miratuar shitja e njëmbëdhjetë automjeteve të vjetëruara. Automjetet ende nuk janë shitur, as nuk janë evidentuar në kontabilitetin e DPHM-së, ndërsa mosveprimi i tillë sipas vendimit të Qeverisë rezulton me mungesë të të hyrave në Buxhetin e Shtetit.

Revizioni konstatoi rënie të ndjeshme të numrit të punonjësve nga viti 2019 deri në mars 2024, me 69 vende pune të zbratura dhe vetëm 60% të themelimit të marrëdhënieve të punës nga punësimet e miratuara nga Ministria e Financave. Mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara dhe dalja në pension e punonjësve, të cilët përbëjnë 70% të daljes së punonjësve, ndikojnë në këtë gjendje dhe në ushtrimin e veprimtarisë së DPHM-së. Mosha mesatare e punonjësve është rritur nga 51 në 53 vjeç, ndërsa numri i pamjaftueshëm i burimeve njerëzore mund të ndikojë në cilësinë e ushtrimit të veprimtarisë themelore të DPHM-së në të ardhmen.

Nga inspektimi i kryer i stacioneve meteorologjike në vend dhe analizat e kryera, konstatuam se nga gjithsej 19 stacionet meteorologjike, tri janë jofunksionale, ndërsa ekziston rreziku i mbylljes së katër të tjerave për shkak të daljes në pension të punonjësve. DPHM-ja do të funksionojë me dy të tretat e kapaciteteve të tij, që në pjesën më të madhe janë të parregulluara dhe jofunksionale, me ç'rast të dhënat do të ofrohen kryesisht përmes stacioneve automatike, të cilat ofrojnë informacione meteorologjike themelore, por jo edhe informacione meteorologjike shtesë.



STACIONI METEOROLOGJIK MANUAL DHE AUTOMATIK

Në llogarinë buxhetore nga aktivitetet me vetëfinancim, si çështje kryesore u theksua se dispozitat ligjore janë të pasakta, jokonsistente dhe krijojnë pasiguri në llogaritjen dhe realizimin e të ardhurave të DPHM-së në të ardhmen. Nevojiten ndryshime dhe plotësime të paanulueshme në Ligjin për veprimtarinë hidrometeorologjike për të siguruar mjete të mjaftueshme financiare për modernizimin e pajisjeve. Edhe pse DPHM-ja i arkëton shërbimet sipas listës tarifore të vitit 2009, përpjekja për ta përditësuar në vitin 2015 ishte e pasuksesshme. Në 14 vitet e fundit, lista tarifore nuk ka ndryshuar dhe nuk është në përputhje me çmimet reale të shërbimeve në treg dhe lëvizjet inflatore.

Konstatuam se në periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2019, nuk është ofruar mbrojtja nga breshëri, prandaj subjektet juridike dhe personat fizikë të cilët merren kryesisht me bujqësi dhe pemëtari janë të ekspozuar ndaj rreziqeve dhe dëmeve shtesë mbi këtë bazë.

Në vitin 2019, futet metoda e re e mbjelljes së reve me avion për mbrojtje, e cila metodë u aplikua në vitet 2021 dhe 2022, por nuk u realizua në vitet 2023 dhe 2024, sepse në procedurat e prokurimeve publike nuk ishte paraqitur asnjë operator ekonomik.

Gjatë vitit 2023, janë paguar 50.718 mijë denarë për kompensimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore.

Për të tejkaluar gjendjen e lartpërmendur dhe për të zvogëluar rrezikun në nivel të pranueshëm, revizioni nxjerr në pah praktikën e vendeve fqinje që shfrytëzojnë metoda të ndryshme të mbrojtjes, duke përfshirë sisteme të kombinuara dhe dronë, të cilat mund të jenë shembull për veprim nga DPHM-ja.

5.2.12.2.

NP "PYJET NACIONALE" P.P. – SHKUP




Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Ndërmarrjes Publike për Ekonomizimin e Pyjeve Shtetërore "Pyjet Nacionale" p.p. - Shkup, për vitin 2023, ku kemi konstatuar gjendjet, më të rëndësishmet prej të cilave janë:

- /// Mjetet biologjike nuk vlerësohen sipas vlerës së tyre objektive, përkatësisht nuk zvogëlohen ose zhvlerësohen për sipërfaqet që ndodhen brenda kufijve të Parkut Nacional të Sharrit dhe të rregulluara me plane të veçanta ekonomike pyjore, si dhe sipërfaqet e prekura nga zjarret pyjore në të cilat fondi pyjor është shkatërruar plotësisht;
- /// Ndërmarrja publike, bazuar në raportet mujore mbi drurin e prerë, ndan mjete për riprodhim të thjeshtë dhe të zgjeruar. Në fund të vitit 2023, ka deklaruar detyrime ndaj Buxhetit të Shtetit për riprodhim të zgjeruar në shumën prej 450.844 mijë denarë dhe detyrime ndaj llogarisë së veçantë për riprodhim të thjeshtë (nuk është hapur) në

shumën prej 250.186 mijë denarë, ndërsa kërkon 164.275 mijë denarë nga shteti, bazuar në pjesëmarrjen në aksionin "Dita e Drurit". Duke marrë parasysh gjendjen financiare dhe likuiditetin e zvogëluar të ndërmarrjes, dhe në përputhje me kornizën dhe kërkesat e SNK-së, nuk i është qasur rentabilitetit të këtyre kërkesave me një pjesë të detyrimeve, gjë që do ta zvogëlonte borxhin ndaj shtetit në 286.569 mijë denarë;

- /// Duke marrë parasysh strukturën e moshës së kërkesave nga punonjësit mbi baza të ndryshme: sasi të pakta të përcaktuara të drunjve teknikë dhe drunjve për ngrohje, avanset e papaguara, qarkullimi i papaguar ditor nga shitja, përdorimi i shërbimeve hotelierike, etj.), nga të cilat 95% kanë të bëjnë me periudhën para vitit 2018, për shkak të mosndërmarrjes së masave për arkëtimin e tyre dhe afatit të përgjithshëm të parashkrimit, ekziston pasiguri e madhe rreth arkëtimin të 36.460 mijë denarë.



STRUKTURA E MOSHËS SË KËRKESAVE TË PUNONJËSVE

/// Për depozitimet e investimeve në shumën prej 2.226 mijë denarë, të cilat burojnë nga vitet e kaluara dhe kanë të bëjnë me objektet e investimeve në filialet "Biglla" Demir Hisar dhe "Lumi Ravna" Pehçevë,

nuk është siguruar dokumentacioni i besueshëm, nuk është konstatuar gjendja faktike, përkatësisht nuk është bërë vlerësimi për arsyeshmërinë e vazhdimit të investimeve;

"LUMI RAVNA" PEHÇEVË



/// Edhe pse në vitin 2024 janë ndërtuar dhe janë në përdorim 7 serra me lëndë plastike në vlerën prej 12.785 mijë denarë, nuk janë evidentuar siç duhet në kontabilitet dhe për to nuk llogaritet amortizimi, ndërsa lënda e parë e blerë torfe në vlerën prej 1.452 mijë denarë nuk është klasifikuar siç duhet si tepricë e lëndës së parë;

/// Mjetet financiare afatgjata prej 7.374 mijë denarë kanë të bëjnë me mjetet e investuara në themelimin e dy shoqërive shoqëruese që u ndanë nga ndërmarrja publike në vitin 2005. Shoqëria për Prodhimet e Sharrës dhe Përpunimin e Drunjve nuk ekziston në Regjistrin Tregtar që nga viti 2020, ndërsa Shoqëria për Kultivimin dhe Prodhimin e Peshqve, pas ndarjes së saj nga ndërmarrja publike, ka pësuar transformime, përkatësisht pjesa e investimit është transferuar, emri i shoqërisë ka ndryshuar dhe ajo është në posedim të një personi tjetër juridik. NP

"Pyjet Nacionale" p.p. - Shkup, në arkivin e vet nuk i ka shkresat e asaj procedure, por pas inspektimit të regjistrit të AKP-së, ndryshimi i pronës së patundshme është regjistruar në vitin 2016, me të drejtën e pronësisë në IL numër 243 të PK 375/1 për KK Klenoec Kërçovë;

/// Në kundërshtim me dispozitat e kontratave të punës, nga totali prej 355 punonjës në kohë të pacaktuar, 73%, përkatësisht 259 punonjës, të cilët janë të punësuar në vendet e punës, si prerës druri, transportues druri, renditës druri dhe punëtorë pyjesh, kryejnë punë administrative dhe detyra pune në drejtori ose filial;

/// Në vitin 2023, në Filialin "Pylltaria" Shën Nikollë, me kërkesë të udhëheqësit të filialit dhe autorizimit të dhënë, është lidhur kontratë për shitblerjen e sortimenteve të drurit në trungje në shumën prej 2.561 mijë denarë me TVSH, për dru dushku

për ngrohje, në mënyrë jotransparente pa kriteret e përcaktuara për zgjedhjen e personit juridik, as nuk është kërkuar dokumentacioni që duhet të posedojë për kryerjen e punëve kulturore pyjore dhe verifikimin e tij, që do të thotë devijim nga procedura standarde, me rrezikun e lidhjes së kontratave me subjektet që nuk kanë kapacitetet, njohuritë ose profesionalizmin përkatës për ekonomizimin dhe shfrytëzimin e duhur dhe efikas të burimeve pyjore;

- /// Treguesit financiarë për vitin 2023, detyrimet totale prej 1.074.644 mijë denarë, varësia e vazhdueshme nga kredia afatshkurtër revolving për pagesën e rrogave, tregojnë rrezik të shtuar të likuiditetit të zvogëluar të ndërmarrjes, prandaj është i domosdoshëm plani për stabilitetin financiar, vlerësimi i rreziqeve të likuiditetit, afati kohor për shlyerjen e detyrimeve, zvogëlimi i varësisë nga huamarrjet afatshkurtra, si dhe arkëtimi prioritar i kërkesave dhe optimizimi i shpenzimeve, me qëllim të sigurimit të stabilitetit afatgjatë dhe qëndrueshmërisë së punës së ndërmarrjes publike.

- /// Edhe pse sistemi elektronik për ndjekjen e masës drusore, i prokuruar në shumën prej 32.518 mijë denarë dhe mirëmbajtja mujore aktuale prej 167 mijë denarë, është vënë në përdorim që nga viti 2017 dhe teknikisht është instaluar në platformën e Telekomit të Maqedonisë SHA Shkup, me qasjen VPN të siguruar për NP "Pyjet Nacionale" p.p. - Shkup, ai nuk përdoret në praktikë nga subjektet (Inspektorati Shtetëror për Pylltari dhe Gjueti dhe Policia Pyjore), as nuk janë zbatuar të gjitha fazat e ndjekjes së masës drusore, gjë që e kufizon mundësinë e kontrollit, ndjekshmërisë dhe transparencës në menaxhimin e masës drusore - nga prerja e drurëve deri në shitjen përfundimtare.

Revizioni njoftoi edhe për mbrojtjen e pamjaftueshme të pyjeve (ndërmarrjen e aktiviteteve të duhura për të parandaluar dhe menaxhuar rreziqet e paraqitjes së zjarreve në pyje) dhe dobësitë sistematike në përballjen me rreziqet e sëmundjeve, zjarreve dhe prerjes së paligjshme të pyjeve, realizimin e pjesshëm dhe efikasitetin e kufizuar në shfrytëzimin e mjeteve nga Programi për Riprodhimin e Zgjerruar të Pyjeve për vitin 2023.

PYE ME PISHA TË SHKATËRRUARA



LUMI I GARDENIT

KARASLARI



PYJET E DJEGURA




DELLÇEVË

BEROVË



Devijimi i ndjeshëm i realizimit të planit për prodhimin e drunjve teknikë dhe drunjve për ngrohje, si dhe planit financiar për të ardhurat nga shitja e drunjve teknikë dhe drunjve për ngrohje, lidhen përgjithësisht me mekanizimin e

pamjaftueshëm dhe të vjetëruar, numrin e kufizuar të personelit profesional dhe teknik, transparencën e kufizuar të komplekseve pyjore, si dhe largësinë e terrenit.



PLANI I REALIZUAR I PRODHIMIT TË SORTIMENTEVE TË DRURIT NË M3 PËR PERIUdhËN 2014-2023

Në mënyrë plotësuese, ndërmarrja me burimet e veta kryen vetëm 42,45% të fazës së prerjes së drunjve, 34,04% të shpërndarjes dhe 32,13% të fazës së transportit, që do të thotë se mbi 50% e procesit të prodhimit varet nga angazhimi i realizuesve të jashtëm.

Gjendjet e lartpërmendura tregojnë nevojën për të ndërmarrë masa dhe aktivitete bazuar në rekomandimet e dhëna për t'i tejkaluar arsyet e konstatuara për gjendjen e theksuar të ndërmarrjes publike, për të përgatitur plan përkatës të biznesit për konsolidimin e ndërmarrjes publike dhe për të futur lloje të reja të aktiviteteve / produkteve të gatshme, të cilat do të tejkalojnë gjendjen e prerjes së vetme tradicionale të drunjve teknike dhe drunjve për ngrohje.



5.2.13.

SISTEMI SHËNDETËSOR

5.2.13.1.

FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023, gjatë të cilit konstatuam më shumë gjendje.



Dobësitë në funksionimin e **sistemit të TI-së** së Fondit për shkak të mungesës së strategjisë së TI-së, mungesës së kuarit të TI-së, strukturës së vjetëruar të serverëve dhe sigurisë së pamjaftueshme të sistemit të TI-së rezultuan me sulm kibernetik në shkurt 2023, i cili çoi në ndërprerjen e funksionimit të të gjithë sistemit shëndetësor në vend.



Në procedurën për dërgimin e personave të siguruar për mjekim jashtë vendit ka më shumë dobësi dhe parregullsi, përkatësisht **nuk është siguruar mbrojtja juridike adekuate për kërkuesit dhe nuk është vendosur kontrolli dhe sistemi për ndjekjen e suksesit të mjekimit jashtë vendit**, për të cilin nga Fondi mbi këtë bazë janë paguar mjete në shumën prej **311.237 mijë denarë**.



Aktivitetet e kontrollit për kryerjen e shërbimeve shëndetësore në institucionet shëndetësore **nuk janë vendosur ose zbatuar në mënyrë të mjaftueshme, prandaj nuk sigurohet konfirmimi i plotë i faturave për shërbimet e kryera shëndetësore**. Mosekzistimi i sistemit të vetëm të integruar për lëshimin e udhëzimeve, raporteve mjekësore dhe llogaritjeve për shërbimet e kryera shëndetësore, të cilat janë bazë për përgatitjen e faturave/raporteve mujore, krijon rrezik për lëshime dhe gabime.




Për kërkesat për avanset e dhëna për mjekim jashtë vendit, të cilat përfundimisht më 2023 janë **300.292 mijë denarë**, nuk janë vendosur kontrole adekuate për konfirmimin e faturave nga spitalet e huaja dhe mbyllet në kohë të avanseve të dhëna, gjë që çon në rritjen e vazhdueshme të tyre.



Kontrollet e reja të inkomputuara sistematike në sistemin e TI-së së Fondit për **recetat e faturuara nga barnatoret** dhe mënyra manuale ekzistuese e kontrollit të recetave nga barnatoret nuk janë mjaftueshëm të plota dhe efikase, ndërsa **sistemi i e-Recetave nuk është vendosur ende**.

U konstatuan edhe më shumë dobësi në pozicionet e paraqitura në Bilancin e gjendjes. Pra, **statusi juridik pronësor i një pjese të objekteve ndërtimore dhe tokës ende nuk është rregulluar, vlera e pronës së patundshme nuk është përcaktuar plotësisht dhe ajo nuk është evidentuar plotësisht në librat e punës**. Detyrimet ndaj furnitorëve evidentohen **jo në kohë në librat e punës**, gjë që çon në paraqitjen joreale në raportet financiare.



Në pjesën Theksimi i Çështjeve të Pasigurisë, revizion zbulon:

- /// se mungojnë informacione të plota mbi kërkesat e bazuara në kontributin e papaguar të sigurimit shëndetësor, ndërsa arkëtimi i këtyre kërkesave që kanë ndodhur përfundimisht me vitin 2008 është i pasigurt;
- /// se ka pasiguri në lidhje me rezultatin përfundimtar të procedurave gjyqësore në të cilat Fondi paraqitet si palë e paditur dhe paditës;
- /// se çmimet referuese për shërbimet shëndetësore që bien në ngarkesë të Fondit nuk janë të përditësuara dhe nuk i pasqyrojnë shpenzimet reale;
- /// se kontributi për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor për qytetarët që nuk kanë sigurim shëndetësor për asnjë arsye nuk është paguar plotësisht nga Ministria e Shëndetësisë.

Në pjesën Çështjet Kryesore të Revizorit njoftohet mbi mënyrën e pagesës për shërbimet e kryera të institucioneve shëndetësore, duke treguar se nuk është siguruar blerja e vërtetë e shërbimeve të parashikuara me Ligjin për sigurim shëndetësor. Pra, Fondi në kuadër të buxhetit të përcaktuar, në vend që t'i kompensojë shërbimet e kryera shëndetësore, është i detyruar të sigurojë mjete për funksionimin e plotë të të gjitha institucioneve shëndetësore publike, me ç'rast 2/3, përkatësisht 77 institucione shëndetësore publike, kanë statusin e të paqëndrueshmeve, për shkak të realizimit të vëllimit dukshëm më të vogël të shërbimeve në krahasim me kompensimin e rënë dakord.

Në pjesën Çështjet e tjera, njoftojmë mbi Listën e Barnave në ngarkesë të Fondit, e cila nuk është përditësuar që nga viti 2014 në përputhje me metodologjinë e re, ndërsa në vitin 2024 u plotësua vetëm me 8 barna.

5.2.13.2.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË




Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e përputhshmërisë së llogarive 637, 787 dhe 786-72 të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2023, me ç'rast e konstatoi këtë si në vijim:

- /// nuk sigurohet pasqyra e plotë e gjendjes së mjeteve, detyrimeve dhe të ardhurave të pritura, gjë që ndikon në saktësinë e raporteve financiare të ministrisë;
- /// me buxhetin e vitit 2023 sigurohen mjetet në shumën prej 5.294.146 mijë denarë për realizimin e 23 programeve të mbrojtjes shëndetësore, të cilat nuk janë të mjaftueshme për t'i shlyer plotësisht të gjitha detyrimet ndaj ISHP-ve që i zbatojnë aktivitetet e programit, gjë që ndikon në likuiditetin e tyre. Në mënyrë plotësuese, konstatoam më shumë parregullsi në evidencat e vendosura, zbatimin dhe njoftimin për një pjesë të programeve individuale;

- /// për prokurimin e punimeve ndërtimore si fazë e dytë e projektit për ndërtimin e Spitalit të Përgjithshëm në Kërçovë, janë konstatuar gjendjet që kanë gjeneruar implikime të konsiderueshme financiare për vlerën e përgjithshme të objektit, anulimin afatgjatë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore me cilësi më të lartë për qytetarët e Kërçovës, si dhe rrezik të shpenzimeve shtesë në varësi të rezultatit të procedurës gjyqësore;



Gjendja e jashtme e objektit të pandërtuar të ISHP Spitali i Përgjithshëm në Kërçovë



/// në pjesën e realizimit të projektit për ndërtimin e qendrës së re klinike në Shkup dhe në Shtip, konstatuam se, megjithëse ai filloi në vitin 2015, aktivitetet ende nuk kanë përfunduar për shkak të Vendimit të miratuar për anulimin e komponentit për ndërtimin e Qendrës Klinike në Shkup dhe prolongimin e afateve dhe ndërprerjen e kontratës për ndërtimin e Qendrës Klinike në Shtip. Për shkak të së lartpërmendurës, bartësit e kontratave iniciuan procedurat e arbitrazhit për arkëtimin e kërkesave të dëmshpërblimit në shumën prej 45 milion euro. Nga ana tjetër, mjetet e miratuara sipas kontratës së huas në shumën prej 83.4 milion euro janë tërhequr.



Gjendja e jashtme e objektit të pandërtuar të Qendrës së re Klinike në Shtip

Pavarësisht nevojës së madhe të qytetarëve, objektet shëndetësore të pandërtuara kanë efekt negativ në arritjen e qëllimeve për shërbimet shëndetësore më të mira, racionale dhe efikase për qytetarët.

Në pjesën Theksimi i Çështjeve të Pasigurisë dhe Vazhdimësisë, revizioni zbuloi për:

/// punimet e papërfunduara ndërtimore të ISHP Spitali Special i Ortopedisë dhe Traumatologjisë Shën Erazmi - Ohër dhe ISHP Spitali i Përgjithshëm i Qytetit në Strumicë, të filluara në vitet 2015 dhe 2016. E theksuara është rezultat i prolongimit të afatit të punimeve, lidhjes së një numri të madh aneksesh për shkak të lëshimeve në dokumentacionet e projektit, rritjes së çmimeve të materialeve ndërtimore, si dhe padive të iniciuara para gjykatave



Gjendja e punimeve të papërfunduara ndërtimore në një sallë operacioni dhe bosht ashensori në objektin e ISHP Spitali Special i Ortopedisë dhe Traumatologjisë Shën Erazmi - Ohër, për shkak të të cilave nuk është kompletuar realizimi i punimeve ndërtimore.





Punimet e përfunduara ndërtimore dhe pajisja e instaluar në objektin e ISHP Spitali i Përgjithshëm në Strumicë, të cilat nuk përdoren, sepse objekti nuk është vënë në përdorim.

/// Për shkak të së lartpërmendurës, ndërtimi i objekteve gjeneroi implikime të konsiderueshme financiare për vlerën e përgjithshme të projekteve, ndërsa prolongimi i afatit për ndërtimin e objektit kontriboi në anulimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore me cilësi më të lartë për shfrytëzuesit për periudhë prej gati 10 vite;

/// mbulimi i pamjaftueshëm i popullsisë me vakcina, që lëviz prej 56,3% në 87,7%, veçanërisht i theksuar pas pandemisë në vitin 2020, si rezultat i mosbesimit të qytetarëve në sigurinë e vaksinave, si dhe anulimit në vaksinimin me vakcina të caktuara;

Në pjesën Çështjet Kryesore të Revizorit, njoftojmë për statusin, ekipimin e kuadrin, financimin dhe mënyrën e kryerjes së veprimtarisë së Njësisë për Zbatimin e Projektit për Ndërtimin e Qendrës së re Klinike në Shkup dhe në Shtip, si dhe për mjetet e pashfrytëzuara monetare në llogari në shumën prej 571.251 mijë denarë dhe sigurinë e shpenzimeve që do të duhet të mbulohen me to në periudhën e ardhshme.

5.2.13.3.

INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE (ISHP)



Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e përputhshmërisë së katër klinikave universitare në kompleksin e klinikave "Nënë Tereza" - Shkup për vitin 2023, përkatësisht: Klinikën e Dermatologjisë, Klinikën e Hematologjisë, Klinikën e Neurologjisë dhe Klinikën e Radioterapisë dhe Onkologjisë. Shprehëm gjithsej 16 opinione, nga të cilat 4 janë rezervë, 7 me rezervë, 4 janë opinione të pavolitshme dhe një është i përmbajtur nga dhënia e opinionit. Me revizionet e kryera e konstatuam këtë si në vijim:

- /// ISHP-të nuk kanë vendosur evidencë të kontabilitetit të rezervave të barnave për sëmundjet e rralla të prokuruar nga Ministria e Shëndetësisë në shumën prej 453.171 mijë denarë dhe të barnave të marra përmes donacioneve në shumën prej 161.169 mijë denarë. Në mënyrë plotësuese, konstatuam edhe rezerva të barnave për sëmundjet e rralla. Për shkak të të lartpërmendurës, nuk sigurohet menaxhimi i duhur dhe pasqyra e plotë e gjendjes së rezervave të ISHP-së;
- /// u konstatuan dobësi në planifikimin dhe realizimin e kompensimit të kushtëzuar për prokurimin e barnave, aparateve dhe shërbimeve të tjera specifike, i cili u miratua në shumën prej 178.938 mijë denarë. Pra, janë konstatuar dobësi në përgatitjen e planeve për llojin dhe vëllimin specifik të shërbimeve shëndetësore, ndërsa nevoja për pajisjet mjekësore, barnat dhe numri i pacientëve që do të mbulohen prej tyre nuk janë rezultat i propozimeve të dorëzuara nga kolegji profesional. Gjithashtu, ISHP-të nuk kanë

miratuar protokolle, as kritere zyrtare për mjekimin dhe rangimin e pacientëve që kanë nevojë për barna që prokurohen me kompensimin e kushtëzuar;

- /// prokurimet e materialeve laboratorike dhe punimeve ndërtimore dhe zejtare për të cilat gjatë vitit 2023 u ndërmorën angazhime në shumën prej 215.339 mijë denarë u zbatuan në mënyrën që e zvogëlon konkurrencën dhe krijon rrezik për shfrytëzimin joracional të mjeteve në procedurën e prokurimit publik;
- /// janë angazhuar infermiere, mjekë dhe punonjës të sportelit me kontratë në vepër, pa marrë pëlqimin nga Ministria e Financave.

Në pjesën Theksimi i Çështjeve të Pasigurisë, revizioni zbuloi për:

- /// mënyrën në të cilën realizohet kompensimi i kushtëzuar për prokurimin e barnave për trajtimin e sëmundjeve malinje në Klinikën e Radioterapisë dhe Onkologjisë, i cili, megjithëse në rritje të vazhdueshme, nuk është i mjaftueshëm për t'i përfshirë të gjithë pacientët të cilët, sipas indikacioneve mjekësore, mund ta marrin terapinë. Vetëm 24% e pacientëve që marrin terapinë në spitalin ditor janë të regjistruar në terapinë biologjike;
- /// pajisjen mjekësore në një pjesë të ISHP-së, që nuk është vënë në përdorim ose nuk përdoret plotësisht. Pra:
 - /// në Klinikën e Radioterapisë dhe Onkologjisë, akceleratori i prokuruar në vitin 2016 u instalua në vitin 2024, ndërsa pas kalimit të fazës së testimit, u vu në përdorim në vitin 2025. Akceleratori, i marrë përmes donacionit në vitin 2015, nuk është vënë në përdorim, po ruhet në magazinë dhe, për shkak të vjetërimit teknologjik, vënia e tij në përdorim është e pasigurt. Kjo klinikë zotëron

edhe një aparat për përgatitjen qendrore të terapisë citostatike me licencën softueri KATO, e cila nuk është vënë në përdorim, sepse nuk janë prokuruar të gjithë komponentët e domosdoshëm për funksionalitetin e saj, hapësira ku ndodhet nuk është përshtatur dhe mungojnë burimet njerëzore për të punuar me të;

- /// Klinika e Dermatologjisë ka dy aparate mjekësore – lazerë që nuk shfrytëzohen plotësisht. Aparatet mund të përdoren për të kryer shërbime me natyrë estetike dhe kozmetologjike që nuk mbulojnë nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, për ofrimin e të cilave janë kërkuar pëlqime nga Fondi dhe Ministria e Shëndetësisë, të cilat ende nuk janë dhënë.
- /// kërkesat e paarkëtuara nga Ministria për shërbimet e kryera shëndetësore në kuadër të programeve të mbrojtjes shëndetësore në shumën prej 397.081 mijë denarë, arkëtimi i të cilave është i pasigurt.

Në pjesën Çështjet Kryesore të Revizorit, njoftojmë për këtë si në vijim:

- /// nuk është siguruar blerja e vërtetë e shërbimeve shëndetësore për shkak të detyrimit ligjor të Fondit për të siguruar mjete për funksionimin e plotë të atyre ISHP-ve, të cilat për arsye të shumta nuk arrijnë të ofrojnë llojin dhe vëllimin përkatës të shërbimeve shëndetësore në lartësinë e kompensimit të rënë dakord dhe
- /// pothuajse të gjitha shërbimet shëndetësore në fushën e onkologjisë dhe radioterapisë ofrohen në Klinikën e Radioterapisë dhe Onkologjisë, megjithëse ka departamente onkologjike në më shumë qendra mjekësore në të gjithë vendin. Kjo Klinikë nuk ka numër të mjaftueshëm punonjësish shëndetësorë për të realizuar këtë vëllim shërbimesh, gjë që rezulton me mbingarkesë të kuadrit dhe ndikon në cilësinë e shërbimeve shëndetësore për qytetarët.



5.2.14

KULTURË DHE SPORT

5.2.14.1.

MINISTRIA E KULTURËS



Revizioni i kryer i raporteve financiare, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Ministrisë së Kulturës për vitin 2023, konstatoi gjendje, parregullsi dhe mosharmonizime që ndikojnë në opinionet e lëshuara.

Lidhur me fondin e evidentuar të Ministrisë, revizioni i kryer konstatoi se ai buron nga 17 projektet kapitale për botimin e librave të realizuara midis viteve 2009 dhe 2019, të vlerësuar në 408.123 mijë denarë dhe përfshin 686.318 ekzemplarë. Për shkak të mosekzistimit të planit të shpërndarjes së librave të botuar dhe të

pashpërndarë, krijohet problemi i rëndësishëm me vendosjen, i cili ndërlikohet më tej nga mungesa e interesit nga institucionet shtetërore për marrjen e librave për shkak të plotësisht të kapaciteteve të tyre. Gjithashtu, nuk është kryer regjistrimi për të përcaktuar gjendjen faktike, si në aspektin e numrit të librave, ashtu edhe në kushtet në të cilat ruhen, gjë që mund të çojë në dëmtimin dhe shkatërrimin e tyre.

gjendja në
31.12.2023

vlerësuar në vlerë prej
408.123 mijë denarë

fond librash, të shtypër në
periudhën e mëparshëm. pjesë
nga **17** projekte kapitale

nga **2009** deri **2019**

libra prej **686.318**
kopje

problem për **akomodim në kushtet adekuate**



nuk është kryer regjistrimi i fondit të librave

sipas revizioneve të kryera në vitin 2019, gjendet **nuk janë të ndryshuara**

librat ende janë në depo të IN dhe të njëjtit **nuk dorëzohen** te shfrytëzuesi i fundit ose te publiku i gjerë

nuk ka planë të përgatitur përgatitur për shpërndarjen e ekzemplarëve dhe kopjet e pa shpërndarë, gjegjësisht për qasjen tyre te publiku

rrezik nga hapësira e pasigurt dhe e paplotë dhe kushteve që mos të vinë deri te dëmtimi dhe mospërdorimi i tyre

Qeveria në disa raste ka miratuar Vendim për shmangie të përhershëm të një pjese nga këto sasive të më shumë institucione, institucione arsimorë dhe bibliotekat dhe **nuk ekziston** interes **as hapësirë** për pranim të sasisë shtesë!

Sa i përket zbatimit të prioritetëve për zhvillimin dhe avancimin e kulturës, është konstatuar se Strategjia Nacionale e fundit për Zhvillimin e Kulturës, e miratuar nga Kuvendi e mbulon periudhën 2018-2022, duke i lënë aktivitetet për vitin 2023, lëndë e revizionit aktual, pa udhëzime të qarta. Ministria nuk ka miratuar plan vjetor as për periudhën e mëparshme, as për vitin 2023, gjë që është vënë re në raportet e mëparshme të revizorit. Mungesa e strategjisë afatgjate për zhvillimin e kulturës çon në prioritetet e përcaktuara përgjithësisht dhe krijon sfida në planifikimin e aktiviteteve kulturore. Në dhjetor 2023, Qeveria miratoi Strategji të re Nacionale për Kulturën për periudhën 2023-2028, por ajo nuk është miratuar nga Kuvendi.


Revizioni konstatoi mangësi në shpërndarjen e mjeteve për projektet kulturore, i cili kryhet përmes Konkursit Vjetor në përputhje me Ligjin për kulturë. Pra, nuk ekzistojnë kualifikime të qarta për anëtarët e komisioneve të vlerësimit, prioritetet në konkurse janë shpesh të përgjithshme dhe nuk bazohen në politikat afatgjate, ndërsa kriteret për vlerësimin e projekteve nuk janë të përkufizuara në mënyrë strikte, gjë që krijon hapësirë për subjektivizëm, emërim jokompetent të anëtarëve dhe kategorizim të pasaktë. Këto mangësi çojnë në shpërndarjen e mjeteve me cilësi të pamjaftueshme, ndërsa komisionet vlerësojnë projektet pa udhëzime konkrete dhe pa kriteret për vlerësimin negativ të autorëve të pasuksesshëm.


TOTALI



Në vitin 2023, Ministria e Kulturës pagoi gjithsej 318.152 mijë denarë për projektet e miratuara për shfrytëzuesit e tjerë, gjë që nxjerr në pah nevojën urgjente për rregullat dhe kriteret e qarta në shpërndarjen e mjeteve. Pavarësisht prioritetit për reformat në këtë fushë, propozimi për ligj të ri, i cili mund ta përmirësojë sistemin, ende nuk është miratuar.

Pasqyra e detajuar e secilës veprimtari në fushën e kulturës të shfrytëzuesve të tjerë, duke përfshirë edhe numrin e projekteve dhe mjetet e paguara individualisht, është paraqitur në vizualizimin e mëposhtëm:





Në kuadër të Konkursit Vjetor për Financimin e Projekteve me Interes Nacional në Kulturë për vitin 2023, Ministria e Kulturës ka mbështetur 74 nga 185 aplikimet për projektet ndërdisiplinore, që është 40% e propozimeve, me pagesë totale prej 22.185 mijë denarë. Pavarësisht faktit se veprimtaria ndërdisiplinore nuk është përkufizuar formalisht në Ligjin për kulturë, Ministria vazhdon të financojë projekte jashtë kategorive të përcaktuara, gjë që krijon pabarazi. Për shkak të kontratave financiare që lejojnë financimin e më shumë se dy projekteve nga një person juridik, si dhe mungesës së dokumentimit dhe vlerësimit të plotë të ndryshimeve në kontratat, rrezikohet transparencja dhe drejtësia në shpërndarjen e mjeteve. Këto mangësi hapin hapësirë për parregullsi dhe favorizimin e projekteve të caktuara në aktivitetet ndërdisiplinore.

Janë konstatuar dobësi edhe në shpërndarjen e mjeteve për projektet me interes nacional, veçanërisht në bashkëpunimin kulturor ndërkombëtar, të cilat tregojnë mungesë transparence. Një pjesë e mjeteve të paguara për projektet nuk janë ndarë përmes konkurseve të rregullta, ndërsa disa subjekte juridike kanë marrë mbështetjen mbi limitin prej katër projekte, gjë që shkel respektimin e kushteve të konkursit.

Tetë projekte morën gjithsej 5.407 mijë denarë pa arsye objektive për mosdorëzimin e aplikimeve.

Edhe pse Ministria ka miratuar Udhëzimin e Financimit, ai nuk ofron udhëzime mjaftueshëm të sakta, gjë që krijon situatë të pafavorshme për pjesëmarrësit e tjerë në konkurset. Reformat urgjente dhe kriteret e qarta të financimit janë të domosdoshme për trajtimin e drejtë të të gjitha projekteve në kulturë.

Në vitin 2023, Ministria ndau 37.392 mijë denarë si dotacione kapitale për nëntë komunat për ndërtimin e objekteve kulturore, me ç'rast pagesa e mjeteve u bë pas pranimit të kërkesës me dokumentacionin e bashkangjitur. Megjithatë, për Komunën e Likovës, Qeveria miratoi Vendim të ndajë 30.000 mijë denarë shtesë për projektin "Shtëpia e Kulturës" në fshatin Mateç, por pagesa ishte bërë pa dorëzimin e dokumentacionit, gjë që nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara për komunat e tjera.

Revizioni konstatoi dobësi edhe në evidentimin e mjeteve dhe dokumentacionin e projektit për objektet kapitale nga viti 2012 deri në vitin 2023.

Mungesa e njësisë organizative të plotësuar të revizionit të brendshëm i rrit rreziqet e mungesës së bindjes përkatëse dhe shërbimeve këshillëdhënëse për Ministrinë dhe institucionet nacionale për t'i arritur qëllimet e tyre.

U konstatuan edhe pagesat e kompensimeve pa bazë ligjore, si dhe lëshime në dy prokurimet publike me vlerë 18.455 mijë denarë, të cilat mund të ndikojnë në konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.



5.2.14.2.**NDËRMARRJA PUBLIKE PËR EKONOMIZIMIN E OBJEKTEVE SPORTIVE NË PRONËSI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Ndërmarrja Publike për Ekonomizimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm NP EOSP) ka kompetencë për të kryer mirëmbajtje të investimeve dhe të vazhdueshme të objekteve sportive, shfrytëzimin e tyre në funksion të sportit, të lidh kontrata të qirasë për pjesët e objekteve që nuk janë në funksion të sportit, si dhe planifikimin dhe ndërtimin e objekteve të reja sportive.

Në përputhje me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024, realizuam revizionin e raporteve financiare për vitin 2023 të NP EOSP-së.

Me revizionin e kryer konstatuam se, për shkak se NP EOSP:

- /// punon me llogari të bllokuar për një periudhë të gjatë kohore (20 vjet);
- /// me mjete të pamjaftueshme financiare;
- /// një numër i vogël punonjësish pa njohuritë dhe aftësitë e nevojshme përkatëse;
- /// humbjen e dokumentacionit për shkak të përmbajtjeve, zbatimit të procedurave hetimore nga organet e tjera kompetente;
- /// ndryshimin e shpeshtë të drejtorëve dhe anëtarëve të Bordit Drejtues, që nga viti 2017 nuk ka Bord Mbikëqyrës dhe mungesë transparence në punë;
- /// ndryshime të shumta në rregullativën ligjore dhe respektimin e pamjaftueshëm të dispozitave ligjore, përkatësisht zbatimin e tyre në praktikë, ai nuk ka dokumentacion të plotë dhe relevant për evidencën e saktë, të vazhdueshme dhe të plotë të objekteve, përkatësisht të pronës, detyrimeve dhe kërkesave, të ardhurave dhe shpenzimeve nga puna e NP EOSP-së dhe, për rrjedhojë, veprimin ligjor përkatës në punën dhe respektimin e parimeve themelore në kryerjen e veprimtarisë me interes publik /

siguri në ofrimin e shërbimeve, vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimit, transparencës, disponueshmërisë dhe shërbimit universal, mbrojtjes së shfrytëzuesve dhe konsumatorëve.

Për këtë arsye, nuk ishim në gjendje t'i konfirmonim vlerat e:

Mjeteve materiale - 1.971.377 mijë denarë (tokë, objekte ndërtimore, pajisje, mjete transportuese, mjete në përgatitje): NP EOSP nuk ka vendime qeveritare dhe lista pronësore si dëshmi të së drejtës së fituar për shfrytëzim ose pronësi të objekteve të ndara, nuk ka të dhëna historike për vlerën e tyre, ndërsa tashmë për disa vjet nuk është kryer regjistrimi.

As me vendimin për themelimin e NP EOSP, as me Statutin e NP EOSP, as me Ligjin për sport nga viti 2002, nuk është kryer përcaktimi dhe specifikimi i saktë i objekteve sportive që do të jenë në fushëveprimin e ekonomizimit të NP EOSP. Në mënyrë plotësuese, me ndryshimet në Ligjin për sport nga viti 2013, për objektet sportive me rëndësi lokale, megjithëse ishte e detyruar, Qeveria nuk ka miratuar vendime individuale për transferimin e së drejtës së pronësisë së objekteve sportive me rëndësi lokale të NJVL-së.

Këto gjendje kanë kontribuar që NP EOSP mos të ketë të dhëna dhe informacione të sakta në lidhje me objektet sportive në pronësi të shtetit që i menaxhon, si dhe në pamundësinë për t'i regjistruar ato në librat publikë, gjë që krijon rrezik për veprimin e paligjshëm me pronën shtetërore.

Nuk ishim në gjendje të konfirmonim që të ardhurat për vitin 2023 në shumën prej 6.212 mijë denarë rrjedhin nga të gjitha kontratat aktive në përputhje me lartësinë e dakorduar të kompensimit të qirasë:

TË ARDHURA NGA QIRAJA E OBJEKTEVE SIPAS KONTRATAVE TË LIDHURA




1 NP EOSP nuk ka evidencë për objektet që janë ndarë me qira (vendndodhja, sipërfaqja, të dhënat kadastrale, funksionaliteti i objektit, të dhënat mbi kontratat e lidhura dhe anekset e kontratave, kohëzgjatja dhe lartësia e qirasë, mënyra e pagesës)

2 Nuk ishim në gjendje të konfirmim që NP EOSP lëshon rregullisht fatura për 56 kontratat në baza mujore, sepse nuk ka të dhëna të përditësuara mbi funksionalitetin e objekteve të dhëna me qira, pavarësisht nëse qiramarrësi punon apo jo

3 Mundësohet shfrytëzimi i objekteve deri në 30 vjet, pa klauzolë për kthimin e tyre pas skadimit të afatit, mund të jepen me nënqira


4 NP EOSP nuk ka dokumentacion për t'i konfirmuar investimet e kryera / investimet aktuale nga qiramarrësit si bazë për lirimin nga pagesa e qirasë

Kërkesat nga blerësit sipas kontratave të lidhura të qirasë për objektet dhe/ose pjesët sportive:




Ose 16.553 mijë denarë sipas kontratave ose anekseve të kontratave të qirasë të lidhura në periudhën nga viti 2002 deri në vitin 2023

Faturat nuk përmbajnë të dhëna mbi numrin dhe datën e kontratës /aneksit të lidhur në kontratën me qëllim që të konfirmohet baza juridike dhe saktësia e lartësisë së qirasë.



Ose 87.763 mijë denarë - të evidentuar "kolektivisht"

Nuk janë ndarë sipas komitentëve individualë; gjendja e bartur nga periudhat e mëparshme; NP EOSP nuk ka dokumentacion financiar.



Ose 98.004 mijë denarë - "komitentë" të evidentuar

Gjendja e bartur nga periudhat e mëparshme; NP EOSP nuk ka dokumentacion për të konfirmuar vlerën, bazën juridike, strukturën e moshës dhe mundësinë për arkëtimin e tyre



Ekziston mundësia reale që 92%, përkatesisht 185.767 mijë denarë, nga kërkesat e evidentuara që mos të arkëtohen.

Për rrogat e papaguara të punonjësve dhe kompensimet e papaguara të anëtarëve të BD-së -61.448 mijë denarë: nuk ishin prezantuar aktet, vendimet për përcaktimin dhe llogaritjen e rrogave të punonjësve, pëlqimet nga Qeveria (si themelues), dosjet personale për punonjësit. Në vitin 2023, janë punësuar katër persona, dy u.d. drejtorë, ndërsa rrogat dhe kompensimet paguhen përmes cesioneve dhe asignacioneve.

Për detyrimet ndaj furnizuesve në shumën prej 32.465 mijë denarë, konstatuam se për 30% të tyre ose 9.890 mijë denarë nuk ka të dhëna për emrin e furnizuesit, prandaj nuk është e mundur të përcaktohet vlefshmëria dhe ligjshmëria e tyre, ndërsa 9.426 mijë denarë ose 29% e detyrimeve janë detyrime të papaguara për energjinë elektrike, ujësjellësin dhe kanalizimin, shërbimet postare, etj.

Detyrimet për: tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin personal mbi të ardhura / tatimin mbi të ardhurat personale, tatimin mbi fitim, tatimet dhe kontributet për rroga dhe kompensime të vlerësuara në shumën prej 111.870 mijë denarë, nuk janë të harmonizuara me gjendjet e bilancit bruto

dhe nuk korrespondojnë me të dhënat e publikuara nga DAP-ja për borxhet që nuk janë paguar deri më 31.12.2023, mbi të njëjtat baza.

Me ndryshimet në Ligjin për sport të botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 148/13, megjithëse më 1 maj 2017 pushon së ekzistuari baza ligjore për punën e NP EOSP, ai vazhdon të punojë vazhdimisht. Qeveritë e Republikës së Maqedonisë së Veriut të zgjedhura pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare në dhjetor 2016, vazhdimisht deri në vitin 2023 emërojnë drejtorë dhe anëtarë të BD-së së NP EOSP. Përveç kësaj, pas shkarkimit të fundit të anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës në vitin 2017, NP EOSP funksionon pa organin mbikëqyrës.

Realizuar analizën e kontratave për një pjesë të objekteve që u jepen në shfrytëzim subjekteve të tjera juridike, ndërsa për t'i konfirmuar gjendjet e lartpërmendura, ESHR-ja iu drejtua agjencisë kompetente të kadastrës, ku konstatuam se:

- /// objektet jepen me qira për periudhë të gjatë prej 20-30 vjet, qiratë e rëna dakord janë të vogla në aspekt të hapësirës së ofruar, ndërsa qiramarrësi mund t'i japë ato me nënqira;



nuk ka dokumentacion për ndryshimet e regjistruara në listat pronësore në lidhje me pronësinë për shkak të legalizimit, privatizimit ose mbi bazë tjetër;

PISHINA E HAPUR "KALE" - SHKUP

nuk ka dokumentacion me të cilin konfirmohen depozitimet e investimeve nga qiramarrësi të parapara me kontratat;

PARTIZANI - PARKU I QYTETIT



/// tjetërsohet prona me interes publik nëpërmjet procedurave ekzekutive;

/// pavarësisht kontratave të ndërprera, qiramarrësit nuk i lëshojnë objektet dhe vazhdojnë t'i shfrytëzojnë në mënyrë të paligjshme;

mosmarrja e objekteve nga njësitë e vetëqeverisjes lokale ka kontribuar për neglizhencën më të madhe, rrënimin e objekteve, shfrytëzimin e tyre për qëllime të cilat nuk janë në drejtim të sportit, si dhe zotërim të paligjshëm;



SALLA PARTIZAN NË GJORÇE PETROV – SHKUP

/// nuk ka dëshmi se prona që, sipas kontratës me SHTN Beton Strumicë SHA Strumicë, i kalon NP EOSP si bashkinvestitor, afërsisht 781 m² hapësirë, atë e ka marrë në zotërim, as nuk ka dëshmi që objektet janë ndërtuar.

Në pjesën e Vazhdimësisë në Punë, zbuluam për mosndërmarrjen e masave dhe aktiviteteteve për të zbatuar dispozitat ligjore nga Qeveria dhe Agjencia e Rinisë dhe Sportit pas ndërprerjes së NP EOSP, prandaj ajo ende ekziston dhe vepron në vitin 2024, ka status aktiv në Regjistrin Qendror, statusi i punonjësve nuk është zgjidhur, po gjenerohen detyrime dhe humbje të reja nga puna, si dhe humbje për pronën e shtetit.

E theksuam çështjen e pagesës prej 78.363 mijë denarë sipas kontestit gjyqësor që NP EOSP duhet t'ia paguajë qiramarrësit të objektit "Pishina Olimpikë" në Shkup. Detyrimi rrjedh nga kontrata e vitit 2004 dhe aneksi nga viti 2006, me të cilën vazhdohet periudha e qirasë së objektit deri në vitin 2035 dhe, me kompensim paraprakisht njihet dhe arkëtohet qiraja për 373 muaj (31 vjet) në shumën prej 20.682 mijë denarë (336.288 euro) bazuar në faturat për investimet në objekt. Faturat nuk iu paraqitën revizionit dhe është e pasigurt nëse NP EOSP i ka ato.

U sugjeruam organeve kompetente (ministri dhe themeluesit të NP-së) nevojën për t'i përcaktuar të gjitha objektet që ishin në kompetencë të NP EOSP dhe statusin e tyre, si dhe për të rishqyrtuar dëmin juridik dhe financiar të të gjitha kontratave të qirasë të lidhura midis NP EOSP dhe personave të tretë me qëllim të ndërmarrjes së masave për minimizimin e rreziqeve juridike dhe financiare dhe mbrojtjen e pronës shtetërore.

5.2.14.3.

SHOQËRIA PËR NDËRTIM, MENAXHIM DHE DHËNIE ME QIRA TË SALLËS ME QËLLIME TË SHUMTA BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJP SHKUP



Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e përputhshmërisë së Shoqërisë për Ndërtim, Menaxhim dhe Dhënie me Qira të Sallës me Qëllime të Shumta BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJP Shkup, për vitin 2023.

Veprimtaria prioritare e shoqërisë është të lidh kontrata për dhënien me qira të hapësirës afariste me të cilën disponon dhe të realizojë të ardhura nga qiraja. Dhënia me qira e hapësirës afariste kryhet nëpërmjet ankandit publik elektronik në përputhje me Ligjin për shitjen dhe dhënien me qira të hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në bazë të tij përcaktohet edhe çmimi i qirasë.

Revizioni i kryer konstatoi se shoqëria ka lidhur 24 kontrata për dhënien me qira të objekteve, 3 prej të cilave janë lidhur në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2013 pa procedurë të ankandit publik. Kontratat për dhënien me qira lidhen me vlefshmëri për katër vjet dhe pas skadimit të afatit, me anekse të kontratës vazhdohen me kushte të pandryshuara dhe pa marrë parasysh kushtet aktuale të tregut.

Analizat e kryera të kontratave të lidhura kanë konstatuar se në 2 kontrata, çmimi i arritur përmes ankandit publik është më i lartë se çmimi i përcaktuar fillimisht, në 5 kontratat e lidhura, mbeti i pandryshuar, ndërsa në 14 kontratat e dhënies me qira, çmimi i arritur është më i ulët se çmimi i vlerësuar fillimisht, ndërsa ulja lëviz prej 6% deri në 50%.



KONTRATAT E LIDHURA PËR DHËNIEN ME QIRA ME ULJE PREJ 6% DERI NË 50%

Përveç të ardhurave të lartpërmendura, shoqëria ka realizuar të ardhura nga shitja e të mirave dhe shërbimeve mbi më shumë baza dhe ato, në vitin 2023 ishin 74% të të ardhurave totale të realizuara nga shitja. Krahasuar me vitin 2022, këto të ardhura

u ulën për 3%, ndërsa krahasuar me vitin 2021, u rritën për 33%. Të ardhurat e realizuara në periudhën 2021 - 2024 nga pikat e shitjes paraqiten në detaje në fotografinë e mëposhtme:



Rezultatet e analizës së zbatuar tregojnë se të ardhurat nga shfrytëzimi i pishinës së notit, patinazhit, sallës së vogël, sallës së lojës me birila, sallës së kongreseve dhe qendrës së pingpongut

në tri vitet e fundit vazhdimisht shënojnë rritje që vazhdon edhe në vitin 2024, ndërsa Parku Akua ka trend të rënies së të ardhurave të realizuara, ndërsa në vitin 2024 nuk punon dhe nuk realizon të ardhura.

Të ardhurat e pritura nga puna e Parkut Akua në vitin 2023 nuk u arritën, përkatësisht të ardhurat totale të realizuara janë 4.290 mijë denarë dhe ato ishin 41% më pak se sa ishin planifikuar. Në vitin 2024, Parku Akua u mbyll, ndërsa arsye u përmendën jofitimprurësia ekonomike e punës së tij, si dhe afati i skaduar i garancisë prej 10 vjet për rekuizitat / pajisjet e instaluara dhe instalimet, gjatë së cilës periudhë realizuesit garantojnë cilësinë e punimeve të kryera.



Revizioni i kryer tregon ekzistencën e pasigurisë në lidhje me funksionimin e mëtejshëm të "sistemit diellor" të instaluar që përbëhet nga panelet diellore dhe pompat termike për ngrohjen e pishinës së notit. Shoqëria pagoi mjete në shumën prej afërsisht 26.000 mijë denarë për prokurimin e këtij sistemi në të kaluarën, ndërsa vlera e tij aktuale në përputhje me librat tregtarë të shoqërisë është 2.856 mijë denarë. Ky sistem është vënë në përdorim në vitin 2014 dhe ka funksionuar me ndërprerje deri në vitin 2023. Për shkak të konstatimit të mangësive teknike në panelet diellore, sistemi nuk funksionon dhe për to nuk është gjetur zgjidhje e re përkatëse.



Në mënyrë plotësuese, revizioni nxori në pah mundësinë e humbur të BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJP Shkup për ekonomizimin e parkingut, për të cilin shoqëria ka fituar të drejtën e shfrytëzimit, për këtë arsye për vite me radhë nuk realizon të ardhura nga dhënia me qira e parkingut për vizitorët.

Në kuadër të Kryesimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me OSBE-në, në periudhën nga 30 nëntor deri më 1 dhjetor 2023, shoqëria, me rekomandimin e Qeverisë, i mundësoi MPJ-së mbështetje logjistike dhe ndihmë për përshtatjen dhe rregullimin e jashtëm të shoqërisë për nevojat e ngjarjes, të cilin e kreu MPJ-ja. Pas procedurave të zbatuara paraprakisht për ndarjen e kontratave të prokurimeve publike, MPJ-ja lidhi disa kontrata me vlerën totale prej 124.234 mijë denarë. Revizioni konstatoi se nuk janë dorëzuar procesverbale nga MPJ-ja që konfirmojnë punët e kryera dhe të mirat dhe sendet e instaluar që mbetën në zotërim të shoqërisë. Gjithashtu, nuk është vepruar sipas dispozitave të kontratës së lidhur të bashkëpunimit midis dy institucioneve, përkatësisht punët e kryera dhe të mirat dhe sendet e instaluar (të integruara) në shoqëri, ende nuk janë vënë në zotërim të saj.

Revizioni i kryer konstatoi edhe gjendje të tjera, të tilla si dobësitë në punën e parave të gatshme, mënyrën e evidentimit të tepricave të lëndëve të para dhe materialeve, regjistrimin e kryer në mënyrë jo të plotë, kompetencat e papërcaktuara në mënyrë të saktë për Bordin Mbikëqyrës, dobësitë në aktin e sistemimit dhe aktet që rregullojnë mënyrën e llogaritjes së rrogave, si dhe parregullsitë dhe mosharmonizimet e tjera.



5.2.15

PUNË DHE POLITIKË SOCIALE

5.2.15.1

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT C.O. SHKUP



Enti Shtetëror i Revizionit, si kërkesë e detyrueshme, kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut (Fondi) për vitin 2023.

Pavarësisht faktit se FSPIMV-ja vazhdimisht çdo vit është lëndë e revizionit, edhe me këtë revizion kemi konstatuar gjendjet si në vijim:

- /// nuk është bërë evidentimi i pronës në librat afaristë të mjeteve të përhershme të pranuar në bazë të procedurave të falimentimit në shumën prej 123.601 mijë denarë për të cilat Fondi ka pronësi ose të drejtë të transferuar të shfrytëzimit;
- /// regjistrimi i mjeteve dhe detyrimeve nuk është zbatuar plotësisht;
- /// për sendet e tundshme të shlyera në shumën prej 6.679 mijë denarë, është kryer fshirja nga evidenca e kontabilitetit, pa vendim të Qeverisë dhe pa zbatuar procedurën për asgjësimin ose tjetërsimin e tyre;
- /// mungesa e të dhënave mbi totalin e mjeteve të arkëtuara nga akcizat dhe plotësinë e të ardhurave të arkëtuara mbi këtë bazë;
- /// llogaria për pagesën dhe shpërndarjen e kontributeve, në fund të çdo viti mbeten mjete monetare, për të cilat një pjesë janë

pagesa të paidentifikuara të kontributit dhe për to nuk janë krijuar mundësitë të përdoren për pagesat e pensioneve;

- /// është lidhur kontrata e qirasë së hapësirës afariste për 20 vjet pa zbatuar procedurën e duhur;
- /// dobësitë në zbatimin e procedurave dhe realizimin e kontratave të prokurimeve publike;
- /// dobësitë në mënyrën e ndarjes dhe përmbushjes së kushteve për akomodim në banesat në shtëpitë e banimit për shfrytëzuesit e pensioneve të ekonomizuara nga Fondi;
- /// dobësitë në sigurinë dhe mbrojtjen e sistemit të TI-së.

Në qershor të vitit 2022, pas konkursit dhe procedurës së zbatuar publike, me Vendim të Bordit Drejtues është emëruar drejtori i Fondit për të cilin Qeveria nuk ka dhënë pëlqim, gjë që nuk është në përputhje me Ligjin për SPI-në. Në mars të vitit 2023, pas nëntë muaj, Qeveria miratoi Aktvendim me të cilin nuk i jepet pëlqimi vendimit të BD-së nga qershori 2022 për drejtorin e emëruar të Fondit nga BD-ja, gjë që ndikon në cilësinë e menaxhimit dhe punës, si dhe në mënyrën e realizimit të të drejtave dhe detyrave të drejtorit të përcaktuara me ligj.

Во текот на 2023 година, спроведена е набавка за теГјатë vitit 2023, u zbatua furnizimi për mirëmbajtje të vazhdueshme dhe kryerje të punimeve ndërtimore dhe zejtare në objektet afariste të Fondit në selinë qendrore, filialet, zyrat afariste dhe shtëpitë e pleqve, për të cilën u lidhën kontrata dhe anekse të kontratave në shumën totale prej 35.883 mijë denarë, për të cilat u konstatuan dobësitë në zbatimin dhe realizimin e saj. Pra, për pozicionet për të cilat u ofrua çmimi

minimal, nuk u bënë porositë gjatë realizimit të kontratës. Kontrata u realizua vetëm për disa pozicione pune, të cilat, krahasuar me ofertat e operatorëve të tjerë ekonomikë që u vlerësuan si të papranueshme dhe për ato pozicione, kishin çmime nga 2 (dy) deri në 22 (njëzet e dy) herë më të ulëta.

Fondi po përballet vazhdimisht me mungesën e kapaciteteve të kuadrit të personelit profesional dhe të trajnuar në sektorët kryesorë të veprimtarisë, njësitë rajonale, në Sektorin e TI-së dhe në Departamentin e Revizionit të Brendshëm, gjë që ndikon ndjeshëm në cilësinë e kryerjes së veprimtarisë dhe punën e Fondit.

Gjatë vitit 2023, u angazhuan 206 persona fizikë me kontratë në vepër për periudhë prej 2 deri në 12 muaj, për të cilët Fondi ka siguruar pëlqimet e Ministrisë së Financave, për të kryer detyra pune në përputhje me sistemimin e vendeve të punës, për të cilat u paguan mjete në shumën prej 50.377 mijë denarë. Nuk ka evidencë për praninë e personave të angazhuar, prandaj ekziston mundësia e pagesës së mjeteve monetare për personat që nuk kanë qenë të pranishëm në vendet e punës dhe nuk i kanë kryer detyrat e punës. Kontratat nuk parashikojnë detyrimin që personat e angazhuar të dorëzojnë raporte mbi punën e kryer, gjë që nuk ofron siguri në lidhje me përmbushjen e detyrave dhe detyrimeve të tyre të punës për të cilat janë angazhuar, me ç'rast një pjesë e madhe e kontratave nuk janë nënshkruar nga realizuesit.

Janë konstatuar gjendjet që kanë të bëjnë me mënyrën e kryerjes së detyrave të punës së njësisve rajonale, si dhe gjendjen në to, si në vijim:

- /// në punë nuk sigurohet përditësimi dhe ka sende dhe lëndë të pazgjidhura nga shumë vite më parë;
- /// sistemi i evidencës së orarit të punës nuk është funksional;
- /// ekziston shpërndarja joadekuate e obligimeve të punës midis punonjësve dhe personave me kontratë në vepër, një vëllim më i madh i punës për PE të caktuara dhe nevoja për punësime të reja;
- /// gjendja e kushteve higjienike joadekuate të punës në hapësirat afariste dhe tabelat e shkatërruara të Fondit, nevoja për rikonstruksionet e objekteve që përdoren kryesisht së bashku me FSSH-në;
- /// lëndët ruhen në kushte joadekuate dhe ekzistojnë mundësitë për dëmtimin e tyre nga vjedhja, lagështia dhe përmytjet dhe shkatërrimi i lëndëve;
- /// komunikimi dhe koordinimi i dobët i PE-së me Selinë Qendrore në Shkup.

KUSHTET NË TË CILAT RUHEN LËNDËT NË NJËSITË RAJONALE TË FONDIT




Gjithashtu, janë konstatuar dobësi në pjesën e funksionimit të kontroleve të brendshme të vendosura në procesin e përpunimit të dosjeve pensionale dhe pagesës së të ardhurave

pensionale, i cili zhvillohet përmes sistemit të vendosur elektronik, gjë që ndikon në afatet kohore dhe saktësinë e procedurës për llogaritjen dhe pagesën e të ardhurave pensionale.

Në pjesën që identifikon çështjen kryesore të revizorit që ka të bëjë me deficitin e mjeteve me të cilin Fondi përballat vazhdimisht, theksohet se të ardhurat nga kontributi i arkëtuar nga rroga për sigurimin pensional dhe invalidor në vitin 2023 janë rritur për 13% krahasuar me vitin paraprak 2022 dhe janë 63.340.987 mijë denarë


me pjesëmarrjen prej 65,74% në të ardhurat totale të realizuara. Rritja e realizuar e të ardhurave në vitin 2023 ende nuk është e mjaftueshme për t'i mbuluar shpenzimet për beneficionet sociale, të cilat gjithashtu po shënojnë rritje çdo vit.



STRUKTURA E TË ARDHURAVE TË FONDIT TË REALIZUARA NË VITIN 2023

Trendi i lëvizjes së pjesëmarrjes së mjeteve të transferuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në të ardhurat totale në

periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2023 është paraqitur në grafikon e mëposhtëm:



Të dhënat e lartpërmendura tregojnë se përqindja e mjeteve të veçuara nga Buxheti i Shtetit ka qenë në rritje të vazhdueshme deri në vitin 2018, për të filluar të shënojë trend të rënies duke filluar nga viti 2019. Në vitin 2023, pjesëmarrja e mjeteve të transferuara nga Buxheti i Shtetit është 32,6%.

Në dhjetor 2023, numri i personave të siguruar ishte 573.372 persona, ndërsa numri i pensionistëve ishte 337.814 persona, përkatësisht korelacioni pensionistë / persona të siguruar ishte 1:1,70, që ai shënon rënie të lehtë krahasuar me vitin 2022, kur ishte 1:1,71.

Në pjesën Çështjet e tjera, u theksua gjendja me Ligjin e miratuar për mbështetje financiare për kategoritë e cënueshme sociale të qytetarëve në dhjetor 2023, me të cilin është kryer pagesa e: shfrytëzuesve të shtesës së veçantë, shfrytëzuesve

të së drejtës së kompensimit për shkak të aftësisë së kufizuar, prindërve të vetëm që janë evidentuar për ndihmën e garantuar minimale, shfrytëzuesve të së drejtës së pensionit në lartësinë deri në 19.000 denarë.

Në përputhje me dispozitat e ligjit të lartpërmendur, shfrytëzuesve të pensioneve u janë paguar mjete në periudhën parazgjedhore nga shkurti deri në prill 2024 në shumën totale prej 1.243.322 mijë denarë, gjë që është në kundërshtim me kërkesat e nenit 8-a të Kodit Zgjedhor, në përputhje me të cilin nuk mund të kryhen pagesa të rrogave, pensioneve, ndihmës sociale ose pagesave të tjera dhe kompensimeve materiale nga mjetet buxhetore ose nga mjetet publike që nuk janë pagesa të rregullta mujore.

PAGESA E MJETEVE SIPAS LIGJIT PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR KATEGORITË E CËNUESHME SOCIALE TË QYTETARËVE NË 2023 DHE 2024

Përshkrim	Ndarje			Gjithsej
	MPPS	"Fondi"	MASh	
Janë paguar pas 14.02.2024 – pas shpalljes së zgjedhjeve përfundim me prillin 2024 dhe në MASh përfundim me qershor 2024 deri në zgjedhjen e Qeverisë së re	102.902	1.243.322	404.325	1.750.549
Gjithsej: (MASh pagesa është përfundim me shtatorin 2024)	171.142	2.137.087	781.139	3.089.368

5.2.15.2

AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT




Burimi i fotografisë: Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Raportet financiare dhe harmonizimi i punës me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e përcaktuara të APRMV-së janë lëndë e revizionit për çdo periudhë raportimi.

Pavarësisht kryerjes së vazhdueshme të revizionit të APRMV-së, për periudhën raportuese në vitin 2023 konstatuam gjendjet në më shumë fusha, përkatësisht:

Për pagesën e mjeteve të kompensimit social në rastin e papunësisë në vitin 2023 janë paguar mjete në shumën totale prej 1.305.639 mijë denarë, përkatësisht 21.229.902 euro, ato shënojnë trend të rënies krahasuar me vitin 2022, përkatësisht janë paguar më pak mjete në shumën prej 102.071 mijë denarë.




PAGESA E MJETEVE PËR KOMPENSIMIN MONETAR PËR PERIUdhËN 2019-2023

● Pagesa e mjeteve për sigurim material
 ● Pagesa e mjeteve për kompensim monetar

Gjatë pagesës së shpenzimeve mbi këtë bazë, u konstatua se në një pjesë të lëndëve që ishin përfshirë me revizionin, dokumentacioni ishte i paplotë, përkatësisht u vu re mungesa e një pjese të dokumentacionit të kërkuar, që është për shkak të mospërditësimit në punën e një pjese të qendrave të punësimit, ndërsa një pjesë e dokumentacionit është siguruar ose përgatitur pas skadimit të afatit të përcaktuar me ligj, që është për shkak të mosvendosjes së shkëmbimit elektronik të të dhënave dhe lidhjes së evidencave midis Agjencisë dhe Fondit të SPI-së.


Për realizimin e gjithsej 14 programeve dhe masave të punësimit të parashikuara me planin operativ në vitin 2023, janë paguar mjete në shumën prej 1.239.596 mijë denarë ose 20.156.033 euro, që paraqet rënie prej 13% krahasuar me vitin 2022 (viti 2022 - 1.420.003 mijë denarë ose 23.089.480 euro).



Pjesa më e madhe e mjeteve për programet dhe masat aktive të punësimit paguhet për masën e mbështetjes për vetëpunësim (sipërmarrësi).

Një nga kriteret për ndarjen e mjeteve për masat aktive të punësimit është zhvillimi i barabartë rajonal. Shpërndarja e mjeteve nuk e respektoi parimin e zhvillimit të barabartë rajonal të tetë rajoneve të planifikimit në mënyrën siç përkufizohet në udhëzimin operativ dhe planin operativ.

Për një pjesë të rajoneve të planifikimit paguhet shumë më e lartë e mjeteve në krahasim me përqindjet e përcaktuara të pjesëmarrjes në përputhje me Vendimin për klasifikimin e rajoneve të planifikimit sipas shkallës së zhvillimit. Zakonisht, më të ulëta janë mjetet e paguara për rajonet e planifikimit në pjesën qendrore dhe lindore të vendit, ndërsa më të larta se shumica e përcaktuar janë mjetet e paguara në rajonin e planifikimit të Shkupit dhe rajonet e planifikimit në pjesën perëndimore të vendit, me ç'rast në raste të caktuara tejkalimi është edhe katër herë më i madh se shumica totale e përcaktuar me vendim.



Lidhur me kontrollet e brendshme në lidhje me shfrytëzimin me dedikim dhe ligjor të mjeteve të ndara për masat aktive të punësimit, me revizionin është konstatuar se nuk ishin të përshtatshme dhe të mjaftueshme, me ç'rast pjesa më e madhe e procesverbaleve që u referoheshin kontrolleve të kryera formalisht me formulime të përgjithshme pa dhënë përshkrim më të detajuar të dedikimit për të cilin janë shfrytëzuar mjetet, përkatësisht pajisjet e blera me mjetet e subvencionuara.

Gjatë vitit 2023, për masën Trajnimi për fitimin e aftësive në fushën e aftësive të avancuara të TI-së është paguar shuma prej 87.080 mijë denarë, përkatësisht 1.415.935 euro, që paraqet rritje prej 47.361 mijë denarë ose 54% krahasuar me vitin 2022. Revizioni konstatoi se numri i kandidatëve që e kanë dhënë me sukses provimin e parashikuar pas përfundimit të trajnimit është i vogël dhe arrin 22% përfundimisht me shtatorin 2024. Duke marrë parasysh se për këtë aktivitet përdoret shumë e konsiderueshme mjete, gjendja e konstatuar tregon se masa nuk e ka arritur efektin e saj të plotë, pasi pjesa më e madhe e kandidatëve nuk e kanë realizuar me sukses trajnimin dhe nuk e kanë përfunduar provimin.

U konstatuan dobësi dhe lëshime edhe në mënyrën e realizimit të procedurës së prokurimit publik për: dru zjarri (peleta) në shumën totale prej 2.100 mijë denarë, përkatësisht 34.146 euro, ku çmimet e tregut të peletave në kohën e dorëzimit ishin më shumë se dyfish më të ulëta se çmimi me të cilin u zbatua kjo procedurë.

U konstatuan dobësi në procedurën e prokurimit për pajisjen informatike - kompjuterë portativë, personalë dhe printerë në pjesën që lidhet me pajisjet e TI-së për të cilat është lidhur kontratë në lartësinë prej 20.587 mijë denarë, përkatësisht 334.800 euro, e realizuar plotësisht në vitin 2024, gjë që ka ndikim në shfrytëzimin ekonomik, efektiv dhe efikas të mjeteve dhe në respektimin e parimeve themelore të Ligjit për prokurime publike.

Revizioni konstatoi rregullimin joadekuat të së drejtës për rrogën e drejtorit dhe zëvendësrdrejtorit, ku në vend që kjo e drejtë të rregullohet me anë të lidhjes së kontratës së menaxherit midis drejtorit të emëruar, zëvendësrdrejtorit dhe Qeverisë, ajo rregullohet me marrëveshjen kolektive në nivel të punëdhënësit, gjë që nuk është në përputhje me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë.

5.3

REVIZIONET E SUKSESIT DHE REVIZIONET E PAJTUESHMËRISË

5.3.1.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE


5.3.1.1.

MUNDËSITË PËR PËRDORIMIN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË SEKTORIN PUBLIK

Realizuar revizionin e sistemeve të informacioneve si revizion të suksesit me temë **"Mundësitë për përdorimin e inteligjencës artificiale në sektorin publik"** me qëllim që t'i përgjigjemi pyetjes: **A është sektori publik gati të përdorë inteligjencën artificiale në aktivitetet e tij?**

Revizioni i sistemeve të informacioneve si revizioni i suksesit u krye në përputhje me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024. Ky revizion i TI-së si revizion i suksesit u zbatua si revizion paralel në kuadër të Grupit të Punës së TI-së të EUROSAI-t, ndërsa koordinator i tij ishte ISR i Izraelit dhe morën pjesë ISR-të e 11 (njëmbëdhjetë) vendeve anëtare të EUROSAI-t.

Strategjia Nationale dhe rregullativa ligjore për t'i përcaktuar rregullat për zbatimin e projekteve të inteligjencës artificiale në sektorin publik nuk është miratuar dhe kjo gjendje po tejkalohet duke përkufizuar sfidat me IA-në në strategjitë e tjera nacionale. Për shkak të mungesës së strategjisë së përgatitur për IA-në, nuk janë përgatitur planet e veprimit për zbatimin e IA-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut me afate, kompetenca dhe përgjegjësi të përcaktuara, si dhe përkufizimin e mjeteve buxhetore për realizimin e projekteve të IA-së. Investimet në infrastrukturën e TIK-së për burimet e avancuara kërkimore, siç janë superkompjuterët, serverët e specializuar për përpunimin e të dhënave të mëdha dhe të mësuarit makinerik, zhvillimi i qendrave teknologjike janë të parëndësishme dhe kontribuojnë në uljen e interesit për projektet me përdorimin e IA-së.



Shteti ka financuar **48 projekte të inteligjencës artificiale në shumën totale prej 375.768 mijë denarë ose 6.110.044 euro**. Pavarësisht mjeteve të investuara, promovimi i pamjaftueshëm dhe mungesa e regjistrimit publik të projekteve të IA-së, ndikojnë në popullarizimin e pamjaftueshëm dhe mundësitë për investime të mëtejshme në këto projekte zbatimin e tyre në sektorin publik. Deri në ditën e hartimit të këtij raporti, **asnjë projekt nuk është zbatuar në sektorin publik**. Gjendjet e tilla i kanë çuar ato të funksionojnë në formën e "filluskave" pa bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e IA-së dhe në përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm që do të punojnë në sektorët që varen nga teknologjitë e avancuara.

01

02 Rregullativa nacionale për mbrojtjen e të dhënave personale është në përputhje me rregullativën e BE-së, por **pa mekanizëm të duhur kontrolli të vendosur**, koordinim të aktiviteteve midis trupave kompetentë në vend, **mungojnë vlerësimet e ndikimit në mbrojtjen e të dhënave personale** me qëllim që të sigurohet që të dhënat personale mbeten të mbrojtura gjatë zbatimit të projektit të inteligjencës artificiale dhe ato përdoren në mënyrë etike dhe të sigurt në të gjitha segmentet e shoqërisë.

03

Mungesa e kornizës strategjike dhe ligjore, planeve të veprimit dhe buxhetit për zhvillim si dhe gjendjet e infrastrukturës së TIK-së, ndikojnë në gatishmërinë e sektorit publik për të shfrytëzuar inteligjencën artificiale në aktivitetet e tij.

Në dhjetor 2018, u vendos Portali i të Dhënave të Hapura, ekosistemi dinamik i të dhënave të hapura, në të cilin të dhënat e shënuara janë të arritshme dhe shfrytëzohen nga faktorët e ndryshëm të sektorit publik, privat, akademik dhe civil. Sipas shumicës së indekseve në kornizat botërore dhe rajonale për pjekurinë digjitale, të dhënat e hapura dhe gatishmërinë e sistemit nacional për përdorimin e IA-së, vendi ynë pozicionohet nën mesataren në mungesën e aftësive të avancuara digjitale, investimeve në infrastrukturën digjitale dhe përmirësimit të administratës publike.

Në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2023, përmes Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik u financuan gjithsej 48 projekte të cilat në zgjidhjen e problemeve të caktuara shfrytëzojnë IA-në. Vlera totale e projekteve të financuara është 375.768 mijë denarë ose 6.110.044,42 euro, ose shuma e bashkëfinancimit për këto projekte është 267.104 mijë denarë ose 4.343.161,75 euro. Në mungesën e regjistrimit të projekteve të IA-së që mund të përmirësohen dhe përdoren në sektorin publik, mungesës së strategjive nacionale përkatëse dhe planeve të veprimit, edukimit dhe zhvillimit të infrastrukturës, inteligjenca artificiale në kohën e afërt nuk do të zbatohet në sektorin publik si mjet i përditshëm.

Projektet e NLP-së që po zhvillohen në Maqedoni janë me rëndësi të madhe për perceptimin e IA-së në vend, veçanërisht në kontekstin e ruajtjes së gjuhës maqedonase dhe dialekteve të saj.

Këto projekte kanë potencialin për të përmirësuar përpunimin automatik të teksteve në gjuhën maqedonase, si dhe për të ndihmuar në zhvillimin e mjeteve të avancuara në shëndetësi, shërbimet juridike, arsim dhe biznes.

Republika e Maqedonisë së Veriut ka bazë për ndjekjen e komponentit etik të projekteve të IA-së, por nuk ka mekanizëm të formalizuar që i rregullon plotësisht të gjitha aspektet e etikës në zbatimin e IA-së.

Rekomandimet e dhëna u referohen aktiviteteve që Ministria e Transformimit Digjital, në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe faktorët e tjerë sistematikë, duhet t'i ndërmarrë drejt vendosjes së kornizës strategjike dhe ligjore për zbatimin e inteligjencës artificiale, përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese të TIK-së, vendosjes së bazës së centralizuar të projekteve të IA-së për zhvillimin dhe zbatimin e tyre të mëtejshëm në sektorin publik, pjekurisë digjitale dhe gatishmërisë për përdorimin e IA-së në sektorin publik, përmirësimit të komunikimit midis administratës publike, komunitetit akademik dhe sektorit të biznesit për zhvillimin e projekteve të IA-së, si dhe vendosjes së mekanizmit për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë zbatimit të projekteve të IA-së.



5.3.2.

SISTEMET E TI-SË DHE SIGURIA DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE

5.3.2.1.

HARMONIZIMI I PROCEDURAVE PËR SIGURINË E TË DHËNAVE NGA REGJISTRI QENDROR I POPULLSISË

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e sistemeve të informacioneve si revizion i suksesit me temë "Harmonizimi i procedurave për sigurinë e të dhënave nga Regjistri Qendror i Popullsisë" në Ministrinë e Transformimit Digjital, trashëgimtar juridik i MSHIA-së për periudhën nga viti 2019 deri në vitin 2024.

Me fushëveprimin dhe dëshmitë e siguruara nëpërmjet zbatimit të teknikave dhe metodologjisë së revizorit, kemi marrë bindje të arsyeshme për të shprehur konkluzionin e mëposhtëm:

Në bazë të revizionit të kryer, konkluduar se, përveç gjendjeve që lidhen me kapacitetin e burimeve njerëzore, pozicioneve të ndjeshme të papërkufizuara të punës, mungesës së procedurave për aktivitetet që lidhen me funksionimin e RQP-së, mungesës së procedurave për përcaktimin e përbushjes së standardeve të cilësisë së të dhënave, mungesës së standardeve të përkufizuara për zbatimin e sigurisë së TI-së, mungesës së kontrolleve sistematike për shkëmbimin e të dhënave midis institucioneve që do të parandalonin anashkalimin e Regjistrit Qendror të Popullsisë, në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullativën nënligjore, dokumentet strategjike, marrëveshjet dhe politikat e përcaktuara.


Regjistri Qendror i Popullsisë është bazë e integruar e të dhënave personale të popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe mbahet në formë elektronike në Ministrinë e Transformimit Digjital. Baza e integruar e të dhënave gjenerohet bazuar në integrimin automatik të të dhënave të përmbajtura në bazat e të dhënave individuale të mirëmbajtura nga organet kompetente, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Transformimit Digjital ²⁷ - Drejtoria për Mbjajtjen e Librave të Amzës dhe organi kompetent për mbajtjen e regjistrit të adresave të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Baza e integruar gjenerohet bazuar në integrimin automatik të të dhënave të përfshira në bazat e të dhënave individuale të cilat udhëheqën nga organet kompetente, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Transformimit Digjital - Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë dhe organi kompetent për udhëheqjen e regjistrit të adresave të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



²⁷ Më 17 dhjetor 2024, u miratuan ndryshimet e Ligjit për evidencën e amzës, me anë të të cilave, në vend që si organ brenda Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria bëhet organ brenda Ministrisë së Transformimit Digjital. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 255/24






Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Regjistrin Qendror të Popullsisë, është e nevojshme mirëmbajtja e bazave të të dhënave individuale, si dhe qasja dhe përpunimi i të dhënave të përmbajtura në regjistër nga subjektet e tjera që lidhen me të dhënat personale të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe të dhënat mbi shtetasit e huaj me qëndrim të rregulluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për më shumë se një vit.

Revizioni i mbuloi fushat e mëposhtme:

- /// Korniza ligjore dhe
- /// Siguria e të dhënave personale në RQP dhe burimet e të dhënave.

Nga analizat e bëra të zbatimit të rregullativës ligjore dhe nënligjore që ka të bëjë me Regjistrin Qendror të Popullsisë, konstatuam se mungojnë mekanizmat për konfirmimin e cilësisë së standardizuar të të dhënave në burimet e të dhënave, mungon Rregullorja mbi standardet dhe rregullat për sigurinë e sistemeve të informacioneve të përdorura në organet e komunikimit elektronik, mosharmonizimi në aspekt të kërkesës për integrimin dhe sinkronizimin e të dhënave nga burimet e të dhënave në kohë reale.

Gjithashtu, Regjistri i Personave Juridikë që ka qasje në RQP nuk përmban të dhëna të plota mbi personat juridikë.



Revizioni konstatoi se ekziston numër i pamjaftueshëm i punonjësve të angazhuar për t'i kryer aktivitetet për t'i realizuar detyrat në sektorë dhe departamente të shumta, mungesë të udhëheqësve të sektorëve dhe departamenteve të shumta, nuk janë përkufizuar pozicionet e ndjeshme të punës në aktin e sistemit të vendeve të punës në Ministrinë e Transformimit Digjital dhe mungesë të procedurave për aktivitetet që lidhen me funksionimin e RQP-së nga MSHIA-ja dhe MTD-ja.

Bazuar në analizën e të dhënave dhe raporteve të dorëzuara mbi të dhënat e shkarkuara nga RQP-ja, konstatoam se që nga vendosja e regjistrimit, janë realizuar 19.769.806 thirrje, nga të cilat 44.261 kanë qenë të pasuksesshme. Përqindja e suksesit të thirrjeve është 99,78%.

Në përputhje me të dhënat, konstatoam se në vitin 2024 u realizuan 1.634.415 thirrje, nga të cilat 23.658 ishin të pasuksesshme. Përqindja e suksesit të thirrjeve është 98,55%.

Në pjesën e sigurisë së të dhënave personale në RQP dhe burimet e të dhënave, konstatoam se mungojnë kontrollet sistematike për shkëmbimin e të dhënave midis institucioneve që do të parandalonin anashkalimin e RQP-së. Gjithashtu, mungojnë procedurat e shkruara për dhënien e qasjes personave juridikë që i përdorin të dhënat, si dhe mekanizmat kontrollues për të konfirmuar standardet minimale për sigurinë administrative të sistemeve në burimet e të dhënave.

Në pjesën Theksimi i Çështjeve të Pasigurisë, i theksojmë gjendjet që lidhen me zbatimin e ndryshimeve të miratuara të Ligjit për regjistrin qendror të popullsisë, të cilat përkufizojnë

"mbikëqyrjen inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji, rregullave të tjera dhe akteve të përgjithshme të miratuara në bazë të këtij ligji do të kryhet nga sektori kompetent për mbikëqyrjen inspektuese brenda Ministrisë". Ministria nuk ka bërë ndryshime të akteve për organizimin e brendshëm dhe aktit për sistemin e vendeve të punës që do të mundësonin kompetencat ligjore të Ministrisë për mbikëqyrjen inspektuese.


Për t'i tejkaluar gjendjet e konstatuara janë dhënë rekomandime me qëllim të ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve për përmirësimin e gjendjeve me kapacitetet njerëzore, përgatitjen dhe miratimin e procedurave të shkruara për RQP-në dhe sistemet e tjera që janë në kompetencë të MTD-së, përgatitjen e doracakëve dhe futjen e mekanizmave për kontrollin e standardeve të cilësisë së të dhënave, kontrollet e detajuara për kontrollin e kushteve fizike dhe administrative minimale, futjen e kontrolleve sistematike për shkëmbimin e të dhënave midis institucioneve dhe futjen e mekanizmit të automatizuar dhe të koordinuar për ndjekjen e njoftimeve për mospërputhjet në të dhënat personale të përmbytura në bazat individuale të të dhënave.

5.3.2.1.

DIGJITALIZIMI I LIBRAVE TË AMZËS

Realizuar revizionin e sistemeve të informacioneve si revizion të suksesit me temë "Digjitalizimi i librave të amzës", me qëllim që t'i përgjigjemi pyetjes: **A do t'i thjeshtojë dhe përsheptojë digjitalizimi i librave të amzës dhe proceseve në Drejtorinë e Mbatjes së Librave të Amzës shërbimet për qytetarët, si dhe do të përmirësojë cilësinë e tyre?**

Në vitin 2014 filloi zbatimi i regjistrimit elektronik të amzës, ndërsa në vitin 2019 filloi procesi i digjitalizimit të librave të amzës në Drejtorinë. Shkalla e digjitalizimit të librave të amzës është 52% e shkresave të skanuara dhe 49% e të dhënave të futura nga vëllimi i parashikuar i aktiviteteve, përkatësisht digjitalizimi i librave të amzës nuk ka përfunduar plotësisht.



Ekzistojnë 8.000.000 shënime në librat amë

Me këtë shkallë nuk janë thjeshtuar dhe përsheptuar shërbimet për qytetarët, ndërsa cilësia e të dhënave të përdorura nga institucionet në përputhje me kompetencat e tyre ligjore nuk është përmirësuar. Planifikimi i projekteve pa analizat përkatëse dhe planin e detajuar të veprimit për procesin e digjitalizimit të librave të amzës ka çuar në rritjen e mjeteve të planifikuara nga 13.116 mijë denarë në 157.400 mijë denarë, që është për dymbëdhjetë herë më shumë mjete, ndërsa procesi i digjitalizimit ende nuk ka përfunduar.

Në mungesë të protokolleve të përkufizuara, planit të detajuar për digjitalizimin dhe evidencës së centralizuar të librave të amzës, Drejtoria nuk mund të përcaktojë dhe ndjekë shkallën e digjitalizimit të librave të amzës.


Drejtoria nuk ka siguruar kushte përkatëse për vendosjen e librave të amzës dhe ruajtjen e materialit arkivor me vlerë të përhershme dhe materialit dokumentar në mënyrë që ai të mos dëmtohet, zhduket ose shkatërrohet. Gjendja e mosharmonizimit të rregullativës ligjore dhe formularëve, çon në lëshimin e certifikatave të lindjes për qytetarët me të dhëna të paplota dhe formularë të paunifikuar për të gjithë qytetarët. Konfirmimi i të dhënave të futura në regjistrin amë elektronik është i ngadaltë, ndërsa të dhënat e shkëmbyera me institucionet nuk janë gjithmonë të sakta.

Zyra lokale e DMLA Mavrovi Anovi



Konstatuam mungesën e burimeve njerëzore të TI-së me përvojë dhe të kualifikuar, gjë që çon në rritjen e rrezikut për sigurinë e sistemit të informacioneve të Drejtorisë, ndërsa menaxhimi jo në kohë dhe i padokumentuar i përdoruesve dhe privilegjeve të përdoruesve e rrit rrezikun e qasjes së paautorizuar në të dhënat personale të qytetarëve dhe aktiviteteve korruptive.

Gjithashtu, punonjësit/ofiqarët hyjnë në ambientet e Drejtorisë dhe regjistrin amë elektronik jashtë orarit të përcaktuar të punës, gjatë fundjavave dhe festave. Konstatuam që punonjësit para orës 6:30 dhe pas orës 22:00 **krijojnë regjistrime dhe ndryshime në regjistrin amë elektronik pa mbikëqyrje të duhur, ndërsa certifikata janë shtypura nga librat e amzës gjatë fundjavave dhe festave në më shumë zyra lokale.**



U angazhuan personat me kontratë në vepër për "futjen dhe konfirmimin e të dhënave në regjistrin amë elektronik në vëllim më të gjerë për realizimin e projektit të regjistrimit amë elektronik". Në vend të futjes së të dhënave, këtyre personave iu caktuan detyra të tjera pune. Për këtë u paguan 30.578 mijë denarë, megjithëse në të njëjtën periudhë u lidhën edhe kontrata të prokurimeve publike për skanimin e librave të amzës dhe futjen e të dhënave në regjistrin amë elektronik.

Për punonjësit e Drejtorisë u siguruan 61 certifikata për nënshkrim elektronik për nënshkrimin e certifikatave elektronike. Konstatuam se 13 ofiqarë nuk kanë nënshkruar fare certifikatë elektronike, ndërsa 92% e totalit të certifikatave elektronike të lëshuara janë në zonën e Qytetit të Shkupit.

U dhanë rekomandime në drejtim të përsheptimit të procesit të digjitalizimit të librave të amzës, përmirësimit të sigurisë së të dhënave personale dhe librave të amzës, sistemeve të informacioneve dhe bazave të të dhënave, përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara, uljes së rreziqeve të korrupsionit, si aspekt i rëndësishëm i vendosjes së administratës profesionale, efikase dhe llogaridhënëse, ndërmarrjes së aktiviteteve për rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet dhe minimizimit të procedurave administrative.

5.3.2.3.

SISTEMI I PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR TË BURIMEVE - SISTEMI PIB

Realizuar revizionin e sistemeve të informacioneve si revizion të suksesit me temë **"Sistemi i Planifikimit të Integruar të Burimeve - Sistemi PIB" me qëllim që t'i përgjigjemi pyetjes "A janë përcaktuar dhe zbatuar masat për mbrojtje efikase dhe të plotë të të dhënave në sistemin e planifikimit të integruar të burimeve?"**


Shërbimi për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ofron shërbime të kontabilitetit për më shumë institucione shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me qëllim të kryerjes së aktiviteteve të punës së tyre në mënyrë më efikase dhe më moderne, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe Ministria e Transportit dhe Lidhjeve në vitin 2014 lidhën kontratë për prokurim grupor, përkatësisht prokurim publik për sistemin PIB për institucionet shtetërore për të cilat shërbimin e ofron Shërbimi për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta i Republikës së Maqedonisë. Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, si realizues i prokurimit, lidhi kontratë në vlerën prej 1.743 mijë denarë. Pas prokurimit të sistemit PIB, ai u instalua dhe u përdor në Shërbim për nevojat e shfrytëzuesve të shërbimeve.

Ministria zbaton procedurë të prokurimit publik me qëllim të sigurimit të mirëmbajtjes parandaluese dhe adaptive të sistemit të planifikimit të integruar të burimeve. Për këtë dedikim, gjatë vitit 2019, pas procedurës së zbatuar të prokurimit publik, u lidh kontratë në vlerën prej 7.080 mijë denarë

me kohëzgjatje prej 12 muaj, dhe gjatë vitit 2022 u lidh kontratë në vlerën prej 14.160 mijë denarë me kohëzgjatje prej 24 muaj. Pas skadimit të kontratës së vitit 2022, u lidhën dy Aneks-Kontrata për mirëmbajtjen e sistemit, me të cilat u vazhdua afati i kohëzgjatjes së kontratës për gjithsej 9 muaj, përkatësisht deri më 13.09.2024. Në të njëjtën kohë, vlera e kontratës rritet gjithashtu për gjithsej 2.832 mijë denarë.

Edhe pse sistemi PIB u zbatua në vitin 2016, ende mungon akti juridik që i rregullon të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë si pronare dhe të Shërbimit si përdorues i sistemit, gjë që krijon rrezik për menaxhim joadekuat të të dhënave.

Ky sistem përpunon të dhënat për 40 subjektet juridike, siç paraqitet në infografikun e mëposhtëm.




Revizioni i përdorimit të moduleve e konstatoi këtë si në vijim:

- /// Moduli për punën materiale dhe të magazinimit me inventar të vogël është zbatuar dhe përdoret vetëm nga dy institucione ekskluzivisht për nevojat e SHPPP-së dhe Drejtorisë për Punë Hidrometeorologjike.
- /// Moduli për mjetet themelore përdoret nga 22 institucione. Një pjesë e institucioneve të tjera përdorin sisteme shtesë për të cilat ndahen burimet financiare shtesë. Qasja për punonjësit e institucioneve, si dhe anëtarët e komisioneve të regjistrimit, nuk është vendosur, gjë që do të mundësonte kryerjen më efektive të punëve.

- /// Moduli për punën e arkëtarit përdoret në 15 institucione. Në një institucion, konstatuam se shërbimet e punës së arkëtarit kryhen manualisht edhe pse moduli është zbatuar dhe ai nuk përdoret.
- /// Moduli për punën buxhetore nuk është zbatuar dhe nuk përdoret plotësisht. Kërkesat minimale për modulin e punës buxhetore nga specifikimi teknik për prokurimin e sistemit, ndër të tjera, kërkojnë realizimin e pagesave dhe shkëmbimin e të dhënave me MF-në, gjë që nuk është zbatuar dhe nuk përdoret. Nga ky modul, është zbatuar vetëm një pjesë e modulit të Thesarit dhe raportit të BI-së, i cili ofron tri pasqyra vjetore, por vetëm për 8 institucione dhe për periudhën fikse. Megjithatë, këto pjesë nuk janë të integruara me modulet e tjera të sistemit PIB.

/// Moduli për ndjekjen e realizimit të kontratave nuk është zbatuar dhe nuk përdoret. Për të nuk janë dorëzuar udhëzime për përdorim, të cilat janë detyrim i bartësit të prokurimit në përputhje me dokumentacionin e tenderit.

/// Moduli për punën financiare dhe të kontabilitetit përdoret në 40 institucione.



Sistemit PIB i mungon integrimi i moduleve në sistem. Mirëmbajtja nuk ofrohet vazhdimisht dhe në kohë e siguruar me kontratat e nënshkruara. Mungojnë procedurat e përkufizuara për menaxhimin e qasjes dhe mbrojtjen e të dhënave, si dhe dokumentacioni i përditësuar që e mbulon konfigurimin e sistemit.

Nuk janë ndërmarrë aktivitete për të kontrolluar rregullisht kopjen rezervë të të dhënave dhe nuk ekzistojnë kontrolle përkatëse për të monitoruar sigurinë e sistemit.

Gjithashtu, mungojnë politikat dhe procedurat për testimin e rregullt të kopjeve rezervë. Stacionet e punës përdorin sistem të vjetëruar operativ pa përditësime të sigurisë dhe mbështetjen nga prodhuesi, gjë që e rrit rrezikun e sulmeve të sigurisë dhe qasjes së paautorizuar. Konfigurimi

i qasjes VPN, pa autentifikim shumëfaktorësh, përkatësisht konfirmimin e identitetit përmes dy ose më shumë faktorëve të pavarur dhe me fjalëkalim të përbashkët, e rrit mundësinë e kompromentimit të sistemit. Mungesa e burimeve njerëzore ndikon në kryerjen në kohë dhe efikase të detyrave, me largimin e vazhdueshëm të punonjësve për shkak të daljes në pension dhe mungesës së punonjësve me aftësi dhe njohuri përkatëse.

Gjendjet e tilla, si dhe mosintegrimi i të gjitha moduleve në sistem, tregojnë se masat e përcaktuara dhe të zbatuara nuk janë të mjaftueshme për mbrojtjen efikase dhe të plotë të të dhënave në sistemin PIB, gjë që e ekspozon sistemin ndaj rreziqeve të mundshme të sigurisë dhe kompromenton konfidencialitetin e të dhënave.

5.3.3.

PUNË DHE POLITIKË SOCIALE

5.3.3.1.


ZBATIMI I KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EVROPËS PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE (KONVENTA E STAMBOLLIT) ME VËSHTRIM TË VEÇANTË NDAJ SHËRBIMEVE TË SPECIALIZUARA PËR GRATË VIKTIMA TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE

Vendet anëtare të Këshillit të Evropës në maj 2011 nënshkruan Konventën për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje. Republika e Maqedonisë së Veriut e nënshkroi këtë Konventë në korrik të të njëjtit vit dhe ajo u ratifikua nga Kuvendi në dhjetor 2017. Ratifikimi i Konventës së Stambollit obligohet për përballjen gjithëpërfshirëse të dhunës ndaj grave në të gjitha format e saj, nëpërmjet vendosjes së kornizës juridike dhe institucionale për mbrojtjen e grave viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Me qëllim përt'iu përgjigjur pyetjes **"Aofrojnë masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente shërbime të specializuara efektive për mbështetjen dhe mbrojtjen e grave viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje?", realizuam revizionin e suksesit me temë "Zbatimi i Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) me vështrim të veçantë ndaj shërbimeve të specializuara për gratë viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje".**

Kemi fituar siguri të arsyeshme se masat dhe aktivitetet për ofrimin e shërbimeve të specializuara për mbështetjen dhe mbrojtjen e grave viktime të DHBGJ-së dhe DHF-së, të cilat ndërmerren nga institucionet kompetente, nuk janë mjaftueshëm efektive me qëllim të parandalimit, mbështetjes dhe mbrojtjes së grave viktime të DHBGJ-së dhe DHF-së dhe riintegritimit të tyre të plotë.

Plani i Veprimit për Zbatimin e Konventës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave




dhe Dhunës në Familje për periudhën 2018-2023 është bazë e mirë për parandalimin dhe mbrojtjen efikase të viktimeve, por nga 52 aktivitetet e planifikuara, 38% nuk janë zbatuar, ndërsa 19% janë zbatuar pjesërisht, gjë që tregon se vetëm 22 aktivitete janë zbatuar plotësisht. Vazhdimësia në nivel nacional për veprimin sistematik në këtë fushë nuk është siguruar për shkak të faktit se për periudhën pas vitit 2023 nuk është hartuar dhe miratuar Strategjia Nationale për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna me Bazë Gjinore dhe Dhuna në Familje dhe nuk janë miratuar një pjesë e akteve nënligjore të parashikuara me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje. Programi për riintegrimin e viktimeve të dhunës është i përgjithshëm, nuk ka periudhë të përcaktuar së cilës i referohet, as nuk ka qëllime të qarta me tregues të matshëm që duhen arritur. Harmonizimi i Kodit Penal me një pjesë të kërkesave të Konventës së Stambollit është bazë e mirë për parandalimin dhe mbrojtjen e grave viktime të DHBGJ-së dhe DHF-së, megjithatë, mundësia e dhënë për tërheqjen e kallëzimeve penale nga viktimat e DHBGJ-së dhe DHF-së ka efektin e ndalimit të procedurës për ndjekjen objektive të autorëve dhe mbrojtjen efikase të viktimeve.

QPS-të kryejnë aktivitete të shumta në fushën e mbrojtjes sociale dhe nuk është kryer riorganizimi i planifikuar, sepse nuk është hartuar analiza funksionale dhe standardet e punës, prandaj ato përballen me mungesë të ekipimit të kuadrit.

Një pjesë e shoqatave të qytetarëve që ofrojnë shërbime të specializuara për viktimat e DHBGJ-së dhe DHF-së nuk janë të licencuara dhe nuk është rregulluar mënyra e licencimit të linjave SOS.

Numri i strehimoreve dhe këshillimoreve për viktimat në vend dhe shpërndarja e tyre territoriale nuk është në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit, dhe një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kushtet për themelimit të parashikuara me

Rregulloren për Standardet dhe Procedurat për funksionimin e tyre në aspektin e vendndodhjes, pajisjeve, hapësirës dhe kuadrit.



PASQYRË E STREHIMOREVE TË PARAPARA NË PËRPUTHJE ME KS SIPAS RAJONEVE PLANORE DHE TË VENDOSURA NGA SHTETI DHE ORGANIZATAT JOQEVERITARE;

PASQYRË E KËSHILLIMOREVE TË PARAPARË NË PËRPUTHJE ME KONVENTËN E STAMBOLLIT SIPAS RAJONEVE PLANORE DHE TË VENDOSURA NGA SHTETI DHE ORGANIZATAT JOQEVERITARE;

Analiza e shpenzimeve për serviset e specializuara për dhunën në familje dhe dhunën seksuale, e cila duhet të jetë bazë për planifikimin real të mjeteve të nevojshme, nuk është bërë për arsye se nuk mund të përcaktohet nëse mjetet e siguruar si kompensim mujor për shfrytëzues janë të mjaftueshme për të ofruar shërbim të specializuar cilësor për viktimën.

Burrat vazhdojnë të jenë autorët më të shumtë të veprave penale dhe të kundërvajtjes që lidhen me DHF-në. Numri i burrave që janë autorë të veprave penale është 9 deri në 11 herë më i lartë se numri i grave që janë autore, ndërsa numri i burrave që janë autorë të veprave penale të kundërvajtjes është 3 deri në 6 herë më i lartë se numri i grave që janë autore.

Korelacioni midis grave dhe burrave si autorë dhe viktimat të veprave penale dhe të kundërvajtjes që lidhen me DHF-në shënoi trend të vazhdueshëm dhe ka ndryshime të parëndësishme.

NUMRI I REGJISTRUAR I AUTORËVE TË VEPRAVE PENALE DHE TË KUNDËRVAJTJES QË LIDHEN ME DHF-NË SIPAS MOSHËS DHE GJINISË

	Autorë të regjistruar të veprave penale		Autorë të regjistruar të veprave kundërvajtëse		Viktimat e raportuara të veprave penale		Viktimat e raportuara të veprave kundërvajtëse	
	gra	burra	gra	burra	gra	burra	gra	burra
2018	84	11.3 953	59	5.8 340	864	4 217	202	0.9 212
2019	82	11.4 931	76	5.8 440	847	3.9 214	305	1.3 229
2020	95	9.8 930	87	5.4 471	840	3.9 212	274	0.9 284
2021	109	9.1 988	74	4.7 348	890	3.4 265	215	1 210
2022	93	11.4 1061	59	5.8 341	942	3.8 249	231	1.3 179
2023	96	10.4 1001	90	3.2 285	883	3.7 240	228	1.4 166

● marrëdhënia gra/burra

Për sa i përket numrit të viktimave të raportuara të veprave penale nga DHF-ja, numri i viktimave gra është 4 herë më i lartë se numri i viktimave burra, ndërsa i viktimave të veprave të kundërvajtjes korelacioni midis grave dhe burrave është pothuajse i barabartë.

Korelacioni i pandryshuar midis autorëve dhe viktimave të DHF-së tregon se aktivitetet e ndërmarra në pjesën e parandalimit dhe mbrojtjes së viktimave nuk po përmirësojnë gjendjen.

Funksionaliteti i Trupit Koordinues Nacional duhet të përmirësohet se si të sigurojë koordinim përkatës në zbatimin e politikave dhe masave për të parandaluar dhe luftën kundër të gjitha formave të dhunës ndaj grave. Gjithashtu, mungon sistemi i integruar i

evidencës së viktimave, gjë që e bën të pamundur ofrimin e të dhënave të sakta, në kohë dhe të unifikuara nga të gjitha institucionet kompetente të përfshira në procesin e parandalimit dhe mbrojtjes së grave viktimat të DHBGJ-së dhe DHF-së, si dhe informacioneve të tjera relevante për ndjekjen e gjendjes së dhunës ndaj grave, të cilat duhet të jenë bazë për krijimin e masave përkatëse për parandalim dhe mbrojtje më efektive të grave viktimat të DHBGJ-së dhe DHF-së.

Pa procesin e riintegrit, viktimat do të mbeten në rrezik të riviktimizimit, ndërsa shteti duhet të marrë përgjegjësinë dhe të vendos sistem të qëndrueshëm që do t'u mundësojë viktimave një shans të vërtetë për një jetë të re pa dhunë.



5.3.3.2.**INVESTIMET PUBLIKE PËR TË SIGURUAR KAPACITETE DHE KUSHTE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NË KOPSHTE****Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e suksesit me temë "Investimet publike për të siguruar kapacitete dhe kushte për mbrojtjen e fëmijëve në kopshte"**

Revizioni mbulon periudhën nga viti 2020 deri në qershor 2024, me qëllim të vlerësimit të efektivitetit të masave dhe aktiviteteve të ndërmarra nga institucionet kompetente për të siguruar investim përkatës, mbulim optimal dhe të shtuar të fëmijëve të moshës parashkollore dhe kujdesin e edukimin e tyre.

Janë konstatuar dobësi të konsiderueshme në planifikimin, menaxhimin dhe realizimin e investimeve, duke rezultuar në shfrytëzimin e pamjaftueshëm të mjeteve të investuara, mungesë të kushteve përkatëse për rritjen e mbulimit të fëmijëve, prandaj investimet publike në kopshtet nuk janë mjaftueshëm efektive në përmbushjen e qëllimeve.

Dokumentet e programit për zhvillimin e veprimtarisë për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe për ndërtimin, pajisjen dhe mirëmbajtjen e objekteve të mbrojtjes së fëmijëve, nuk përmbajnë tregues të matshëm për ndjekjen e suksesit, as nuk hartohen raporte mbi shkallën e realizimit të qëllimit të sigurimit të kushteve optimale për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore.

Në nivel nacional, nuk është vendosur kornizë juridike sistematike për menaxhimin e investimeve publike, ndërsa regjistrat e kapaciteteve të kopshteve, si bazë për krijimin e politikave të investimeve, nuk janë të plota dhe të përditësuara.

Revizioni i kryer konstatoi se të dhënat mbi përfshirjen e fëmijëve në arsimin parashkollor ndryshojnë ndjeshëm në varësi të institucionit që gjeneron, përpunon dhe publikon të dhënat.

Pra, sipas Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, në vitin 2023, nga 115.003 fëmijë deri në moshën gjashtë vjeç, 39.129 ishin të përfshirë në kopshte dhe qendra për zhvillim të hershëm të fëmijëve, që paraqet mbulim prej 34,5%. Nga ana tjetër, sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, numri i përgjithshëm i fëmijëve në këtë grupmoshë është 129.879 fëmijë, nga të cilët 37.804 ndjekin institucionet parashkollore, me çka mbulimi arrin 29%. Ky mosharmonizim i të dhënave midis institucioneve krijon mundësinë e vlerësimeve të gabuara në planifikimin e politikave dhe shpërndarjen e burimeve të nevojshme.

Sipas të dhënave që kemi siguruar, 4.851 fëmijë janë në listën e pritjes, ndërsa 75.874 fëmijë nuk janë akomoduar në kopshte. Kjo ngre pyetjen nëse ky dallim për kujdesin e fëmijëve është për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme apo faktorëve të tjerë (demografia, shpërngulja) gjë që kërkon analiza shtesë dhe ndërmarrjen e masave të duhura nga institucionet kompetente.

Në kushtet e kapaciteteve të kufizuara në kopshtet, numri i fëmijëve të regjistruar vazhdon të tejkalojë kapacitetin e projektuar, gjë që çon në pasoja serioza për cilësinë e procesit edukativo-arsimor.

Kapaciteti i plotësuar për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore në shtator 2023 e tejkalon kapacitetin e disponueshëm në 31% të kopshteve, ndërsa në maj 2024 në 67% të kopshteve. Kjo çon në ngarkesën e tepërt në grupet (më shumë fëmijë në grupet sesa numri i nevojshëm i përcaktuar), veçanërisht në grupmoshat 3-4 dhe 4-5 vjeç, gjë që ndikon në kushtet e punës së edukatorëve dhe në cilësinë e kujdesit që u ofrohet fëmijëve.

PËRMBUSHJA E ÇERDHEVE PËR FËMIJË KRAHASUAR ME NORMAT E PËRCAKTUARA

Përshkrimi i normës – Numri i fëmijëve në grup	Numri i përcaktuar sipas standardeve dhe normave	Numri mesatar i mbushur në ÇF
deri 2 vjet	më së paku 10 , ndërsa më së shumti 12 fëmijë	17
deri 2-3 vjet	më së paku 12 , ndërsa më së shumti 15 fëmijë	27
deri 3-4 vjet	më së paku 15 , ndërsa më së shumti 18 fëmijë	30
deri 4-5 vjet	më së paku 18 , ndërsa më së shumti 20 fëmijë	33
deri 5-6 vjet	më së paku 20 , ndërsa më së shumti 25 fëmijë	25

Edhe pse Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë dhe komuna të caktuara po bëjnë përpjekje përmes investimeve kapitale për t'i zgjeruar kapacitetet, gjendja faktike është se një numër i konsiderueshëm kopshtesh punojnë me dyfishin e numrit të fëmijëve sesa kapaciteti i tyre i parashikuar.

Kopshtet publike financohen me mjetet nga buxhetet shtetërore dhe komunale, fondet e IPA-së, huaja nga Banka Botërore dhe donacionet e ndryshme. Burimi i rëndësishëm financiar është huaja nga Banka Botërore në shumën prej 28,7 milion euro, nga të cilat 15,1 milion euro janë të dedikuara për ndërtimin dhe rehabilitimin e kopshteve.

BURIMET E PROJEKTEVE TË FINANCUARA PËR INVESTIMET PUBLIKE NË KOPSHTET
NË PERIUDHËN NGA VITI 2020 DERI NË VITIN 2024

Burimi i financimit	Numri i çerdheve për fëmijë të përfshirë me ndërtim, rikonstruim dhe adaptim	Kapaciteti i projektuar për mbrojtjen dhe edukimin e fëmijëve	Numri i çerdheve të pajisura për fëmijë
Fondet buxhetore nëpërmjet Ministrisë	11	1057	19
Fondet e kredisë nga Banka Botërore	16	1961	15
Fondet e IPA-s	2	320	2
Gjithsej:	29	3.338	36

**BUXHETI I MIRATUAR DHE MJETET E REALIZUARA BUXHETORE PËR INVESTIMET KAPITALE NË KOPSHTET NË PERIUdhËN
2020 - 2023**

në 000 denarë

Viti	Buxheti i miratuar	Buxheti me ribalancin / ridedikimet	Realizimi i buxhetit	% e realizimit
2020	82.569	/	82.309	100%
2021	67.650	111.786	80.035	72%
2022	152.035	49.625	32.342	65%
2023	132.005	358.650	341.375	95%
Totali	434.259	520.061	536.061	

Revizioni realizoi analizën e projekteve të investimeve kapitale të planifikuara dhe të zbatuara në kopshtet për periudhën 2020-2023, duke konstatuar rënie të vazhdueshme të numrit të projekteve të reja për ndërtimin dhe zgjerimin e kopshteve. Në vitin 2023, Programi Vjetor i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale nuk parasheh asnjë projekt të ri, ndërsa realizimi i aktiviteteve të miratuara tashmë po zhvillohet me anulime të konsiderueshme. Realizimi total i mjeteve buxhetore për investimet kapitale në kopshtet në periudhën e analizuar (2020 - 2023) arrin 536.061 mijë denarë ose 8.716.439 euro, ndërsa realizimi më i ulët është shënuar në vitin 2022, që arrin 65% të buxhetit të miratuar.

Ndërtimi i kopshteve është vendimtar për avancimin e mbrojtjes së fëmijëve dhe sigurimin e kushteve përkatëse për më të vegjlit. Megjithatë, analiza e realizimit të këtyre projekteve tregon sfida serioze, vonesa dhe pengesa administrative që e ngadalësojnë procesin e ndërtimit dhe vënies në përdorim.

Ndërtimi i kopshtit në Komunën e Çairit, me kapacitet prej 350 fëmijë, filloi në vitin 2020 dhe ende nuk ka përfunduar.

Janë lidhur tetë anekse të kontratës, duke e vazhduar afatin deri më 1 dhjetor 2024. Arsyet kryesore për vonesën janë ndryshimet në rolet e personave juridikë-realizuesit, punimet shtesë dhe të paparashikuara të ndërtimit, pengesat administrative që lidhen me qasjen në parcelën ndërtimore dhe intensiteti i zvogëluar i punës gjatë periudhës së pandemisë.



Edhe pse deri më tani janë paguar 82% e mjeteve të kontraktuara, 99.024 mijë denarë nga gjithsej 120.084 mijë denarë, kopshti ende nuk është funksional.

Të papërfunduara mbeten pozicionet në katin përdhes të cilat do të mund të realizohen pasi të përfundojë lidhja e ujit dhe të zgjidhet problemi i vendosjes së gardhit në anën perëndimore të parcelës.



Për shkak të një sërë vonesash dhe problemesh të pazgjidhura infrastrukturore, ndërtimi i kopshtit me kapacitet prej 72 fëmijë në fshatin Erxhelia, Komuna e Shën Nikollës, i cili duhej të përfundonte në mars të vitit 2022, ende nuk është vënë në funksion. Pavarësisht faktit se punimet ndërtimore kanë përfunduar dhe janë paguar mjetet në shumën prej 23.200 mijë denarë, përkatësisht 94% të vlerës së rënë dakord. Objekti nuk mund të vihet në përdorim për shkak të përfundimit të aktiviteteve të nisura nga komuna në pjesën e rregullimit të katit përdhes dhe eliminimit të mangësive të paraqitura në objekt nga realizuesi.

Përfundimisht me qershorin 2024, me thirrjen e parë publike për hua nga Banka Botërore, janë paguar mjete në shumën prej 799.852 mijë denarë ose në lartësinë prej 13.005.723 euro për ndërtimin dhe zgjerimin e kapaciteteve të 16 kopshteve, nga të cilat një objekt nuk ka përfunduar - në Komunën e Manastirit, ndërsa tri nga kopshtet e ndërtuara nuk janë vënë në përdorim - në komunat e Haraçinës, Likovës dhe Koçanit, për shkak të mossigurimit të pëlqimeve të punësimit, si dhe përfundimit të procedurës për lëshimin e aktvendimit për përmbushjen e kushteve në Komunën e Koçanit.

Në përputhje me inspektimin e kryer në procedurat për ndërtimin dhe pajisjen e kopshteve në komunat e Likovës dhe Haraçinës, janë konstatuar dallime të konsiderueshme në çmimet, pavarësisht faktit se objektet kanë dedikim dhe koncept identik. Ndërtimi i kopshteve është rezultat i dy prokurimeve publike të zbatuara në maj 2021, me kontratat e lidhura në gusht 2021. Vlera e kopshteve është 46.913 mijë denarë (Likovë) dhe 45.255 mijë denarë (Haraçinë). Konstatuam se në Haraçinë çmimet për pozicionet identike të ndërtimit janë më të larta për 1.277 mijë denarë, për të cilat Komisioni i Vlerësimit nuk

kërkoj shpjegim për dallimet. Lëshime çmimesh janë konstatuar edhe në prokurimet e mobiljeve dhe pajisjeve (2022-2023), ku për Haraçinën janë shpenzuar 12.050 mijë denarë, ndërsa për Likovën 8.759 mijë denarë, edhe pse bëhet fjalë për të njëjtin lloj të pajisjes me dallim prej 3.291 mijë denarë. Dallimi tregon çmime dukshëm më të larta në Komunën e Haraçinës, ku pozicione të caktuara janë madje dy herë më të shtrenjta. Moszbatimi i prokurimit të përbashkët, edhe pse kopshtet po ndërtoheshin njëkohësisht, rezultoi me shpenzim joadekuatë të mjeteve nga huaja e marrë.

Për ndërtimin e **kopshtit në Komunën e Manastirit me mjete nga huaja e Bankës Botërore**, në qershor të vitit 2021 u lidh kontrata në shumën prej 55.224 mijë denarë me afat prej 16 muaj, por punimet nuk ishin zhvilluar sipas dinamikës së planifikuar. Realizuesi parashtroi gjashtë kërkesa për vazhdimin e afatit, pesë prej të cilave u miratuan, me total prej 340 ditë shtesë, ndërsa pas kërkesës së gjashtë nuk është miratuar vazhdimi i ri. Deri në maj të vitit 2023 ishin realizuar 36% e punimeve me 20.106 mijë denarë të paguar. Me situatën e gjashtë, u paguan 3.705 mijë denarë (pas llogaritjes së miratimit të regjistruar prej 2.866 mijë denarë për pjesën e mbetur të

avansit të pakthyer nga realizuesi) për 48% të punimeve ndërtimore të përfunduara. Kontrata u ndërpre më 03.05.2024 për shkak të mosdorëzimit të garancisë bankare, ndërsa deri në tetor 2024 nuk është bërë pasqyra e punimeve të kryera, gjë

që e anulon përfundimin e projektit dhe krijon nevojën për të zgjedhur realizues të ri brenda periudhës kohore për përfundimin e projektit deri më 30.06.2025.



NDËRTIMI I KOPSHTIT NË KOMUNËN E MANASTIRIT

Revizioni konstatoi se, megjithëse komunat kanë kompetencë ligjore për të financuar dhe mirëmbajtur kopshtet, angazhimi i tyre në investimet kapitale mbetet i kufizuar. Komunat e mëdha, sipas mundësive, investuan në ndërtimin dhe zgjerimin e kopshteve, por në komunat e vogla këto investime ishin minimale, gjë që çoi në kapacitetet e pamjaftueshme dhe procesin e ngadalshëm të decentralizimit në mbrojtjen e fëmijëve.

Me mjetet e Komunës së Manastirit në vitin 2021, filloi ndërtimi i kopshtit të ri në komunë në zonën e PDU - ARM 2 (ish-kazerma), me kapacitet të projektuar për t'u kujdesur për 246 fëmijë. Vlera totale e kopshtit është parashikuar të jetë 114.481 mijë denarë, nga të cilat 104.544 mijë denarë kanë të bëjnë me pjesën e ndërtimit, ndërsa mjetet e pajisjeve janë në vlerë prej 9.937 mijë denarë. Për shkak të punimeve të paparashikuara të ndërtimit që lidhen me shfaqjen e niveleve të larta të ujërave nëntokësore dhe afatit të shkurtër të parashikuar për realizimin e punimeve sipas kontratës themelore, ato kontribuan në lidhjen e anekseve të kontratës themelore, të cilat, së bashku me rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve, çuan në realizimin e dobët dhe ndërprerjen e saj me arkëtimin e garancisë bankare.

Deri në periudhën e njoftimit nga revizioni, kopshti ishte ndërtuar deri në fazën e karabinës me xham. Vazhdimi i shumëfishtë i afateve për realizimin e kontratave, zbatimi i procedurave të veçanta të prokurimit publik për ndërtimin e kopshtit dhe ndërtimin e sistemit të kullimit, shfaqja e punimeve të paparashikuara dhe lidhja e aneks-kontratave në kushtet kur problemi me shfaqjen e ujërave nëntokësore ishte i njohur, tregojnë për dobësitë dhe mangësitë në projektet dhe llogaritjet e matjeve në përputhje me të cilat komuna i realizon investimet e saj kapitale. Periudha e gjatë e ndërtimit të kopshtit në Manastir nuk mundësoi kujdes dhe edukim në kohë dhe cilësor të fëmijëve.



Me revizionin e kryer konstatuam se në periudhën nga viti 2021 deri në tetor 2024, janë ndërtuar shtatë kopshte të reja, për të cilat janë paguar mjete në vlerën totale prej 263.890 mijë denarë ose 4.290.894 euro me 785 vende për akomodimin e fëmijëve, por deri në momentin e revizionit të kryer, asnjë nga këto kopshte nuk kishte filluar me punë.

Tri prej tyre u ndërtuan me mjete buxhetore përmes Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë në komunat e Sopishtës, Vasilevës dhe Shën Nikollës. Dy të tjera u financuan përmes huas së Bankës Botërore në kuadër të Projektit për Përmirësimin e Shërbimeve Sociale (PPSHS) dhe ndodhen në komunat e Haraçinës dhe Likovës. Një kopsht u ndërtua me mjetet e fondeve të IPA-së në Komunën e Tetovës, ndërsa një me mjetet e Komunës së Prilepit.

TË DHËNAT PËR KOPSHTET E NDËRTUARA RISHTAZI NË PERIUdhËN nga viti 2020 deri në tetor 2024, të cilat nuk kanë filluar me punë

VENDBANIMI / KOMUNA	VLERË E INVESTIMIT - PUNIMET NDËRTIMORE DHE PAJISJET	NUMRI I VENDEVE TË REJA PËR AKOMODIMIN E FËMIJËVE	DATA E HYRJES NË NDËRTIM	DATA E PRANIM-DORËZIMIT TË KOMUNËS	AKTIVENDIMI PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NGA MINISTRIA
SOPISHTË	18.736	57	26.06.2020	29.12.2021	11-4501/8 nga 23.11.2022
F. ANGELLCI, VASILEVË	15.378	55	24.06.2020	05.08.2022	NUK KA
F. ERXHELIA, SHËN NIKOLLË	24.632	72	27.12.2021	22.05.2024	NUK KA
HARAÇIN	57.969	115	13.10.2021	27.09.2023	11-6445/7 nga 15.11.2022
F. MATEÇ LIKOVË	58.101	114	05.11.2021	10.11.2023	11-1712/7 nga 17.07.2024
TETOVË	39.200	154	02.12.2021	22.11.2023	11-976/6 nga 09.05.2024
PRILEP	49.874	218	12.05.2021	09.10.2023	11-2659/11 nga 24.10.2024
TOTALI	263.890	785	-	-	-

Kopshtet në komunat e lartpërmendura po përballen me probleme serioze kur vihen në përdorim. Edhe pse objektet janë lëshuar tashmë, nuk janë përbushur të gjitha kushtet për vënie në përdorim, gjë që vjen për shkak të mungesës së burimeve të kuadrit për të filluar punën dhe detyrimeve të papërfunduara të komunës, të cilat çojnë në anulimet në fillimin e punës dhe e rrisin rrezikun e pasojave negative, dëmtimit të kopshteve dhe mungesës së kujdesit cilësor dhe të plotë për të gjithë fëmijët që kërkojnë kujdes në kopsht. Njëkohësisht, theksojmë se për shumicën e objekteve nuk janë ndërmarrë aktivitete për ofrimin dhe sigurimin e tyre, gjë që krijon rrezik për vjedhje dhe dëmtime të tjera të objekteve që në të ardhmen do të shkaktonin shpenzime shtesë

për punimet për të cilat tashmë janë shpenzuar mjetet financiare.

I tillë është rasti me kopshtin e sapondërtuar në f. Angellci në Komunën e Vasilevës, ku për shkak të mosndërmarrjes së masave për sigurimin e objektit dhe kujdesit nga themeluesi dhe kopshti amë, kontribuoi të ndodhin vjedhje dhe dëme të tjera në objekt. Kopshti, i ndërtuar me mjetet buxhetore dhe i dorëzuar komunës në gusht 2022, nuk është vënë në përdorim deri në ditën e njoftimit të revizionit, për shkak të mosndërmarrjes së masave për riparimin e dëmeve të ndodhura.



KOPSHTI NË F. ANGELLCI, KOMUNA E VASILEVËS



Aktivitetet e ndërmarra nga Ministria për të ndërtuar kapacitete të reja dhe për të zgjeruar kapacitetet në objektet ekzistuese me mjetet buxhetore nuk i kanë dhënë rezultatet e pritura në sigurimin e kushteve për mbulimin optimal të fëmijëve në sistemin e të drejtave të mbrojtjes së fëmijëve. Nga kapaciteti i projektuar total prej 1.057 fëmijë në 11 kopshtet e mbuluara nga punimet ndërtimore, në periudhën e analizuar kapacitetet u plotësuan në 3 kopshte me 158 vende, që paraqet 15% të kapacitetit të plotësuar në krahasim me kapacitetin e projektuar.

Për punimet e realizuara ndërtimore dhe pajisjet e kopshteve, Ministria për më shumë se 4 vjet ka paguar mjete buxhetore në shumën totale prej 252.887 mijë denarë ose 4.111.984 euro, nga të cilat 40.200 mijë denarë për kopshtet që funksionojnë dhe e ushtrojnë veprimtarinë për mbrojtjen e fëmijëve, ndërsa 212.687 mijë denarë ose 3.458.325 euro në kopshtet, ndërtimi i të cilave nuk ka përfunduar për periudhë më të gjatë kohore, të përfunduara, por nuk janë vënë në përdorim, si dhe punimet ndërtimore të filluara në vitin 2023.



EFEKTET E INVESTIMEVE TË KRYERA KAPITALE TË MINISTRISË NË PERIUdhËN NGA VITI 2020 DERI NË QERSHOR 2024

NË 000 DENARË

ÇERDHE TË PËRFSHIRA ME INVESTIMET KAPITALE	NUMRI	INVESTIMET ME MJETET BUXHETORE	NUMRI	INVESTIMET ME MJETET NGA KREDIA E BANKËS BOTRORE
Numri i çerdheve të përfshirë me investimet kapitale	11	252.887	16	790.804
Kapaciteti total i parashikuar për vendet e reja	1.057	-	1.961	-
Çerdhet në të cilat kanë përfunduar aktivitetet e ndërtimit dhe pranim-dorëzimi në komuna:	6	77.176	15	770.699
Pranim-dorëzimi i çerdheve (objektet) të cilat punojnë në 2024	3	40.200	12	597.294
Vende të reja të krijuara në çerdhet	158	-	1.471	-
Pranim-dorëzimi i çerdheve (objektet) të cilat kanë filluar të punojnë, por pastaj janë mbyllur	1	3.313	-	-
Vende të reja të krijuara në çerdhet (objekte)	20	-	-	-
Pranim-dorëzimi i çerdheve (objektet) në 2021 - 2022 të cilat nuk kanë filluar me punë	2	33.663	3	173.405
Vende të reja të krijuara në çerdhet të cilat nuk kanë filluar me punë	112	-	341	-
Çerdhet ku aktivitetet ndërtimore janë në rrjedhë	5	175.711	1	20.106
Kapacitetet e projektuara në çerdhet të cilat janë në rrjedhë me aktivitetet ndërtimore	767	-	149	-

Në drejtim të tejkalimit të gjendjeve të konstatuara, revizioni dha rekomandime për përmirësimin e gjendjeve në pjesën e: kornizës juridike dhe programore të sistemit për investim në kopshtet, regjistrin të të dhënave për kopshtet, planifikimit, financimit dhe realizimit të projekteve

për ndërtimin, zgjerimin, përshtatjen dhe pajisjen e kopshteve, si dhe kapaciteteve për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve, me qëllim të arritjes së mbulimit optimal dhe rritjes së numrit të fëmijëve të moshës parashkollore.

5.3.4.

VETËQEVERISJA LOKALE DHE ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL

5.3.4.1.

EFEKTET E INVESTIMEVE PUBLIKE NË ZHVILLIMIN E BARABARTË RAJONAL



Realizuar revizionin e suksesit me temë "Efektet e investimeve publike në zhvillimin e barabartë rajonal" me qëllim që t'i përgjigjemi pyetjes "A janë planifikuar dhe zbatuar investimet publike për zhvillimin e barabartë rajonal në mënyrë efektive dhe a janë ato të qëndrueshme në planin afatgjatë?"

U përfshinë shtatëdhjetë e gjashtë (76) investime publike, për të cilat u ndanë mjete nga Buxheti në shumën prej 2.041.277 mijë denarë, përkatësisht 33,2 milion euro, dhe projekte për menaxhimin rajonal të mbeturinave për shtatë (7) rajone të financuara me hua, grante dhe mjete buxhetore në shumën prej 144 milion euro.



Masat dhe aktivitetet e ndërmarra për të ndarë mjete për zhvillim të barabartë rajonal në shumën prej të paktën 1% të BPV-së nga Buxheti në nivel vjetor nuk janë arritur, përzgjedhja e projekteve nuk është efektive për të financuar projektet e investimeve publike për nevojat e qytetarëve me ndikim në zhvillimin rajonal, ndërsa nuk është vendosur monitorimi efikas dhe mungon sistemi për vlerësimin e qëndrueshmërisë së projekteve para se të miratohen dhe pas përfundimit.

Projektet e investimeve publike të financuara përmes Programit për Zhvillim të Barabartë Rajonal dhe Programit për Uljen e Dispariteteve midis Rajoneve janë përzgjedhur në procedurë transparente, në përputhje me rregullativën për zhvillim të barabartë rajonal, por ndarja e mjeteve vetëm në rajonet planifikuese/komunat sipas shkallës së zhvillimit të rajoneve planifikuese nuk i jep rezultatet e pritura. Në procedurën e vlerësimit dhe përzgjedhjes së projekteve përmes këtyre programeve, nuk ka fusha të qarta prioritare, pas thirrjes, u miratuan mjetet për financimin e projekteve në fusha të ndryshme: mjedisi jetësor, transporti, arsimi, ndihma sociale.

Konstatuam praktikë të mirë në ndarjen e mjeteve për komunat/rajonet në projektet e financuara me hua dhe grante për shkak të përkufizimit të më shumë kriterëve për ndarjen, përkatësisht: shkalla e zhvillimit, numri i banorëve, vendbanimet, shuma lineare.

Përmes Buxhetit të ministrive në periudhën 2021-2023, mjetet u transferuan te komunat për financimin e projekteve pa zbatuar procedurën transparente dhe pjesëmarrëse për përzgjedhjen e komunave dhe përzgjedhjen e projekteve.

Në vitin 2023, 72% e dotacioneve kapitale iu ndanë 41 komunave për 67 projektet e drejtpërdrejta, pa thirrje publike, me vendime të Qeverisë, pas amendamentit të miratuar në Kuvend në procedurë të rregulluar me Ligjin për buxhete.

Për përzgjedhjen nuk ka procedurë të përzgjedhjes për komunat dhe projektet, ndërsa në realizimin nuk është vendosur monitorimi efikas i zbatimit të këtyre projekteve.



²⁸ Për projektin "Ndërtimi i udhëkryqit në kryqëzimin midis bulevardit Nikolla Karev dhe bulevardit Sllovenia - faza e dytë", janë marrë mjete në shumën prej 120.000 mijë denarë në vitin 2021, kontrata e prokurimit publik u lidh pas dy vite e katër muaj.

Për proProjektin "Ndërtimi i plotë i Korridorit Jugor si zgjidhje për bulevardin" dhe projektin "Ndërtimi i plotë i Bulevardit KAÇKM dhe Ndërtimi i Bulevardit Hasan Prishtina (Vizbeg)", janë ndarë mjete në shumën prej 600.000 mijë denarë, por nuk janë lidhur kontrata për realizim.

Janë ndarë mjete për realizimin e projekteve për komunat, mjetet janë transferuar, por projektet janë në fazën fillestare ose nuk kanë filluar, përkatësisht:

/// Në periudhën 2021-2023, Qytetit të Shkupit iu ndanë mjete përmes Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve në shumën prej 720.000 mijë denarë për ndërtimin e projekteve infrastrukturore që ndodhen në llogaritë e dedikuara në Qytetin e Shkupit ²⁸, ndërsa projektet nuk kanë filluar.

/// Në vitin 2023, Komunës së Manastirit iu ndanë mjete përmes Ministrisë së Transportit për ndërtimin e bulevardit në shumën prej 110.000 mijë denarë, ndërsa projekti ka filluar të realizohet;

/// Në periudhën 2020-2023, Komunës së Strumicës iu ndanë mjete përmes Ministrisë së Transportit për ndërtimin e vendbanimit social (faza e parë dhe e dytë) në shumën prej 191.000 mijë denarë, faza e parë është realizuar, ndërsa faza e dytë nuk ka filluar. Mjetet e ndara për fazën e dytë në shumën prej 65.000 mijë denarë janë transferuar nga llogaria e dedikuar në llogarinë themelore të buxhetit të komunës.

/// Në vitin 2023, Komunës së Çuçer Sandevës përmes MMJPH-së i janë ndarë mjete për ndërtimin e stacionit të pastrimit në shumën prej 60.000 mijë denarë, ndërsa realizimi i projektit nuk ka filluar për shkak të vlerës së parashikuar të projektit në shumën prej 223.472 mijë denarë.

/// Në vitin 2023, Komunës së Prilepit përmes MMJPH-së për projektin për përfundimin e fabrikës për riciklimin e mbeturinave i janë ndarë mjete në shumën prej 90.000 mijë denarë. Projekti filloi të ndërtohet në vitin 2013, ndërsa pas zbatimit të procedurës së prokurimit publik në vitin 2024, u lidhën kontratat për përfundimin e projektit.



Projektet sektoriale të menaxhimit të mbeturinave të financuara me hua, grante dhe mjete nga Buxheti për nevojat e komunave në shumën prej 144 milion euro janë projekte të mëdha për nga vlera dhe efektet që duhen arritur me realizimin e tyre, por për to kemi konstatuar rreziqe të konsiderueshme në mënyrën e planifikimit dhe zbatimit për shkak të komunikimit të dobët, koordinimit në nivel qendror dhe lokal, mungesës së vendimeve të miratuara nga këshillat komunalë për t'i pranuar projektet, rrezikut të arritjes së qëllimeve në mjedisin jetësor dhe rreziqeve të larta fiskale për shkak të humbjes së mjeteve nga grantet e BE-së dhe vlerësimit joreal të projekteve për shkak të analizave joadekuate për vlerësimin e tyre.

Me revizionin e kryer, konstatuam se nuk ka sistem të vendosur për të kontrolluar nëse investimet publike janë vënë në përdorim dhe nëse janë evidentuar në librat e punës.

Për shkak të mungesës së kontrollit vendimtar nga shteti për vlerësimin e projekteve në fazën e planifikimit me qëllim të vlerësimit të pjekurisë dhe qëndrueshmërisë së tyre, si dhe kontrollit eks post të projekteve pas përfundimit të projektit, megjithëse mjetet publike janë shpenzuar, ekziston rreziku i lartë që mos të arrihen efektet e investimeve publike në zhvillimin rajonal dhe qëllimet e projektit, si dhe rreziku i shfrytëzimit jo me dedikim i mjeteve.

Për t'i tejkalar gjendjet e mësipërme, kemi dhënë rekomandime që synojnë ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve nga institucionet kompetente në drejtim të sistemit më efikas të ndarjes së mjeteve për investimet publike për zhvillim të barabartë rajonal, sistemit të vlerësimit të projekteve, monitorimit efikas të zbatimit dhe rritjes së transparencës në shfrytëzimin e mjeteve buxhetore.



5.3.5.

CILËSIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE GRUMBULLIMI, SHPENZIMI DHE SHFRYTËZIMI I MJETEVE DHE BURIMEVE PUBLIKE

5.3.5.1.

PËRMIRËSIMI DHE AVANCIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE OBJEKTEVE INFRASTRUKTURE ME PARTNERITETIN PRIVAT PUBLIK




Revizioni me temë **"Përmirësimi dhe avancimi i shërbimeve publike dhe objekteve infrastrukturore me partneritet publiko privat"** u realizua në përputhje me Programin Vjetor të Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024. Qëllimi i revizionit ishte t'i japë përgjigje pyetjes "A ofrojnë masat dhe aktivitetet e ndërmarra për të vendosur dhe realizuar kontratat e partneritetit privat publik shërbime publike efikase dhe objekte të përmirësuara infrastrukturore?". Revizioni mbulon periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2024.

Me revizionin e kryer, konstatuam se në partneritetin privat publik (PPP) u investuan mjete të konsiderueshme nga partnerët publikë dhe privatë. Ka mangësi në kornizën ligjore dhe institucionale, në proceset e

dhënies dhe zbatimit të kontratave, të cilat së bashku me konkurrencën e kufizuar dhe kontratat e realizuara në mënyrë joadekuate nuk i kanë përmbushur pritshmëritë për ofrimin e shërbimeve publike efikase dhe përmirësimin e ndjeshëm të objekteve infrastrukturore.

Gjatë kryerjes së revizionit, u konstatua se ishin lidhur gjithsej 68 kontrata për ndarjen e PPP-së, por për shkak të evidencës së vendosur në mënyrë joadekuate, numri i kontratave të lidhura të PPP-së mund të jetë më i lartë. Struktura e kontratave të lidhura të PPP-së sipas partnerit publik dhe llojit të kontratës është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



Revizioni i kryer përfshiu 25 procedura të PPP-së, me ç'rast nga të dhënat në dispozicion u konstatua se partneri publik kishte arkëtuar kompensime nga partneri privat në shumën prej 89.780 mijë denarë, ndërsa partnerit privat i pagoi kompensime në shumën prej 188.488 mijë denarë. Përveç kësaj, pjesëmarrja e partnerëve privatë në kontratat e mbuluara për themelimin e PPP-së është 2.292.518 mijë denarë (vlera e prokuruar e objekteve të ndërtuara). Pjesëmarrja e partnerit publik është e rëndësishme, por kjo nuk mund të shprehet në vlerë, duke qenë se bëhet fjalë për të drejta të ceduara (pëlqime dhe leje të siguruara për ndërtim, aktvendime), cedimin e tokës, objekteve dhe pajisjeve të ndërtimit.

Në mënyrë plotësuese, nuk kryhet matja dhe ndjekja e rregullt e efekteve të kontratave të lidhura të PPP-së, prandaj nuk mund të përcaktohet dhe konfirmohet ndikimi i tyre në cilësinë e shërbimeve publike dhe zhvillimin infrastrukturor të vendit.

Procedura për ndarjen e kontratave për vendosjen e PPP-së zbatohet pa aktivitete përgatitore të detajuara, përkatësisht në 80% të procedurave të zbatuara për vendosjen e kontratave të PPP-së që ishin lëndë e revizionit, nuk u hartuan Raporte për analizën paraprake, ku duhet të theksohen elementet themelore të projektit.

ECURIA E PROCEDURËS PËR VENDOSJEN E PPP-SË



Analiza e ankandëve të zbatuara elektronike, të mbuluara nga revizioni, tregon se afërsisht 80% e kontratave u lidhën me ofertuesin e vetëm më të volitshëm, gjë që tregon mungesën e konkurrencës.

Gjatë revizionit, u konstatuan dobësi në përmbajtjen e kontratave të lidhura të PPP-së, gjë që është mundësi e mospërmbushjes së detyrimeve nga partneri privat, mbrojtje juridike joadekuate që nuk krijon kushte për arkëtimin e dënimeve penale në rast të ekzekutimit jocilësor / mosekzekutimit të kontratave.

Gjithashtu, në rastet individuale, janë konstatuar parregullsi në pjesën e vendosjes dhe zbatimit të kontratave të PPP-së, që nuk mundëson arritjen e vlerës më të mirë për mjetet e investuara monetare. Ekziston shembulli i kontratës së PPP-së të lidhur me kohëzgjatje prej 96 vjet, gjë që është në kundërshtim me limitin ligjor nga më së shumti prej 35 vjet.

Procedurat gjyqësore janë duke vazhduar në të cilat partneri publik paraqitet si i paditur për borxh prej afërsisht 239.755 mijë denarë.

Me revizionin e kryer në procedurat e veçanta të detajuara, revizorët konstatuan dobësi në mënyrën e vendosjes dhe realizimit të kontratave të PPP-së.

1. Në vitin 2011, Qeveria filloi ndërtimin e Kompleksit "Fshati Maqedonas", i cili ndodhet në f. Nerez i Epërm, me qëllim të zhvillimit dhe avancimit të turizmit, etnologjisë, ruajtjes së arkitekturës dhe ushqimit tradicional maqedonas. Vlera totale e investimit është 293.961 mijë denarë. Investimi i lartpërmendur nuk i ka dhënë rezultatet e pritura, prandaj, për të gjetur zgjidhje dhe vlerën e tij të përdorimit, në vitin 2016 u lidh kontrata për vendosjen e PPP-së. Të ardhurat e pritura për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës janë 53.800 mijë denarë, që është 18% e investimit total. Kontrata u lidh pa aktivitete

dhe analiza të mjaftueshme përgatitore dhe nuk siguroi bashkëpunim afatgjatë dhe përfitime ekonomike, për arsye se ajo ishte ndërprerë nga koncesionari në tetor 2018, për shkak të joprofitabilitetit ekonomik, а, поради економска неисплатливост.



Duke marrë parasysh investimin e konsiderueshëm në ndërtimin e objektit, revizioni tregon se nëse Kompleksi "Fshati Maqedonas" nuk vihet në funksion dhe nuk mirëmbahet rregullisht në të ardhmen, ekziston rreziku që ai të dëmtohet plotësisht nga ndikimet e jashtme, faktori njeri dhe ndikimet e tjera të dëmshme.

- Në vitin 2019, Qeveria miratoi Vendim për të filluar procedurën për ndarjen e kontratës për vendosjen e PPP-së për menaxhimin e integruar të zgjidhjeve inovative për ndërhyrjet kirurgjikale dhe mbrojtjen shëndetësore nga infeksionet spitalore, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të integruara për menaxhimin e stacioneve qendrore të sterilizimit, sigurimin e instrumenteve kirurgjikale sterile dhe materialit mjekësor (veshjes) për një përdorim në sallat kirurgjikale, trajtimin e rreziqeve nga mbetjet biologjike dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale.

Në dhjetor 2019, u lidh kontrata e PPP-së midis Qeverisë përmes Ministrisë së Shëndetësisë si partner publik dhe një grupi operatorësh ekonomikë si partner privat, për periudhë 15-vjeçare, me anë të së cilës partneri privat u zotua të rinovonte dhe përshtaste katër objekte në Qendrat e Sterilizimit, brenda dy viteve, përkatësisht deri në dhjetor 2021. Për shkak të kushteve të papërmbushura plotësisht nga partneri publik, afati i realizimit është prolonguar shumë herë në kohë të pacaktuar.

Komisioni për Ndjekjen e Realizimit të Kontratës së PPP-së konstatoi se partneri privat ka rinovuar, përshtatur dhe pajisur plotësisht vetëm një Qendër të Sterilizimit të Pajisjeve Kirurgjikale (objekti në "Majçin Dom" - Shkup), ndërsa aktivitetet nuk kanë filluar në tre objektet e tjera, sepse ato nuk i janë dorëzuar në posedim partnerit privat.



Në maj të vitit 2024, Komisioni vizitoi përsëri ambientet e ISHP KU të Gjinekologjisë dhe Obstetrikës "Nënë Tereza" Shkup dhe konstatoi se protokollet dhe standardet për fillimin e punës ishin respektuar, por deri në përfundimin e revizionit, bashkëpunimi nuk ishte vendosur ende.

Në gusht të vitit 2024, me qëllim të informimit mbi progresin e zbatimit të kontratës së PPP-së, Ministria e Shëndetësisë përgatiti dhe i dërgoi Qeverisë informacion, i cili u shqyrtua si dokument me karakter informativ, pa dhënë propozim - konkluzione për veprimin e mëtejshëm.

Revizorët theksojnë se nëse nuk vendoset bashkëpunimi midis dy partnerëve dhe nuk gjendet zgjidhja e përbashkët, ekziston rreziku i dëmeve të mundshme për të dyja palët. Këto dëme nuk kufizohen vetëm në aspektet ekonomike, por mund të kenë edhe ndikim negativ në perceptimin publik të institucioneve dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore të cilat u ofrohen qytetarëve.

3. Во ноември 2021 година, склучен е договор за доделување на ЈПП за управување со паметни туристички инфо и промо центри во Полошкиот регион. Предмет на договорот е обезбедување услуги за функционирање на вакви центри на две локации – во Тетово и Попова Шапка. Од страна на јавниот партнер обезбедени се монтажни објекти од привремен карактер, додека во договорот не се прецизирани конкретно обврски на приватниот партнер. Договорот е склучен со вкупна вредност од 60.000 илјади денари, со цел да се обезбедат навремени и квалитетни информации за туристите поврзани со сместување, угостителство, настани и други релевантни содржини, како и да се поддржат маркетинг иницијативи, промоција на локални производи и креирање атрактивни туристички понуди кои ќе го поттикнат развојот на туризмот во регионот.



4. Në vitin 2012, SHA Ekonomia e Ujërave - filiali "Tikvesh" Kavadar, bazuar në studimin paraprak të fizibilitetit për rikonstrukcionin e objekteve ekzistuese dhe zbatimin e 4 MHC-ve të reja në Lumin e Boshavës, zbatoi procedurë për vendosjen e kontratës së PPP-së. Në të njëjtin vit, u lidh kontrata e PPP-së për realizimin e projektit Boshava për shfrytëzimin e ujit me qëllime të shumta, me të cilën është rregulluar që partneri privat të ndërtojë 5 MHC. Numri i MHC-ve nuk është në përputhje me studimin e fizibilitetit, thirrjen publike dhe dokumentacionin e tenderit për vendosjen

e PPP-së. Gjendja e lartpërmendur tregon se kontrata e lidhur e PPP-së nuk është harmonizuar me aktivitetet përgatitore dhe procedurën e zbatuar për ndarjen e kontratës, gjë që mund të ndikojë në justifikimin dhe cilësinë e kryerjes së veprimtarisë së partnerit publik.



Në pjesën e kornizës juridike, është konstatuar mungesa e politikave nacionale dhe strategjisë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e PPP-së, gjë që ndikon negativisht në planifikimin e projekteve, shpërndarjen e burimeve dhe përkufizimin e prioritetëve. Kjo, nga ana tjetër, e bën të vështirë tërheqjen e operatorëve ekonomikë dhe ngadalëson zhvillimin e shërbimeve dhe infrastrukturës publike cilësore.

Edhe pse Këshilli i PPP-së ishte emëruar dy herë nga Qeveria, si trup i rëndësishëm këshillëdhënës për avancimin dhe zbatimin efektiv të PPP-së në vend, përsëri nuk e ka kryer funksionin ligjor. Për këtë arsye mungojnë aktivitetet promovuese për PPP-në, propozimet për projektet e lidhura me ndihmën e PPP-së, iniciativat dhe propozimet për ndryshimin e rregullave në këtë fushë.

Ekzistojnë dobësi në rregullativën ligjore nacionale për PPP-në, që ndikon në mënyrë të pavolitshme në mënyrën e planifikimit, vendosjes, menaxhimit, ndjekjes dhe llogaridhënies për projektet e PPP-së dhe respektimi jo i plotë i parimeve të barazisë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe transparencës në procedurat. Në mënyrë plotësuese, nuk parashihet ekzistimi i Sistemit të Vetëm Elektronik të PPP-së, përmes të cilit të gjitha procedurat do të zbatoheshin në mënyrë transparente dhe do të mundësohej mbajtja automatike e regjistrit të kontratave të ndara.

Mungesa e Sistemit të Vetëm Elektronik të PPP-së dhe Regjistri i Kontratave të Ndara të PPP-së i përditësuar jo plotësisht (i mbajtur si pasqyrë tabelare në Excel), i cili duhet të jetë bazë e vetme e të dhënave për ndjekjen e të gjithë procesit, ndikon në zbatimin me sukses të ligjit dhe nuk ofron qasje transparente dhe të unifikuar në informacionet mbi kontratat e lidhura.

Mënyra se si rregullohet mbikëqyrja nuk është saktësuar mjaftueshëm dhe nuk mundëson ndjekjen dhe informimin në kohë mbi shkallën e realizimit të kontratave. Rregullativa ligjore nuk përmban dispozita të kundërvajtjes për mosdërgimin e njoftimit të kontratës së lidhur, as dispozita për njoftimin e kontratës së ndërprerë të PPP-së nga partneri publik në ME, gjë që ndikon në mirëmbajtjen e përditësuar të Regjistrit të Kontratave të Ndara për vendosjen e PPP-së dhe plotësinë e tij. Ekipimi i pamjaftueshëm i kuadrit të partnerët publikë ndikon në mënyrë të pavolitshme në mënyrën se si zbatohen aktivitetet e mbikëqyrjes në PPP.



5.3.6.

GIJQËSORI DHE SUNDIMI I SË DREJTËS

5.3.6.1.

REFORMA E SISTEMIT PENITENCIAR



Qëllimi i revizionit ishte t'i jepte përgjigje pyetjes "A kontribuojnë aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente në avancimin dhe humanizimin e sistemit për ekzekutimin e sanksioneve dhe reformave në sistemin penitenciar" dhe të jepte rekomandime për ndërmarrjen e masave për përmirësimin e gjendjeve.

Me revizionin e kryer dhe metodologjinë e aplikuar të revizorit, dëshmitë e grumbulluara të revizorit, kemi fituar bindje të arsyeshme se aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente nuk kontribuojnë plotësisht në avancimin dhe humanizimin e sistemit për ekzekutimin e sanksioneve dhe reformave në sistemin penitenciar.

Kushtet materiale në institucionet ose departamentet individuale brenda institucioneve dhe mbipopullimi nuk kontribuojnë në sigurimin e kushteve njerëzore të akomodimit, siç parashikohen në standardet ndërkombëtare në këtë fushë, respektimin e personit dhe dinjitetit të personave të privuar nga liria. Prolongimi i periudhës së investimeve për ndërtimin e objekteve në Segmentin 2 të DHNP Idrizovë në kuadër të Projektit "Rikonstruksioni i INP-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut" i filluar në vitin 2010, kryesisht si rezultat i mjeteve të pasiguruara buxhetore për realizimin e projektit, por edhe zbatimit jo në kohë dhe jo të plotë të vërejtjeve dhe rekomandimeve të BRSE-së, nuk kontribuon në rritjen e kapaciteteve të akomodimit dhe përmirësimin e kushteve.



FOTOGRAFIA: OBJEKTI I AMBULANTËS SË DHPN IDRIZOVË



FOTOGRAFIA: PARABURGIMI BURGU I SHKUPIT

Për shkak të mungesës së mjeteve financiare, institucionet nuk mund të planifikojnë aktivitetet, t'i realizojnë aktivitetet e planifikuara dhe t'i shlyejnë detyrimet nga vitet e kaluara.

Institucionet nuk kanë pajisje të sigurisë, as nuk është vendosur koncepti i unifikuar për mbikëqyrjen vizuale-elektronike dhe mirëmbajtjen e mbikëqyrjes me video, as nuk kanë detyrim të paraparë për të hartuar projekte / plane për t'i përcaktuar të gjitha pikat kryesore të rrezikut, numrin dhe llojin e nevojshëm të kamerave, vendndodhjen e kamerave të mbikëqyrjes me video, dhe në bazë të analizës së mëparshme të përgatitur nga personat profesionalë të fushës.

Për shkak të numrit të pamjaftueshëm të pjesëtarëve të policisë së burgjeve, janë rritur shpenzimet për punën jashtë orarit, ndërsa paditë nga policia e burgjeve për punë më të gjatë se orari i plotë i punës dhe shtesat e tjera të rrogës kontribuojnë në rritjen e shpenzimeve gjyqësore dhe pagesave sipas aktvendimeve ekzekutive.

Nuk është siguruar plotësisht mbrojtja shëndetësore për personat e privuar nga liria për shkak të personelit të pamjaftueshëm mjekësor, ndërsa mungesa e të dhënave të përditësuara mbi sigurimin e detyrueshëm shëndetësor çon në mosrealizimin e së drejtës për sigurim shëndetësor për personat që vuajnë dënim me burg dhe vuajnë masa edukuese në dhomën edukativo-korrektuese. Specifikimi teknik për prokurimin e ushqimit nuk është i unifikuar, prandaj institucione të caktuara kanë ushqim më të larmishëm sesa institucionet e tjera, si dhe dallime të konsiderueshme në çmimet e artikujve ushqimorë midis institucioneve.

Mënyra e vendosur e trajtimit dhe ndihmës paspenale për personat e dënuar nuk siguron risocializimin dhe përshtatjen e tyre sociale në shoqëri. Në INP, përfitime shfrytëzojnë të gjithë personat e dënuar të cilëve këtë ua lejon grupi i trajtimit, me kusht që nëse kundër tyre nuk është iniciuar procedurë disiplinore, pavarësisht nga rezultatet që arrijnë në angazhimin e tyre në punë.

Institucionet nuk kanë kuadër të mjaftueshëm me instruktorë, të cilët mund të ofrojnë aftësim profesional për personat e dënuar, dhe nuk kanë numër të mjaftueshëm edukatorësh për t'i zbatuar masat e trajtimit. Nuk është zbatuar procesi edukativ për personat e dënuar dhe fëmijët në DHKE.

Rreth 8% e personave të dënuar janë të angazhuar jashtë institucioneve, për të cilët nuk sigurohet

kontroll i plotë mbi punën e tyre. Ekziston përqindje e ulët e shfrytëzimit të ndihmës paspenale, e cila është një nga arsyet e mundshme për recidivizëm në INP.

Zhvillimi i pamjaftueshëm i shërbimit të provës në sistemin e drejtësisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në drejtim të zbatimit të masave përkatëse dhe të qëndrueshme për riintegrimin e autorëve në komunitet të cilët kryejnë masa alternative, si dhe shqiptimi i pamjaftueshëm i masave të shërbimit të provës nga organet kompetente, ndikon pamjaftueshëm në arritjen e qëllimit themelor të shërbimit të provës dhe në zvogëlimin e popullsisë së burgjeve.

Kryerja e punëve të shërbimit të provës nga nëpunësit e shërbimit të provës përfshin edhe ndjekjen elektronike dhe përdorimin e byzlykëve gjatë ndjekjes së ekzekutimit të vendimit me të cilin është shqiptuar arresti shtëpiak me mbikëqyrje elektronike. Në tetor të vitit 2015, nëpërmjet Projektit IPA 10 - Mbështetja e mëtejshme për gjyqësor të pavarur, të përgjegjshëm, profesional dhe efikas dhe promovimi i shërbimit të provës dhe sanksionimit alternativ, i financuar nëpërmjet Ministrisë së Financave-CFCD, u prokuruan pajisje për mbikëqyrje elektronike në vlerën prej 52.043 mijë denarë, që përfshin 400 byzlykë për ndjekjen elektronike dhe pajisjen shoqëruese që deri në ditën e njoftimit me revizion, nuk ishte siguruar funksionimi i sistemit, gjë që paraqet rrezik të ndikimit të mundshëm financiar në shumën prej 634 mijë euro në buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Më 12.12.2024, u lidh Kontrata midis DES-së dhe operatorit ekonomik për prokurimin e shërbimeve për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e pajisjeve informatike për mbikëqyrjen elektronike gjatë ekzekutimit të arrestit shtëpiak ose liritimit me kusht për nevojat e DES-së, e cila përcaktoi dinamikën për ekzekutimin e lëndës së prokurimit dhe për të siguruar funksionimin e plotë të sistemit.

Në periudhën 2021-2024, nuk është kryer mbikëqyrja e rregullt e punës së të gjitha institucioneve nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, as nuk është kryer mbikëqyrja kontrolluese, gjë që mund të çojë në mosveprimin e institucioneve sipas vërejtjeve dhe afateve të përcaktuara në urdhrin nga mbikëqyrja e rregullt dhe heqjen e tyre në kohë.

Për gjendjet e konstatuara, revizioni dhe rekomandime, zbatimi i të cilave do të siguronte tejkalimin e tyre.



5.3.7.

TRAFIKU, TRANSPORTI DHE KOMUNIKIMET

5.3.7.1

SIGURIA NË TRAFIKUN RRUGOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Menaxhimi i sigurisë në trafikun rrugor u referohet normave, metodave dhe masave të parandalimit dhe sanksioneve të përdorura për të parandaluar ose zvogëluar pasojat e padëshiruara për pjesëmarrësit në trafik.

Me Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2015-2030 ²⁹, prioritetet nacionale të zhvillimit, të drejtat ndërkombëtare të njeriut, obligimet për barazinë gjinore dhe Agjenda 2030 nevojitet:



deri në vitin 2020 të përgjysmohet numri i vdekjeve dhe lëndimeve nga aksidentet e trafikut në nivel global, dhe



deri në vitin 2030, ndër të tjera, të përmirësohet siguria rrugore, në veçanti përmes zgjerimit të transportit publik, me vëmendje të veçantë për nevojat e personave të cenueshëm, grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve.


Të dhënat e disponueshme publikisht nga ueb-faqja e MPB-së tregojnë gjendjet shqetësuese në lidhje

me numrin e aksidenteve në trafik që ndodhin në rrugët e vendit. Pra, në periudhën 2020-2023 kanë ndodhur gjithsej 31.176 aksidente trafiku, nga të cilat 15.724 kanë pasur pasoja të rënda për pjesëmarrësit në aksidentet e trafikut, ndërsa 492 persona kanë humbur jetën.

Kemi kryer revizionin e suksesit me temë **“Siguria në trafikun rrugor në Republikën e Maqedonisë së Veriut” me qëllim që t’i përgjigjemi pyetjes “A e menaxhojnë institucionet kompetente sigurinë në trafikun rrugor në vend në mënyrë efikase?”**

Vlerësuar se masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente, megjithëse kontribuojnë në përmirësimin e kushteve për menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor, nuk janë efikase në uljen e viktimave nga aksidentet në trafik në gjendjen e dëshiruar në nivel nacional dhe evropian.

Aktivitetet e revizorit kishin për qëllim t’u përgjigjeshin nënpyetjeve të mëposhtme:



A janë krijuar kushtet normative për zbatimin efikas të aktiviteteve të institucioneve kompetente për menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor në vend?



A kontribuojnë aktivitetet e institucioneve kompetente në menaxhimin efikas të sigurisë në trafikun rrugor në vend?



A ekziston sistemi efikas për njoftimin, monitorimin dhe vlerësimin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor në vend?

²⁹ Qëllimet Globale të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara

Në pjesën e kushteve normative, kemi konstatuar më shumë gjendje, si në vijim:

Strategjia Nacionale për Siguri në Trafikun Rrugor për periudhën 2015-2020 është strategjia e dytë dhe e fundit nacionale për përmirësimin dhe forcimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor. Për periudhën nga miratimi i saj deri në ditën e revizionit, nuk është hartuar asnjë dokument i vetëm për të vlerësuar efektet e masave dhe aktivitetet e planifikuara, as raport mbi shkallën e realizimit të tij, për shkak të faktit se Qeveria nuk ka themeluar Trup Koordinues që është kompetent për aktivitetet e theksuara.

Strategjia Nacionale për Siguri në Trafikun Rrugor 2015-2020 kishte për qëllim::

- /// numri i viktimave të aksidenteve në trafik deri në vitin 2020 të zvogëlohet në numrin mesatar të viktimave në vendet anëtare të Bashkimit Evropian;
- /// numri i viktimave – shoferë të rinj – të zvogëlohet për 30%;
- /// numri i personave të lënduar seriozisht të zvogëlohet për 40% dhe
- /// numri i fëmijëve viktimë në aksidentet e trafikut të zvogëlohet në zero.

Konstatuam se qëllimet e strategjisë nacionale 2015-2020 nuk janë arritur, përkatësisht:


- /// numri i viktimave në aksidentet e trafikut në vitin 2020 nuk ka rënë në mesataren në vendet anëtare të BE-së. Pra, numri i personave të vdekur në aksidentet e trafikut shënon rënie, më pas numri i vdekjeve për 1 milion banorë në vend është 62 persona dhe është për 20 persona më i lartë se numri i personave të vdekur për 1 milion banorë në BE në vitin 2020, që është 42 persona;
- /// qëllimi i uljes së numrit të viktimave - shoferëve të rinj për 30% nuk është i matshëm, sepse kategoria "shofer i ri" nuk është përkufizuar;
- /// numri i personave të lënduar seriozisht, i cili në vitin 2020 arriti në 801 persona, nuk është ulur për 40% krahasuar me vitin 2009 kur arriti në 985 persona;
- /// numri i fëmijëve - viktimë në trafik të jetë zero nuk është arritur dhe ai në vitin 2020 është 8 persona³⁰.



³⁰ Llogaritja përfshin kategoritë e moshës nga 0 deri në 17 vjeç.



GRAFIKU 1: NUMRI I PERSONAVE TË VDEKUR NË AKSIDENTET E TRAFIKUT PËR MILION BANORË NË VENDET E BE-SË DHE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT 2017-2023



Për periudhën pas vitit 2020, nuk është hartuar strategjia e re, e tretë nacionale.


Në mungesë të Strategjisë Nacionale, Qeveria i përcakton dhe zbaton politikat e menaxhimit të sigurisë në trafik përmes dokumenteve të tjera strategjike dhe të planifikimit në fushën, në koordinim me institucionet e tjera kompetente.

Pra, është hartuar Strategjia Nacionale e Transportit 2018-2030 - SNT dhe ai është dokument strategjik operativ për përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës dhe shërbimeve të transportit, me aktivitete që lidhen me avancimin e sigurisë rrugore në vend, bazuar në politikën e transportit të BE-së, politikën e transportit të përcaktuar nga Observatori i Transportit të Evropës Juglindore (SEETO), që vazhdon me Kontratën për Themelimin e Komunitetit të Transportit, të ratifikuar nga Republika e Maqedonisë në vitin 2017. Ministria e Transportit është e ngarkuar për ndjekjen e zbatimit.

Raporti i Komunitetit të Transportit për vitin 2023 shënon nivel të ulët të progresit të përgjithshëm në zbatimin e Planit të Veprimit për Sigurinë Rrugore në RMV, i cili është kryesisht për shkak të mungesës së strategjisë nacionale për sigurinë rrugore për periudhën 2021-2030, si dhe aktiviteteve të papërfunduara për ndryshimin e rregullativës ligjore dhe themelimin e Agjencisë për Sigurinë Rrugore.

Gjithashtu, është hartuar Strategjia Nacionale për Sistemet Inteligjente të Transportit 2023-2032 - SIT në kuadër të Projektit për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor, për përgatitjen e të cilit u realizuan 17.700 mijë denarë me hua nga BNRZH-Banka Botërore, e miratuar në vitin 2019.

GRAFIKU 2: REALIZIMI I AKTIVITETEVE QË LIDHEN ME SIGURINË NË TRAFIKUN RRUGOR TË PARASHIKUARA ME SIT



Konstatuam se ka realizim të ngadaltë të aktiviteteve të parashikuara në dy strategjitë nacionale, gjë që nga ana e vet shkakton vazhdimin e afateve, shfrytëzimin joefikas të mjeteve, krijon shpenzime të reja dhe nuk mundëson arritjen e efekteve të pritura për rritjen e sigurisë rrugore dhe uljen e numrit të aksidenteve dhe viktimave të trafikut.

Në drejtim të zhvillimit dhe zbatimit të politikave përkatëse, zhvillimit të qëllimeve dhe planeve të veprimit për menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor, Instituti i Standardizimit, në vitin 2019, përgatiti Standard Nacional Maqedonas "MKC ISO 39001:2019 - Sistemet e menaxhimit të sigurisë në

trafik (RTS) - Kërkesat me udhëzimin për përdorim", i pajtueshëm me "ISO ndërkombëtare 39001:2012/ Amd 1:2024-Road traffic safety (RTS) management systems-Requirements with guidance for use". Standardi nuk është i detyrueshëm për institucionet në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë krijimit të politikave përkatëse.

Edhe pse Kuvendi ka detyrimin me propozim të Qeverisë të miratojë Strategji për Zhvillimin dhe Mirëmbajtjen e Rrugëve Shtetërore, zbatimi i së cilës është në kompetencë të Ministrisë së Transportit, që nga përcaktimi i këtij detyrimi ligjor në vitin 2008 deri në ditën e këtij revizioni, strategjia e lartpërmendur nuk është miratuar.

Në pjesën e ligjeve dhe akteve nënligjore, janë bërë ndryshimet në rregullativën ligjore në fushën përkatëse në drejtim të forcimit të masave dhe aktiviteteve për siguri më të madhe rrugore, siç janë vlerësimet e ndikimit në sigurinë rrugore, por ato vlejnë vetëm për rrugët TEM ³¹, ndërsa zbatimi i tyre do të fillojë pas anëtarësimit të vendit në BE.

Kemi kryer analizën e aktiviteteve të ndërmarra nga institucionet kompetente, kryesisht: Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Transportit, Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore dhe Këshilli Republikan për Siguri në Komunikacionin Rrugor.

Në drejtim të sigurimit të të dhënave të nevojshme brenda BE-së, protokollin CADA^S është zhvilluar si grup minimal i të dhënave të standardizuara që mundëson të dhëna dhe analiza të krahasueshme të aksidenteve në trafik në nivel evropian.

MPB-ja ka vendosur bazë të dhënash për aksidentet në trafik në rrugët e vendit, e cila mundëson evidentimin e të dhënave mbi aksidentet në trafik, por nuk është plotësisht në përputhje me protokollin CADA^S, pasi nuk futen koordinatat




gjeografike të vendndodhjes së aksidentit në trafik për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme teknike nga pajisjet në dispozicion të MPB-së.

Analizat e të dhënave nga bazat e MPB-së tregojnë se aksidentet në trafik me pasoja:

- /// kanë ndodhur gjatë ditës (59%), në kushte të mira atmosferike / mot me diell (45%), në rrugë në vendbanime (63%) dhe në sipërfaqe të thata rrugore (79%), gjë që tregon se kushtet e rrugëve nuk janë shkaku kryesor i aksidenteve në trafik;

numri më i madh kanë ndodhur në territorin e SPB³² Shkup;

GRAFIKU 3: AKSIDENTET NË TRAFIK SIPAS SPB-SË




³¹ Rrugët shtetërore të shpërndara në rrjetin e rrugëve ndërkombëtare dhe të cilat janë të lidhura me rrugët përkatëse të vendeve fqinje

³² Sektori i Punëve të Brendshme


/// Kundërvajtjet më të zakonshme në trafik sipas llojeve, të konstatuara nga kontrollet e zbatuara në periudhën 2019-2023, kanë të bëjnë me: vozitjen e shpejtë, kalimin në

sinjalin e mbyllur, tejkalimin e parregullt dhe mosdhënien e përparësisë së kalimit.



/// Gjatë kontrolleve të zbatuara, numri më i madh i shoferëve janë përjashtuar për arsye të vozitjes së automjetit pa patentë shoferi, ndërsa i konsiderueshëm është

edhe numri i shoferëve të përjashtuar për arsye të vozitjes së automjetit në ndikimin e alkoolit.



GRAFIKU 5: ARSYET PËR PËRJSHTIMIN NGA TRAFIKU


Për shkak të faktit se koordinatat gjeografike të vendndodhjes së aksidenteve në trafik nuk futen në aplikacionin përkatës, si dhe për shkak të kufizimeve teknike të aplikacionit për kontrollet e zbatuara, MPB-ja nuk është në gjendje t'i përdorë ato si bazë për planifikimin e aktiviteteve të reja dhe krijimin e masave të reja për të rritur efikasitetin e ndërhyrjeve të MPB-së.



Ligji për automjete parashikon që MPB-ja duhet të mbajë Regjistër të Automjeteve me qëllim të vendosjes së sistemit për shkëmbimin e të dhënave midis subjekteve në fushën e automjeteve për miratim, lëshimin në treg, kontrollin teknik, regjistrimin dhe lëshimin në trafikun rrugor. Konstatuam se Regjistri i Automjeteve nuk është vendosur, për shkak të moshartimit të aktit nënligjor.

Sistemi "Safe City" "Qyteti i Sigurt", i cili është në pronësi dhe menaxhohet nga MPB-ja, është zbatuar dhe funksional prej disa vitesh, për të cilin vazhdimisht sigurohen mjete për mirëmbajtje, por ai ende nuk përdoret për dokumentimin e kundërvajtjeve në trafik dhe për shqiptimin e gjobave për shkak të rregullativës ligjore të papërshtatur.


Brenda kompetencave të veta, Ministria e Transportit ka ndërmarrë aktivitete për realizimin e projektit për lidhjen e rrugëve lokale.



Në mars të vitit 2023, u përgatit raporti dhe plani i veprimit me aktivitete dhe rekomandime për përmirësimin e gjendjeve të menaxhimit të sigurisë rrugore, i cili iu dorëzua MT-së në dhjetor të vitit 2024, përkatësisht 20 muaj pas përgatitjes së tij, për shkak të të cilit zbatimi i një pjese të aktiviteteve të parashikuara për vitet 2023 dhe 2024 u anulua për në vitin 2025, gjë që e ngadalëson arritjen e efekteve të pritura.

rikonstruksionit, rehabilitimit, mirëmbajtjes dhe mbrojtjes së rrugëve publike, NPRRSH-ja kryen numërimin e pjesëmarrësve në trafik, mban kadastrën e rrugëve shtetërore dhe themelon bazat e të dhënave të domosdoshme.

Me mjetet e Projektit të Rehabilitimit të Rrugëve Nacionale dhe Rajonale, si dhe nga mjetet e veta, janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:



Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore - NPRRSH

Në kuadër të kompetencave të caktuara për menaxhimin e rrugëve shtetërore në pjesën e planifikimit, ndërtimit,

2017-2018 kryerja e incizimit, rangimit dhe vlerësimit të sigurisë rrugore në akset rrugore krye-

2017-2018 kryerja e incizimit, rangimit dhe vlerësimit të sigurisë rrugore në akset rrugore

2018-2023 70 njehsorë fiks dhe 10 të lëvizshëm të numërimit të mjeteve të vendo-

2018 Prokurimi i softuerit për kontrollin e pagesës së

7,4 milion denarë =120.000 euro

Përmes Programit iRAP

NPRRSH-ja nuk ka mjetin e domosdoshëm special me pajisje për incizimin e rrugëve, prandaj angazhohet firma e jashtme.



nga 83,6 milion denarë=1,4 milion euro

NPRRSH-ja herë pas here i përditëson të dhënat me mjetin e vet special.

kapacitetet e kufizuara njerëzore për ta menaxhuar atë

Moduli "Banka e të Dhënave për Rrugët (RDB)", me të dhënat mbi gjendjen e rrugëve të nevojshme për planifikimin e aktiviteteve aktuale dhe investuese të NPRRSH-së për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve

Vlerësimi i të dhënave për rrugët me qëllim të hartimit të programit për rehabilitimin e rrugëve shtetërore

pjesa më e madhe e segmenteve të propozuara rrugore, deri në ditën e revizionit, nuk ishin planifikuar në programet vjetore



109 milion denarë= 1,7 milion euro

Ueb-aplikacioni funksional

1,6 milion denarë = 25.700 euro


Ende nuk është vënë në përdorim



Për të përmirësuar lidhshmërinë e rrugëve nacionale dhe rajonale me korridoret kryesore evropiane, si dhe për të përmirësuar kapacitetin e NPRRSH-së për sigurinë rrugore dhe rezistencën ndaj klimës, në tetor 2014, ishte lidhur Kontrata me

BNRZH-në - Bankën Botërore për hua në shumën prej 52 milion euro (3.200.000 mijë denarë). Mjetet e huas shfrytëzohen për të financuar Projektin e Rehabilitimit të Rrugëve Nacionale dhe Rajonale (NNRRP).

PROJEKTI I REHABILITIMIT TË RRUGËVE NACIONALE DHE RAJONALE (NNRRP)
SHËRBIMET KËSHILLËDHËNËSE = 33,8 MILION DENARË



Revizioni konstatoi se mjetet u shpenzuan, ndërsa qëllimet nuk u arritën.



Për të avancuar arsimin mbi trafikun dhe edukimin e pjesëmarrësve në trafik, KRSKRR-ja zbaton vazhdimisht fushata edukative, me qëllim të rritjes së sigurisë në trafik.

Për realizimin e fushatave në periudhën 2019-2023, nga mjetet e planifikuara në shumën totale prej 37.180 mijë denarë, pjesa më e madhe, përkatësisht 39%, ka të bëjë me hartimin e materialeve për fushata, ndërsa 21% për kompensimet e grupeve të punës të angazhuara për fushatat. Konstatuam që KRSKRR-ja nuk bën matjen e efektit të arritur të fushatave të zbatuara si tregues për përmirësimin e tyre.

Të ardhurat që KRSKRR-ja i realizon nga arkëtimi i taksës gjatë regjistrimit të automjeteve janë të paplota dhe në periudhën nga viti 2019 deri në tetor 2024, disa stacione teknike kanë paguar më pak mjete në dobi të KRSKRR-së në shumën prej 2.193 mijë denarë (35.653 euro), prej të cilave një pjesë kanë të bëjnë me periudhën mbi 3 vjet, gjë që krijon rrezik të parashkrimit të arkëtimit.

Revizioni njofton se në vitin 2020, Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë bleu softuer dhe pajisje në shumën totale prej 7.322 mijë denarë për qëllimet që lidhen me sigurinë në trafik, të cilat nuk janë përdorur nga institucionet kompetente deri më sot.

Analizat e kryera dhe inspektimet e zbatuara të sigurisë në trafik nga ekspertët e angazhuar për nevojat e revizionit tregojnë shkallë të lartë të rrezikut në segmentet rrugore që janë lëndë e analizës, sinjalizimi horizontal dhe vertikal i pakënaqshëm, mirëmbajtja e dobët e rrugëve të cilat mund të shkaktojnë aksidente trafiku me pasojat e tyre.



FOTOGRAFIA NUMËR 1 - DËMTIMET FIZIKE DHE MIRËMBAJTJA E DOBËT E RRUGËS

Në pjesën e njoftimit, monitorimit dhe vlerësimit:

- /// është vendosur mekanizmi i njoftimit, përmes të cilit institucionet kompetente, përmes takimeve të punës dhe mbledhjeve, si dhe përmes raporteve periodike dhe vjetore, njoftojnë rregullisht Kuvendin dhe Qeverinë për realizimin e aktiviteteve, ndërsa me publikimin e tyre në ueb-faqet, njoftohet publiku dhe palët e tjera të interesuara për aktivitetet e tyre aktuale.
- /// nuk është kryer ndjekja e realizimit të aktiviteteve të Strategjisë Nationale për Siguri në Trafikun Rrugor 2015-2020 dhe vlerësimi i efekteve të tyre.

- /// institucionet kompetente nuk i vlerësojnë efektet e arritura të masave dhe aktiviteteve të zbatuara në përputhje me treguesit e përcaktuar, për zbulimin dhe eliminimin në kohë të dobësive në menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor.

Për tejkalimin dhe përmirësimin e gjendjeve në pjesën e kornizës juridike dhe strategjike për procesin e menaxhimit të sigurisë në trafik, forcimin e kapaciteteve njerëzore, financiare dhe teknike të institucioneve, si dhe vendosjen e sistemit për monitorimin dhe vlerësimin e efekteve të aktiviteteve të zbatuara.

5.3.8.

SISTEMI SHËNDETËSOR

5.3.8.1.

SHFRYTËZIMI I PAJISJEVE MJEKËSORE MODERNE

3 SHËNDET I MIRË
DHE MIRËQENIE




Kemi kryer revizionin e suksesit me temë **"Shfrytëzimi i pajisjeve mjekësore moderne"** me qëllim për t'iu përgjigjur pyetjes **"A sigurohet shfrytëzimi i mirë dhe disponueshmëria rajonale e shërbimeve me pajisjet mjekësore moderne, përkatësisht përmbushja e nevojave të mbrojtjes shëndetësore të popullsisë?"**.



Revizioni mbuloi pajisjet mjekësore moderne që i vlerësuam me vlerën më të lartë të prokurimit dhe ka nevojë dhe interes të konsiderueshëm për shërbimet me to, të tilla si: KT, angiografë, akceleratorë, mamografë me tomosintezë dhe stereotaksë, PET/KT dhe aparat të rehabilitimit robotik. Gjithashtu, i mbuluam politikat dhe aktivitetet e ndërmarra për prokurimin, vënien në përdorim dhe shfrytëzimin e tij në periudhën nga viti 2021 deri në vitin 2023, ndërsa çështje dhe ngjarje të caktuara janë mbuluar para dhe pas kësaj periudhe.

Furnizimi me pajisjet e lartpërmendura në shëndetësinë publike sipas qyteteve në vend paraqitet në grafikun e mëposhtëm.


FURNIZIMI ME PAJISJET MJEKËSORE MODERNE NË SHËNDETËSINË PUBLIKE



Konstatuam se është arritur përparimi në sigurimin e shpërndarjes rajonale të pajisjeve të reja mjekësore në shëndetësinë publike dhe në rritjen e numrit të përgjithshëm të shërbimeve shëndetësore në tre vitet e fundit, por edhe më tutje një pjesë e pajisjeve ende nuk është vënë në përdorim ose nuk përdoret mjaftueshëm, kryesisht për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe/ose kushteve të pasigurta hapësinore dhe të tjera. Prandaj, për një pjesë të shërbimeve nuk sigurohet disponueshmëria e mjaftueshme rajonale, përkatësisht për përmbushjen e nevojave të mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve.

Në periudhën e deritanishme, qëllimet e përcaktuara strategjike janë realizuar pjesërisht, ndërsa sigurimi i pajisjeve të reja mjekësore moderne për ISHP-të nuk është bërë gjithmonë në bazë të kriterëve për përcaktimin e prioriteteve për nevojat dhe analizën dhe koordinimin e duhur në drejtim të sigurimit të kushteve të nevojshme hapësinore, pajisjeve shoqëruese dhe kuadrit profesional dhe të trajnuar për të punuar me to.

Në periudhën 2021-2023 është prokuruar pajisja mjekësore në vlerë totale prej 998.109 mijë denarë, përkatësisht 16.2 milion euro me mjete buxhetore, mjete të huas dhe nga donacioni, të paraqitur në grafikun në vijim.



Më shumë se gjysma e shërbimeve të KT-së kryhen në bazë të udhëzimeve pa termin dhe udhëzimeve urgjente për shkak të termineve të rregullta të krijuara në mënyrë të pamjaftueshme, me ç'rast mungojnë të dhënat reale mbi vëllimin dhe frekuencën e përdorimit të pajustifikuar dhe të pabazuar të udhëzimeve urgjente dhe prioritare, si dhe kontrollit efikas të tyre.


Në periudhën 2021-2023 në 9 ISHP u kryen gjithsej 32.238 shërbime me angiograf, me ç'rast numri i shërbimeve është në rritje, por mënyra e referimit dhe evidentimit nuk është e rregulluar dhe e unifikuar mjaftueshëm në të gjitha ISHP-të, prandaj nuk sigurohet evidentimi dhe ndjekja e plotë e shërbimeve, si dhe caktimi elektronik i ndërhyrjeve.

Rritja e numrit të shërbimeve shëndetësore dhe pajisjeve mjekësore nuk është shoqëruar me rritje proporcionale të numrit të punonjësve shëndetësorë në ISHP-të që i përdorin këto aparate. Për shkak të pamundësisë për të gjetur mekanizma efikas për mbajtjen e kuadrit profesional dhe të trajnuar në shëndetësinë publike, ISHP-të po përballen me largim dhe mungesë të personelit mjekësor, të cilat tejkalohen vetëm pjesërisht nga angazhimet e herëpashershme nga ISHP-të e tjera, gjë që ndikon në mbingarkesën e kuadrit shëndetësor dhe pajisjeve në një pjesë të ISHP-ve.

Konstatuam se ka dallime të konsiderueshme në evidencat e shërbimeve të kryera midis ISHP-së, Termini Im dhe Fondit, gjë që rezulton në të dhënat joreale mbi shërbimet në Termini Im, më pak shërbime të paraqitura në Fond dhe të paktën 15.177 mijë denarë (247 mijë euro) më pak participim të arkëtuar nga ISHP-ja.

Në kushtet e listave të pritjes të pavendosura për një periudhë të gjatë, mungojnë të dhënat mbi kërkesën reale për shërbime, ndërsa për shkak të evidencave të paharmonizuara të shërbimeve të kryera në ISHP, Termini Im dhe sistemin e Fondit, nuk mund të përcaktohet as numri i saktë i shërbimeve të kryera shëndetësore.

Për t'i tejkaluar gjendjet e lartpërmendura, kemi dhënë rekomandime me qëllim të ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve nga institucionet kompetente, ndërsa në funksion të eliminimit të shkaqeve të gjendjeve të konstatuara, krijimin e kushteve për shfrytëzim më të mirë të pajisjeve mjekësore moderne dhe rritjen e disponueshmërisë së shërbimeve shëndetësore, dhe në këtë mënyrë edhe përmbushjen optimale të nevojave të qytetarëve për mbrojtjen shëndetësore.



5.3.9.

QËLLIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË OKB-SË - AGJENDA 2030 DHE MJEDISI I SHËNDETSHËM JETËSOR

5.3.9.1.

PLANIFIKIMI URBANISTIK I INFRASTRUKTURËS SË GJELBËR NË QYTETET



Realizuar revizionin e suksesit me temë **"Planifikimi urbanistik i infrastrukturës së gjelbër në qytetet"** me qëllim t'i përgjigjemi pyetjes **"A sigurojnë masat dhe politikat e pushtetit qendror dhe lokal planifikim efikas të infrastrukturës së gjelbër në qytetet?"**


Me fushëveprimin dhe dëshmitë që i siguroam, kemi fituar bindje të arsyeshme se masat dhe politikat e pushtetit qendror dhe lokal nuk sigurojnë planifikim efikas të infrastrukturës së gjelbër në qytetet.

Me ndarjen e veprimtarisë së planifikimit hapësinor dhe urbanistik dhe mungesës së koordinimit të institucioneve kompetente të përfshira në proces, mungojnë politikat që e rregullojnë planifikimin hapësinor, ndërsa me zgjidhjet ligjore për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje shkelet sistemi i planifikimit urbanistik. Në kushtet kur Plani i ri Hapësinor si dokumenti më i lartë strategjik

i shtetit nuk është miratuar për më shumë se katër vjet, dokumenti ekzistues me periudhë planifikimi deri në vitin 2020, nuk është bazë e mirë për dokumentet e tjera strategjike dhe planifikuese, sepse shfrytëzohen të dhënat dhe informacionet që nuk janë të përditësuara dhe nuk përkrijnë me gjendjet në vend.

Duke marrë parasysh se nga 34 komunat me seli në qytet, vetëm dy komuna ("Qyteti i Shkupit dhe Komuna e Ohrit") kanë miratuar strategji për zhvillimin e gjelbërimit, Kadastër të Gjelbër në formën e portalit SGJI kanë vetëm tre komuna ("Qyteti i Shkupit, Komuna e Kavadarit dhe Komuna e Ohrit"), ndërsa 18 komuna nuk kanë miratuar programe vjetore për krijimin dhe mirëmbajtjen e gjelbërimit, kjo tregon konstatimin se mungon vizioni për nevojat për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra për të përmirësuar qëndrueshmërinë e qyteteve.


PLANET E PËRGJITHSHME URBANISTIKE



Procedura për miratimin e planeve urbanistike kryhet përmes sistemit elektronik e-urbanizëm në të cilin kanë qasje të gjitha institucionet e përfshira, por për shkak të kompleksitetit të procedurave administrative dhe mosrespektimit të afateve të përcaktuara me ligj, nga gjithsej 34 komunat me seli në qytet, 8 komuna (23%) kanë PPU të vlefshme, 24 komuna (71%) kanë PPU me periudhë të kaluar të planifikimit, ndërsa dy komuna (6%) aspak nuk kanë miratuar plan të përgjithshëm urbanistik. Si rezultat i mosrespektimit të afatit të përcaktuar me ligj për procedurat për miratimin e PDU-së deri në

18 muaj, në periudhën 2020-2024, 77% e procedurave të PDU-së ende nuk kanë përfunduar, gjë që krijon pasiguri juridike dhe pamundësi për qytetarët që t'i ushtrojnë të drejtat e tyre, ndërsa komunat të planifikojnë gjelbërimin në hapësirë. PPU-të e 22 komunave nuk e përmbushin standardin e rekomanduar të gjelbërimit prej 25 m² për kokë banori, ndërsa sipërfaqet e gjelbra që mirëmbahen dhe sipërfaqet e gjelbra të ndërtuara rishtazi në korrelacion me numrin e banorëve në përputhje me regjistrimin e vitit 2021 tregojnë se asnjë komunë nuk e përmbush standardin.

 qytete të vogla	 qytete mesatarisht të mëdha
Berovë 6.9	Manastiri 11
Vallandovë 4.82	Velesi 16.3
Vinicë 8.13	Gostivar 6.89
Gjevgjeli 9.08	Kavadar 14.31
Dibër 14.1	Kërçovë 7.41
Demir Kapi 21.47	Koçanë 7.65
Kratovë 13	Ohër 10.82
Kriva Pallankë 10.93	Prilep 7.5
Krushevë 23.6	Strugë 11.8
Mak. Kamenicë 22	Strumicë 2.8
Brod i Maqedonisë 8.6	Tetovë 12.14
Negotinë 11	Shtip 16.9
Pehçevë 10	
Probishtip 6	qytete të mëdha
Radovish 5.78	Qyteti i Shkupit 12.44
Resnja 20.83	Kumanovë 18.83
Sveti Nikolla 10	



standardi i rekomanduar për gjelbërim prej **25m² për kokë banori**

Incizimet nga incizimi i kryer me dron në më shumë lokacione dhe qytete të shumta tregojnë se zonat qendrore urbane të qyteteve nuk përmbajnë

mjaftueshëm sipërfaqe të gjelbra publike që duhet të kontribuojnë në uljen e ndotjes dhe për mjedis të pastër jetësor.



KOMUNA E ČAIRIT



KOMUNA E KISELLA VODËS



KOMUNA E SHTIPI

Edhe pse në PPU të Shtipit parashihen 16,9% sipërfaqe të gjelbra me dedikimin D, përmes NPK "Isar" nga Shtipi mirëmbahen 8,97 ha që është vetëm 0,39% të sipërfaqes së planit të përgjithshëm urbanistik prej 2.292 ha.



KOMUNA E TETOVËS

PPU-ja aktuale e Tetovës ka periudhë planifikimi prej 2003-2013 dhe parashikon 12,4% sipërfaqe të gjelbra. Karakteristike për Tetovën është që nuk ka park qyteti.

Programet vjetore për financimin e planeve urbanistike në nivel qendror në periudhën 2020-2024 janë miratuar në mënyrë jotransparente, pa thirrje publike, komision dhe kritere të përzgjedhjes, ndërsa mjetet e parashikuara nuk janë të mjaftueshme për të financuar projektet e planifikuara. Informimi dhe interesi i pamjaftueshëm i qytetarëve për pjesëmarrjen në procedurat për miratimin e planeve urbanistike, si dhe financimi i planeve nga personat juridikë/fizikë të interesuar me 48% në programet vjetore të komunave, e vendos interesin privat mbi interesin publik.

Komunat nuk sigurojnë mjete të mjaftueshme për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra publike, për arsye se 80% e tyre nuk kanë miratuar vendime për arkëtimin e kompensimit për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra, 20-30% arkëtojnë taksa komunale për përdorimin e sipërfaqeve të gjelbra publike dhe vendosjen e tabelave reklamuese në sipërfaqet e gjelbra, ndërsa 59% e komunave nuk kanë ndarë mjete për ndërtimin e sipërfaqeve të reja të gjelbra në periudhën 2020-2024.

Pushteti qendror dhe lokal nuk kanë siguruar monitorim dhe kontroll efikas, përkatësisht mosshqiptimi i gjobave ndaj shkelësve, zvogëlimi i shumave të gjobave për kundërvajtje, si dhe mosdërmarrja e aktiviteteve nga ana e MMJPH-së për të vendosur mbikëqyrje mbi komunat në pjesën e zbatimit të dispozitave ligjore për gjelbërimin urban, kontribuon në shkatërrimin e gjelbërimit, dështimin e saj për ta mirëmbajtur dhe dështimin e saj për ta zëvendësuar me gjelbërim të ri.

Për t'i tejkaluar gjendjet e konstatuara, janë dhënë rekomandime me qëllim të ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve nga institucionet kompetente dhe personat përgjegjës për të krijuar kushtet që do të përmirësojnë planifikimin urbanistik të infrastrukturës së gjelbër në qytetet.

5.3.9.2.

TRANZICIONI I GJELBËR PËRMES PROMOVIMIT TË BURIMEVE TË RINOVUESHME TË ENERGJISË



Realizuar revizionin e suksesit me temë **"Tranzicioni i gjelbër përmes promovimit të burimeve të rinovueshme të energjisë"** me qëllim që t'i përgjigjemi pyetjes **"A do të sigurojnë reformat e planifikuara për tranzicionin energjetik me burime të rinovueshme të energjisë siguri energjetike, stabilitet ekonomik dhe përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare të dekarbonizimit?"**.

Republika e Maqedonisë së Veriut, si anëtare e Komunitetit Energjetik dhe në përputhje me obligimet e ndërmarra ndaj BE-së, ka për detyrë t'i ndjekë politikat globale për tranzicion të gjelbër dhe t'i zbatojë obligimet e ndërmarra në fushën e energjisë dhe klimës me qëllime të përcaktuara deri në vitin 2030. Për këtë qëllim, po zbatohen reformat e dekarbonizimit, reformat në tregun e energjisë elektrike që janë planifikuar në mënyrë strategjike, me deklaratën e përbashkët është formuar platforma e investimeve për tranzicionin

e drejtë energjetik, është vendosur korniza institucionale, por ka sfida në zbatimin e këtyre planeve nga shteti.

Me miratimin e Planit Nacional Klimatik dhe Energjetik në vitin 2022, në përputhje me detyrimet ndaj Komunitetit Energjetik, vendi ka vendosur qëllime për uljen e emisioneve të gazrave serrë për 82% krahasuar me vitin 1990, mbylljen e termoelektraneve me qymyr dhe pjesëmarrjen e burimeve të rinovueshme të energjisë në konsumin përfundimtar në shumën prej 38% deri në vitin 2030.

Qëllimi i përgjithshëm për të gjitha palët kontraktuese të Komunitetit Energjetik për pjesëmarrjen e burimeve të rinovueshme të energjisë në konsumin përfundimtar deri në vitin 2030 është 31%, siç paraqitet në Tabelën nr. 1.

TABELA NR. 1. QËLLIMET PËR PJESËMARRJEN E ENERGJISË NGA BURIMET E RINOVUESHME NË BRUTO KONSUMIN PËRFUNDIMTAR TË ENERGJISË (VITET 2005, 2020 DHE 2030) PËR PALËT KONTRAKTUESE

Shteti	Pjesëmarrja në BRE në vitin 2005	Qëllimi për	Qëllimi për
Shqipëria	31,20 %	38 %	52 %
Bosnjë e Hercegovina	34,00 %	40 %	43,60 %
Gjeorgjia	-	-	27,40%
Kosova	18,90 %	25 %	32,00 %
Moldavia	11,90 %	17 %	27,00 %
Mali i Zi	26,30 %	33 %	50,00 %
Republika e Maqedonisë së Veriut	17,20 %	23 %	38,00 %
Serbia	21,20 %	27 %	40,00 %
Ukraina	5,50 %	11 %	27,00 %
Gjithsej (mesatarisht):	-	-	31,00 %

³³ <https://www.energy-community.org/implementation/package/CEP.html>

Për tranzicionin energjetik nevojiten investime të mëdha publike, por po zhvillohet në kushte të hapësirës së kufizuar fiskale, rritjes së borxhit publik dhe gjendjes së pavolitshme financiare të SHA ESM, ndërsa ka edhe pasoja sociale dhe ekonomike për rajonet e varura nga qymyri.

Në vitin 2024, SHA ESM merr pjesë me rreth 58% të prodhimit total të energjisë elektrike, që paraqet shtyllë të prodhimit vendas të energjisë elektrike dhe subjekt vendimtar në procesin e tranzicionit energjetik të vendit.

Në përputhje me obligimet e ndërmarra, vendi deri në vitin 2030 duhet t'i mbyllë termoelektranat që janë ende prodhuesit më të mëdhenj të energjisë elektrike, me 38,4% të prodhimit të përgjithshëm, dhe gjithashtu edhe ndotësit më të mëdhenj që emetojnë CO₂ në ajër.

Për shkak të vendimit për të shitur 100% të prodhimit të energjisë elektrike të SHA ESM të furnizuesi universal me çmim më të ulët se çmimi i prodhimit, megjithëse me ligj kjo përqindje duhej të ishte ulur në 30% deri në vitin 2025, puna është me humbje, ndërsa vihet në pikëpyetje edhe vazhdimësia e punës së kompanisë në kushte të tilla.

Politika e Qeverisë për shitjen e prodhimit të furnizuesi universal për t'i mbrojtur qytetarët nga goditjet e çmimeve kontribuoi për mbështetjen shtetërore të SHA ESM përmes Buxhetit, ndërsa SHA ESM në vitin 2023 mori hua nga BERZH-i në shumën prej 100 milion euro për likuiditet.

Në vitet e fundit, ka pasur rritje të madhe të elektrocentraleve të BRE-së nga 303 në fund të vitit 2020, deri në mbi 1.500 deri në vitin 2024. Sipas studimeve të bëra, sistemi për momentin mund të pranojë vetëm deri në 1,5 GW, ndërsa kërkesat për lidhjen e prodhuesve të BRE-së me rrjetin e transmetimit janë 8,663 GW.

Me ndryshimet e Ligjit për energjetikë të vitit 2022 parashihet planifikimi sistematik i ndërtimit të kapaciteteve të prodhimit të BRE-së. Qeveria ende nuk ka miratuar Plan Indikativ për Ndërtimin e Kapaciteteve të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë, të cilit i mungon strategjia e qartë për përzgjedhjen dhe priorizimin e projekteve dhe ofron mundësi për vendimmarrje joadekuate për një numër të madh kërkesash për lidhje në rrjetin e transmetimit.

Është miratuar Ligji i ri për energjetikë në maj 2025, i cili parashikon planifikim vjetor dhe përzgjedhje transparente të projekteve, të cilat duhet të kontribuojnë për koordinim më të mirë dhe shpërndarje të drejtë të kapaciteteve.

Reformat e tregut janë iniciuar përmes masave të reja të planifikuara të mbështetjes në formën e ankandeve CfD, do të futen garancitë e origjinës dhe nevojiten përpjekje të mëtejshme për të lidhur tregjet në nivel rajonal.

Me deklaratë të përbashkët të propozuar nga bankat dhe partnerët multilateralë, të udhëhequr nga BERZH-i, është vendosur Platforma e Investimeve për Tranzicion të Drejtë Energjetik (JETIP), sipas së cilës është përgatitur draft-versioni i projekteve të tranzicionit energjetik në vlerën prej 1,823 miliardë euro, ku janë planifikuar projekte për SHA ESM në vlerën prej 1,12 miliardë euro dhe projektin për Çebren dhe "Orlov Kamen" për të cilin vlera nuk është theksuar, si dhe projektet për SHA MEPSO në shumën prej 128 milion euro. Platforma e investimeve planifikon të arrijë heqjen graduale të termoelektraneve me qymyr, të instalojë 1,7 GW kapacitet të energjisë së rinovueshme, nga të cilat të paktën një (1) GW përmes ankandeve, të forcojë rrjetin dhe ruajtjen e energjisë për integrimin e burimeve të rinovueshme dhe të sigurojë tranzicion të drejtë.

Zhvillimi i rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike është vendimtar për të siguruar të ardhme energjetike stabile, fleksibile dhe të qëndrueshme për vendin dhe rajonin.

Fotografia e poshtësheksuar e tregon gjendjen e shkallës së ndërtimit të trafostacionit 400/110 kV të Ohrit dhe zgjerimin e trafostacionit të Manastirit.



Po rrjedhë procedura për Planin e ri të zhvillimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025–2035, për të cilin është zhvilluar debati publik, është dorëzuar në ministrinë kompetente dhe është dorëzuar në KEM, por në kushtet kur nuk është përgatitur Studimi për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, ekziston rreziku që të mos jenë identifikuar nevojat kryesore për zhvillimin e rrjetit.

Me rritjen e numrit të projekteve të burimeve të rinovueshme të energjisë (BRE), rritet nevoja për kapacitetet balancuese, ndërsa kapaciteti i pamjaftueshëm për shërbimet sistematike përbën rrezik për stabilitetin e rrjetit.

Me ndryshimin e Ligjit për energjetikë të vitit 2022 për herë të parë ishin paraparë dispozita për ruajtjen e energjisë elektrike, ndërsa me Ligjin e ri për energjetikë të miratuar në maj 2025 në mënyrë të detajuar është përmirësuar materia e ruajtjes dhe balancimit.

rrjetin për integrimin e investimeve në burimet e rinovueshme të energjisë, nevojitet balancimi i prodhimit të ndryshueshëm, ndërsa ekzistojnë edhe probleme në zbatimin e projekteve strategjike për ndërtimin e rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike në Korridorin 8 drejt Shqipërisë.

Kompania energjetike shtetërore SHA ESM nuk ka ndërtuar kapacitete të reja energjetike për një kohë të gjatë dhe po përballet me një gjendje të pavolitshme financiare, operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike duhet të zhvillojë

5.3.9.3.


PËRGATITJA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR T'U PËRBALLUR ME NDRYSHIMET KLIMATIKE



projekt inovativ, **Climate Scanner** (Skneri i Klimës), i cili ka për qëllim të zhvillojë mjet të vlerësimit të shpejtë të dizajnuar për të vlerësuar veprimin e qeverive nacionale mbi ndryshimet klimatike.

Kryesimi i ISR-së së Brazilit me Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizorit (INTOSAI), në partneritet me Grupin e Punës për revizionin e mjedisit jetësor të INTOSAI - WGEA, ka krijuar

Enti Shtetëror i Revizionit iu bashkua 141 ISR-ve nga e gjithë bota dhe iu përgjigj detyrës së **Sknerit të Klimës**, me çka rezultatet u përpunuan dhe u prezantuan në Konferencën Botërore të Klimës COP29 që u mbajt në Baku, Azerbajxhan, në të cilën morën pjesë shefat e shteteve dhe qeverive nga 200 vendet, përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut.



Të dhënat e Skanerit të Klimës ishin bazë për kryerjen e revizionit të suksessit me temë **"Gatishmëria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për t'u përballur me ndryshimet klimatike"** me qëllim që t'i përgjigjet pyetjes: **"A ka vendosur Qeveria mekanizma, sisteme dhe politika për t'u përballur me ndryshimet klimatike?"**

Me fushëveprimin dhe dëshmitë që i siguruar, kemi fituar bindje të arsyeshme se në **Republikën e Maqedonisë së Veriut janë përmbushur parakushtet themelore dhe është arritur progresi i caktuar në hartimin e politikave, por nevojiten masa dhe aktivitete shtesë për të vendosur mekanizma dhe sisteme për t'u përballur me ndryshimet klimatike.**


Aktivitetet e revizorit u përqendruan në tri fusha (menaxhimi i ndryshimeve klimatike, politikat publike të ndryshimeve klimatike, financimi i ndryshimeve klimatike) dhe u konstatuan gjendjet e rëndësishme si në vijim:

Sa i përket menaxhimit të ndryshimeve klimatike, legjisllacioni ekzistues në fushën e mjedisit jetësor, megjithëse rregullon çështje të caktuara që lidhen me ndryshimet klimatike, ato nuk janë të mjaftueshme për të vendosur sistem me të cilin shteti do t'i menaxhojë

ndryshimet klimatike. Duke anuluar procedurën për miratimin e Ligjit për veprimin klimatik, e cila zgjat për më shumë se 5 vjet, shteti nuk ka vendosur sistem institucional, koordinim dhe komunikim midis institucioneve të përfshira në procesin e ndryshimeve klimatike. Pavarësisht përfshirjes së një numri të madh institucionesh, personash juridikë dhe palëve të interesuara në propozim-versionin e Ligjit për veprim klimatik, mungon përfshirja e pushtetit lokal, që është bartës i politikave në nivel lokal dhe në të njëjtën kohë i zbaton politikat në nivel qendror.


Për shkak të kapaciteteve të dobëta administrative, nuk është siguruar baza e vetme e të dhënave e nevojshme për hartimin dhe përditësimin e Inventarit Nacional të Gazrave Serrë, i cili është hartuar për herë të fundit në vitin 2019 me ndihmën e projekteve ndërkombëtare, përkatësisht për 5 vitet e fundit vendi nuk ka të dhëna për emisionet e gazrave serrë, gjë që nuk është bazë e mirë për hartimin e politikave dhe menaxhimin e ndryshimeve klimatike.

EMISIONET NETO NGA VITI 1990 DERI VITIN 2019



Me Strategjinë Afatgjate të Veprimit Klimatik, vendi u obligua t'i zvogëlojë emisionet neto të gazrave serrë ("pa përfshirë emisionet MEMO") për 72% deri në vitin 2050 krahasuar me vitin 1990, përkatësisht nuk

konstatoi emisione "zero neto", me çka nuk i përmbushi detyrimet me Kontratën e Gjelbër Evropiane.



Me Kontributin e Reviduar dhe të Përcaktuar Nacional (NDC Nationally Determined Contribution), vendi u obligua deri në vitin 2030 t'i zvogëlonte emisionet neto të gazrave serrë për 82% krahasuar me vitin 1990, ndërsa sipas të dhënave zyrtare nga Inventari i Gazrave Serrë, në vitin 2019, emisionet totale të gazrave serrë u zvogëluan për 9,2% krahasuar me vitin 1990.

Sa u përket politikave publike mbi ndryshimet klimatike, Republika e Maqedonisë së Veriut, si nënshkruese e Marrëveshjes së Parisit, përcaktoi kontributin e saj në përpjekjet globale për ndryshimet klimatike me NDC-në e Parë në vitin 2015, ndërsa në vitin 2021 vendosi qëllime më ambicioze me NDC-në e Reviduar, duke i përmbushur kështu detyrimet e kontratës. Edhe pse Strategjia e Zbatjes nuk është miratuar si dokument i veçantë strategjik, NDC-ja e Reviduar përfshin politika dhe masa për zbatimin e emisioneve të gazrave serrë. Vendi nuk ka Plan Nacional për Përshtatje ndaj Ndryshimeve Klimatike, por një pjesë e strategjive sektoriale parashikojnë masa dhe politika të përshtatjes. Për shkak të mosvendosjes së mekanizmave për ndjekjen e realizimit të politikave

Mosvendosja e mekanizmave të monitorimit nga MMJPH-ja dhe mosnjohimi nga ministrinë kompetente, nuk mundësojnë të bëhet vlerësimi i rëndësishëm së masave dhe efekteve të tyre në arritjen e qëllimit të caktuar.

dhe masave të parashikuara, nuk mund të konfirmohet nëse ato janë të përshtatshme për arritjen e qëllimeve të përcaktuara me NDC-në e Reviduar.

Sa i përket financimit të ndryshimeve klimatike, në Strategjinë Afatgjate të Veprimit Klimatik parashihet që për realizimin e politikave dhe masave për periudhën 2020-2050 do të nevojiten investime kapitale prej 35 miliardë euro dhe shpenzime në Sektorin Energjetik prej 121 miliardë euro. Duke pasur parasysh se ende nuk ka bazë ligjore, në Buxhetin e Shtetit nuk është vendosur sistemi për shënimin klimatik të projekteve relevante ose të lidhura me ndryshimet klimatike, prandaj shteti nuk ka të dhëna relevante mbi mjetet financiare të dedikuara për ndryshimet klimatike. Në periudhën 2020-2024, nuk janë hartuar raportet dyvjeçare (BUR), me të cilat shteti ka detyrim ndërkombëtar për të njoftuar mbi mjetet e shfrytëzuara nga buxheti i brendshëm, buxhetet e njësisë të vetëqeverisjes lokale, si dhe mjetet nga fondet dhe institucionet ndërkombëtare dhe sektori privat.



**DOBĚSITĚ
SISTEMORE**

06



Enti Shtetëror i Revizionit kryen edhe vlerësimin e shkallës së përputhshmërisë së akteve ligjore dhe nënligjore dhe jep rekomandime për ndryshimin, plotësimin dhe harmonizimin e tyre. Në këtë pjesë i theksojmë disa nga dobësitë sistemore kryesore

të konstatuara, për të cilat është e nevojshme ndërmarrja e veprimeve nga ana e organeve kompetente të pushtetit ekzekutiv / legjislativ për tejkalimin e tyre.

LIGJI PËR BUXHETE

Në Ligjin për buxhete, zbatimi i të cilit do të fillojë më 1 janar 2026, përveç dispozitave nga neni 121, në të cilin theksohen përjashtimet nga zbatimi i dispozitave të caktuara të ligjit të lartpërmendur, është e nevojshme të ndërmerren aktivitete të caktuara për harmonizimin e dispozitave të caktuara, përkatësisht:

- /// neni 35 të plotësohet paragrafi 3, në drejtim të përkufizimit të dokumentacionit buxhetor për Propozim-Buxhetin e komunave;
- /// neni 76 të plotësohet:
 - /// paragrafi 3, në përputhje me të cilin shfrytëzuesit buxhetorë amë, përveç që rregullisht t'i dorëzojnë të gjitha kontratat e koncesioneve në kompetencë të tyre në Ministrinë e Financave, ato t'i dorëzojnë edhe në komunën në territorin e së cilës ndodhet koncesioni, si dhe
 - /// paragrafi 5 që Ministria e Energjetikës, Minierave dhe Lëndëve të Para Minerale, përveç në Ministrinë e Financave, të gjitha kontratat e partneriteteve private publike rregullisht t'i dorëzojë edhe në komunën në territorin e së cilës zbatohet kontrata e partneritetit privat publik.
- /// neni 94 të ndryshohet dhe plotësohet:
- /// paragrafi 6 në të cilin pjesa për refuzime të mundshme të rekomandimeve individuale të revizorit të fshihet;
- /// paragrafi 7 nevojitet të ndryshohet dhe rregullohet që Kuvendi gjatë miratimit të Llogarisë Përfundimtare, e shqyrton edhe Raportin Përfundimtar të revizorit të autorizuar shtetëror për revizionin e kryer të Llogarisë Përfundimtare të buxhetit, duke përcaktuar afatin për të.

KODI ZGJEDHOR

- /// Në nenin 83 të Kodit Zgjedhor jepet mundësia partive politike që mjetet e marra nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për financimin e punës së rregullt të partisë si mjete financiare t'i transferojnë në llogaritë transaksionale "të fushatës zgjedhore" të pjesëmarrësve në të, gjë që mund të çojë në financimin e fushatës zgjedhore me mjetet nga Buxheti i Shtetit në shumë më të lartë se ajo e përcaktuar në nenin 88 të Kodit Zgjedhor, prandaj konsiderojmë se këto dy nene duhet të harmonizohen.
- /// Me dispozitat e nenit 71, paragrafi 6, afati i fundit për pagesën e donacioneve për financimin e fushatës zgjedhore është deri në ditën e mbylljes së llogarisë transaksionale, e cila bëhet pas shpalljes së përfundimit të rezultateve të fushatës zgjedhore dhe krijon rrezik për ndikim, prandaj konsiderojmë se është e nevojshme të përcaktohet që donacionet duhet të paguhen më së voni deri në ditën e përfundimit të fushatës zgjedhore.
- /// Përcaktimi i dispozitave që do të rregullojnë nëse koalicioni ose partia politike mund të mbështesë kandidat të pavarur - grup votuesish dhe duke vepruar kështu t'i përdor mjetet e ndara për reklamimin e paguar politik për kandidatin e pavarur - grupin e votuesve, nëse po, në çfarë kushtesh dhe në çfarë mënyre, dhe nëse, gjatë mbështetjes së tillë, ai ka të drejtë t'i përdor edhe mjetet që i takojnë si kandidat i pavarur.
- /// Përcaktimi i mënyrës në të cilën donatorët do të vërtetojnë / konfirmojnë se nuk janë "persona të lidhur" me radiodifuzerët, mediat e shtypit dhe mediat elektronike (portalet e internetit) gjatë financimit ose dhënies së donacioneve për partitë politike.

RREGULLIMI I DISPOZITAVE TË KODIT ZGJEDHOR NË PJESËN E:

- /// Kushteve dhe kritereve që nevojitet t'i plotësojnë mediat elektronike për të qenë në gjendje të aplikojnë për reklamimin e paguar politik në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.
- /// Kritereve të qarta dhe precize për ndarjen e mjeteve buxhetore të dedikuara për reklamimin e paguar politik në mediat elektronike (portalet e internetit).
- /// Vendosjes së sistemit ndërveprues për shkëmbimin dhe kontrollin e të dhënave mbi aktivitetin e banerëve dhe përcaktimin e organit kompetent për ndjekjen dhe njoftimin mbi prezantimin mediatic zgjedhor të mediave elektronike (portalet e internetit).
- /// Parashikimit të gjobave për mediat elektronike (portalet elektronike) në rast të mosdorëzimit të Raportit mbi hapësirën reklamuese të përdorur nga secili pjesëmarrës në fushatën zgjedhore dhe mjetet e paguara dhe të kërkuara mbi këtë bazë.
- /// Rregullimit të mënyrës së organizimit, pagesës, ndjekjes dhe njoftimit tek organet kompetente mbi prezantimin në internet të kryer nga pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore përmes rrjeteve sociale.
- /// Rregullimit nomoteknik të Kodit Zgjedhor për shkak të faktit se pika të caktuara të neneve të caktuara nuk kanë ndjekshmëri dhe në të njëjtën kohë në këto dispozita të neneve të caktuara ka referencë të gabuar.

FINANCIMI I PARTIVE POLITIKE

Ligji për financimin e partive politike

- /// të miratohen udhëzime më konkrete për rregullimin e mënyrës së pagesës dhe evidentimit të anëtarësimit si burim financimi për partitë politike me qëllim të sigurimit të uniformitetit në mënyrën e evidentimit të tyre të kontabilitetit dhe konfirmimit të limitit të përcaktuar me ligj për secilin anëtar veç e veç;
- /// përcaktimi i afateve për aktivitetet individuale të ndërrmarra nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Ministria e Drejtësisë, lidhur me mënyrën e planifikimit, shpërndarjes dhe pagesës së mjeteve nga financimi i rregullt vjetor i partive politike;
- /// ndryshimi dhe plotësimi i akteve nënligjore që rregullojnë mënyrën e mbajtjes së kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse, të cilat do të sigurojnë respektim konsekuent të parimit të kontabilitetit të "ndodhjes së modifikuar të ndryshimeve afariste përkatësisht transaksioneve";

Ligji për taksa komunale

- /// Taksa komunale për shfrytëzimin e rrugëve nga mjetet motorike të pasagjerëve dhe mallrave, autobusët, automjetet speciale dhe motoçikletat, në përputhje me dispozitat e nenit 20 të Ligjit për taksa komunale (numri tariferor 9), arkëtohet nga personat juridikë të autorizuar për kryerjen e regjistrimit të automjeteve dhe paguhet në llogarinë përkatëse të pagesave në kuadër të llogarisë së thesarit. Zgjidhja ekzistuese ligjore nuk përcakton afatin brenda të cilit personat juridikë duhet ta paguajnë taksën e arkëtuar në llogarinë e komunës dhe nuk janë të detyruar t'i njoftojnë komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit, për numrin e automjeteve të regjistruara në varësi të kubikazhit dhe për shumën mujore të mjeteve të mbledhura në mënyrë individuale dhe kumulative.
- /// Taksa komunale për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, në përputhje me dispozitat e nenit 20, paragrafi 3 të Ligjit për taksa komunale (numri

tarifor 10], arkëtohet nga shoqëria tregtare kompetente për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe është e detyruar ta paguajë atë në llogarinë përkatëse të pagesave brenda llogarisë së thesarit. Zgjidhja ekzistuese ligjore nuk përcakton afatin në të cilin duhet të bëhet pagesa, as nuk përcakton detyrimin e shoqërisë tregtare që bën arkëtimin e taksës nga mbajtësit e njehsorëve për t'i njoftuar komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit për numrin e tatimpaguesve sipas kategorive (numri i njehsorëve) në përputhje me numrin tarifor, si dhe për të ardhurat e arkëtuara dhe kërkesat e paarkëtuara mbi këtë bazë.

Ligji për tatime mbi pronë

Revizioni nxjerr në pah pasigurinë në pjesën e zbatimit të nenit 39 të Ligjit për tatime mbi pronë që nga miratimi i tij në vitin 2004, në pjesën e detyrimit për harmonizimin e regjistrit të pronës së patundshme që e mbajnë komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit me regjistrin që e mban Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive, ndërsa më së voni deri më 31 dhjetor të vitit, të dhënat nga gjendja e regjistrave duhet të dorëzohen në Regjistrin Qendror dhe në Drejtorinë e të Ardhurave Publike. Për zbatimin e kësaj zgjidhjeje ligjore, nevojiten saktësime të caktuara shtesë në Ligj, si dhe lidhje softuerike e organeve kompetente.

Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale

Me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, për financimin e kompetencave të transferuara në arsim, kulturë, mbrojtjen e hershme të fëmijëve dhe mbrojtjen e të moshuarve për komunat janë futur bllok-dotacionet. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton Urdhëresë për metodologjinë për përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen e bllok-dotacioneve me propozim të ministrisë kompetente, që bazohet në formulën me shfrytëzimin e treguesve përkatës të nevojave për secilin program. Urdhëresat janë identike çdo vit dhe nuk i pasqyrojnë nevojat dhe

standardet reale, gjë që vë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve të kompetencave të transferuara dhe servisimin e rregullt të detyrimeve. Për këto arsye, është e nevojshme të ripërkufizohet mënyra dhe të përcaktohen kriteret për bllok-dotacionet për komunat me formulë të qartë, transparente, efikase dhe funksionale që do t'i përfshijë të gjitha llojet e shpenzimeve me vlera dhe madhësi reale, me qëllim që të vendoset sistemi optimal, ekonomik dhe efikas për financimin e kompetencave të transferuara të komunave.

Ligji për zjarrfikje

/// Në përputhje me nenin 49 të Ligjit për zjarrfikje, i cili i referohet financimit të aktiviteteve të Njësive Territoriale të Zjarrfikjes, Qyteti i Shkupit dhe komunat kanë mundësinë të realizojnë të ardhura shtesë nga dënimet monetare të arkëtuara për kundërvajtjet e kryera në fushën e mbrojtjes nga zjarret dhe shpërthimet, kontributet vullnetare dhe mjetet e tjera nga shoqëritë e sigurimit, fondacionet, personat juridikë dhe fizikë të dedikuara për avancimin e mbrojtjes nga zjarret dhe të ardhurat nga burimet e veta për shërbimet e ofruara. Qyteti i Shkupit dhe komunat nuk realizojnë të ardhura mbi këto baza, përveç të ardhurave nga shoqëritë e sigurimit në shumën prej 2% të premive të arkëtuara për sigurimin e mjeteve motorike dhe sigurimin e përgjegjesisë nga përdorimi i mjeteve motorike për të cilat nuk kanë dijeni për lartësinë e mjeteve që duhet të paguhen, as nuk janë të detyruar ligjërisht të jenë në gjendje të verifikojnë plotësinë dhe saktësinë e mjeteve të paguara.

/// Në përputhje me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik, zjarrfikësit profesionistë të punësuar në njësitë territoriale të zjarrfikjes i përkasin grupit II - vende pune të personave të autorizuar zyrtarë në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe zbulimit, ose nëngrupit 11 - personave të tjerë të autorizuar zyrtarë në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe zbulimit.

Neni 11-b paragrafi 8 të Ligjit për zjarrfikje përcakton tre kategori të vendeve të punës, përkatësisht: A - Zjarrfikës udhëheqës të lartë shpëtimtarë, B - Zjarrfikës udhëheqës shpëtimtarë dhe C - Zjarrfikës profesionale shpëtimtarë. Për shkak të llojit dhe natyrës së punëve që kryejnë, shumica e rrogës së zjarrfikësve profesionistë në njësitë e zjarrfikjes, në përputhje me nenin 13 të Ligjit për zjarrfikje, është për 20% më e lartë se rroga e punonjësve të tjerë me përgatitje profesionale përkatëse për vendet e punës në administratën komunale. Kjo dispozitë ligjore nuk është mjaftueshëm e saktësuar, dhe duke marrë parasysh që struktura e punonjësve në komunat është shumë e ndryshme dhe varet nga më shumë faktorë, mënyra e llogaritjes dhe pagesës së rrogave në një numër të madh komunash kontestohet nga zjarrfikësit profesionistë. Për t'i tejkaluar gjendjet e konstatuara, nevojitet zgjidhja e qartë dhe precize ligjore për të përcaktuar shumën e rrogës së zjarrfikësve profesionistë.

Ligji për menaxhim me hedhurina

- /// Neni 105 i Ligjit për menaxhim me hedhurina parashikon të drejtën e ofruesit të shërbimit për të arkëtuar çmimin për shërbimin e ofruar, i cili përfshin: shërbimin për mbledhjen, transportimin dhe përzgjedhjen e hedhurinave komunale dhe shërbimin për trajtimin e hedhurinave komunale. Lartësia e çmimit të shërbimit varet nga lartësia e tarifës së hedhurinave të përcaktuara nga Komisioni Rregullator për secilin ofrues individual të shërbimit, bazuar në Planin e Tarifave të Shërbimeve të dorëzuar për menaxhimin e hedhurinave komunale në përputhje me kushtet dhe procedurën e përcaktuar në nenin 107 të Ligjit dhe Rregulloren e Tarifave të Hedhurinave.

Ofruesi i shërbimit që bën mbledhjen dhe transportin e hedhurinave komunale është i detyruar nga shfrytëzuesi i fundit ta arkëtojë çmimin për shërbimin sipas tarifës së hedhurinave të llogaritur në përputhje me Rregulloren e Tarifave të Hedhurinave dhe të përcaktuar në vendim për përcaktimin e tarifave për shërbimet e menaxhimit të hedhurinave komunale ose vendim për tarifën rregullatore. Aktet nënligjore të mëposhtme nuk janë miratuar: Plani i Tarifave të Shërbimeve

të Menaxhimit të Hedhurinave Komunale dhe Rregullorja e Tarifave të Hedhurinave, megjithëse në përputhje me nenin 145 të ligjit, ato duhet të ishin miratuar brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e ligjit, përkatësisht më së voni deri në shtator 2023. Për shkak të akteve nënligjore të pamiratuara, nuk janë krijuar kushtet për respektim të plotë dhe konsekuent të parimit "ndotësi paguan", sipas të cilit, prodhuesi ose mbajtësi i hedhurinave është i detyruar t'i bart të gjitha shpenzimet e shkaktuara në menaxhimin e hedhurinave.

Ligji për mbrojtje shëndetësore

Ligji për mbrojtje shëndetësore dhe Ligji për evidencat në fushën e shëndetësisë nuk janë të harmonizuara në pjesën që rregullon funksionimin e sistemit të integruar informatikë shëndetësor dhe Termini Im, përkatësisht të dy ligjet rregullojnë vendosjen e të njëjtit sistem shëndetësor informatikë, por me fushëveprim të ndryshëm të funksionaliteteve dhe kompetencave të institucioneve. Kjo çon në rrezikun e interpretimit të ndryshëm të dispozitave ligjore, prandaj sinkronizimi është i nevojshëm për t'i përkufizuar ato qartë. Gjithashtu, një pjesë e akteve të nevojshme nënligjore, siç janë udhëzimet profesionale, protokollet për trajtimet mjekësore dhe certifikimi i softuerëve, nuk janë miratuar. Pra:

- /// Mungon lista e pritjes afatgjate e përcaktuar dhe e vendosur, përkatësisht ndjekja sistematike e nevojës reale të pacientëve për shërbimet me pajisjen mjekësore moderne;
- /// Nuk ka afat të përcaktuar për dhënien e rezultateve;
- /// Nuk janë përcaktuar udhëzimet profesionale për kryerjen e një pjese të shërbimeve me pajisjen mjekësore moderne;
- /// Nuk është miratuar akti nënligjor për certifikimin e softuerëve që i përdorin institucionet shëndetësore për lidhjen dhe integrimin me Termini Im.

Ligji për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë

Në përputhje me nenin 89 të Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut (APRMV) drejtohet nga Bordi Drejtues (BD), i përbërë nga nëntë anëtarë, nga radhët e profesionistëve me njohuri ose përvojë në fushën e punësimit, nga të cilët pesë përfaqësues emërohen nga Qeveria, nga dy përfaqësues emërohen nga organizata e punëdhënësve dhe organizata përfaqësuese sindikale. E theksojmë detyrimin që, në pjesën e profesionalizimit të anëtarëve të emëruar të BD-së, Ligji nuk parashikon profil dhe shkallë të arsimimit që duhet të kenë anëtarët e BD-së të emëruar nga Qeveria, Unioni i Sindikatave dhe Organizata e Punëdhënësve. Gjithashtu, nuk është bërë lidhja e pagesës së kompensimit për anëtarët e BD-së me pjesëmarrjen e tyre në punën e mbledhjeve, përkatësisht ligji nuk parashikon pjesëmarrje të detyrueshme në mbledhje. Ekziston nevoja për t'i përcaktuar dispozitat ligjore dhe nënligjore që do të përcaktojnë mënyrën e përcaktimit të lartësisë së kompensimeve dhe kushtin për pagesën e kompensimeve për anëtarët e BD-së.

Ligji për kontribute për sigurim të detyrueshëm social

Bazuar në Ligjin për kontribute për sigurim të detyrueshëm social, kontrolli, përcaktimi, arkëtimi, arkëtimi i detyrueshëm, parashkrimi dhe shlyerja e kontributeve kryhen nga Drejtoria e të Ardhurave Publike (DAP). Në përputhje me nenet 21 dhe 23 të këtij Ligji, DAP-ja dhe institucionet për sigurim të detyrueshëm social kanë për detyrë të shkëmbejnë të dhëna për tatimpaguesit për pagesën e kontributeve. Për të përmbushur këtë detyrim ligjor, DAP-ja, Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor, Fondi i Sigurimit Shëndetësor dhe Agjencia e Punësimit kanë lidhur Kontratë të ndërsjellë për evidentimin dhe ndjekjen e kërkesave. I njëjti Ligj nuk parashikon detyrim për mënyrën e gjenerimit të të dhënave dhe informacioneve të nevojshme për kërkesat nga tatimpaguesit që kanë për detyrë të llogarisin dhe paguajnë kontributet e sigurimit social të cilët nuk kanë dorëzuar llogaritje mujore për arkëtimin e integruar të kontributeve dhe tatimit personal, përkatësisht nuk kanë paraqitur lartësinë që janë

të detyruar të paguajnë në llogaritë përkatëse të pagesave të bartësit të qarkullimit pagesor, për çka ka nevojë për rregullim dhe saktësim shtesë.

Ligji për sigurim pensional dhe invalidor

Zgjidhjet ligjore nuk e rregullojnë pezullimin e marrëdhënies së punës në kushtet kur jepet pensioni i përkohshëm invalidor, për arsye se personat e siguruar, të cilëve u ndërpritet pensioni i përkohshëm, mbeten të pambrojtur në aspektin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre nga marrëdhënia e punës. Rrethanat e tilla e ndërlikojnë ndjeshëm arkëtimin e kërkesave mbi këtë bazë, veçanërisht për shkak të mekanizmave të pamjaftueshëm për arkëtim të detyrueshëm dhe zgjidhjeve ligjore joadekuate për sigurimin e pensioneve të përkohshme të paguara.

Ligji për sigurim pensional dhe invalidor (Ligji për SPI) dhe Ligji për nëpunës administrativë

Edhe pse në përputhje me dispozitat e neneve 3 dhe 4 të Ligjit për nëpunës administrativë dhe duke marrë parasysh nenin 164 të Ligjit për SPI-në, sipas të cilit punonjësit në shërbimin profesional të Fondit kanë statusin e nëpunësve administrativë, punonjësit në Fond nuk përjashtohen në nenin 4 të Ligjit për nëpunës administrativë nga rregullimi i çështjeve të caktuara që lidhen me marrëdhënien e punës me ligj të veçantë dhe marrëveshje kolektive. Pra, në nenet 164-a dhe 164-b të Ligjit për SPI-në, rrogat e punonjësve në shërbimin profesional të Fondit përcaktohen dhe përshkruhen me pika dhe kategori të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 87 të Ligjit për nëpunës administrativë.

Për shkak të kësaj, është e nevojshme të harmonizohet Ligji për nëpunës administrativë dhe Ligji për SPI-në.

Ligji për letra me vlerë

Në përputhje me nenin 182, paragrafët 3, 4 dhe 5 të Ligjit për letra me vlerë, persona të zgjedhur dhe të emëruar janë pesë komisionerë, njëri prej të cilëve është kryetari. Dy komisionerët (anëtarët) e ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë profesionale, ndërsa tre janë komisionerë (anëtarë) të jashtëm. Neni 182, paragrafi 6 të Ligjit për letra me vlerë rregullohet se lidhur me ushtrimin e të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisive që rrjedhin nga marrëdhënia e punës së kryetarit dhe komisionerëve (anëtarëve) të Komisionit zbatohet Ligji për marrëdhënie pune, pa saktësuar mënyrën e llogaritjes së rrogave të komisionerëve që e ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë profesionale. Kompensimi i tre komisionerëve (anëtarëve) të jashtëm përcaktohet me Vendim³⁴ të miratuar nga Komisioni, siç parashikohet në nenin 182, pika 5 të Ligjit për letra me vlerë. Rroga e kryetarit dhe komisionerit që është i angazhuar profesionalisht rregullohet me Vendim³⁵ të miratuar gjithashtu nga Komisioni dhe ai u referohet edhe komisionerëve, edhe të gjithë punonjësve të Komisionit.

Neni 417 i Ligjit për instrumentet financiare, i cili pritet të hyjë në fuqi në shtator 2025, gjithashtu nuk përcakton mënyrën e llogaritjes së rrogës / kompensimit të komisionerëve (anëtarëve) të Komisionit. Duke pasur parasysh se kryetari dhe anëtarët e Komisionit zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, e theksojmë nevojën për të rregulluar me ligj rrogën dhe kompensimin e kryetarit dhe komisionerëve (anëtarëve) të Komisionit për Letra me Vlerë.

Ligji për procedurë jashtëkontestimore dhe Rregullorja Gjyqësore

Është e nevojshme të harmonizohen dispozitat e nenit 307 të Ligjit për procedurë jashtëkontestimore dhe dispozitat e nenit 359 të Rregullores Gjyqësore për shkak të mosharmonizimit në lidhje me pronësinë e depozitave të pranuar pas

parashkrimit të tyre. Pra, në LPJ-në, nëse brenda dhjetë vjet nga dorëzimi i lëndës në depozitën e gjykatës nuk e tërheq lëndën e deponuar, gjykata do të përcaktojë me vendim se lënda e deponuar është bërë pronë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa Rregullorja Gjyqësore parashikon që pas parashkrimit të depozitave të aplikuara, lënda e depozitës bëhen të ardhura të individit shfrytëzues të pushtetit gjyqësor.

Ligji për shërbimin gjyqësor / Ligji për kontrollin e brendshëm financiar publik

Harmonizimi i dispozitave nga neni 10 të Ligjit për shërbimin gjyqësor dhe neni 20 të Ligjit për sistemin e kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik në pjesën e kushteve që duhet t'i përmbushë udhëheqësi i njësisë së çështjeve financiare. Me Ligjin për shërbimin gjyqësor, nëpunësit udhëheqës duhet të kenë "dhënë provimin e jurisprudencës", duke mos përfshiruar edhe udhëheqësin e sektorit / departamentit të çështjeve financiare, ndërsa me Ligjin për sistemin e kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik, ndër kushtet që duhet të përmbushen është edhe arsimimi në fushën e ekonomisë.

Ligji për shërbimet postare

Në nenin 6 të Ligjit për shërbimet postare është përkufizuar se Ministria e Transportit (ish-Ministria e Transportit dhe Lidhjeve), si organ kompetent për kryerjen e punëve në fushën e shërbimeve postare, duhet të përgatisë Strategjinë për zhvillimin e shërbimeve postare dhe ta dorëzojë atë për miratim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Ministria nuk ka përgatitur Strategjinë për zhvillimin e shërbimeve postare, për shkak të së cilës nuk është mundur përcaktimi i prioritetëve, qëllimeve dhe politikave për zhvillimin e shërbimeve postare dhe në mënyrë adekuate të drejtohen aktivitetet në nivel vjetor dhe shumëvjeçar.

³⁴ Vendimi për përcaktimin e lartësisë së kompensimit për anëtarët e jashtëm (komisionerët) e Komisionit për Letra me Vlerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 05-362/1 nga 13.07.2023.

³⁵ Vendimi për përcaktimin e vlerës dhe lartësisë së pikave për pozicionet e punës në Komisionin për Letra me Vlerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, numër 03-363/1 nga 13.07.2023 dhe numër 03-956/1 nga 22.11.2018.

Ligji për Regjistrin Qendror

Në Ligjin për Regjistrin Qendror mungojnë dispozitat për:

- /// përcaktimi i bartësit të së drejtës së pronësisë së QRMMV-së,
- /// vlera e kapitalit themelues të QRMMV-së dhe
- /// mënyra e menaxhimit të kontabilitetit në QRMMV-së.

Ligji për koncesionet dhe partneritetin publiko-privat

Në Ligjin për koncesionet dhe partneritetin publiko-privat mungojnë dispozita të sakta për:

- /// përfshirjen e detyrueshme të publikut të interesuar gjatë marrjes së vendimeve për vendosjen e PPP;
- /// përcaktimin e kompetencave të Ministrisë së Financave në lidhje me dhënien e mendimit në fazën para dhe gjatë përgatitjes së projekteve, për qëndrueshmërinë financiare dhe menaxhimin me rrezikun fiskal të projekteve;
- /// ekzistenca e një Sistemi të Vetëm Elektronik për PPP për zbatimin transparent të procedurave;
- /// mënyrën e kryerjes së aktiviteteve mbikëqyrëse në pjesën e monitorimit të realizimit të kontratave të lidhura për PPP;
- /// shqiptimi i gjobës për kundërvajtje në rast të mosdorëzimit të njoftimit të kontratës së lidhur për PPP nga ana e partnerit publik deri te ministria kompetente dhe
- /// përcaktimi i një afati ligjor për njoftim nga ana e partnerit publik në rast të procedurave të filluara, por të papërfunduara për PPP ose të ndërprerjes së kontratave për PPP.

Ligji për shitjen dhe dhënien me qira të ndërtesave afariste dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kushtet, mënyra dhe procedura për shitjen dhe dhënien me qira të ndërtesave dhe hapësirave afariste janë të rregulluara me Ligjin për shitjen dhe dhënien me qira të ndërtesave afariste dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me analizën e dispozitave ligjore gjatë revizionit konstatuam dobësi në rregullativën ligjore, dhe atë:

- /// në nenin 9 të ligjit është e përcaktuar forma dhe përmbajtja e kontratës së qirasë, por jo edhe mundësia dhe kushtet në të cilat mund të lidhet një aneks-kontratë;
- /// nuk ekzistojnë dispozita për përcaktimin e periudhës së vlefshmërisë së kontratës së qirasë dhe
- /// në nenin 7 të ligjit është përcaktuar mënyra e ankandit publik me të drejtë për uljen e çmimit të përcaktuar fillestar, i cili mund të jetë maksimumi 30% e vlerës së tregut të hapësirës afariste gjatë ankandit në raundin e parë pavarësisht se sa ofertues janë paraqitur në ankand publik. Në shpalljet e raundit të dytë, ulja e çmimit fillestar mund të jetë maksimumi deri në 30% të vlerës së tregut të hapësirës afariste nëse është paraqitur vetëm një pjesëmarrës ose më së shumti deri në 50% të vlerës së tregut të hapësirës nëse janë paraqitur dy ose më shumë pjesëmarrës në ankand. Ky mënyrim i ankandit publik krijon një mundësi ligjore për arritjen e çmimeve më të ulëta për qiranë e hapësirës afariste sesa ato të vlerësuara fillimisht, me çka humbet edhe vetë qëllimi i parimit të ankandit publik.

**RAPORTET FINANCIARE
TË ENTIT SHTETËROR
TË REVIZIONIT DHE
RAPORTI I REVIZORIT
TË PAVARUR**

07





RSM MAKEDONIJA DOOEL Skopje

Датум Струца 1900 Тинца 11, Сопје, Македонија

Телефон: 02 3203 707

Е-пошта: info@rsm.mk

www.rsm.mk

Ревизијата вклучува извршување на постапки за приобликување на ревизорски докази за изградите и објектитувањата во финансиските извештаи. Извршените постапки зависат од расудувањето на ревизорот, вклучувајќи ја и процената на ризиците со материјално големо приклучување на финансиските извештаи, без разлика дали е резултат на изградата или грешка. Кога ги прави тие процени на ризикот, ревизорот ја извршува интернага контрола релевантна за подготвувањето и објективно презентирањето на финансиските извештаи на ентитетот за да објектно ревизорски постапки коишто се соодветни во односите, но не за целта на изразување на мислење за ефикасноста на интернага контрола на ентитетот. Ревизијата исто така вклучува и оценка на соодветноста на користените сметководствени политики и на разумноста на сметководствените процени направени од страна на раководството, како и оценка на целокупното презентирање на финансиските извештаи.

— Не веруваме дека ревизорските докази коишто ги имаме прибавено се доволтни и сподобни за да обезбедат основа за нашето ревизорско мислење

Мислење

Според нашето мислење, финансиските извештаи ја презентираат објективно, од сите материјални аспекти, финансиската состојба на Државниот завод за ревизија – Сметка на основен буџет на Република Северна Македонија 020021504063710 заклучно со 31 декември 2024 година, како и неговите приходи и расходи за годината којашто завршува тогеш во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за ознамена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AMBIT | TAX | CONSULTING

Објектот на ревизија е предмет на ревизија вршена од страна на Ревизијата на Република Северна Македонија во согласност со Законот за ревизија на Република Северна Македонија, Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за ознамена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа.



RSM МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

Државен Завод за Ревизија, Трговски Котар 1, Скопје (Македонија)

T: +389 (0)2 3233 77

E: info@rsm.mk
www.rsm.mk

Извештај за други правни и регулативни барања

Во согласност со Законот за државна ревизија, Државниот завод за ревизија има обврска да изготвува годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија.

Наша одговорност во согласност со Законот за ревизија е да изразиме мислење во врска со квалитетноста на годишниот извештај за работа со годишната сметка и финансиските извештаји за истата година.

Мислење

Според наше мислење, податоците во годишниот извештај се квалитетни во однос на годишната сметка и финансиските извештаји на Државниот завод за ревизија за 2024 година.

Скопје, 27.05.2025

Овластен репортер
 Публица Емилиевска Костевска

Друштво за ревизија
RSM МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје
 Јаглица Јорданова Андојска



THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
 ALSO IN TAX | CONSULTING

Репорти вјетор пѐр ревизионет е крѣра дхе пунѐн е **ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION**. Репорти вјетор пѐр ревизионет е крѣра дхе пунѐн е **ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION**. Репорти вјетор пѐр ревизионет е крѣра дхе пунѐн е **ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION**. Репорти вјетор пѐр ревизионет е крѣра дхе пунѐн е **ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION**.

Drejtore - zëvendësuesi

Revizionet kryera dhe punën e ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION - Bilanci në PCM 002.10 (që përfshijë vitet 2023 dhe 2024)

БИЛАНС НА ПРИХОДИ И РАСХОДИ

Опис на позицијата	Образлож ание	но денари		
		Буџет 2024	Реализирано 2024	Реализирано 2023
Приходи				
Трансфери и донации	3.1.	188.599.000	178.024.401	145.204.883
Вкупно приходи		188.599.000	178.024.401	145.204.883
Расходи				
Тековни расходи	3.2.			
Попли, наемнини и надоместоци	3.2.1	151.197.000	141.407.003	116.449.165
Стпки и услуги	3.2.2	28.950.000	28.379.641	21.269.202
Разни трансфери	3.2.3	6.443.000	416.799	522.911
Вкупно тековни расходи		186.590.000	170.203.443	138.241.278
Капитални расходи	3.3.			
Капитални расходи		7.815.000	7.728.958	6.973.605
Вкупно капитални расходи		7.815.000	7.728.958	6.973.605
Вкупно расходи		188.599.000	178.024.401	145.204.883
Нето вишок на приходи - добиење по оданочување				

Скопје, 21.02.2025

*Данче Ангеловска*Рководител на сектор за
финансиски прашања
Данче Ангеловска*Миксим Ацевски*

Главен државен ревизор

Миксим Ацевски



Детален извештај за резултат
финансиски извештај на Сметката за доходи буџет на РКИМ БИТ, Осамнаесетини дигурата на 31 декември 2024

БИЛАНС НА СОСТОЈБА

		мл. денари	
Опис на позицијата	Образложение	2024	2023
Актива			
Тековни средства	4.1.		
Товарувања од купувања	4.1.1.	-	
Товарувања од вработените	4.1.2.	426.654	202.904
Аутрири вршење-ски разграничувања	4.1.3.	13.723.991	16.057.413
Залози	4.1.4.	2.264.892	1.772.491
Вкупно тековни средства		16.504.408	18.032.808
Постојани средства	4.2.		
Нематеријални средства	4.2.1.	7.268.821	8.312.459
Материјални средства	4.2.2.	445.527.431	432.251.492
Вкупно постојани средства		452.796.252	440.563.951
Долгорочни кредитни титови	4.2.3.	1.129.000	-
Вкупна актива		471.527.462	458.596.760
Акцибизирани пасива		-	-
Пасива			
Тековни обврски	4.3.		
Кредиторски обврски од грама добавувачи	4.3.1.	1.744.009	2.404.037
Кредиторски обврски од платени и други обврски од грама вработените	4.3.2.	11.979.931	11.057.040
Платени вршење-ски разграничувања	4.3.3.	485.565	232.634
Вкупно тековни обврски		14.209.505	13.764.737
Долгорочни обврски	4.4.	1.129.000	2.495.670
Измирени средства	4.5.		
Измирени капитални средства		359.375.170	367.503.294
Резервационна резерва		57.373.627	74.752.592
Вкупно измирени деловни средства		416.748.797	442.255.886
Вкупна пасива		471.527.462	458.596.760
Вонбилансна пасива		-	-

Скопје, 21.02.2025

Д. Ангелоска
 Маководител на сектор за
 финансиска администрација
 Данче Ангелоска



М. Адемов
 Главен државен ревизор
 Милослав Адемов



RSM MAKEDONIJA DООЕЛ Скопје
 Државна Група | Државна Ревизија на Република Македонија
 Улица Партизанска 11 | 5500 Скопје
 Контакт: 02/3220000 | info@rsm.mk
www.rsm.mk

ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИОТ РЕВИЗОР

До Собранието на Република Северна Македонија

Извештај за финансиските извештаи

Ние извршивме ревизија на приложните финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија - Сметка на плански буџет на Република Северна Македонија 020021504063119, а коишто го вклучуваат Билансот на приходите и расходите за годината којшто завршува на 31 декември 2024, како и билансот на состојба заклучно со таа дата, и гледанот на значајните сметководствени политики и други објаснувачки податоци.

Објективноста на декларацијата за финансиските извештаи

Ревизионското е одговорно за подготвеноста и објективноста презентирање на овие финансиски извештаи во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на токовната основа и интерната контрола којшто е релевантна за подготвувањето и објективноста презентирање на финансиските извештаи којшто се ослободени од материјална погрешно прикажување, без разлика дали е резултат на измама или грешка.

Објективноста на декларацијата

Наша одговорност е да извршиме контрола за овие финансиски извештаи врз основа на нашата ревизија. Ние ја оправдуваме нашата ревизија во согласност со стандардите за ревизија коишто се во примена во Република Северна Македонија. Тие стандарди бараат да ги почитуваме етичките барања и да ја планираме и извршиме ревизијата за да добиеме разумно уверување за тоа дали финансиските извештаи се ослободени од материјално погрешно прикажување.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AICIT | TAX | CONSULTING

© 2024 RSM Group of Companies. RSM Group of Companies is a registered trademark of RSM Group of Companies. RSM Group of Companies is a registered trademark of RSM Group of Companies. RSM Group of Companies is a registered trademark of RSM Group of Companies.



RSM MAKEDONIJA DООЕЛ Скопје
Државен Завод за Ревизија
Улица Брвова 1, 1001 Скопје, Република Македонија
Телефон: +389 2 3011 30
Е-пошта: revizija@rsm.mk
revizija.mk

Извештај за други правни и регулативни барања

Во согласnost со Законот за државна ревизија, Државниот завод за ревизија има обврска да изготви годишни извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија.

Наша одговорност во согласnost со Законот за ревизија е да изразиме Мишленје во врска со konsistentноста на Годишниот извештај за работа на Годишната сметка и финансиските извештаји за истата година.

Мишленје

Според наше мишленје, подготвените во Годишниот извештај, се konsistentни со сите во Годишната сметка и финансиските извештаји на Државниот завод за ревизија за 2024 година.

Скопје, 27.05.2025

Сопствен ревизор
Љубица Евтимовска Костаќска

Друштво за ревизија
RSM MAKEDONIJA DООЕЛ Скопје
Јасмина Јорданова Андоњска

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

ADG Tax | CONSULTING

ADG Tax | CONSULTING е меѓународна компанија со седиште во Скопје, Македонија. ADG Tax | CONSULTING е меѓународна компанија со седиште во Скопје, Македонија. ADG Tax | CONSULTING е меѓународна компанија со седиште во Скопје, Македонија.

Drangoni, Lirija et al.
 Financieri i ministrit të Shtetit në shtetësi buxhetare të Mbrojtjes dhe të Sigurimit të shtetit të Republikës së Kosovës

БИЛАНС НА ПРИХОДИ И РАСХОДИ

во денари

Опис на позицијата	Образложение	Бюџет 2024	Реализирано 2024	Реализирано 2023
Приходи	3.1.			
Трансфери и донации	3.1.1	3.000.000	401.472	374.733
Вкупно приходи		3.000.000	401.472	374.733
Расходи	3.2.			
Тековни расходи				
Стипи и услуги	3.2.1	2.500.000	-	-
Разни трансфери	3.2.1	500.000	-	-
Вкупно тековни расходи		3.000.000	-	-
Капитални расходи				
Капитални расходи	3.2.2	-	-	-
Вкупно капитални расходи		-	-	-
Вкупно расходи		3.000.000	-	-
Остварен вишок на приходи		-	401.472	374.733
Даноци, придонеси и други давачки од вишокот на приходи				
Нето вишок на приходи		-	401.472	374.733
Распоредување на вишокот на приходи				
Дел од нето вишокот на приходи за транс. во наредна година		-	401.472	374.733
Обврски за данок на добивка		-	-	-
Вкупно распоред на вишок на приходи		-	401.472	374.733

Скопје 21.02.2025

Ангеловски
 Раководител на сектор за
 Финансиски прегледи
 Данчо Ангеловски



Главен државен ревизор
 Милош Илиќ

Делегати-заменик ревиор
 Делегати-заменик ревиор на објектот-буџет на РСМ 2011-19 на територијата на Република Македонија

БИЛАНС НА СОСТОЈБА

Опис на позицијата	Образложение	во денари	
		2024	2023
Активна			
Тановни средства			
Тановни средства	4.1.		
Тановни средства	4.1.1.	401.472	374.733
Тобировања од кулуверните војскаџа	4.1.2.	8.930.068	8.900.068
Тобировања од врзбениците	4.1.3.	-	-
Активни временски разграничувања	4.1.4.	-	-
Вкупно тановни средства		9.331.540	9.304.801
Постојани средства			
Постојани средства	4.2.		
Нематеријални средства	4.2.1.	-	-
Материјални средства	4.2.2.	-	-
Вкупно постојани средства		-	-
Вкупна активна		9.331.540	9.304.801
Вонбилансна евиденција - активна		-	-
Пасива			
Тановни обврски			
Тановни обврски	4.3.		
Краткорочни обврски спрема добавувачи	4.3.1.	-	-
Тановни административни разграничувања	4.3.2.	9.331.540	9.304.801
Вкупно тановни обврски		9.331.540	9.304.801
Извори на средства			
Извори на капитални средства	4.4.		
Ревалоризациони резерви		-	-
Вкупно извори на деловни средства		-	-
Вкупна пасива		9.331.540	9.304.801
Вонбилансна евиденција - пасива		-	-

Скопје, 21.02.2025

Делегат
 Републикител на сектор за
 финансиски прапача
 Даличе Ангеловска



Главен државен ревизор
 Максим Анувски



RSM MAKEDONIJA DOOEL Скопје
 Димитар Миладиновски 100/Скопје, Република Македонија
 Т: +383 (0)2 3023 401
 Е: info@rsm.mk
www.rsm.mk

Извештај за други правни и регулативни барања

Во согласnost со Законот за државно ревизија, Државниот завод за ревизија има обврска да изготвува годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија.

Наша одговорност во согласnost со Законот за ревизија е да изразиме мислење во врска со конзистентноста на годишниот извештај за работа со годишната сметка и финансиските извештаи за истата година.

Мислење

Според наше мислење податоците во годишниот извештај се конзистентни со оние во годишната сметка и финансиските извештаи на Државниот завод за ревизија за 2024 година.

Скопје, 27.05.2025

Овластен ревизор
 Луѓица Евтимовска Костовска

Друштво за ревизија
 РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје
 Јагосла Јорданска Андријеска


THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
 AUDIT | TAX | CONSULTING

Правилни даноци за работилница
 Финансови прашања за ДОНАТОРСКА СРЕДБА 2023 СО РИНСКОТ Сопудниот период на 31 декември 2024

БИЛАНС НА СОСТОЈБА

Биланс на позицијата	Образложение	во денари	
		2024	2023
Активна			
Вкупна актива		-	-
Пасива			
Вкупна пасива		-	-

Скопје, 21.02.2025


 Раководител на сектор за
 финансиски прашања
 Данче Ангеловска


 Главен државен ревизор
 Максим Ацевски

SHKURTESAT E PËRDORURA	
/// APRMV	Agjencia për Punësim në Republikën e Maqedonisë së Veriut
/// APMT	Agjencia për promovimin dhe mbështetjen e turizmit
/// SHA	Shoqëri Aksionare
/// SHA MEPSO	Operatori i Sistemit Elektrotransmetues i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shoqëria Aksionare për Transmetim të Energjisë Elektrike dhe Menaxhimin e Sistemit Elektroenergjetik
/// SHANEHBHA	SHA për ndërtimin dhe ekonomizimin e hapësirës banesore dhe me hapësirën afariste me rëndësi për Republikën
/// SHAEHA	SHA për ekonomizimin e hapësirës afariste në pronësi shtetërore
/// SHA ESM	SHA për prodhimin e energjisë elektrike ESM
/// AMC	Audit management system
/// ASOSAI	Organizata Aziatike e Institucioneve Supreme të Revizionit
/// BPV	Bruto prodhimi vendor
/// VMRO-DPMNE	Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar Maqedonas
/// ISR	Institucioni Suprem i Revizionit
/// FVD	Fondacioni Vestminster për Demokraci
/// KRSH	Kryerevizori shtetëror
/// GREKO	Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit i këshillit të Evropës
/// PPU	Plani i përgjithshëm urbanistik
/// TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
/// ESHR	Enti Shtetëror i Revizionit
/// ESHS	Enti Shtetëror i Statistikës
/// KSHZ	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
/// KSHPK	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
/// ISHIT	Inspektorati Shtetëror për Inspektim Teknik
/// ÇF	Çerdhe për fëmijë
/// ISHP	Inspektorati Shtetëror i Arsimit
/// KSHS	Konvikti Shtetëror Studentor
/// BDI	Bashkimi Demokratik për Integrim
/// KE	Komisioni Evropian
/// NJVL	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale
/// PIB	Planifikimi i integruar i burimeve
/// SEPP	Sistemi elektronik për prokurime publike
/// SEPEO	Sistemi elektronik për paraqitje dhe evidentim të detyrimeve
/// BE	Bashkimi Evropian
/// EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Revizionit
/// ZKRSH	Zëvendës kryerevizori shtetëror

/// LPP	Ligji për prokurime publike
/// IAS	International Auditing Standard
/// IDI	Iniciativa Për Zhvillim INTOSAI
/// FZ	Fushatë Zgjedhore
/// TIK	Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit
/// INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Revizionit
/// IPA	Instrumenti për ndihmë paraaderuese
/// ISSAI	Standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit
/// TI	Teknologjia informatike
/// IFMIS	Sistemit të integruar informativ për menaxhim me financat publike
/// ISHP	institucionet shëndetësore publike
/// RPR	Raportet Përfundimtare të revizionit
/// NKP	Ndërmjarrja komunale publike
/// PPP	Partneritet publiko privat
/// NPVK	Ndërmarrje Publike për Veprimtari Komunale
/// PP	Prokurime Publike
/// PPRM	Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut
/// NP	Ndërmarrja Publike
/// NPRRSH	Ndërmarrje Publike për Rrugë Shtetërore
/// NP MOSP	Ndërmarrja publike për menaxhimin e objekteve sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut
/// ZHVP	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional
/// PVP	Përmirësim i vazhdueshëm profesional
/// INK	Institucion ndëshkues-korrektues
/// TK	Tomografi Kompjuterike
/// IEK	Institucion edukativo-korrektues
/// MPB	Ministria e Punëve të Brendshëm
/// MSHIA	Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës
/// FMN	Fondi monetar ndërkombëtar
/// MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
/// RM	Rezonanca Magnetike
/// SNK	Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit
/// MTL	Ministria e Transportit dhe Lidhjes
/// MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
/// MK	Ministria e Kulturës
/// MMJPH	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
/// MBPEU	Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujit
/// MF	Ministria e Financave
/// NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior,



/// BKRMV	Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut
/// IKD	Instituti Kombëtar Demokratik
/// NPAA	Programi nacional për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian
/// BRE	Burime të rinovueshme të energjisë
/// OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
/// KB	Kombet e Bashkuara
/// PPRMV-së	Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut
/// ISHP	Institucionet shëndetësor private
/// SPI	Sigurimi pensional-ivalidor
/// SPIMV	Sigurimi Pensional Ivalidor i Maqedonisë së Veriut
/// PP	Partit politike
/// KEM	Kombinati Energjetik i Minerave
/// RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
/// DHBGJ	Dhuna bazuar në gjini
/// KRSTRR	Këshilli Republikan për Sigurinë në Trafikun Rrugor
/// DHF	Dhuna në familje
/// LSDM	Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë
/// SÇE	Sekretariati për Çështje Evropiane
/// SIGMA	Support for Improvement in Governance and Management
/// SHPPP	Shërbimi për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta
/// DAP	Drejtoria e të Ardhurave Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut
/// DFP	Drejtoria për financa publike
/// KU	Klinika Universitare
/// KD	Këshilli Drejtues
/// DPH	Drejtoria për Punë Hidrometeorologjike
/// UN WOMEN	Trupi i Kombeve të Bashkuara për barazi gjinore dhe forcimin e gruas
/// UNDP	Programi për zhvillim të Kombeve të Bashkuara
/// FB	Facebook
/// FSSH	Fondi për sigurim shëndetësor
/// QP	Qendrat e punsimit
/// CIPFA	Instituti i Pavarur i Financave Publike dhe Kontabilitetit (Chartered institute of Public Finance and Accountancy)
/// RQRMV	Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut
/// QZHQ	Qëllimi për zhvillim të qëndrueshme
/// CAAT's	Teknikat e revizionit të ndihmuar me kompjuter
/// HRMV-Transport	Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Transport

